


BIBLIOTEKA

IRAKLI KOÇOLLARI

949.65

K 77



Arcanitet

albin

949.65

KFT

Irakli Koçollari

ARVANITET



albin 1994

ARVANITET

Red.shkencor
Art Grafik
Botues

Irakli Koçollari
Dr.Adem Mezini
Teodora Naçko
Albinform

Tiranë 1994

Albinform. Shtator 1994. a.062

Tiranë

NE VEND TE HYRJES

Di fjalë çova Djevit
Të fala! Të të thetë
Po Djevi nuk ta tha
Se nuk e lanë retë.

(Këngë popullore arvanite)

...Por, unë me gjithatë do t'u dërgoj përherë të fala duke shpresuar dhe besuar se të falat dhe malli im një ditë do të zbresë përmesreve tek ju...!

Autori

Arvanitet kjo pjesë e gjakut tonë larguar nga toka amë nëpër mugëtirat historike drejt jugut dhe e vendosur përjetësisht aty, pothuaj nëpër tërë teritoret greke, përbën padyshim një pjesë të patjetërsueshme të historisë së kombit tonë. Ata kursesi nuk mund të neglizhohen. Pa biografia e tyre, historia e Kombit tonë do të ishte e cunguar. Harresa ndaj "gjakut të shprishur" është në çdo rast një faj i rëndë ndaj memuarit arbëror-shqiptar.

Arvanitët, kjo fare e ashpër dhe krenare, e cila përllogaritet të jetë rreth 3 milion në shtetin e sotëm grek,⁽¹⁾ vazhdon të mbijetojë dhe të bëjë historinë si një pjesë vitale e këtij vendi, mes stuhive të asimiit dhe ruajtjes së origjinës. Përpara këtij emri, historia dhe kultura e të cilit bart më shumë anë të errëta se të ndriçuara, çdo studjesi i lindin pyetjet: Si u gjend tërë kjo masë e madhe e popullsisë tonë në këto vise? - Kur shkoi e u vendos aty? Në çkushte e për ç'arsye ndodhi ky emigrim? Si u priten nga vendasit emigranët? - Ç'ngjau me të në rrjedhat e shekujve? Dhe ajo që ka rëndësi të veçantë për t'u mësuar është - si valle ajo u shpëtoi rebeshëve të kohës dhe i rrezistoi asimilimit?

Popujt me kulturë të zhvilluar edhe nën pushtimet e ashpëra e të gjata ushtarake kanë mbijetuar. Edhe populli grek megjithë pushtimin e gjatë romak, mbijetoi, nuk u asimilua, nuk u latinizua. Në të kundërt thuhet që: "Greqi u pushtua ushtarakisht nga Roma, por vetë kjo e fundit, u pushtua nga Greqia kulturalisht." Brenda këtij vendi me një histori të përndritur, me një kulturë të stërlashtë, infiltrroi kjo

1. *Ethnos: I kathodhos ton Alvanon qe o robs tus sti dhiamorfosi tu eleniku kratu. F. 14 V.Rafailidhis, 1986, Maj 5*

masë e madhe shqiptarësh që megjithëse rrebeschin e shekujve çuditërisht nuk u asimilua. Në të kundër ajo jetoi dhe jeton krenare me emrin e njohur nga vendasit **arvanitas**.

Hulumtimet e deritanishme evidentojnë përmes një sërë dokumentesh se emigrimet e shqiptarëve nga trojet e tyre drejt Jugut zënë fill në shekujt e XIII-XIV dhe në raste të veçanta e të shkëputura, prania e shqiptarëve në territorët greke haset edhe në shekullin e XII.

Po, ç'përfaqësonte atdheu i këtyre emigrantëve në kohën e zbritjeve të tyre? Në ç'stad zhvillimi ekonomik ndodhej Arbëri? Cilat ishin nivelet kulturore të kësaj popullsie? Cili ishte formimi kombëtar? Ç'tipare, tradita, zakone, elemente të karakterit ishin ngjizur tek kjo popullsi? A dallohej ajo nga popujt e tjerë fqinje ballkanike dhe më gjërë?

SHQIPERIA NE SHEKUJT E XII-XVI (ARBERIA)

Pa synuar të marrim përsipër analizën terësore të gjithë kushteve në të cilat ndodhej Arbëria në këta shekuj, është me interes të ndalemi në ato çështje që ndriçojnë nivelet e formimit e ngjizjes kombëtare, tiparet dhe kushtet e tij të dallueshme në raport me popujt e tjerë, vendin që e rriti dhe e ushqeu këtë fare të ashpër e krenare, ku "si të përflakur çajnë qiellin malet e perëndishëm e të shenjtë të Shqipërisë.... majat e tyre humbasin në kaosin e kaltersive nën kurorën e dëborës dhe mjegullës. Banorët janë një rracë e ashpër dhe shumë luftarake... Malet e Toskëve në qendër, në veri malet e Gegërisë dhe në jugë shtrihen malet e Labërisë dhe ato të Camërisë.

E shtënë vend sa një grusht dhe, i mbushur me shkëmbinj, hone e burime të ftohtë... Njerëzit që banojnë në këto vende

ngajnjë shumë me tokët e tyre. janë të ashpër, veshur hollë
dhe hijerëndë”¹⁾

Duke iu referuar vendit që rriti dhe formoi këtë popull, pozicionit gjeografik, kushteve dhe natyrës së tij, mjaft personalitetet politike, ushtarake, njerëzët letrave dhe kulturës që kanë kaluar në shekuj në këto trojet duket se kanë vlerësimë të njëjta. Mjafton këtu të përmendim një tjetër nënvizim që gjendet në shënimet e udhëtimit të lord Bajroni në fillimet e shekullit të kaluar ku thekson: “Shqipëria ka më shumë bukuria natyrore se sa rajonet e Greqisë klasike...”²⁾

Dhe kuptohet që ishte ky vend, me bukuritë e tij natyrore të cilat impresionuan atë e të tjerë artistë për të krijuar kryevepra. Por në se Bajronit i vuri në lëvizje penën e tij magjike, piktorit romantik naglez Eduart Lear i mbingarkoi penelin e tij për peizazhet e njoitura kushtuar vendit tonë si “Mali i Tomorit”, etj dhe në bllokun e shënameve të tij të udhëtimit të gdhendëte këto fjalë tërë emocion: “... e kam tepër të vështirë të kthehem duke lënë pas këto pamje të mrekullueshme..”³⁾

Ndërsa akademiku anglez Henri Hollant, i cili kaloi në vendin tonë në fillimin e shekullit të kaluar i mahnitur nga natyra dhe bukuritë shënon tiparet dhe karakteristikat e banorëve të këtij vendi. Liri duke vazhduar impresionet e tij të udhëtimit në vendin tonë shton “malet me pamje të mrekullueshme, këto ngushtica dhe kalime të përkryera të një bote të mahnitshme, janë peisazhe që asnjë shpirt artisti apo piktori nuk mund ti riprodhojë. Këto mrekulli shtrihen njera pas tjetrës, çfaqen mbas pyjeve larg e larg deri në pafundësinë e asaj që kap syri. Plaja dhe krahina të ndara nga përdredhja e lumejve, fushat shtrihen nën një ngjyrë blu të ngrohtë e të qetë. Tomori qëndron në mës të tyre si një ishull blu i errët. Ai ndjek sytë e mendjes time duke më përzier

1. *Tasos Vurnas “Ali Pasa Tepelenlis”, F.6*

2. *L.Bajron Ditar e shëname, f.343*

3. *Eduard Lear in the Levant, London 1988, F.87, 71*

të tashmen me të kaluarën...

...Malet e Shqipëri janë të mahnitshëm e përrallorë...

Megjithse e ashpër dhe e vështirë edhe në këto shekuj të mesjetës e gjendur bri Europës që pulsonte drejt një Rilindjeje të madhe, edhe Arbëria lëvizte me po ato ritme sikurse edhe fqinjët e saj europjane. Ajo duke u ndodhur në udhikryqet më të rëndësishme gjeopolitike, u përfshi nga fushatat e panumurta ushtarake që zbrisnin nga Veriu drejt Jugut, nga Perëndimi në Lindje apo e kudnerta. Me tërë këto rrebeshe luftrash e kryqëzata shqipërisht e Arbërit qëndronin për të mbijetuar mbi hirin e vullkanit të luftrave. Nën Perandorinë Bizantine që përfshinte teritorët e Arbërisë prej fundit të shekullit të VI, ajo lëvizte në mënyrë aktive në jetën politike, sociale, kulturore e ushtarake, me emra e personalitete që ngjisnin shkallët deri në fronet perandorake, drejtonin shtabet e luftës dhe u bënë të njohtu për arritjet më në zë të kulturës së hinterlandit bizantin.

Që të barazmateshe, të ndesheshe dhe tek e fundit të mbijetoje në çdo fushë të rëndësishme të ejtës do të thoshte të kishe arritje, ritme e lëvizje të njëjta politike, ekonomike, ushtarake e kulturore me vendet e popujt që prindim në këto fusha.

E ndodhur në kufijtë perëndimorë të Bizantit, në fqinjësi të afërt me Europën dhe vendet mesdhetare, ajo rivalizonte denjësisht dhe mbetej edhe në këto shekuj një nga rrugëkalimet më të rëndësishme, në mos kryesorja për tregëti mes këtyre dy botëve Lindjes dhe Perëndimit. "Vija Egnatia" ishte një arter i rëndësishëm ekonomiko-tregtar për këto dy botë në përgjithësi dhe për vetë vendasit në veçanti. Karvane të tëra të ngarkuara me prodhime të gatshme të perëndimit kalonin në lindje dhe një numur i madh ngarkeshash me mallra gjysëm të gatshme apo lëndë të para shkarkoheshin në portet shqiptare për në drejtim të Perëndimit drejt portave raguzjane, napolitane, venecjane, siciliane, katalanase, etj.

Këto lëvizje të mëdha karvanesh me mallra drejt portave të bregdetit tonë, apo nga këto të fundit drejt botës së largët dhe të pasur të Lindjes, kryheshin përmes teritoreve të vendit

tonë, nën kontrollin dhe veprimin e ligjeve të rrepta. Princat vendas kishin përcaktuar pikat e kontrollit, tagrat dhe taksat doganore portuale mbi vlerat dhe sasitë e mallit etj.

Teritoret e arbërit nuk ishin vetëm zona tranzite për këto arterje të fuqishme të tregëtisë europjane e ballknaike. Drejt porteve italike, apo më gjërë europjane si Venecia, Brindizi, Bari, Napoli, siçili, në bregdetin Dalmat, në Raguze, deri në Aragone eksportoheshin produkte blektorale e bujqësore si lesh, dyllë, lëndë druri, kripë, lëkurë, mish, djath, etj. të prodhuara në Arbëri. Në një numur të madh dokumentash në arkivat venecjane raguzjane, etj evidentohen dhe ruhen fatura, akt marrveshje, kontrata me kushtet përkatëse ligjore për çmimet e këtyre mallrave, kushteve e lëvrimit të tyre. Në to gjejmë emra tregëtarësh të fuqishëm shqiptarë me zë në botën komerciale të perëndimit deri të tillë si Zore Baksa, i cili në shekullin e XIV njihet si tregëtari më i madh i raguzes.

Në arkivat venecjane (-Acta Albana-Veneta-) gjenden veç të tjera edhe mjaft transaksione tregëtare për lëvrimin e mallrave. Në këtë rast mund të përmendim vetëm faktin qe në fundin e shekullit të XVII (që padyshim nënkuption edhe shkujt pararendës) kurtregtia nëpër teritorët tona kish filluar tanimë të binte në mënyrë të theksuar në portin e Durrësit ngarkoheshin rreth 16.000-18.000 dëngje me mallra për në Venecia".

Po rreth kësaj kohe, në arkivat shtetore venedikase - "Documenti Greci" - gjendet një fond i përbërë nga 93 letra të shkruara nga tregëtarë të qyteteve Kostur, Selanik, Berat, Kavajë, Durrës, Elbasan, etj. që drejtohen Kumanos, një agjent komisioner në Venecia që më pas caktohet konsull Venedikas në Durrës.¹⁾ Në këto dokumente evidentohen deri emrat e tregtarëve si D.Theodhori, Qaro, etj nga qytetet tona. Ky arter me vlera të mëdha tregëtare e urbane ruhej përgjatë tërë shtrirjes së tij nga Durrësi deri në Selanik nga njësi të rregullta të armatosura.²⁾

1. *Vakalopoulos The history of Macedonia, F.296*
2. *Po aty f.286*

Mjaftë zgjeruar ishin shkëmbimet tregëtare mes qyteteve bregdetare të Arbërisë dhe Republikës së Raguzes. "S'ka dyshim që territoret e Arbërisë për tregëtinë Raguzjane mesjetare kanë pasur rëndësinë e tyre të veçantë dhe të posaçme... Që. këtej eksportohej mish, vaj, drithra etj. Nëpërmjet territoreve shqiptare kalonin rrugë të rëndësishme tregëtare Ulqin-Shkodër-Prizren-Serbi e Bullgari ku kishte miniera të shumta e të pasura.¹⁾

Raguzjanet kishin marrëdhënie direkte intensive me qendrat e rëndësishme për tregëtinë e kripës, siç janë Draçi, Durrësi, Valona, Skutari, etj.²⁾ Po kështu një pjesë e rëndësishme e tregëtisë së drithit zhvillohej në territoret shqiptare, sidomos në fusha e Arbërisë së mesme dhe të jugut ku derdhet Shkumbimi dhe Semani.³⁾

Për artikuj të veçantë, realizoheshin eksporte në sasi aq të mëdha sa arrinin deri të plotësonin nevojat e qyteteve apo republikave më të zhvilluar të kohës. Kështu mund të përmendim "mishin i cili shërbente përfurnizimin dhe plotësimin e nevojave të qytetit të Raguzes,... mandej tregëtarëve raguzjane u jepej leja që një pjesë e caktuar e mishit e importuar nga Shqipëria të transportohej në vendet e tjera".⁴⁾

Për vete interesin e madh që paraqeste tregëtia me vendin tonë dhe që këto lidhje tregtare të ishin të qëndrueshme venecjanet, napolitanet apo raguzjanet dërgojnë amasadore e konsuj pranë princave shqiptare në territoret e Arbërit. Kështu në mësin e shekullit të XIV nga Republika e Venecias dhe ajo e Raguzes gjemë një numur ambasadorësh të tillë nëpër princat si të Blesh de Mataranges - zot i territoreve të

-
1. *Mahnhem Irmagard "Mardh. midis Raguzhaneve dhe Shqip. në mesjetë"* F.345
 2. *Po aty*, 349
 3. *Po aty*, 350
 4. *Mahnhe, Irmagard: "Mardhën. midis Raguzj. dhe Ship. në Mesjetë* F.351

Shkumbinit dhe një tjetër pranë Topiajve.¹⁾

Po në këtë shekull, e konkretisht më 1325, Prizreni si vend me rezerva dhe burime minerare të mëdha ishte bërë një nga qendrat më të rëndësishme tregëtare-ekonomike. Rëndësi kishte dhe pozicioni i tij si pikë ndërmjetëse urbane në rrugëkalimin e rëndësishëm Tivar, Ulqin, Shkodër-Prizren drejt burimeve të Trepçes, Nish, Serbi e Bullgari. Gjatë këtyre kohëve pranë kësaj qëndre gjejmë të vendosur një konsull të përhershëm raguzjan që ndjek tërë lëvizjet tregëtare nga kjo zonë për në republikë.²⁾

Po të kësaj rëndësie paraqiten edhe Ulqini e Tivari të cilët deri në shekullin e 16 ishin krejtësisht shqiptare ndërsa Tivari edhe me ndonjë përzjerje të vogël sllave. Në këta shekuj popullsinë shqiptare e gjejmë ende të shtrirë në thellësitë veriore të brigjeve dalmate, deri në anët e Kotorit e pranë Dubrovnikut ku siç na bën të njohur dokumenti i arkivave raguzjane tëm vitit 1285 ku thuhet "dëgjova një zë që thërriste në mal në gjuhën shqipe" (audi vi unam vocem clamantem in monte in lingua albanesk,a)³⁾ Edhe në një dokument venecjan të vitit 1297 nr.527 bëhet fjalë për "një sulm të pabesë të shqiptarëve mbi raguzjanet", në thellësi të brigjeve dalmate.⁴⁾

Lidhjet midis kësaj Republike (Raguzes) dhe qyteteve e qendrave me rëndësi portuale e tregëtare shqiptare ishin të mëdha e të shumta. Fuqizimi i potencialit ekonomik të tregëtarëve vendas, për nevoja të zgjerimit të mëtejshëm të fuqisë së tyre, diktonte që mjaft prej tyre të vendoseshin në këto metropole të zhvilluara ekonomike. Kështu në shekullin e XIV-XV, në listën e rretheve "nobile" të përbërë nga 153 emra familje patricësh Raguzjane, 14% e tyre kryas emrit

1. Po aty F.352

2. Po aty F.352

3. Egerem Çabej: *Studime Gjuhësore - Rilindja, Vëll IV, f.164*

4. *Acta et diplomatica Alba-Veneta* nr.386

dhe mbiemrit të vendosur në Isitë, evidencojnë me mburrje origjinën e tyre shqiptare (arbërore) dhe jo vetëm kaq, por edhe të qyteteve nga ku ata kishin ardhur. Ndër to gjejmë "Filipo...Durazzo d'Albani, ...Dulzigni d'Albania, ...da Scutari d'Albania, ...Valona d'Albania...¹⁾

Elementin shqiptar e ndeshim dhe midis zanatçijve, artizanëve dhe mjeshtërve. Në dokumentacionin e madh e të shumtë të arkivave raguzjane gjejmë një numur të madh shqiptarësh të shtrirë në këto profesione e mjeshtëri. Një pjesë e tyre kanë marrë një emër dhe famë të madhe sidomos si argjendarë, këpuçarë, robaqepës, farkëtarë, gurgdhënës, etj. Në këto dokumente krahas emrave e mbiemrave konkrete gjendet e theksuar edhe vendardhja e tyre e cilësuar, si d'Albani - pra shqiptari. Kështu gjejmë Gjon d'Albani, Lek d'Albani...²⁾

Fuqizimi i vazhdueshëm i mjaft zejtarëve shqiptarë bëri që passardhësit e tyre të zënë vend dhe në radhët më të larta të pushtetit ekonomik dhe politik të këtyre metropoleve. Një ndër më të njojurit, rrëth fundit të shekullit të XIV më 1386, në tërë republikëm e mëtej, bëhet djali i një gurgdhëndësi nga Tivari, - shqiptar, Zare Boksa "egregius milies". Ai ishte bërë në këtë kohë njeriu i parë i Republikës raguzjane, pra njeriu më i pasur i saj.³⁾

Prania e madhe shqiptarëve në këto qendra të zhvilluara të botës ekonomiko-tregtare, kërkonte në mënyrë të natyrshme dhe institucionet përkatëse për nevojat e shërbesave shpirtrore. Syfflay na bën të njojur se në vitin 1350 në Dubrovnik ...në manastiret raguzjane kish rrëth 24 freter shqiptare, një pjesë e mirë e të cilëve ishte nga Drivasti, i cili në atë kohë ishte një peshkopatë.⁴⁾

Lidhjet e principatave të Arbërit, të tregëtarëve të saj, të

-
1. *M.Irmgard, f.357*
 2. *Po aty, faqe 374*
 3. *Po aty, faqe 372*
 4. *Po aty faqe 367*

emigranteve nga vendi ynë të vendosur këtu. me Raguzen apo me Venecian, etj. kuqtohet që nuk mund të kishin thjesht dhe vetëm karakter ekonomik. Këto lidhje i gjejmë të shtrira në mënyrë të ndryshme deri në ato martesore. Shumë dokumente citojnë aktet e kurorëzimit të martesave mes shqiptarëve dhe raguzjaneve, venecjaneve, etj dhe anasjelltas. Ajo çka tërheq vëmendjen është tendenca e raguzjaneve përt'u martuar me vajza shqiptare. Këto martesa ata i synonin në Ulqin, Tivar, Drac (Drisht), Lissus (Lezhë) deri në Prizren. Kjo gjë evidentohet që në vështrimin e parë e të përgjithshëm që mund t'i bëhet këtij dokumentacioni.¹⁾

Lind pyetja në se kërkesat e shumta për martesat në vajzat shqiptare, ishin thjesht dëshira të banorëve të këtyre vendeve; diktoheshin nga interesat ekonomike apo nga traditat e nivelet mondane të kohës, nivelet kulturore të vajzës shqiptare në veçanti e të njeriut shqiptar në përgjithësi, nga vyrtytet morale të sja, bukuria fizike, etj?

Nuk ka dyshim që vajza shqiptare i gjëzonte këto vyrtyte dhe njëherësh ajo nuk ndjehej e ndrojtur ne rrugët e këtyre qendrave të mëdha të civilizimit europjan bile dhe as në sallonet mondane mbretërore, pasi nga të tilla ambjente vinin edhe vetë ato.

Lidhje tregëtare tradicionale ruanin dhe zhvillonin edhe krahinat e jugut të Arbërisë si Valona, Durahi, Kanina, Elbasani, Himara, Preveza, etj. "Duke iu referuar disa hollësive, atyre të fushës së tregëtisë - duhet theksuar se gjiri i Artës është rrugëdlja kryesore për zonat kryesore të Shqipërisë.

...Vaji dhe duhani që eksportohet nga ata reklamohen dhe vlerësohen jashtëzakonisht për cilësinë e tyre të mirë, këto të fundit vijnë këtu nga fushat veriore të Shqipërisë.

...Mallrat e importit që vijnë e shkarkohen në Arte, këtu qëndrojnë vetëm tranzit për t'u transportuar mandej në brendësi të Shqipërisë. Këto kryesisht janë sheqer, metrazhe

1. Po aty F.367

(coha) basma, veludh, stof, armë, topa, pushkë, prodhime metali dhe lëndë të tjera".¹⁾

Qendrat e zhvilluara të Arbërisë së jugut komunikonin në këmbimet e tyre tregëtare me brigjet italike si Brindizi, Bari, me Siçilinë, me Korfuzin, etj.

Për periudhën e shekujve të XII, XIV, XV gjendet një numur i madh dëshmish arkivore të cilat bëjnë të njojur intesitetin e madh të lëvizjeve dhe shkëmbimeve tregëtare të teritoreve shqiptare me Perëndimin dhe Lindjen. Dokumentet në fjalë janë akt-marrëveshje, akte noterie, etj. në të cilat raguzjaneve, venecjaneve, fjorentinas napolitaneve, etj. u njihet e drejta të bëjnë tregëti në territoret shqiptare, konform detyrimeve fiskale dhe siguracione ku qytetarëve të huaj u garantohen pasuritë e tyre në këto territore, etj. Edhe në dokumente të tjera bizantine të po këtyre shekujve gjenden procesverbale ligjore për blerje tokash, vreshtash apo baneshash nga tregëtarë të huaj apo vendas banorëve shqiptarë.²⁾

Përtëruajtur e zhvilluar edhe më tej prodhimet bujqësore, blektoral, e artizanale, vendi nën suazën e Perandorisë Bizantine kishte legjisacionin e tij të gjerë, mes të cilit mund të përmendim atë agrar, krahas atyre kodeve morale të trashëgura, të cilët kishin fuqi ekzekutive edhe për tërë territoret e Arbërisë në tërësi. Në këtë lkgj që përmendim më sipër (atë agrar) renditen dispozitat për pronën, të drejtat e trashëgimisë së saj dhe të humbjes së kësaj të drejte, taksat mbi prodhimet bujqësore dhe ato blektorale, shitblerjen e tokave, sanksionet për rastet e dëmtimit, vjedhjes dhe shkatërimit të saj, detyrimet ndaj shtetit, kishës, etj.

Padyshim sanksionet e këtyre ligjeve janë tepër ekstreme dhe antihumane. Ato parashikojnë për raste vjedhjesh apo

1. Henri Holland: "Travel in the Yoniun Iceland, and Albania", F.77

2. Dokumente të periudhës Bizantine, vitet 1230-1300, Faqe 77-105

dëmtimesh qoftë edhe të vogla, dënimë tepër ekstreme. Duke iu referuar disa prej këtyre gjejmë: "...ai që djeg gardhin e vreshtit... t'i damkoset dora...", "...ai që ka vënë zjarr në lëmë le të digjet me zjarr", "...ai që therr një ka të gjetur... t'i priten duart" "...ai që grabit bagëtitë...të ngulet në hu..."¹⁾

Principatat e Arbërisë megjithëse nën Perandorinë e Bizantit, çfaqen në këto shekuj me pavarësinë e tyre relative dhe jo rallë me një potencial ushtarak të rëndësishëm. Nuk do të teaprohej po të thuhej se potenciali i tyre bëhej kohë pas kohe tepër shqetësues si për Perandorinë Bizantine edhe për fuqitë e tjera ushtarake më të mëdha të kohës si Venecjanet (superfuqia detare), frangët, napolitanët, katalanët, etj.

Tiparet luftarake dhe aftësitë e veçanta ushtarake të shqiptarëve në këta shekuj çfaqen dhe nënvizohen pothuaj në shënimet e çdo udhëtari, në defterët e çdo kronisti, në kronikat e ushtarake të betejave kudo ku ata gjenden në trevat e Ballkanit apo më gjérë. Këto tipare vërtet, në se nuk do ta tepronim janë më se një fenomen mbarëarbëror që ndoshta vlen të shikohet më gjérë dhe më thellë.

Duke iu referuar atyre çka parashtron Allein Ducelier në veprën "Arbanoni dhe shqiptarët në shekullin e 11" si dhe analizave të studjuesit grek Kostat Birri, gjejmë tezen se "përmendja e dy personazheve që ndoshta i përkasin familjes së famshme të Arjanitëve, vërteton praninë e shqiptarëve në hierarkinë Bizantine..." që në këtë shekull (XI)

Shqiptari i parë në këto rangje përmendet nga Skilices - Kedronosi në vitin 1001 në kohën e sundimit arab mbi Kolesirinë. Në ketë dokument shkruhet: "Perandori do të kishte hequr Niqifor Uranasin nga qeverisja e Selanikut dhe do ta zëvendësonë atë me Patricin David Arjanitasin."

Një Arjanit i dytë përmendet me 1050 në fushatën kundër Peçengeve. Po ashtu K.Biri na ben të njojur edhe një

1. Dokumente të për. bizant.për historinë e Shqipërisë. Faqe 87

ushtarak në rangjet e larta, me funksionin e komandatit në herarkinë perandorake bizantine me mbiemrin Komiskorti nga Arbanosi.¹⁾

Studjuesi i mësipërm përpinqet dhe argumenton se edhe mbiemri i këtij komandanti përbëhet nga dy fjalë shqipe dhe spjegohet vetëm me këtë gjuhë. Sipas tij Kom-i-skort, rrjedh nga Kom-kembë, dhe i skort-i shkurtër. Pra sipas tij është togfala “këmbëshkurti”.

Dokumentacioni i mugët dhe pak i gjurmuar i kësaj kohe nuk mungontë përmendë Arbërin dhe popullsinë e këtueshme dhe jo rallë e gjejmë të nënvizohet: “Albanoni si një vend i vështirë por jo i padepërtueshëm... nëpër të cilin kalonte rruga Egnatia... pranë saj është Petrela një kala e fuqishme dhe e fortifikuar mirë...” Eshtë pothuaj një mendim i pajtuar edhe tek historjanë të tjerë të njojur për këto tipare të burrave të arbërit që i cilësojnë, si njerëz që njojin në mënyrë të përkryer artin e luftës. Ana Komnenna duke iu referuar me tone miqësore Albanoit, thekson se “shqiptarët ishin rezervë e trimave për babanë tim”, i cili siç dihet ishte Perandori i Bizantit (Komneni).

Princat shqiptare të Arbërisë në shumë raste i gjejmë të evidencuar në skenat politike dhe ushtarake të kohës si subjekte të pavarur nga pushteti qendor i Koshtandinopolit. Aq shqetësues dhe potent bëhej arsenali dhe fuqi e tyre ushtarake në ato shekuj sa jo rrallë konsuj, misionarë ushtarake apo informatorë të ndryshëm njoftojnë shtabet ushtarake të vendeve të tyre në mënyrë alarmante për masat urgjente që duhet të mernin për perandalimin dhe frenimin e fuqisë në rritje te principatave të arbërvë.

Kështu më 14 Maj 1354 Senati i Republikës Venecjane, mbasi ka marrë vendim i dërgon këtë urdhër Kapitenit (komandantit) të garnizonit ushtarak të qytetit të Durrësit ku thekson: “As shqiptarët dhe as të tjerët në asnjë mënyrë nuk duhet të mbajnë anije të armatosura, mbasi ruajtja e atij gjiu

1. Kostas Biri: “Arvanites që i katagogji ton elinon” Faqe 11

(bregdeti dhe gjiri i Durrësit - shën.ynë) na takon ne... në
softë se shqiptarët gjenden në det me anije të armatosura...
ti dënoni si piratë dhe armiq të hapur..."¹⁾

Të gjendura përpëra faktit apo të imponuara nga realitetet politiko-ushtarake me potenciale të konsiderueshme të principatave të Arbërisë, fuqi të ndryshme ushtarake, më të mëdha të kohës, ndërtojnë me ta aleanca të ndryshme politike e ushtarake, u japin atyre garanci, konçensione apo i nderojnë me tituj nderi e shpërblime të vlefshme.

Më 30 korrik 1280 me anë të një urdhëri, Mbreti Karli i Parë urdhëron Kastelanin e Brindizit të lirojë nga burgu Princin Gjon Muzaka dhe ta kthejë atë në Durrës, sipas kërkesës së Bujarëve të Durrësit e Arbërisë. Padyshim nuk mund të shprehemi në mënyrë kategorike në këtë çështje, por ashtu si edhe mjaft dokumente të kësaj natyre, nënkuftojmë se kjo duhet të jetë një protestë e përgjithshme dhe kanosje unanime e bujarëve të Arbërisë e cila paralajmëronte rreziqe serjoze përvetë Karlin, duke imponuar kështu atë të lirojë Muzakën

Në një tjetër dokument të vitit 1304, Princi i Tarentinos, Filipi u siguron privilegje breznive (princërve) shqiptarë: "...Albëve, Shpatajve, Katerukeve, Biskezineve, Aranitëve, Leceneve, Turbacajve, Markove, Skurajve, Zeneviseve, Bucazeve, Logoreskeve, Matasve, etj., me kushtin që këta ti qëndrojnë besnik mbretit të Sicilisë dhe të Jerusalemit..."²⁾ Në fund të fundit kjo është një lloj aleance me kushte të caktuara kompromisi mes sicilianëve dhe princave e principatave më të dëgjuara të Arbërisë.

Në një dokument bizantin të viteve 1246-1249 komandanti i famshëm Frederik Barbarosa i drejtohet më këte letër princit shqiptar në teritorët e të cilët do të kalonin njësitë e ushtrisë së tij: "Ju lutem ... të lejosh që ata (trupat e tij ushtarake - shën.ynë) të kalojnë përmes vendit tënd gjallë... të

1. *Acta Albana - Veneta Vëll.II, nr.876*

2. *Po aty A-V, Vëll.I, nr.563*



pashqetësuar dhe të padëmtuar deri në Durrës...¹⁾

Vetëm ky fragment i kësaj korespondencë nënkupton qartë sa potencialin e madh ushtarak të princave vendas shqiptarë aq edhe atë që kjo forcë kishte ato përmasa sa duhej marrë në konsideratë deri nga strategë ushtarakë të famshëm siç është rasti i Barbarosës.

Po gjate kësaj kohe Akropoliti na bën të njohur për një betejë dhe fitore të shqiptarëve rreth kështjellës së Elbasanit mes forcave të këtyre të fundit dhe atyre të Despotit Mihal të Epirit. Vetë fisniku Nestor që ndërmori këtë fushatë, bën të njohur Akropoliti, - mezi mundi të dalë nga rrethimi dhe shkatërrimi i forcave të tij në vitin 1251.²⁾

Duke iu referuar fondeve arkivore të këtyre shekujve në to gjejmë një numur të konsiderueshëm dhe të tipizuar princiash shqiptare. Të tillë ishin: Skurajt, Muzakajt, Arianitet, Dukagjinët, Zebeviset, Progonet, Gropajt, Komnenet, Vranat, Topiajt, etj.

Për territorret e Arbërit, harku kohor i shekujve XII-XV, është nga më të ngjeshurit me lëvizje politike, ushtarake, aleanca e konfrontime. Operacionet ushtarake të katalaneve, fushata dhe ekspansioni venecjan për vendosjen e hegemonisë së tij në tërë brigjet e Adriatikut, Egjeut dhe më gjërë në Mesdhe, fuqizimi i shtetit serb te Stefan Dushanit dhe shtrirja e tij në pothuaj në tërë Ballkanin, operacionet e bullgarëve, ato të sicilianëve, frangëve, normaneve, etj. janë gjurmë e pasoja në rrjedhat historike të popullit tonë.

Por, ndoshta ajo çka është më evidentja, pse jo më e përnditura për historinë e këtyre shekujve të Arbërisë dhe të popullit tonë, në aspektin e konsolidimit të koncepteve të një shteti shqiptar, të ngjizjes së mëtejshme të psikologjisë kombëtare, është roli që luajti njëri prej princave dhe burrave të mëdhej të Arbërit të asaj kohe, - ajo e Karlit nga dera e mirnjohur e TOPIAJVE. Kjo figurë me përmasa vërtet të

1. Dok, të periudhes Bizan. Për hist e Shqip. F.81

2. M.L. Shteti i Epirit në shek.XIII, Ed.1948, Kap.III, F.34

çuditshme, na çfaqet ndër rastet e para të dokumentacionit të asaj kohe në vitin 1358 në betejën e luginës së Ahelout, ku godet me forcat e tij kështjellën e Angjelokastros, që ishte në të njëjtën kohë kryeqendër e Etolisë.

Zoti i këtij vendi Niqifor Angjelos në këtë betejë kishte për aleate serbet (të cilët në ato kohë përjetonin periudhën e artë të fuqisë së tyre) me të cilët kishte realizuar edhe lidhje familjare (kishte divorcuar gruan e tij të parë dhe ish martuar me motrën e Stefan Dushanit). Veç serbëve aleanca fuqizohej edhe nga forca turke, të cilët me trupat e tyre renditen për t'i dhënë një goditje shkatërruese pricnit shqiptar.

Por, në betejën e ashpër që u zhvillua jashtë mureve të qytetit, shqiptarët nën komandën e Karl Topisë, arrijnë një fitore befasuese duke shkatëruar totalisht forcat e Niqiforit dhe ato të aleatëve, duke lënë të vrarë në fushën e betejës edhe vetë komandantin e tyre Niqiforin.

Mbas kësaj fitoreje vërtet të bujshme, Karl Topija ja dorëzon Etolinë dhe Akarnaninë, bashkë me periferitë e Artës pricnit shqiptar Gjin Bue Spata dhe vetë kthehet në Arbëri.

Ajo çka tërheq vëmendjen tek përmasat e kësaj figure, veç të tjetra janë cilësitë e tij të rralla si strateg ushtarak, aftësitë e tij organizuese, dhe përpjekjet e tij (ndoshta të parat) të suksesshme për bashkimin e territoreve të Arbërit dhe organizimin e tij shtetror. Dhe këtë vepër të vështirë dhe tepër të madhe për atë kohë dhe për vitet që pasuan, ai jo vetëm e realizoi dhe e konsolidoi gjatë jetës së tij por edhe e trashëgoi me të birin.

Me t'u kthyer në Arbëri, Karl Topia organizon bashkëpatriotët e tij, i ngrë ata në revoltë dhe me një forcë të organizuar ai godet dhe merr Beratin. Mbas betejës së suksesshme, ai nuk ndalet, por me forcat e tij vazhdon marshimin duke iu drejtar Krujës. Mbas merr edhe këtë qendër të rëndësishme dhe tepër të fortifikuar i ndjekur nga një lavdi e bujshme, Topia me ushtrinë e tij shqiptare godet forcat serbe të Stefan Dushanit, të cilat kontrollonin dhe kishin në zotërimet e veta tërë luginën e Shkumbinit. Mbas

një beteje tepër të përgjakshme në këtë vend ai detyron forcat serbe të largohen të shkatëruara, të lënë njëherë e përgjithmonë këto territore. Ai e shpall vehten Zot të Arbërisë.¹⁾, pasi çliron dhe vë nën zotërimin e tij tërë Arbërinë qendrore.

Përpjekjet e këtij njeriu të fuqishëm për bashkimin e tërë territoreve Arbërore, fuqizimin e tyre nën një shtet të organizuar, dhe daljen e tij në skenën politike dhe atë ushtarake të kohës si një subjekt me potencial e peshë të konsiderueshëme, vazhdojnë edhe më tej.

Duke iu referuar arkivave të Senatit të Republikës Venecjane, gjemjë mes të tjerave një dokument të datës 14 Maj 1364 ku evidentohet hapur shqetësimi i këtij forumi për sulme detare të anijeve të armatosura shqiptare mbi ato Venedikase në bregdetin Adriatik, rrëth Durrësit. Duke pasur në konsideratë faktin që zotërimet rrëth Durrësit në atë kohë ishin vënë nën kontrollin e vetë Karl Topisë (mbasi qyteti dhe kështjella e këtij qyteti ishin koloni e venecjanve që prej gati dy shekujsh) i cili ushqente ambicjen e palëkundur përmarrjen edhe të kësaj baze e porti detar tepërtë rëndësishëm, për Arbërinë mendojmë se këto anije të armatošura janë vetë dora e Karl Topisë dhe shprehje e përpjekjeve të tij përkrijimin dhe fuqizimin e një flote ushtarake.

Brenda një kohe tepër të shkurtër, mbas shpalljes së tij si mbret i Arbërisë, nën aftësitë e tij tepër të veçanta e të rralla Karl Topia arrin të kthejë Arbërinë në një vend me një fuqi të ndjeshme përtë rivalizuar ushtarakisht e politikisht me fuqitë e kohës.

Për të kapërcyer ndonjë krizë të mundshme apo konfrontim me pasoja të papëlqyera, duket se Republika venecjane që ka njojur potencjalin në rritje të Karl Topisë, kërkon të gjejë rrugë efektive dhe të pranueshme përi interesat e saj. Në një vendim të datës 15 Prill 1366 Senati Venecjan e shpall Karl Topinë Mbretin e Shqipërisë - Qytetar Nderi të Republikës. Vërtet tingëllon paradoksal ky fakt, por mesa

1. P. Arvantinou, *Hronografia tis Ipiru*, Vell. V, F. 160

duket venecjanët synonin që "luanin që s'e mposhtnin dot, ta ëmbëlsonin që ky tu hapte rrugë", duke menduar se kështu kishin kapërcyer krizën.

Venecjanët dinin c'bënин.

Por edhe princi i tmerrshëm do të dinte ç'të bënte...

Ai duket që ka pranuar këtë "nder të imponuar" duke ruajtur ndërkokë në synimet e tij ëndrrën e fshehtë për t'u marrë "mique" portin e grabitur - Durrësin.

Më 1368 Karl Topia godet Durrësin dhe mbas një beteje të ashpër ai arrin të thyejë Venecjanët dhe tua heqë nga duart përfundimisht këtë port dhe kështjellë të rëndësishme të brigjeve të Adriatikut. Eshtë domethënës vetëm ky fakt - fitorja mbi superfuqinë detare - Venetikun për te kuptuar deri në c'përmasa ishte ngjitur fuqia e tij ushtarake!.

Mbas kësaj kohë Karl Topia mban të bashkuar nën kontrollin e zotërimeve të tij territorët dhe fortesa e një pjese të konsiderueshme të Arbërisë, kryesisht të asaj qendrore, - nga veriu rreth derdhjes së Bunës dhe në jug në zbritjet e Vjosës. Për më tepër ai i mban kështu të bashkuara për më shumë se 50 vjet, deri më 1387 kur ky princ dhe burrë tronditës vdes, dhe pas tij këto zotërimë i mban i biri Gjergj Topia, deri në fillimet e shekullit të XV.

Zhvillimet ekonomike e politike në kohët për të cilat flasim, pa nënveftësuar periudhat e mëparshme, shërbjen si një shtrat tepër i rëndësishëm dhe i begatë përkonsolidimin e strukturave të para të shtetit të Arbërit dhe në veçanti përfuqizimin e ndjenjës komëtare. Arbëria në këto dekada veç të tjera u afirmua edhe më tej në arenën politike, ushtarake, tregtare, si një vend që duhej vlerësuar dhe marrë në konsideratë atë. Këto lëvizje dhe ngjitje të Arbërisë lënë gjurmë në tërësi edhe në ndërgjegjen e popullit tonë, për atë kohë dhe për lëvizjet e mëpastajme në udhikryqet që do të binte historia.

Progresi në vend qe i dukshëm edhe në fusha të tjera si kulturë, art, teknikë, etj.

Nuk është e rastit aspak që shumë personalitete me zë citohen, që janë shqiptarë apo me origjinë nga Arbëria.

Në vitet 1388-1389, në Raguze çfaqet me titullin Magjistër Gjoni-piktor nga Durrësi,¹⁾ Gjon Mati-a mjek ciroik... që paguhet nga Komuna e Raguzës,...Andrea Suma Episkop, Prokuror shumë i denjë i gjithë Arbërisë,²⁾ plejade e talenteve Gazuli...etj.

Pranë tyre përmendet një ndër themeluesit e artit (pikturës) të rilindjes Europjane dhe asaj italiane Viktor Karpaçio, i bili i një tregëtar i lëkurësh nga Shkodra, Mark Bazaiti, etj.

Gjithashtu Jan Kukuzeli ishte një nga reformatorët më të mëdhej të muzikës bizantine i konsideruar "burim i dytë i saj". Përherë e më tepër gjejmë të dhëna për qenien shqiptare të tij, largimin në moshë të re nga qyteti i tij i lindjes Durrësi dhe vendosjen përfundimtare në Agjo Oros pranë manastireve të themeluar nga shqiptarë emigrantë. Ai shfaqet si novatori i parë, i cili akordononte vjetërsi dhe mënyrën më konservatore të kompozimit për një novacion melodik.³⁾

Emra të tjera mund të përmendim me dhjetra e dhjetra, e padyshim shumë do të shpalosen kur duart e studiuesve do të largojnë nga sipërfaqja e shkresave, shënimive, kornikave të kohës pluhurin e shekujve.

Ngjarjet, dhe proceset ekonomike politike, fuqizuan dhe mbrujtën tek shqiptarët mjaft aspekte të tjera të karakterit të tyre, zakone, tradita dhe në tërësi mentalitetit kombëtar.

Duke ndalur në trajtat dhe dallueshmérinë e tipareve të popullsisë arbërore mund të evidencojmë aftësitë e tyre të veçanta luftarake. Në një letër që mitropoliti Timotheos i dërgon Papës së Romës më 1572 ndër të tjera i thotë: "...shqiptarët ndoshta janë luftëtarët më të zotë në botë. janë burra të fuqishëm dhe e kërkojnë kudo qofshin fushën e luftës, duke rendur në vendet më të vështira ku varet fati i

1) *Acta Albana Veneta*

2) Radonic 437

3) *The new grove dictionary of music and musicians. London 1980. V.I, F.321*

betejës... Nën këto tipare, "duket ajo që në të gjitha kohrat populli shqiptar është destinuar të formojë rrugën e fundit të lirive greko-sllave. Eshtë ai që u rezistoi romakëve më tepër se të tjerët, i sulmuar para grekëve ai u thye më vonë se këta. Asnjëherë ia nuk u fut plotësisht nën zgjehdën e Sulltanëve... në fushat e betejës ai u bë shumë herë tmerri i Lindjes dhe i Perëndimit" ¹⁾

Duke i parë nga afër Camille Paganel, thekson "Egërsisë së këtij vendi i imponohen shqiptarët që në pjesën dërrmuese të tyre i takojnë një brumi të ashër e të çeliktë, me një fytyrë e të reshkur, me një vështrim tejçpues, luftëtarë trima dhe me instikte të tmerrshme. Bukuria e tyre trondit burrat, ndërsa eleganca shtang femrat. Kurrë guximi i tyre stërgjyshor nuk ka pësuar zhgënjjim..."²⁾

Duke iu referuar tipareve fizike të shqiptarëve, të burralve apo të grave, Pouqueville nën impresionet e tij na përcjell këto imazhe "...gratë e gegërisë janë vazhdimisht të armatosura. Kanë një vështrim krenar, ecje të ngadalshme disi të madhërishme, mburren që janë luftëtarë dhe pjesë e çetave të burrave. Të rritura dhe të edukuara në kushte të ashpra dhe të vështira e plot mundime, të mësuara vazhdimisht me rreziqe, vendosmërisht thjesht dhe pa kredenciale kërcënojnë vdekjen, mbasi dhe gjëzimet në jetën e tyre janë të panjohura. Në rrugët e gjata që ato bëjnë me brezin e ngarkuar plot armë dhe të shoqëruara përherë nga qen të tmerrshëm që lehin llahtarshëm... nuk guxon askush t'u afrohet.

Kështu, ndërsa ato i takojnë një race që i kushton pak kohë angazhimit me punët e shtëpisë, vazhdojnë të ruajnë një zakon të lashtë të rracës së tyre - atë që nuk mund të rrojnë pa armë. Po t'i shikosh në beteja, kur rrezikohet shtëpia e tyre prindërore, ngajnjë me amazonat, - zenë menjëherë pozicionin me vijën e luftës duke nxituar e u afruar

1. Cyprien Robert. *Les slaves de Turquie.* 1852, f. 189

2. M. Camille Paganel. *Historie de Scanderbeg.* 1855

drejt gjakderdhjes... Qofshin katolike apo myslimanë asnjë prej tyre nuk mban jasemin, një zili kjo e tërë grave të vendeve lindore për ta pasur veshur.

Janë të bukura, të turpëshme dhe krenare. Por kur lindin e u dhurojnë shumë fëmijë burrave të tyre, atëherë fillon të zgjohet dashuria e tyre dhe të pushtojë zemrën bashkëshortore".

Gratë e toskëve janë të thjeshta dhe të matura me një bukuri të veçantë femërore. Gratë e Myzeqesë dhe të rafshit të Tomorrit janë thesare me vlera të vërteta bukurie për kurorën e dashurisë. Me sy të mëdhej, të kaltër e të ndriçuar me flakë qiellore, me flokë gështenjë në të verdhë apo gështenjë të errëta, hundë të hollë, gojë të ëmbël dhe elegante - këto janë dhuratat që të japid gratë toske.

Me lëkundjet e tyre trupore, elegante dhe të ndjeshme, me finesën e këmbëve të tyre, çdokush mund ti marrë për perëndesha të lashtësisë, apo për nimfa, me të cilat Profeti zbuluroi parajsën ku priste miqtë e tij më të nderuar..." Të gjitha çfaqen si prototipe të përkryera të bukurisë.¹⁾

Studjuesi dhe historjani i talentuar grek Tasos Vurnas nga vëzhgimet e tij për popullin tonë na përcjelle këto konkluzione:... shqiptarët ruajnë dhe trashëgojnë brenda gjirit të tyre mardhënie dhe zakone të stërlashta të të parëve të tyre... Eshtë normë zakonore e trashëguar arma që e mbajnë përherë me vehte me të cilën ruajnë shtëpinë, njerëzit e saj dhe prodhimet... Këta njerëz kurrë nuk i kanë supernderuar gratë si pjesë e shoqërisë, siç ndodhët në sistemet (klanet) feudale, megjithëse kanë vyrtyte të shkëlqyera shpirtërore.

Me karakter të lartë, besnik në lidhjet që afrojnë njerëzit, në gjakun e përbashkët, në mqësi, në fjalën e dhënë. Nuk kishte nder më të madh për ta të bënte vëllam (ose birazel). Të vendosur për jetën dhe para vdekjes. Dhe kur të jepte fjalën e tij "besa ja besa" (e shënuar si e ka shkruar autori në

1. Pouqueville. "Voyage de la Greec", Vëll III, Faqe 213-220

origjinal dhe ashtu sikurse e përdorin edhe sot e kësaj dite grekët këtë fjalë shqipe- shën.ynë) asgjë nuk mund ta bënte të kthehej pas...”¹

Por edhe bota e brendshme shpirtërore e popullit tonë dhe ndjenjat e holla të artit të kultivuar e të trashëguar, kanë tiparet e tyre të veçanta. Ato kanë tërhequr vëmendjen e botës së qytetëruar në raporte krej të dallueshme nga ato të popujve të tjerë. “Në darkë tek qëndronim në dhomë, na tërroqi vëmendjen tingujt e një këngë që vinin në qoshen tjetër të godinës. Brenda në të gjeta një grup njerëzish të çuditshëm... disa komandantë me 12-13 luftëtarë shqiptarë... Na ftuan brenda në dhomën e tyre dhe ne u ulën në këndet pranë tyre. Një luftëtar shqiptar na qerasi me verë shqiptare të përzier me rëshirë. Mandej na sollën kafe... dy vetë prej tyre filluan të këndonin këngë popullore shqiptare të shoqëruara nga një violi, një fyell dhe një def. Këngët e tyre ishin kryesisht të natyrës së luftës. Shpesh dy zërat e veçantë zbuteshin, dhe nga dy varjante të ndryshme bashkoheshin në një linjë të vetme muzikore dhe harmonike, me tone të shkurtëta dhe të egërsuara. Fyelli ishte vërtet një mrekulli, ai çfaqeja kalimtar dhe i ashpër. Dukej që ai irregullonte pengesat në momentet e ndalimit të zërit të këngëtarit....

Më pas ata u ngritën dhe filluan një valle shqiptare shumë më ekspresive nga ç'mund të imagjinohej një e tillë tek fiset e egra të Amerikës së Veriut. Ajo u ekzekutua nga një valltar i vetëm, ndërsa defi dhe fyelli shoqëronin lëvizjet e tij. Valltari hidhte pas flokët e tij të gjata që turfullonin, mbyllte sytë e tij dhe pa ndalur për dhjetë minuta ai mori tërë pozicionet me dinamikë dhe të paimagjinueshme që mund të shohë njeriu. Shpesh herë kthente ftyrën e tij në profil, pastaj binte në gjunjë për pak sekonda, shpesh rrrotullohej fluturimthi, pastaj kryqëzonte duart me forcë rrëth kokës së tij....

Kjo valle kombëtare e tyre, siç emërhohet e njihet

1. Tasos Vurnas: “Ali Pasha Tepelenlis”, Faqe 11

“shqiptarja” shpesh ekzekutohet nga dy vetë. Padyshim nuk dua të aludoj apo këmbëngul se sa ngjan apo rrjedh kjo valle nga e famshmja “pirrote” por elementet e afërsisë së saj bëjnë të lexueshme para spektatorit thyerjet e papritura të papërmajtura e të çuditshme që i ajpin asaj një karakter të veçantë.¹⁾

Se ç'forcë shprehëse, tërheqëse dhe impresionante ka ky art i përpunuar dhe përcjellë në shekuj nga populli ynë e gjejmë edhe tek mjaft fokusime që njerëz të mëdhej të artit dhe kulturës botërore i kanë bërë atij. Rreth muajit Nëntor të vitit 1809, Bajroni kaloi nëpër Akarnani (Krahinë Greke) dhe Etoni i shoqëruar nga 50 shqiptarë. Në Lutraqi të Amvrakisë qëndroi një natë me ta, natë kjo e cila i la përshtypje tepër të forta, që ai i pëershkruan si më poshtë: “Në darkë, mbasi nishin myllur dyert e shtëpive të fshatit, vendosën të shkonim në sofrën e shtruar nga shqiptarët. Therrën një kec dhe e poqën të tërë. Ndezën katër zjarrë rreth të cilëve këta luftëtarë u ulen sipas shoqërisë që kishin. Pasi për një kohë hëngrëm dhe pimë, pjesa më e madhe e tyre u mblodh rreth zjarrit më të madh dhe në kohën që ne më të vjetrit pinim, më të rinjtë i dhanë duart njëri-tjetrit dhe filluan të hidhnin valle rreth zjarrit nën melodinë e këngës së tyre me një lloj dinamizmi dhe gjallëri të (çuditshme) mahnitëshme.

Tema e këngëve të tyre ishte sipërherë lufta e komiteve, hajdutëve. Ishte e një kënge që zgjati më se një orë. Ajo fillonte kështu:

*Kur hikëm nga Parga
Ishim gjashtëdhjetë
Dhe më pas ja kthenim me iso shoqëruesit...
Të gjithë komitët në Pargë
Të gjithë komitët në Pargë*

Dhe ndërsa e theksonin me iso këtë kthim, me gjithë fuqinë e mushkërive të tyre, vinin rreth zjarrit, mbështesnin

1. Henry Holland. “Travel in Ionian Iceland and Albania”, F.70-71

gjurin në tokë, çoheshin të rribënин rrethin dhe pastaj të gjithë përsërisnin gjestin duke rivënë gjurin në tokë dhe duke u ngritur me vërtik. Zhurma e hapave të tyre në guralecat e zallit të bregut ku ishin të ulur, mbushte pauzat e këngës me një muzikë shumë të ëmbël dhe monotone. Nata ishte e errët, por drita që përhapnin flakët e zjarreve bënte që të dalloheshin pemët, shkëmbijtë dhe liqeni. Për më tepër pamja e egër e valltarëve i jepte dekorit të natyrës përreth një pamje tronditëse dhe misterioze si një fantazmë gjysëm e fshehur brenda në hije.”¹⁾

Një tjetër artisti dhe udhëtar anglez Eduart Lear, që ka kaluar në vendin tonë i befasuar para muzikës tonë popullore shkruan: “Unë kurrë nuk kisha parë një shembull kaq pasionant të vlerësimit entuzjast të këngës. Në se kori i tyre mund të thirret këngë, mbasi vija melodike, kalonte përmes një përsëritje të ashpër të korit minor i ndarë në intervalë të një ose dy zërave karakteristike... që krijonin nuanca të reja në boshtin melodik...

Këngët e tyre për herë të fundit unë i ndoqa me shumë vëmendje duke qëndruar pranë Capo d'Opera. Çdo strofë e këngës përfundonte duke iu nënshtruar ndërthurjes në një zinxhir rrotullues të vogël të shpejtë, duke përfunduar në një kor me ison Bo,bo,bo-oooo.

Çdo strofë e mëpasme sa vinte dhe fuqizohej se strofat e mëparme. Në përfundim të strofës të fundit, kur idolgipsi që dukej si diçka jo tokësore, ndërpriste zënë e tij dhe rrëmbente kapelen nga koka duke e tundut atë në dorë në ajër, duke lënë të zbuluar kokën e tij... duke lënë në këtë mënyrë të dëgjohej vetëm cyla (fyelli) në një harmoni të çuditshme dhe me bo,bo, booooo-në në tone të ulëta, duke theksuar vetëm “bo-në” e fundit që vinte papritur si një e shtënë arme, e shoqëruar nga një britmë unanime e këngëtarëve”.²⁾

1. Lord Bajron: *The complete poetical Works*, F.274

2. Eduart Lear: “Eduart Lear in the Levant”, Trevel in Albania, Faqe 107

"Malësori apo luftëtari shqiptar, - shkruan në kujtimet e tij Henri Hollandi - fjalë këto që në fjalorin shqiptar ngjajnë njëloj si sinonime, çfaqen këtu vlerat e vërteta të karakterit dhe të paraqitjes së tyre kombëtare. Përherë me një çfaqe të mprehtë dhe të ashpër të fytyrës duket (sikur kanë gjetur një zgjidhje enkas) se kështu paraqesin lexueshëm atë që ata janë të panënshtuar brenda sllavërisë së heshtur.

Ata kanë një vështrim të çuditshëm, zhbirues kalimtar dhe krenar. Bashkë me veshjet e tyre të veçanta ata shfaqen *si figura* nga më tërheqëset dhe të skalitura, ndoshta nga më të bukurit që unë kam hasur dëri tanë. Për një sy që nuk është mësuar të bëjë dallimin e detajeve, atje ku të gjitha më parë dukeshin njëloj, - do të dallojë ndjeshëm dullamanë e sipërme e cila binte e çrregullt deri tek gjunjët nga ana e pasme, e punuar nga një copë e trashë leshi ngjyrë kafe me bordure dhe zburime të ndryshme të kuqe, - dy jelekë me pjesët e jashtme të hapur që zgjaten deri tek mesi, shpesh të punuar me veludh të lëmuar ngjyrë jeshikle. Jeleku i brendshëm lidhet në mes dhe është shumë i bukur nga punimet dhe larmia e dekoracioneve që qendisen mbi të.

Një rrip i gjërë cohe mbështjell mesin dhe në të si e bërë një qëndroj arma dhe jo rallë herë dy... Një këmishë pambuku e trashë që zbret poshtë rripit dhe bie deri pak sipër gjunjëve, ashtu sikurse edhe kilti skocez - duke mbuluar kështu getat të cilat janë prej pambuku. Tek gjunjët kanë mburoja të vogla të rrumbullakëta prej metali të punuar të cilat janë prej pambuku. Tek gjunjët kanë mburoja të vogla të rrumbullakëta prej metali të punuar të cilat mbulojnë gjunjët e lidhen me çorape e pleksura me shumë ngjyra që përfundojnë tek sandalet. Në këtë pëershkrim duhet evidencuar kapota me kapuçin e madh një nga më prezantët dhe është bukurat e veshjeve shqiptare - e punuar trashë me lesh dhije, me mëngë të hapura dhe një copë në formë trekëndëshi ngapas që shërbën për të mbuluar kokën. Ajo ka ngjyrë gri dhe jo rrallë të bardhë, duke ngjarë kështu me lëkurën e bagëtisë, e vijëzuar në shpatulla. Nuk do të guxoj të pohoj me siguri se ajo është "saguni" i lashtë, por një gjë mund ta them me siguri

se ka shumë ngjashmëri në veshjet e shqiptarëve me ato të ushtarëve antikë grekë e romakë. Duke krahasuar shenjat kryesore të veshjeve kombëtare aktuale me ato të kohëve të shkuara, vështirë të gjesh qoftë edhe një popull tjetër që t'u ngajnjë atyre (kostumeve shqiptare)...”¹⁾ (shih fig. 1)

Shekuj më pas, Puqeville i cili do të qëndronte dhe njihte nga afër Shqipërinë dhe popullsinë e krahinave të saj, tiparet e veçanta të karakterit, moralit, zakonet, etj do të shkruante: “Gegët janë më të egrit.... atlete në paraqitje, me sy të zës hündë të rregullt, me dhëmbë të vegjël por të fortë, mjekër të shkurtër, tërë forcë e shëndet... janë të nxirrë nga dhuna pastorale dhe lufta, të cilat i detyrojnë ata të jetojnë në natyrë të hapur, në ajrin e lirë.

Veshja e tyre e zakonshme janë armët me të cilat ngarkohen rëndë. Kanë mustaqe të trasha dhe gjoksin e mbushur me lesh...

Toskët janë më të qetë... sytë e tyre janë të kaltër, balli i vogël, flokët i kanë gështenjë me ngjyrë të verdhë, hunda romake pa hark. Janë me temperament të ndezur, me gjak që u vlon. Eshtë rraca më e bukur ndër tërë shqiptarët. Mbajnë qylaf në kokë dhe një tip këmishë që i varet deri mbi gjunjë.

Lebërit që banojnë në krahinën e Akrokeraunëve dhe brigjeve të egra të Adriatikut, dallohen nga karakteri i tyre i ashpër. Janë sedimenti i Shqipërisë.... dhe i takojnë një grupi të veçantë. Të pamëshirshëm, hajdutë dhe jetojnë vetëm duke plaçkitur...

Çamët dallohen para kujtdo nga flokët bjond ose gështenjë, nga gjallëria dhe lëvizjet e tyre, melankolia e syve, ndjeshmëria e lëkurës dhe do t'i vlerësonim si ndër më të bukurit... të dhënë pas tregëtie dhe të lindur për përplasje politike. Banesat e tyre të rregullta e të pastra. Fshatrat janë ngritur në rreze të pllajave romantike. Ata duke qenë përgjithësisht të armatosur bien përpara kujtdo pamjen e një

1. Eduart Lear “Travel in Albania” F. 108

jete patriarchale; të lirë dhe pa ligje, të çveshur nga taksat...

Mbas çamërvë ngrihen lebërit, vendbanimet e të cilëve fillojnë mbi territoret e lumit të Dodones dhe popullojnë Kaoninë e lartësitë Akrokeraune mes të cilave është Himara duke shkuar deri në Vlorë. Këtu përfshihet bregdeti i pellgut jonian dhe pjesë të gjirit të Vlorës... janë burra për luftë, të zgjuar e mikpritës. Janë trup vegjël jo shumë të bukur, por të palodhshëm, rrezistentë. Nuk qahet një lab nga të afërmit në se vritet apo plagoset në vjedhje bagëtish. Përgjigja që tanimë është bërë simbolike për atë që e ka kërcënuar është kjo; - koka për kokë -. Të gjithë këtë flasin dialekte të gjuhës shqipe dhe fare pak prej tyre kanë mësuar greqisht.

Mbas lebërve, fqinjë të tyre janë Toskët - një racë burrërore, luftarake, mikpritës, këmbëngulës deri në pikën ku rrezikohen me kokë. Besnike ndaj miqve. Nuk janë aq të ashpër për luftë sa çamët. Janë të dobët, por aq të fortë sa vështirë ti lëvizësh nga vendi... dialekти tyre është i njëjtë me të lebërve.¹⁾

Ndërsa Bajroni në një letër të tij, dërguar nënës nga Preveza, më 1809, mes të tjera i thotë:

“...Të gjithë shqiptarët tërësisht janë të lindurtë ndershëm dhe besnikë, janë të ashpër;...por janë ndoshta rraca më e bukur në botë për nga paraqitja. Gratë e tyre janë përherë një gjë fisnike, por burrat i përdorin si skllave, i godasin, pra me pak fjalë janë si nën zgjedhë. Ato punojnë tokën, mbjellin dhe korrin. Merren me prerjen e drurëve në pyll e deri në rregullimin e rrugëve publike. Burrat janë të gjithë luftëtarë. Lufta dhe gjahu janë të vetmet punë me të cilat merren ata.

Duke i referuar aspektit relixhioz dhe orjentimeve apo influencave tij nga një kohë në tjetërën në vendin tonë, duhet theksuar se qenia e tij nën Bizantin që prej shekullit të IV shtriu mbi këtë vend rritin ortodoks. Vetëm aty nga fillimi i shekullit të XIII gjejmë për herë të parë shtrirjen e influencës katolike në brigjet e Shqipërisë veriore, Shkodër, etj., e cila

1. Puquville "Voyage de la Grec", Vell.III, Fq. 222

në atë kohë shpall edhe ndarjen e saj nga kisha ortodokse dhe bashkimin e saj me atë katolike.

Udhëtarë apo vëzhgues të tjerë të kësaj fushe evidencojnë influencën dhe ndikimin e pakët që kanë pasur këto institucione në vendin tonë. Në observimet e tij Sulltan Jahjha duke analizuar çështjet fetare në Shqipëri, Bullgari, Greqi, etj. vë në dukje: "...shumë fshatra, veçanërisht në Shqipëri ishin pa priftërinj. Edhe vetë priftërinjtë katolikë shumë rrallë dhe me vështirësi vizitojnë këto anë..." Eshtë fjala këtu për vitet 1630.¹⁾

Me interes është gjithashtu të përmendim ceremoninë e një riti mortor, të cilin e gjejmë në një letër të vitit 1467, që Mihal Apostoli nga Konstantinopoli - i cili ka qenë i pranishëm në Shkodër në këtë kohë - i shkruan mikut të tij Gjergj Zevedeut. Ai e përshkruan kështu aktin ceremonial:

"...njeri prej tyre vdiq në orën 3.

Të vdekurin e qanë në këtë mënyrë Taulantët (shkodranët). U grumbulluan të afërmit e tij dhe mbasi e rrethuan atë filluan të qanin. Burrat qëndronin me këmbë, kurse gratë të ulura. Një pjesë e fillonin kujen, kurse pjesa tjetër e pasonin. Tamam kështu bënин kretasit e lashtë në martesat e herojeve dhe në festat e perëndive.... Mbas kësaj dy priftërij me flokë të bardha... filluan të këndoja në këngë lavdëruese për të vdekurin që ishin kulmi i këngëve që ishin kënduar më parë."²⁾

Nërsa, duke ju referuar shkarazi normave morale të shoqërisë shqiptare të asaj kohe, duhet thënë se në këtë shtrirje sheku i XII-XVI, ato tanimë ishin ngjizur apo më saktë ishin parapërgatitur për t'u mbledhur në një institucion të kodifikuar siç është kanuni i Lekë Dukagjinit. Ky Kod, nuk u çfaq fare papritur në botën moralo-juridike shqiptare. Konceptet bazë, idetë përbledhëse, objektionet morale dhe ekonomike që synonin normat si dhe sankzionet për

1. Anatoljak. "Sulltar Jahja", Faqe 156

2. Dokumente të periudhës bizantine për Hist. Shqip. Faqe 79.

çdonjérën prej tyre - si baza materiale e një ngrehine (gurët, llaçi, qeresteja, etj.) ishin grumbulluar në arkivin e moralit shqiptar gradualisht për shumë vite. Lekë Dukagjini më pas çfaqet si "akademistti", që renditi, skematizoi kartelat e dispozitave të veçanta ligjore nën një kodik të vetëm.

Ky kod kishte kishte fuqi teritorjale dhe shtrinte juridikcionin e tij në tërë trevat e Arbërisë, por kapërcimet kohore të mëvonëshme duket që në mënyrë të heshtur dhe të vazhdueshme filluan të kufizojnë mbretërinë e tij autoritare duke i lënë atij pushtete gjithmonë e më të kufizuara teritorjale e morale.

Megjithëse, episodi për të cilën do të flasim i takon një kohe relativisht të vonë, gati një shekulli e gjysëm më parë, duket se ky ligj ende gjëzonte qytetarinë në krahinat jugore të vendit. Në këtë periudhë Eduart Liri na bën të njojur:

"Duket që në krahinën dhe fshatrat e Himarës ka pasur një kod ligjesh shumë të ashpra, dhe nga vetë natyra e tyre arrrij të dalloj se vështirë që ato kanë qenë ndonjëherë të shkelura.

Ato përshembull ndëshkojnë pabesinë e gruas me insistim, me vdekje dhe presin veshët apo hundën e atyre që fyeni apo ngacmonin një grua... Udhëtarë më të hershëm se unë kanë evidentuar të tillë raste në shënimë apo kujtimet e udhëtimeve, bile edhe unë vetë pashë një njeri të tillë kokës të të cilit i mungonin veshët.

Për një rast të tillë mësova në Vuno. Gruaja në formë kategorike, pa asnjë lloj hezitimi u dënuar me vdekje, por bandilli i saj mundi të arratiset dhe qëndroi jashtë vendit për dy vjet, deri sa pas kësaj kohe u kthye dhe vazhdon të qëndrojë këtu.

- Po, - pyeta unë - si është e mundur që ai nuk u ndëshkua?!

- Sepse ai shpëtoi!

- Si është e mundur të ndodhë kështu, kur ndëshkimet për këto raste janë tepër ekstreme? Këtë njeri ju e lejuat të kthehet?!!

- Sepse ne vramë babanë e tij, në vend të tij.

- O zot! Po, çfaj kishte babai i tij?

- Asnjë faj.

- Dikush duhej vrarë... dhe kjo është një lloj paralajmërimi për prindërit ndaj fëmijëve që ata t'u kushtohen atyre për të mësuar dhe respektuar ligjet".¹⁾

Në këta shekuj lëvizjesh, përplasjesh dhe mbijetese historike, të konsolidimit përherë e më të madh të aureolës së shenjtë nationale, krahas fenomeneve të tjera, siç i gjemjë të pranishme dhe më gjërë gjeografikisht lëvizjet e popullsisë, dukurinë e fundit e gjemjë edhe në territoret e Arbërisë. Ky fenomen i dhimbshëm këtu ndodh jo me ardhje por me largime të saj, bile numerikisht ai ka përmasa të mëdha.

Vala e zbritjeve drejt jugut, me indentitetin kombëtar të zbritësve-arvanitas - drejt territoreve e vendeve të tjera (me numur të kufizuar e shumë më të vogël shkonte me emërtimet albanesi-itali., arbanesi-serb, arnaut - tur, etj.²⁾

Në pokëto kohë, në dokumentacionin zyrtar të kancelarive apo dorëshkrime të studjuesve të ndryshëm, jo rallë hasim Arbërinë apo shqiptarët nën emërtimin Maqedoni e maqedonas, bullgarë, epirotë, etj.

Studjesi grek K.Satha na bën të njojur:

"Edhe vetë Halkokondili, Skënderbeu dhe Koroneos shkruajnë shpesh Maqedonia në vend të emrit Epir dhe Arbëri, apo maqedon në vend të arbërit dhe epirotit..."

Në shumë oborre europiane ku shërbenin si luftëtarë të gardës shqiptarët njiheshin me emrin e përgjithshëm maqedone, siç i përmend shpesh edhe vetë Koroneos në poemën e tij."

Duke iu referuar kronistik të njojur bizantin Akropoliti, ky na bën të njojur se "që nga mesi i shekullit të XIII, shqiptarët në vendin e tyre, treguan tendenca për pavarësi dhe

1. E.Lear: *Edward Lear in the levant. Travel in Albania*, Susan Hyman, F.137

2. E.Çabei: *Studime gjuhësore*, Prishtinë, Vëll.III, Faqe 19

emancipim politik ndaj sunduesve bizantinë. Kjo dëshmon se ky popull i vogël filloi të fitojë dhe të ketë krahas vetëdijes kombëtare të ringjallur edhe atë politike"¹⁾

Padyshim nuk duhet kuptuar se në tërësinë e teritoreve arbërore, popullsia e saj dhe principatat lëviznin në mënyre unike dhe në harmoni. Brenda tyre kish rivalitetë, tendenca dhe synime të kundërtë politike, ekonomike, ushtarake dhe jo rallë konfrontime. Por, jo ralolë mes tyre ne gjejmë aleanca, marrveshje, aksione të përbashkëta dhe përpjekje të përhershme për pavarësi ndaj ombrelave hegemoniste të perandorive apo fuqive të mëdha ushtarake të kohës. Pikërisht në këtë periudhë të historisë mesjetare, nga trungu i trojeve shqiptare nis fenomeni i emigrimit të një mase të popullsisë vendase. Kjo hemoragji nuk ishte e vogël. Ajo preku jo vetëm shtresat e ulëta të popullsisë, bujqve, blektorëve, rajave. Së bashku me ta, bile në krye të këtij emigrimi ishin prijësit e tyre.

SHKAQET E EMIGRIMIT TE SHQIPTAREVE NE GREQI

Zbritjet masive të shqiptarëve, drejt jugut në teritorët e Greqisë kontinentale dhe asaj ishullore, vendosja e tyre aty në këta shekuj të mesjetës; është pasqyruar jo pak edhe dokumentacionin e kancelarive të Bizantit, Venedikut dhe Aragonës

Për ç'arsye ndodhen këto emigrime? Cilat ishin shkaqet politike, ushtarake apo ekonomike që i shërbyen këtij largimi të popullsisë?

Cilat ishin kushtet apo mjetet ligjore që rregullonin lëvizjet

1. I.H.Pullos: *I epiqisis ton alvanon en Korinthia*. Athina 1953

e kësaj popullsie në teritoret të administruar nga të tjera?

Ç'natyrë kishin lëvizjet e masës së shqiptarëve? Zbrisnin ata duke përdorur mjetet e dhunës për t'u ngulur në këto vendbanime të reja, apo vendosjet e tyre ishin paqësore?

Prania e tyre në vendbanimet e reja, mes popullsisë autoktone ishte faktor mxitës për progres e zhvillim cilësor të këtij vendi, apo në të kundërt luajti rol regresiv?

Këto e shumë pyetje të tjera janë shtruar vazhdimisht për këtë "farë të ashpër dhe vitale" me kontributet e veçanta në rrugët e historisë së popullit grek. Sipas përgjigjeve që janë dhënë mjaft aspekte janë keqinterpretuar, disa të tjera janë lënë qëllimi i një harresë, përmjaftet e tjera studjuan kanë punuar me pasion e devocion që të sqarohet. Pa mohuar ato arritje që janë evidentuar deri më sot, ka vend ende për shumë punë për të ndriçuar këto çështje me vlera historike e kombëtare.

Në pragun e shekujve të XII-XIII kur themelën e Perandorisë Bizantine kishin filluar të tronditeshin rëndë nga njëra anë nga sulmet e normave, serbeve, bulgare, venecjane, katalanasve etj, dhe nga grindjet e vazhdueshme e të shpeshta mes despotëve vendas nga ana tjetër, institucionet e specializuara ushtarake të perandorisë filluan të përpunojnë platformat e reja që do t'i shërbenin stabilizimit të situatës dhe do të shmangnin rreziqet dhe goditjet vdekjeprurëse që merrte ajo nga forca të jashtme.

Këto institucione të specializuara kishin dhënë mjaft prova dhe ishin projektet politiko-ushtarake të tyre që kishin ngritur dhe fuqizuar makinën ushtarake bizantine.

Por, tanimë në hartën politiko-ushtarake të Evropës ishin shfaqur fuqi të reja, të cilat jo vetëm pretendonin por kishin filluar të punonin përmjaftet e tyre për dominimin toksove dhe detar. "Venecjanët e martuar me detin", katalanasit, napolitanët e sicilianët kishin kohë që godisnin kështjellat dhe garnizonet bregdetare, porte të rëndësishëm në brigjet e Adriatikut, Jonit, Egjeut nga Bosfori në Gjiblartar. Shumë fortesa me rëndësi tanimë kishin rënë në duart e tyre dhe rrugët e fryshtuar së Bizantit azmatik sa

vinin ngushtoheshin përherë e më shumë.

Për të përballuar dhe shmangur me çdo kusht këtë rokopuje të mundshme dhe të afërtë, për të përballuar ekspansionin e fuqive të reja ushtarake si dhe tendencat separatiste të princeve të pabindur ballkanikë, këto institucionet perandorake bizantine shpejtonin dhe përgatitnin platforma të reja rigjeneruese.

Nisur nga fakti që kjo perandori e kish të pamundur të mbante dhe financonte një ushtri të fuqisjmë dhe të madhe numerikisht, shtatmadhoritë dhe specialistët përpunuan dhe realizuan për herë të parë idenë e ngritjes së vendbanimeve të reja me karakter ushtark. Këto vendbanime apo më saktë në gjyhën dhe termologjinë perandorake u thirën "stratopia".

Përherë të parë krijimin e kolonive ushtarake ("stratopia"), sipas dokumentave e ndeshin në fund të shekullit të XI dhe në fillim të shekullit të XII dhe u vu në rrugën e konsolidimit masiv nën Manuil Komnenin. Për zona të veçanta, të cilat kishin disalanca ushtarake lokale, në raport me rreziqet e mundhsme që ato mund të përballonin, specialistët imponuan çvendosjen popullsise nga vendet që kishin më pak nevojë, drejt territoreve me rëndësi strategjike. Në këtë mënyrë ata realizuan ndryshimet e raporteve demografike të zonave në varësi me interesat ushtarake që paraqisin teritoret.

Familjet që zgjidheshin dhe çoheshin në vendbanime të reja - stratopia përzgjidheshin me kriter dhe synime të qarta, që ato të gëzonin cilësi dhe tipare të veçanta, përgatitja dhe aftësi luftarake. Banorët e përzgjedhur për këto qëllime dhe me këto vyrtyte thirreshin "stratiotë", emër të cilin e trashëgon edhe sot e kësaj dite ushtari grek.

Specialiteti i stratiotit ishte në atë kohë jo vetëm mjeshtëri por edhe funksion ushtarak. Pra ky emërtim nënkuqonte edhe gradë dhe profesion. Kur flasim për nënteksin e fjalës profesion këtu kuptohej aftësia e veçantë, cilësitë dhe përgatitjet që duhej të kishte banori i zonave ushtarake si njohës i artit ushtarak, pra tek e fundit një lloj ushtaraku i karjerës. Kështu u çfaqën në perandorinë bizantine familjet ushtarake. Në këto familje bërrat kishin detyrimin të

zterrëviteshin e përgatiteshin ushtarakisht. Secili prej tyre duhej të kishte kalin e tij të luftës dhe të stërvitjes për kalorësi. Në të njëjtën kohë ai punonte për aftësimin e tij të plotë e të gjithanshëm në fushën ushtarake.

Nga radhët e këtyre njerëzve dilnin për ushtrinë e perandorisë grupe më të afta dhe me eksperiencë lufte. Kalorësia e zgjedhur që padyshim ishte arma më e rëndësishme e luftës.

Banorët e thjeshtë të vendbanimeve ushtarake mbushnin radhët e njësive të luftës, kurse zotët e këtyre vendbanimeve, pricat caktoheshin në funksione komanduese të njësive ushtarake.

Banorët që merreshin dhe vendoseshin në vendbanime ushtarake fitonin një privilegji që nuk e gjëzonte popullsisë e zakonshme kudo që të ndodhej brenda kufijve të perandorisë. Këtyre (banorëve) u jepej në pronësi tokë. Ishte ky një privilegji i veçantë për atë kohë zakonisht kur buqit e tjerë punonin argatë në tokat e feudalëve dhe merrnin shpërblime tepër minimale.

Banorët ushtarakë veç detyrimeve ushtarake, nga toka në pronësi ishin të detyruartë paguanin në arkën publike apo të pricit vendas një të dhjetën e fitimit bujqësor apo blektoral, apo një detyrim të kufizuar që për ta përbënte barrë jo të rendë në raport me argatët e thjeshtë.

Zotët e këtyre vendbanimeve, apo arhondet, gjëzonin atributet e nënpunësit të shtetit (perandorisë). Ata kishin të drejtë dhe detyrimin përpëra administratës shtetërore të mbanin përherë të gatshëm numrin e caktuar të ushtarakëve në dispozicion dhe ti vinin ata në lëvizje sa herë që ata do të kërkoheshin nga urdhërat perandorake.

Që në momentin kur jepej urdhëri apo komunikohej dekreti perandorak stratiotët apo ushtarakët e zonave ushtarake fillonin përgatitjet e nevojshme për zbatimin e urdhërit luftarak apo niseshin për në frontet e luftës, në vend dislokimin e tyre të përcaktuar kohe me pare. Pikërisht nga ky çast atij i lindte e drejta e shpërbimit, pra e marrjes së rrogës së tij të rregullt. Në këtë kuotë financiare nuk

përllogariteshin përfitimet e drejtpërdrejta që ushtaraku do të kish nga plaçka dhe pasuritë e fituata në luftë.

"Stratopia-t", vendbanimet ushtarake, siç theksuan, përcaktohesin pérherë të orjentuara nga kritere ushtarake. Zakonisht ato zgjidheshin në terrene kyç apo zona strategjike nga ku praktika historike apo ekspertët ushtarakë i vlerësonin ato si pika nevralgjike. Të tilla parashiheshin rrugë apo vendkalime ku zbrazeshin lëvizjet e detyruara të qëndrave të zhvilluara urbane; gryka të vetmuara që impononin kalime të detyruara për në zona me rëndësi ekonomike, terrene rreth kështjellave me rëndësi të veçantë ushtarake, apo limaneve me peshë të konsiderueshme ushtarako detare e tregtare.

Në mjaft nga vendbanimet ushtarake e më konkretisht pranë vendeve të ndjeshme e rëndësi të veçantë strategjike, ngriheshin edhe objekte konkrete të natyrës e karakterit luftarak që do të shërbenin në momentet oportune pikërisht për qëllime lufte. Kështu studjesi i profilizuar i këtyre objekteve, J. Janopoulos na bën të njëhur: "Vendrojet e zakonshme vendoseshin në distanca, në pikat më të rrezikshme dhe jo në pak raste ato kishin edhe vend strehime (llogore) për 30-40 luftëtarë - roje. Këto vendstrehime në gjuhën e vendasve thirreshin "Vigla". Këta luftëtarë roje nuk ishin veçse të gjithë shqiptarë të vendosur me banim në këto zona që nga koha e frankëve, të cilët ruajnë ende edhe sot traditën e tyre, por padyshim të organizuar në jetën familjare bërthama e sëcilës ka lulëzuar dhe është zgjeruar shumë.

Në kohën e pushtimit turk këto vend - kalime dhe vendbanime ushtarake janë qujtur dervenohoria - .¹⁾

Eshtë me interes të theksojmë se këto vendbanime ushtarake (stratopia) të formuara krejtësisht me banorë të ardhur nga trojet e Arbërisë, u thirrën dhe thirren edhe sot e kësaj dite në gjuhën e tyre "katun".

Me anë të këtyre reforme ushtarake, institucionet

1. Joanni Janopoulos: *I dhitiqi organosi tis Stereas Eladhas kata turkokrati os., Athine 1971, faqe 143.*

ushtarake bizantine shmangnin mbajtjen në këmbë të një ushtrie të madhe dhe ajo çka me shumë rëndësi, evitonin shpenzimet që ajo do të bënte po të konceptohej si ushtri e gatshme e gazermës.

Pikërisht kur perandorët reformatorë, filluan të veprojnë konkretisht për realizimin e ideve të tyre ushtarake tamam në këto kohë del në dritë edhe një dokumentacion konkret që mbështet idenë se shqiptarët kanë qenë të prnaishëm apo kanë filluar të ngulen në teritorët greke. Jo vetëm kaq por me sa duket këto ngulmime shqiptarësh në vendbanime ushtarake duket se kanë filluar të jasin frutin për qëllimet me të cilat u realizuan. Perandori i Bizantit Manuil Paleologu në një letër drejtuar vëllait të tij Theodhorit, Princ i Moresë, pohon si një nga sukseset më të mëdha në punët e tij vendosjen e arvanitëve në principatën e Moresë (Peloponezit) "...Me këtë ushtri - thekson ai, (shqiptarësh) që kurrë nuk ka parë disfata, në të kundërt janë dalluar si shumë të aftë dhe të suksesshëm për luftë, që nuk kanë shpenzuar asgjë veç kanë dhuruar impresione të shkëlqyera kudo... Duke ardhur me këtë ushtri (ti princ Theodori - shënim i ynë) në Peloponez, ushtri që nuk është e vogël, por në të kundërt mjaft e madhe dhe e fuqishme, shumë e zhdërvjellët dhe e aqftë, rregulluam gjithçka mundëm dhe na lipsej..."¹⁾

Një tjetër pohim qe vendosja e shqiptarëve në këto kohë u bë në mënyrë paqsore konform akteve ligjore - urdhërave perandorake, e gjejmë në dokumentin e vitit 1295 kur sevastokrati i Fanarit (Thesali) u dërgon hierkëve të tij këtë mesazh: "...nuk do të lejoj të vijnë më këtu shqiptarë veç atyre të vendosur me trashëgim trojesh në zonat rreth kështjellave (të Fanarit) apo atyre që janë stabilizuar aty mbi bazën e krisobulav dhe urdhërave perandorake..."²⁾

Pra, leximi i këtij teksti është fare i qartë dhe i dukshëm. Në këto territorë të Thesalisë ka pasur shqiptarë të vendosur

1. K.Biris: "Arvanites i doris tu neoteri elinismu" F.126

2. K.Biris: "Arvaniles" F.49

të paktën para 1295, të cilët kanë trashëguar nga të parët e tyre vendbanimet, territoret rreth kështjellave. Siç shihet ata kanë marrë të drejtën e banimit në ato vende mbi bazën ligjore të rregullt - krisobula apo urdhëra perandorake. Pohimin se këto emigrime u realizuan në këtë mënyrë dhe për këto qëllime e afirmojnë edhe studjues të tjerë të mëvonshëm të cilët kanë ndjekur nga afër këtë emigrim masiv shqiptar të këtyre shekujve. Tito Johalla në studimin e tij "Mbi emigrimin e shqiptarëve në Greqi", na bën të njojur: "...Duhet të theksojmë edhe një herë se emigrimi i shqiptarëve u bë njëherësh dhe në mënyrë paqsore, sepse dihet që një pjesë e tyre u vendos në Thesali me krisobule dhe me pëlqimin e perandorëve...

... Në Akarnani u vendosën me lejen e Zotit të Akarnanisë¹⁾... Ardhja e shqiptarëndodhi në përgjithësi në mënyrë paqsore ose me urdhër të perandorëve bizantinë dhe sundusve lokalë, por natyrisht nuk përashtohet ndonjë rast me forcë.²⁾

Në ato raste kur pjesë të territoreve greke ishin pushtuar apo ishin në kontroll të forcave të tjera ushtarake, zbritjet e elementit shqiptar në këto teritore mund të jenë bërë ose me ftesë të princave - ose si shpërblime për aleancat që ata kishin lidhur. Një rast i tillë tipik mund të përmendet ai i vitit 1394 kur Dukati i Athinës në aleancë së bashku me florentinasit synonin të zgjeroin territoret e veta dhe të sulmonin Eubenë qendrore me qendër Halqis (Halqidha) e cila ishte nën zotërimin e vehecjanëve. Duke parë rezikun serioz më 20 Prill 1402 Senati Vendikas shpall vendimin me anën e të cilil synon të shtojë numerikisht dhe të rrisë më tej aftësitë ushtarake të këtij vendi.

Në këtë dokument të cilin do ta citojmë një për një më poshtë, ftohen hapur dhe konkretisht shqiptarët të banojnë në territoret e këtij vendi duke iu premtuar trashëgimi dhe

1. T.Johalla: *Mbi emigrim e shqip. në Greqi*, F.4
2. Po aty.

pasuri bujqësore nga tokat publike, duke u përjashtuar përgjithmonë nga taksat e angaritë me kushtin që çdo familje dhe burrë shtëpie të mbajë kalin e luftës, të ushtrojë stërvitje dhe përgatitje për luftë dhe t'i përgjigjen thirrjes për luftë sa herë e lipte nevoja e mbrojtjes së vendit.

Vendimi i Senatit thekson:

"Për popullimin e ishullit tonë Evripo, (është fjala për ishullin Eube dhe zotërimet ushtarake venecjane aty) mbi bazën e vendimit të Senatit, të lejohet të vendosen dhe të pranohen aty shqiptarë dhe çdo qytetar tjetër që paraprakisht ka plotësuar kërkësë me shkrim drejtuar autoriteteve tona të Ishullit. Ato mund të bëhen banorë të vendit dhe të ndërtojnë shtëpi brenda një afati 2 vjeçar. Ai që do të vijë do të jetë i lirë, i çveshur nga çdo taksë tregtare, angari personale. Do t'i jepen secilit toka djerre, por që janë plotësisht produktive për t'u përpunuar. Çdo gjë e mësipërme do të plotësohet e rregullohet me kushtin që:

A - Shqiptarët apo çdo shtetas tjetër (rrace, nacionalitet) të mund të mbajë aq kuaj sa të jetë numri i meshkuive që ka shtëpia..

B- Të mos mundin të ikin nga ishulli pa lejen e senatit,

C - Duhet të qëndrojnë e të shkojnë si kalorës në çdo vend që do të ketë nevojë, për interesin e mbrojtjes së ishullit. Do të sulmojë e mbrojë kundër kujto që do të rrezikojë këtë vend.

D - Sasia e sipërfaqes së tokës do t'u jepet shqiptarëve apo kalorësve të tjera që do të pranonin të vinin në ishull përcaktohet sipas vendimit që do të marrë këshilli mbi vlerën që ka çdo person, aftësitë ushtarake, gradën që ai mban (titullin) dhe gjendja familjare..."¹⁾

Vendosja e emigrantëve shqiptarë në këto territore, që gjenden aq të shumtë në numur edhe sot e kësaj dite, të shtrirë në krahina të tëra në Eube, siç shihet nuk u realizua me forcë, por të ftuar nga zotët e vendit dhe në përputhje me

1. K. Satha: *Mnimia tis Eleniqis historias*", Vëll.II, Faqe 79

vendimin e senatit venedikas. Pra duke e parë me kujdes vendimin e mësipërm dalin në evidencë të njëjtat motive dhe tendenca të cilat gjendet edhe tek ftesat e perandorëve apo despotëve të tjerë me të cilat janë ftuar tek u drejtohen shqiptarët. E para - ata pranohen me synime dhe kushte ushtarake, - e dyta- atyre u jepen territorë djerre, pra toka që janë nuk punuar apo kultivuar më parë. Fakti se shqiptarët u thirrën dhe u vendosën në këto territorë për vetitë dhe aftësitë e tyre të ralla ushtarake që gjëzonin, e gjejmë të ilustruar në morrinë e ngjarjeve dhe përplasjeve ushtarake të këtyre kohëve dhe të dekadave e shekujve që pasuan. Në to elementi shqiptar - arvanitët, çfaqet kudo. Ai mplekset në aleancat e shpallura për interesa ekonomike dhe politike që impononin kohët. "Nga një dokument i vitit 1350 mësojmë se katalanet së bashku me shqiptarët sulmuan bashkarisht bazën venecjane të hyrjes së gjirit të Pagastikos. "...Katalanet menduan të përfitojnë nga prezanca e shqiptarëve të cilët njiheshin si luftëtarë dhe kalorës të mirë...".¹⁾

Në një dokument tjeter të datës 31 Prill 1381 Mbreti i Aragones Pedro - kryesundimtari, falenderon shqiptarët për ndihmën që i dhanë në mbrojtjen e kontesë së Solonës.²⁾

Cilësitë e pamohueshme ushtarake të shqiptarëve ishin *ato që nxiten* edhe katalanet të tërheqin dhe vendosin ata në *territoret që ishin* nën zotërimet e tyre për të rritur këshfu *fuginë mbrojtse ushtarake si* dhe përfaktin se territoret rrith *Athinës* dhe *ato* të *Atikës* në *përgjithësi* ishin çpopulluar *shumë* nga dyndjet dhe sulmet e navarëve. Ishte kjo arsyja që mbreti i Katalanasve në vitin 1382 të gjithë shqiptarëve dhe grekëve që dëshironin të vendoseshin në Atikë, u fali taksat për dy vjet.³⁾

Vendosjen e shqiptarëve dhe në zona të tjera të territorëve

-
1. T. Johalla "Mbi emigrimin e shqiptarëve në Greqi", Fq 5
 2. Tito Johalla: "Mbi emigrimin e shqiptarëve në Greqi". Faqe 8
 3. T. Johalla: "Mbi emigrimin e shqiptarëve në Greqi". Fq 9

greke në këta dy shekuj (13-14) e gjejmë pothuaj me të njëjtat motive që është çfaqur edhe më parë. Në se do të shtrihemi më gjërë gjeografikisht, psh në ishujt e Cikladeve, ku kolonet shqiptare ishin të shumtë dhe në disa valë zbritjesh, studjesi grek D.Paskalidis bën të njohur se edhe në këto anë shqiptarët erdhën nën nxitjen e sundimtarit të ishullit P.Andre Zeno (1384-1427), i cili kishte nevojë për ta si bujq dhe për nevojat e mbrojtjes së ishullit.

Në zonat perëndimore dhe jugore të ishullit të Peloponezit, me lejen e sundimtarit Theodhor i Parë Paleologut (1380-1407) u vendosën rreth 10 000 shqiptarë së bashku me familjet e tyre. Këta i gjejmë të ngulen kryesisht në Arkadi, Argos dhe Ilia.

Suç pamë edhe "Venecjanët i panë me sy të mirë të shpërngulurit arvanitë sepse ata do të bëheshin barjera kryesore për katalanet dhe do të përballonin sulmet e tyre".¹⁾

Më 1380 Konti i Dhimitriadhës dhe arvanitët e tij mbrojtën qytetin e Negropontit nga sulmet e navarinëve nën udhëheqjen e Majot de Kokerell dhe Pedro de Siperon, duke shpëtuar kështu jetën e shumë Thivasve dhe grekëve që kishin shkuar aty. Dhe ky shërbim që dhuruan arvanitët, kjo rracë e fuqishme në Greqi - nuk ishte as e para dhe as e fundit e tyre.²⁾

Edhe në vite e territore të tjera gjejmë përsëri masa shqiptarësh që emigrojnë të ftuar nga princa nën dekrete dhe vendime ligjore zyrtare të metropolive të ndryshme.

Më 1485 mbas shumë ndeshjesh, turqit dhe venecjanët pranojnë të nënshkruajnë marveshje me njëri-tjetrin duke renë dakort mes tyre që venecjanët t'u lënë turqve ishullin e Qefalonisë në bregdetin jonian, ndërsa turqit t'u njihnin venecjanëve nga ana e tyre zotërimin e ishullit të Zaçinthsos.

Një nga detyrat urgjente që u delte venecjanëve mbas kësaj marveshjeje ishte forcimi ushtarak i ishullit me kolone

1. W.Miller; *The Latin in the Levant*. 1908, F.247-248

2. W.Miller: *The Latin in the Levant*. 1908, F. 311

që do të pranonin të merrnin përsipër dhe kryenin këtë detyrim. Kështu, në maj të vitit 1485 Senati i Republikës Venedikase shpall këtë vendim:

"Eshtë e nevojshme të shpérndahen pasuri-prona me qëllim që të popullohet sa më shpejt ishulli i Zaqinthos, bile me sa më shumë njerëz. Të arrihet të bëhet kjo me sa më pak investime dhe në sa më pak sakrifica. Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që kjo të bëhet me çfardo lloj banori por veç me familje ushtarake që duam të vendosen atje, ashtu sikurse kemi vepruar edhe në vende të tjera... që jo vetëm të arrihet të popullohet ishulli por njëkohësisht të jetë në gjendje të rrezistojë kundër çdo lloj armiku dhe i gatshëm për çdo lloj shërbimi për nevojat që do të ketë Republika e jonë..."¹⁾

Mbasi të na vërtetojnë se do të jenë dakort me kushtet tona, atëhere do të lejohen ata të marrin toka nën zotërimin e tyre, gjithmonë me kushtin që të kenë përherë kalorës lufte të gatshëm nën komandantët e tyre... Bëjmë të njojur se në momentin që ai - banori - do të dalë nga ishulli për shërbime ushtarake apo për nevoja mbrojtjeje në vende të tjera do të furnizohet prej nesh dhe do të paguhet me tre dukata në muaj..."¹⁾

Në këtë mënyrë brenda pak vitesh erdhën në Zaqinthon rrëth 1500 familje, kryesisht shqiptarë duke bërë kështu të mundur që në vitin 1528 numri i përgjithshëm i banorëve të ishullit të arrijë në 17 255 vetë.

Një fenomen i tillë kish ndodhur me ishullin e Qefalonisë pak vite më parë, më 1504. Të orjentuar nga një vendim i tillë, analog i Senatit të Republikës, popullsia e tij arriti në 15 300 banorë.

"Këtonjësi dhe toga arvanitësh në shumë raste u reshtuan në fushat e luftimit duke ndihmuar kështu venecjanët..."²⁾

Në çdo anë të territoreve greke ku u shtri vala e emigrantëve shqitparë, askund nuk gjemë, me përjashtim të

1. M. Pietro Bembo: *Della historia Venetiana*. Libr.I, Faqe 9
2. K. Paparigopoulos: *Historia e Kombit grek*, Vëll.4 Fq 170

ndonjë rasti i cili nuk mund të përligjë tendencën e përgjithshme, vendosje dhe kolonizim të dhunshëm të tyre. Ja si shprehet historiani i mirënjohnur grek dhe një nga mësuesit e parë të Universitetit të parë të Athinës K.Paparigopoulos: "...Kjo çfaqje e valës kolonizuese të shqiptarëve drejt vendeve të Thesalisë dhe në Greqinë Perëndimore, territorë të cilat ishin të shkreta pa banorë dhe jo pjellore ku këta të huaj bënë stacionimet e para, nuk pati padyshim aspak karakter armiqësor siç kanë invazionet e huaja... Zbritja e shqiptarëve nuk u bë me shumicë dhe menjëherë, por dalngadalë dhe me valëtë herëpashershme... Ky emigrim jo vetëm nuk dëmtoi por ai qe mirberës për popullsinë vendase prandaj edhe nuk pati kundërshtime serioze prej saj:"¹⁾

Krahas natyrës dhe qëllimet të zbritjeve të shqiptarëve në këto territor, me interes është të pasqyrohet edhe harta demografike e kohës e territoreve të Greqisë mesjetare. Nga dokumentacioni i principatave dhe materialet e studjuesve dominon përherë e më shumë mendimi se "sundimi frëng dhe luftrat që këta bënë në këto periudha në Greqi, Epir dhe Peloponez kundër princave grekë, apo edhe mes këtyre të fundit me njëri-tjetrin, shkaktuan një rrallim të ndjeshëm të popullsisë në këto vende."²⁾

Po këtë fakt e mbështet edhe Fallmerajeri, i cili duhet të merret me rezerva, kur thekson se këto territor të Greqisë klasike ishin shpopulluar plotësisht nga elementi vendas. Por ka shumë të tjerë që relativisht i qëndrojnë kësaj ideje. Në 1348 kur serbët e Stefan Dushanit pushtuan Shqipërinë, Epirin dhe Thesalinë, popullsia greke u prek rëndë nga kjo. Siç duket serbët shpërndalën një numër të madh grekësh.³⁾

Duke i rikthyer vendimit të senatit venedikas përvendosjen e shqiptarëve në Eube edhe aty nënvizohet vendosja e kolonëve shqiptarë në territorë të shkreta dhe të pabanuara...

1. Po aty Faqe 171

2. Tito Hohalla; Mbi emigrimin e shqiptarëve në Greqi, Fq 3

Mungesën e theksuar të elementit vendas apo rrallimin maksimal të popullsisë greke në territoret e saj në këta shekuj e pranojnë shumë studjues duke argumentuar se "antagonizmat e shumta që u çfaqën në vendin e tyre nga dyndjet e huaja si dhe nga turbullimi i përgjithshëm politik dhe luftrat e vazhdueshme ishte dobësuar shumë elementi vendas".¹⁾

Tendenca paqsore e zbritjeve dhe fakti që shqiptarët e ardhur u vendosën veç të tjerave në territore e zona të papolluara nga vendas, çfaqet direkt apo indirekt edhe në mjaft materiale të tjera të lëna nga princa vendas dhe funksionarë perandorakë. Në një fjalë përkujtimore mortore, që perandori bizantin Manuil i II Paleologu, mbajti mbi varrin e vëllait të tij Theodhorit, ndoshta kur vajti dhe qëndroi pak në Peloponez - fjalë kjo qe është shkruar si epitaf - ndër të tjera thuhet: "Të ardhurit (arvanitët) ngrenë vendbanime në terene të pabanuara duke sheshuar e pastruar pyje dhe tërë vendin. Deri shumë vende të egra që nuk vlenin për asgjë dhe as për kusarë, ata i zbutën duke e mbjellë mebimë të ndryshme, mbasi duart e tyre dinin të punonin tokën..."²⁾

Po ky perandor në këtë material na bën të njojur se ç'përmasa kishte vala e emigrantëve shqiptarë që u vendos në këto territore të Peloponezit. Eshtë fjalë për 10 000 emigrantë të shpërndarur së bashku me gra, fëmijë, bagëti, orendi "...ata zunë ngushticën, ngulën hunjtë dhe me cohat e tyre të trasha ngriten çadrat... mandej ftuan edhe të tjerë të cilët arritën befas..." (është fjalë për vitin 1394)³⁾

Nga dëshmi të tjera historike gjejmë shpërndarje edhe më parë apo më pas këtyre viteve, në përmasa më të mëdha nga ato që përmenden më sipër - në Thesali, në Etolo-Akarnani, Atike, Qiklade, Eube, etj., bile së bashku me

1. S. Llambru: *Toponimia e Atikës dhe e vendeve të banuara nga shqiptarë*, f.29

2. Manueli i II, faqe 40

3. Manueli i II, Faqe 40

prijësit dhe nën udhëheqjen e tyre.

Ajo çka vlen të përmendet në tërë këto zbritje dhe ngulje të shqiptarëve në territoret greke mbi bazen e dekreteve perandorake, të ftuar nga princat vendas apo ata venecjanë, napolitanë, katalane, fjorentinas, etj., nën ftesa për aleanca ushtarake, askund nuk del që britjet e tyre të kenë pasur qëllime apo karakter invazioni ushtarak. Përherë ato çfaqen si emigrime dhe vendosje në zona të pabanuara apo pranë tyre. Ata marrin në zotërim territore djerre dhe i kthejnë në zona pjellore dhe të begata, ngrënë vendbanime, lartësojnë ngrehina dhe bëhen dominues dhe zotërues të vendit.

Ka raste të vendosjes së kësaj popullsie dhe në zona të populluara por me një densitet demokrafik shumë të rrallë apo gati të braktisur nga vendosit. Padyshim nuk përashtohet edhe ndonjë incident, përplasje apo revoltë e popullsise vendase ndaj të ardhurve - arvanitëve. Shkaku i ndonjë konfrontimi i tillë është i natyrshëm dhe i mundshëm mbasi zbritjet ishin të përmasave të mëdha diku 10 000 vetë, gjetkë 12-14 apo 16 000 vetë..

Në se do t'i referohemi studjuesit grek Paparigopoulos, i cili pohon se: "...Vala kolonizuese e shqiptarëve... nuk pati karakter armiqësor apo të një invazioni të zakonshëm të huaj me shumicë, sepse shqiptarët nuk kishin krijuar në vendin e tyre mjaft pushtet politik, mbasi atëhere kishte filluar të njallej vetëdija e tyre kombëtare."¹

- Vërejmë se kjo tezë pjesërisht është e saktë.

Nga dokumentet del se së pari - shqiptarët duke qenë të organizuar në njësi të armatosura dhe të fuqishme, nën drejtimin e prijsave të tyre, të cilët dallohen për cilësitet e tyre të rralla luftarake, mund të zbrisnin si invadore dhe mund të realizonin me dhunë nënshtimin e këtyre vendeve të ralluar demografikisht. Për aftësitë dhe potencialin ushtarak ata e patën treguar edhe herë të tjera vehten.

Së dyti - në se vërtet ata zbrisnin pa identitet kombëtar

1. *Historia e kombit greke. K.Paparigopoulos, vëll.4*

apo ngjizje të tipareve të tyre, të paktën ata duhej të ishin shuar apo asimiluar shumë shpejt. Eshtë e tepërt të thuhet por do të nënvironim vetëm faktin që kudo ku këta kolonë çfaqen në shtegëtimet e deri në vendosjet e tyre, ata përherë i gjemjë të ngulur në bashkësi unike të mëdha, në zona apo krahina të tëra pranë e pranë njëri-tjetrit, me individualitetin e tyre evident-aranit, albanesi, etj.

Së treti - ngjizja e tipareve të tyre nationale ishte e asaj shkalle, sa edhe sot e kësaj dite kjo popullsi, mbas pesë-gjashtë-shtatë e tetë shekujsh ruan identitetin e saj nacional, të atdheut nga zbriste, Arbanonit, Arbërisë, dhe vetthiret e njihet nga ato kohë **arvanite**. Në se do të bënim krahasime me shpërngulje të shumta që ndodhnin në atë kohë në Ballkan e më gjërë në Euro;ë, emigrantët e këtyre kohëve askund nuk mundën ti shpëtojnë valës asimiluese dhe askund nuk i gjemjë ata me identitetin e vendeve nga erdhën, siç ndodhi me kolonet e Arbërisë në Greqi.

Së katerti - pretendimi se shqiptarët nuk mund të vinin si pushtues apo ivadorë sepse ende nuk kishin formuar tiparet e tyre kombëtare, gjykojmë që nuk është plotësisht i bazuar sepse në këta shekuj gjemjë jo pak invazione edhe nga princer apo popuj që ende nuk dinin nga vinin apo cila ishte përkatësia e tyre e origjinës. Ish koha kur organizoheshin fushata ushtarake dhe pushtime thjesht për plaçkitje, pasuri.

Ndërsa arvanitet në zhvillimet dhe tragjeditë historike të shekujve, fati i çoi edhe në territorë të tjera edhe më të largëta, megjithatë ata ruajtën dhe ruajnë identitetin e tyre.

Natyrisht nuk duhet pranuar se i vetmi shkak dhe motiv i zbritjes së shqiptarëve drejt jugut ishin aftësitë e tyre të veçanta luftarake. Në ato pak studime që janë realizuar përkëtëçeshtje, vëmendja përgjithësisht apo më saktë kryesisht është përqëndruar në qëmtimin e materialit që lidhet me faktin se si u priten arvanitet në Greqi, cili mekanizëm ligjor rregulloi vendosjen mes tyre, çtipare të tyre u shfrytëzuan ngå vendasit?, etj. - Ndërsa ende deri sot nuk gjemjë faktorët e brendshëm që nxiten, joshen apo imponuan largimin e gjakut tonë nga atdheu i stërgjyshërvë.

Kjo ka qenë dhe mbetet një çështje dhe ndërmarrje ende e vëhstirë për faktin se edhe sfondi historik i këtyre periudhave, i zhvillimeve të brendshme në vendin tonë është pak i ndriçuar. Megjithatë nga ato çka mundësojnë rrëthanat sot, deduktohet se densiteti i fushatave të ashpra ushtarake, betejave të përgjakshme që zbriten nga tërë horizontet gjeografike mbi territoret e Arbërisë ishin tepër të rënda dhe me pasoja.

Në kufijtë e dy perandorive, por edhe të dy botëve njëkohësisht Lindjes dhe Perëndimit, - të dy tregjeve ekonomike me disbalanca që thellohen, - në kufirin e ndarjes së dy botëve Evropës që rilindte drejt një shoqërie të re, rendit të ri ekonomiko-shoqëror kapitalizmit dhe nga ana tjetër "anatolisë"lindjes, që thellohej nën një humbëtirë, përgjumje osmane shekullore, Arbëria binte fatkeqësisht në rokopujen e Sizifit që për dekada e shekuj do të përpinqej të ngjitej lartësive të kohës dhe përherë do të mbetej pas. Pikërisht këto shkaqe do të rëndonin dhe trondisnin thellë deri ndjenjat e shenja që lidhin njeriun me dheun e stërlashtë të të parëve të tij dhe të detyronin atë kështu të braktiste atë nën një tragjizëm të pakthyeshëm.

Shkatërrimet ushtarake, të vazhdueshme imponuan largimet e dhimbshme apo favorizuan një largim periodik të popullsisë sikundër e gjemjë këtë edhe në periudhën e mbasvdekjes së heroit kombëtar - Skënderbeut, dhe fushatave e genocidit barbar osman. Padyshim nuk përashtojmë këtu ndonjë rast emigrimi të detyruar edhe nga fatkeqësi natyrore, tërmete, etj. por këto nuk përbëjnë kursesi shkakun e emigrimeve për të cilat flasim.

Duke trajtuar çështjen e emigrimit të popullsisë shqiptare, gjykojmë se duhen marrë në konsideratë veç të tjerave edhe faktorët kohorë.

Ky element - koha e largimeve - është i nevojshëm të kihet mirë në konsideratë, pasi shkaqet e largimit të popullsisë nga vendbanimet e saj drejt territoreve të Greqisë nuk kanë qenë të njëjtë nga një kohë në tjetrën. Në se ne një kapërcyell kohor mes princëve ka pasur periudhë flirtesh e aleancash

të cilat kanë nxitur apo kërkuar forcime reciproke me lëvizje popullsish, në një kohë tjetër të mëvonshme aleancat janë kthyer në element rivaliteti e konfrontimi.

Faktori kohë është i nevojshëm për të njojur gjithashtu se cili Zot drejtonte e kontrollonte principatat e krahinat nga një periudhë në tjetrën sa dhe si ai është njojur në historiografi brenda kuadrit të sistemit feudal si despot ekstrem apo tolerant, satrap e tiran apo princ liberal. E padyshim këta tipa princash e zotësh do të ndikonin në dinamikën e lëvizjeve të popullsisë të vendit.

Krahas faktorëve të mësipërm, për t'i shkuar saktësish në thelb çështjes është e nevojshme të hiqe dhe evidentohet qartë se nga ç'pjesë të territoreve të Arbërisë u shkulën këta kolonë. Sqarimi i këtyre faktorëve do të ndihmonë edhe më tej e do të conte përherë e më afër shkaqeve të brendshme që ndikuani në largimet e kësaj popullsie.

Nga tërësia e atij dokumentacioni që disponohet dhe nga ato studime të derisotme që janë realizuar mbi gjuhën dhe dialektet e të folmes së kolonive të ndryshme shqiptare në territoret greke, - një gjë duket se është konkludive dhe e përbashkët, - ajo që të zbriturit në këto territore janë shkulur përgjithësisht nga (Shqipëria) Arbëria qëndrore e kryesisht nga ajo jugore, pa përashtuar ndonjë rast sporadic të emigrimeve nga krahina veriore të vendit. (Fig.2) Historjani i njojur Leonik Halkokondili na bën të njojur se "Shqiptarët të nisur nga Epidamnos, duke shkuar drejt lindjes pushtuan Thesalinë..."¹⁾

Të njëjtën gjë thekson edhe studjuesi ynë i talentuar Egerem Çabej kur thekson se "perandori bizantin Johan Kontakuzino (1314-1254) përtë ulur revoltat e fiseve shqiptare të jugut, shpërnguli shumë nga krerët e tyre në More.." ²⁾

"Në vitin 1349 ai mori një trupë shqiptarësh për të nënshtuar vendin dhe mbas kësaj ekspedite ai i vendosi ata

1. I.H.Pullu: "I epiqiqisis ton Alvanon en Korinthia, faqe 44

2. E.Cabei: Studime gjuhësore Rilindja, Vëll.5, faqe 56

(shqiptarët) në ato anë”¹⁾.

Duke folur për këto zbritje shqiptarësh, Halkokondili na bën të njohur se të zbriturit nga Durrësi (Shqipëria qëndrore), kur arritën në Akarnani me aprovin e sundimtarit të Akarnanisë, ngritën vendbanimet e tyre në këto krahina. Pastaj u muarrën vesh midis tyre që të sulminin grekët në mënyrë që t'u bëhej e mundur që të shkonin më përparrë”²⁾

Po të njëjtën gjë pohon edhe historiani tjetër Anonimi i cili na bën të njohur se: “...vendin që prej Etoleve deri te Thesprotet e Moloset, domethënë krahinën e Epirit në të gjithë atë vend, në krahinat bregdetare banonin grekë, kurse në ato më sipër dhe në brendësi, si në të kaluarën edhe tanë banonin e banojnë barbarë-ilirë, të cilët kishin organizuar rezistencën për lirinë e vendit të tyre, duke mos dashur t'i nënshtroheshin pushtuesve latinë, ju ngjitën maleve të Pindit dhe zbritën në anën tjetër në Thesali. Kjo zbritje dhe vendosje e tyre në territorët e Thesalisë ishte natyrish arbitrale dhe pa ndonjë marveshje me autoritetet greke vendase.”³⁾

Problemi i vendosjet dhe rregullimit të tyre në këto territorë, shqiptarët e zgjidhën vetë me ato mjete e mënyra që ata i përcaktonin si më të përshtatshmet, apo siç ata vetë e shprehnin me gjuhën e tyre, - se ahstu dua u..., Pra, duke shpërndarë vendasit nga tokat e tyre dhe duke u rrëmbyer pjesë të kopeve”.⁴⁾

Një tjetër njoftim vendin se nga u shkulën kolonët shqiptare na vjen nga gjysma e parë e shekullit të 14-të. Në atë kohë “Vasili i Dytë kishtë detyruar bullgarët t'ja mbathnin nga Durrësi. Këta duke u tërhequr shkatëruan fshatrat e Arbërisë të zonës ndërmjet Durrësit, Krujës, Elbasanit. Kjo justifikon arsyen për të cilët banorët u detyruan të iknin nga

1. I.H.Pulli: Po aty.

2. Halkokondili: DPBHS, faqe 323

3. K.Biri “Arvanite...”, f.55 Kantakuzinos 1, II, f.38, Halkokondili f.209

4. K.Biri “Arvanite...”, f.55 Kantakuzinos 1, II, f.38, Halkokondili f.209

Durrësi dhe krahinat përreth..."¹⁾

Fakti që valët e koloneve zbritën kryesisht nga këto territore, veç të tjerave mbështetet nga toponimet e vendbanimeve ku u vendosën të ardhurit (ku ata gjenden dhe banojnë edhe sot). Gajtë këtyre shpërnguljeve ata muarën me vehte, edhe kujtimet e vendeve prindërore që linin pas dhe me po ato emertime ata pagëzuan vendbanimet e reja në territoret e jugut. Kjo temë, - ajo e toponimisë së vendbanimeve arvanite në Greqinë e sotme, padyshim është mjaft e gjerë dhe po, aq me interes të madh historik, gjuhësor, për përcaktuar saktësisht se nga ç'territore e zona konkrete të Arbërisë mesjetare zbriti kjo popullsi për në vendbanimet e reja ku jeton edhe sot. Fatkeqësisht deri më sot, me përjashtim të rasteve të shkëputura, nuk është bërë një përbledhje e përgjithshme e toponimisë së vendbanimeve arvanite për t'u krahasuar me toponimine e vendbanimeve të territoreve shqiptare mesjetare e ato kontemporane. Se me sa interes do të ishte kjo çështje mund të përmendnim vetëm një copëz për të ilustruar atë se ç'emërtime kanë vendbanimet arvanite. Psh në rrëthet e Athinës sot: aty gjemë (në rrugëdaljen Athinë-Selanik) Mallakastra-Avlona-Kuçi, etj. ndërsa në zona të tjera gjemë vendbanimet me emër Golemi, Varibobi, Kapareli, Matësi, Hasi, Kryekuqi, Skrepario, etj.

Në një vështrim të përgjithshëm të toponimisë të mbledhur deri sot nga zona apo territore të shkëputura të banuara nga arvanite, mbështet edhe një herë ideja se shpërnguljet kanë ndodhur nga krahinat e Shqipërisë qëndrore dhe kryesisht asaj jugore.

Ndërsa çështja që mplekset me to por që ka domethënien parësore, kur janë realizuar zbritjet - është në të njëjtën kohë një nga dilemat më të vështira.

Lëvizjet e popujve kanë qënë një kërkësë natyrore, e brendshme dhe historike e tyre. Nga kjo ligjësi nuk kishte se si të përjashtoheshin popujt ballkanike dhe mes tyre populli shqiptar.

1. K.Biri "Arvanites..", faqe 42

KOHA E SHPERNGULJEVE SHQIPTARE DREJT GREQISE

Për vendet fqinje që janë kufizuar me njëri-tjetrin që në periudhat parahistorike, është vështirë të thuhet apo të gjykohet se kur popujt e këtyre dy vendeve kanë filluar të marrin a të japin nga njëri tjetri, - kush dhe kur ishte emigrant i parë që shkoi në territoret e fqinjëve, - sa dhe si janë shtrirë mardhëniet dhe këmbimet midis tyre, - etj.

Të vendosur pranë njëri-tjetrit shqiptarët dhe grekët, qysh në periudha parahistorike apo të mëvona historike ata kanë qënë të lidhur reciprokisht me njëri-tjetrin në mardhënies të ngushta dhe kanë patur shkëmbime intensive ekonomike, kulturore, politike. Këto shkëmbime i realizuan përmes vatje ardhjeve, lëvizjeve të njerëzve. Kultura materiale e shpirtërore gjendet dhe ruhet ende edhe sot në territoret reciproke të këtyre dy popujve. Nisur nga kjo do të gjykonim se është e vështirë apo e pamundur përpjekja që do ti vinte kufij kohorë kontakteve, shkëmbimeve, mardhënieve reciproke midis dy popujve, mbasi një gjë e tillë do të ishte fiktive dhe irreale.

Shumë studjues të kësaj çështjeje, më saktë - të fenomenit

- të zbritjes së shqiptarëve në territoret jugore të Gadishullit Ballkanik, përpinqen të vërtetojnë se koha e zbritjeve të para i takon shekullit të 11-të. Ka të tjerë që mendojnë se zbritjet e para shtrihen më thellë në kohë, bile hipotezohet se "ata qe zbritën si aleatë të Avarëve në sulmet e tyre drejt jugut, iшин shqiptarët".

Studjues të tjeter mendojnë se zbritjet e para të popullsisë shqiptare në Greqi janë ato të shekujve të VI - VII, ku sillavët filluan dyndjet e tyre masive drejt jugut. Në këto rrethana zbritën edhe shqiptarët në territoret jugore të Heladës, të trysnuar nga sillavët.

Ndërsa një grup jo i vogël historjanësh pretendojnë se

emigrimet e fqinjëve veriorë, shqiptarëve, drejt territoret greke kanë rrënjet e tyre qe në kohët antike. Gjetje jo të pakta të një kulture të begatë materiale ilire në këto anë nuk janë dëshmi vetëm e këmbimeve tregëtarë reciproke. Dëshmitë shkrimore të historjanëve të lashtë grekë e latinë kanë ushqyer dhe ushqejnë pretendimet e mësipërme, atë të emigrimeve dhe lidhjeve të fuqishme mes dy popujve.

Duke iu referuar këtyre periudhave parahistorike, historike e klasike gjenden mjaf pika kontaktesh, shkëmbimesh, mardhëniresh reciproke, lëvizje ekonomike, politike, kulturore e shpirtërore midis dy popujve tanë. Ato mpleksen thellë me njëri-tjetrin duke ruajtur individualitetin nacional reciprok me dasitë dhe tiparet e tyre të dallueshme.

Duke i parë kështu dy popujt të lidhur gjeografikisht dhe historikisht pranë njëri-tjetrit, ndërdhëniert reciproke si dhe lëvizjet pjesore të masave të popullsisë ato kanë qenë të ndryshme në kohë të ndryshme. Herë janë intensifikuar e shtuar dhe herë janë kufizuar e zbehur ndoshta për periudha të gjata, por kurrë nuk janë ndërprerë.

Eshëtë çështje tjetër në se qëmton për të evidentuar prej ç'kohe këto këmbime gjejnë vend dhe fiksohen në dokumentacionin dhe letrat e shekujve dhe e gabuar se ngjarjet historike fillojnë kur shkruhet letrat. Duke iu referuar letrave, kjo lëvizje popullsie, pra emigrimet e para shqiptare gjejnë rrugën drejt territoreve greke në mesjetë, rreth fundit të shekullit të X e fillimit të shekullit të XI. Duke iu referuar pikërisht këtyre çështjeve, studjuesi Tito Joholla thekson se: "Në Greqi dhe në botën e jashtme diskutohet akoma teoria e njohur Fallmerajerit, sipas të cilës grekët e vjetër u zhdukën krejt për shkak të dyndjeve të sllavëve në shekullin e VI të erës sonë.

Por dijetari Satha e kundërshtoi këtë pretendim. Sipas mendimit të tij ata që u dyndën në këtë vend qysh në shekullin e VI ishin shqiptarët aleatët e Avareve. Ata që u dyndën nga veriu mbasi shkatëruan vendin dhe përfunduan deri në Peloponez nuk ishin sllavët, por shqiptarët. Këtë ai e fakttoi edhe me një pasazh të Halkokondilit i cili thotë "se

shqiptarët në Peloponez kanë ardhur shumë përpara".¹⁾

Megjithëse pretendimi i Sathës duket jo fort i pranueshëm atë e mbështesin edhe studjes të tjera të mëvonë si P.Kanelidhi, S.G. Panajotopoulos, të cilët argumentojnë tezat e tyre tek topnimet zakonet, troditat e poipullsisë së Manit.²⁾

Studimi i emigrimeve shqiptare në këta shekuj ka rëndësi dhe vlera të veçanta në raport me çdo emigrim apo lëvizje popullsie tjetër që gjemjë të evidentuar në historiografinë tonë, mbasi të paktën nga tërë ato çka njihen: këto shpëngulje të popullsisë së Arbërisë.

a. - janë më masivët që njihen në tërë periudhat e shekujve të mëparshëm a të mëvonë të historisë së tij.

b. Ato janë gjurmë të thella në letrat e kohës, historiografinë bizantine dhe kancelaritë e tjera europiane.

c. Kolonët, emigrantët e Arbërisë nuk shkuan si argatë e lipsarë të thjeshtë, për të siguruar bukën e gojës, zbritjet e tyre patën një natyrë të veçantë.

d. Pinjollët e këtyre emigrantëve rezistuan valëve asimiluese, rrojnë dhe përcjellin besnikërisht në kohët tona moderne kujtimet reale të botës mesjetare arbërore, të gjakut tonë të shprishur.

e. Nga radhët e tyre lindin heroj të betejave, personalitetë historike të fushës së politikës, artit e kulturës, që muarën përmasa ballkanik dhe europian.

Veç arsyeve shkencore, faktorët e mësipërm e bëjnë padyshim edhe më të nevojshëm njohjen e saktë të biografisë së kësaj popullsie të shkëputur nga trungu i atdheut. Duke i referuar studjesit I.H.Pullu, për kohën e emigrimeve të para të shqiptarëve, ai parapëlqen P.Furiqin që duke u përpjekur që etimologjinë e emrit të krahinës Mani (në Pelopones) ta spjegojë mefjalën shqipe, - mani - druri frutor që mban këtë emër. Duke e pranuar si të drejtë këtë etimologji, u detyrua

1. Tito Johalla: *Mbi emigrimin e shqiptareve ne Greqi* Fq 1
2. Po aty, Fq 2

më në fund të pranojë domosdo se "shqiptarët erdhën hnë Greqi dhe bile në Peloponez të paktën që në shekullin e IX-të të Erës tonë, domethënë që kur njihet emërtimi etimologjik i emrit Mani".¹⁾

Këtë pretendim e mbështet edhe studjesi tjetër S.G.Panajotopoulos i cili u referohet disa toponomeve të rrethit të Manit që i konsideron ato si shqipe si dhe përgjasia e shumë zakoneve të mani-ateve me ato të shqiptarëve, i jep të drejtën atij të pranojë se zbritjet shqiptare në këto anë janë të kësaj kohe, domethënë të shek. IX.

Edhe autorit tjetër P.Kunelidhis mbështet këtë mendim duke argumentuar veç të tjerave atë edhe me faktin se zakonet e Manit (të popullsise vendase) dhe sidomos ai i gjakmarrjes, i vlerëson si zakone shqiptare... po ashtu edhe gjuha e tyre përmban shumë fjalë shqipe..."²⁾

Një kontribut të veçantë në mbështetje të pretendimit të mësipërm, të dyndjeve të para shqiptare në Man në shek IX, në grumbullimin e materialit faktik, traditave, zakoneve, toponimisë, folklorit emiteve të kësaj krahine, ka luajtur dhe vazhdon të luajë studjesja e talentuar dhe e palodhur Jona Paiudhusi.³⁾

Por në se zbritjet e shqiptarëve në Peloponez, krahinën e Manit në shekullin e IX, siç pamë më sipër janë ende hipotetike dhe ende të pambështetura fuqimisht në rrugë shkencore; për emigrimet në shekujt e mëvonshëm informacionet janë më të gjera e më të sakta. Në një krisobule të Andronikut të III Paleologut, në Mars 1336, thuhese se: "Peshkopi dhe klerikët e peshkopatës së Stagjith-Thesali raportojnë se disponojnë dy krisobula të lëshuara prej të pahuararit... sundimtarit dhe perandorit, zotit Niqifor Botiniatit që i njeh si pronar të tokave përreth, etj... vlehet,

1. I.H.Pullu: *Kolonitë shqiptare në Korinth*, Faqe 41

2. *Evdhomos* 4, 1887 Nr.37, f.3

3. J.M.Paiudhusi "Ta vilia tu qitherona qe ta arvanitika trgudhia tis." 1980, fq.43

shqiptarët, bullgarët..."

"Me këtë rast klerikët e Fanarit të Thesalisë... kërkojnë me insistim që të sigurojnë një shkresë nga zotëria e ime... mos vendos me banim afër Fanarit, shqiptarë përveç atyre që janë aty me bazë krisobulash apo urdhërit perandorak."

Perandori Androniko III Paleologu urdhëron që "ato çka provohen me anë të krisobulës (aktit) perandorakë të Niqfor Boteniatit - perandor) dhe proces verbale të tjera të ruhen nën atë peshkopatë si prona të saja (pra që mbështeten edhe juridikisht), klerikët, banorët, fshatrat, manastirët që ishin nën atë famulli, vllehe, shqiptarë e bullgarë..."¹⁾

Duke i u referuar aktit të mësipërm si studjues të mëparshëm, ashtu sikurse edhe studjuesi ynë Koço Bozhori konkludojnë si më poshtë, - këto popullsi, siç del nga akti, përmenden si parike që dispononin tokë. Duke marrë parasysh se kjo krisobulë konfirmon, aktin e mëparshëm të perandorit Niqfor Boteniatit dhe atë të Aleks Komennit, të cilët qëndruar në froni perandorak reciprokisht në vitet 1078-1081 dhe 1081-1118, mund të pohohet se të paktën që nga koha e këtyre dy perandorëve ka pasur shqiptarë të vendosur në Thesali".²⁾

Në këtë akt ne nuk gjejmë të evidentuar dhe as mund të konkludojmë saktësisht se: ç'numur e përmasa kishte popullsia shqiptare e vendosur në ato territore, por fakti që ajo renditet pranë asaj vllahe, e cila dominonte numerikisht e para në Thesali, gjykojmë që përqindja e saj duhet të ketë qenë e konsideruesh, e Nuk mund të themi se kur ishte vendosur aty popullsia shqiptare. Por bindëse dhe e pranueshmë është që kjo popullsi, e cila është pranuar me akt perandorak rrëth 1081, padyshim duhet të ketë pasur kohë që ishte vendosur e kishte kërkuar qytetarinë dhe njojhen e pronësisë mbi trojet ku ajo banonte.

Si terrenet fushore aq edhe ato malore të Thesalisë të

1) DRPBHSH, faqe 86

2) DPBHSH K.Bozhori, f.96

populluara që prej këtyre kohëve nga kolonë të mëvonshëm shqiptare. Këta të imponuar nga rrethana të ndryshme do të kalonin Pindet dhe do të përpinqeshin të gjenin strehë në ambjente të paranjohura nga bashkëpatriotët e tyre. Kështu ndodhi më 1381 kur princat italiane Oroshine marshkuar për të nënshtuar teritorët e despotatit të Epirit, shumë shqiptarë të cilët kishin organizuar rrezistencën për lirinë e vendit të tyre, duke mos dashur ti nënshtrohen pushtuesve latinë, ju ngjitën maleve të Pindit dhe zbritën në anën tjetër të tyre, në Thesali..”¹⁾

Duke iu referuar edhe më tej Kantakuzinos në këtë njoftim që ai na jep për shqiptarët, ai shtron se, “në këto emigirime të para shqiptarët përbënëngrupe të mëdha deri në 12 000 vetë. Ata thirreshin Bua-j, Mallakaset, Mesari-tet, në bazë të emrave që kishin princat e tyre. Për praninë e shqiptarëve në trevat e Thesalisë edhe para kësaj kohe ka një njoftim i cili lidhet me vitin 1311 kur katalanët kishin pushtuar Dukatin e Athinës. Këtë vit komandanti i forcave katalanase Don Alfonso Rodrigues, organizon një operacion ushtarak nga Thiva drejt verilindjes-Thesalisë. Arvanitestratiote të këtushëm organizuan një qëndresë të fortë dhe heroike, por katalanët, arritën të bëhen zotër të Lokridës, Siderokastros, Gardhikas dhe Farsallës. Rënia nuk nënkupto fundin e luftës sepse arvanitët e Thesalisë vazhduan luftën dhe sulmet e tyre edhe në vitet e mëpasme.

Në vazhdën e këtyre ngjarjeve, për vitet e sundimit katalan, historjani Marino Sanuto na bën të njojur episodin e mëposhtëm, “Zoti dërgoi këtë masë shtegëtarë nëpër këto territorë të Thesalisë, vend në të cilin kohë më parë po nga kjo rracë ishin vendosur aty - rracë arvanitësh siç thirren. Numri i tyre ishte kaq i madh sa ata shkatërruan plotësisht çka ishte jashtë kështjellave, - sa katallanët, vendbanimet e grekëve dhe ato të bashkapatriotëve të tyre të vendosur aty kohë më parë.

1. M.Kantakuzinos 1, II, Faqe 38

Katallanët organizuan një marrëveshje të përbashkët me grekët dhe ashtu bashkarisht sulmuan arvanitët. Por sulmi i tyre i organizuar nuk arriti asgjë sepse në këtë betejë ata u thyen dhe dështuan keq. Thuhet se arvanitët më pas deshën të largohen nga këto territore të Thesalisë, por grupe të rrij të shpërngulurisht që vinin aty u thanë:

- Pse hikni prej këtej?

- Sepse këtu nuk kemi asnijë kështjellë.

- Mos bëni këtë se këtu po vijnë shumë njerëz të tjerë nga tanët pér të na ndihmuar. Prandaj të qëndrojmë të gjithë kështu së bashku në vendet e Thesalisë!

Dhe kështu u rikthyen të gjithë bashkë përsëri.¹⁾

Duke u rritur pérherë e më shumë numerikisht në këtë zonë - Thesali, ky element i ri, arvanitet, me tipare tepër aktive dhe dinamike, bëhet bëherë e më i pranishëm në kronikat historike dhe në ngjarjet politiko-ushtarake të kohës. Kështu më 1333 kur vdes princi i Fanarit (Thesali) Stefan Gavrilopullo, shqiptarët (arvanitet) kaq të shumtë në numur duke përfituar nga kjo vdekje ngrihen në revoltë dhe bëhen kështu zotër të vendit.

Perandori i Bizantit Androniku i III Paleologu mbasi mësoi përsa sipër, ndërmori një fushatë ushtarake në Thesali dhe mbas një lufte shumë të ashpër i detyroi më në fund ata të rikthejnë përsëri banorëve çfarë u kishin marrë kohë më parë... (është fjala këtu pér vitin 1333). Dhe kështu në dhjetvjeçarin që pasoi, në Thesali ndodh një ndryshim i menjëhershëm, rritet në mënyrë masive numri i banorëve arvanitë.

Një pohim me rëndësi pér praninë e vazhdueshme të popullsisë arbërore në këtë zonë gjatë shekullit të XIV ka dhënë Kantakuzino. Njoftimi i tij është bërë objekt i pandërprerë referencash dhe diskutimi. Studjesi Marino Sanuto duke analizuar dhe referuar këtë njoftim të

1. M.Sanuto: *Mesazhi i tretë. K.Satha: Anegdoda greke, Vëll II, faqe 62. DPBHSH. F.220*

Kantakuzinos sqaron; "Joan Kantakuzinos ka një shënim të shkurtër, me rëndësi për internimin e Siriannit nga Bizanca. Ndër të tjera ai thotë se "zbriti në Eube, përshkoi Lokridën dhe Akarnaninë dhe kërkoi strehim tek shqiptarët e Thesalisë, të cilët i njihet që nga koha kur ishte gjeneral i perëndimit." Por, dihet se këtë post Siriani e mori më 1315, prandaj nisur nga kjo konkludojmë se shqiptarët gjendeshin në Thesali që në fillimet e shekullit të XIV-të, pra kur Siriani ishte aty gjeneral. Domethënë ata kishin kohë që ishin vendosur në ato teritore, pra edhe para 1315-ës".

Krahina e Thesalisë e njohur që prej shekujve të kaluar si shteg i zbritjeve dhe vendosjeve të popullsisë së Arbërisë, edhe në shekullin e XIV-të bëhet objekt i disa valëve kolonizuese të tyre. Bile zbritjet ishin të atyre përmasave sa jo vetëm këtu në Thesali por edhe në zona e krahina të tjera, ata përbysën raportet e përqindjeve të popullsisë në favor të tyre, duke u bërë forca e parë demografike e popullsisë së këtyre vendeve. Kështu studjuesi William Miller për mesin e shekullit të XIV-të, duke iu referuar kolonëve arbërorë, të cilët përbën një racë të re dhe të gjallë, - sqaron se, ata muarrën me vehte në këto shpërngulje edhe familjet e tyre dhe për këtë arsy numri i tyre u rrit shumë, duke zenë kështu renditjen e vllahëve, të cilët deri atëhere përbën shumicën dérmuese të popullsisë së Thesalisë dhe që atëhere për këtë shkak kishte marrë emrin Vllahia e Madhe" ¹⁾

Për të zbriturit e këtyre kohëve, Kantakuzino nën vizion ndoshta jo pa qëllim tiparet e tyre të veçanta duke theksuar se..." ata nuk banojnë në asnje qytet por qëndronin në male dhe nuk i nënshtroheshin sundimit perandorak". ²⁾

Po ky historjan na bën të njohur se po në këto kohë më 1335-1336 princat shqiptarë kishin ngritur krye kundër sundimtarëve bizantinë në Vlorë, Kaninë... prandaj Androniku i III Paleologu (Perandor i Bizantit) u vërsul në beteja drejt

1. W.Miller: "*The latin in the Levant*", 1908, faqe 247
2. DPBHS, faqe 322

Perëndimit duke shpresuar ta vinte Akarnaninë nën vehte... duke marrë për aleate këmbësorë përse-turq... për shkak të shqiptarëve. Me ushtrinë bizantine dhe me ushtarët aleatë-turq, ai marshoi përmes Thesalisë kundër Shqiptarëve... Gratë dhe fëmijët turqit i muarrën rob..."¹⁾

Megjithëse, siç shihet - Kantakuzino nuk flet konkretisht për revolta të popullsisë arbërore në Thesali, ai pohon se ai - marshoi përmes Thesalisë kundër shqiptarëve, që nënkupton se shqiptarët edhe të këtyre anëve ishin ngritur në revoltë.

Në se zbritjet e popullsisë arbërore në teritorët e Thesalisë evidentohen në dokumentacionin historik ndër të parat, kjo nuk don të thotë dhe nuk përjashton atë që valët kolonizuese të shqiptare në po këta shekuj apo edhe më herët të jenë shtrirë në teritorë të tjera kontinentale apo ishullore të Greqisë mesjetare.

Megjithëse ende e mjegullt dhe jo shumë e mbështetur me material tjetër shkencor, nuk duhet lënë jashtë vëmendjes një korespondencë që hedh dritë për një prani shqiptarësh në Atikë (zona përreth Athinës), në shekullin e XII-të. "Pra, kemi një dëshmi të Minaik Akominatos të Koniatit që rreth vitit 1180 ishte Mitropolit i Athinës. Ky herark, filozof klerik e konsideron emërimin dhe vendosjen e tij në Athinë si një lloj internimi. Kuptohet, që Athina në atë kohë për gjante kurrsesi me Athinën e kohës së Perikliut (të kulmit të lulëzimit të saj). Në këtë kohë ajo (Athina) ishte një fshat fare i vogël nga më të këqinjt e Greqisë. Akominatua në një letër dërgua vëllait të tij shkruan: "Jam bërë barbar nga qëndrimi në Athinë. Athinasit janë të varfër, të pashkolluar, fshatarë të pagdhëndur, të cilët edhe një veti tjetër që e bën Akominaton të qajë me lot, - janë indiferent për fenë e krishterë dhe nuk shkojnë fare në kishë. Flasin një gjuhë barbare. Muzat dhe hiret pra fluturuan nga Atika dhe një zë barbar e i trashë ka zaptuar këtë..." Po cila mund të jetë kjo gjuhë barbare?!

- Unë, - thotë A. Kolia, nuk shikoj gjuhë tjetër veç gjuhës shqipe.

Akominatos u përpoq shumë që këta njerëz ti bindi përtitërhequr në kishë por më kot. Kjo është veçori e shqiptarëve, përfundon Kolias." ¹

Ndërsa të dhënët për shpërnguljet dhe vendosjet e popullsisë arbërore në shekujt e XII-XIII janë më të pakta, situata ndryshon pothuaj krejtësisht, për shekullin e XIV e mëtej. Ky qindvjeçar, nuk do ta tepéronin të pohonim se ndoshta është ai që mbart vitet e lëvizjeve e largimeve më të mëdha që kanë pësuar ndonjëherë trojet shqiptare.

Duket se bërthamat e këtij eksplodimi bëhen teritoret jugore të Arbërisë dhe disa ngjarje që ndodhin në të e lënë gjurmë në historinë e Arbërisë dhe ato ballkanike. më 1358, mbasi Karl Topia fiton në luginën e Akelout me forcat e tij - trofenë e fitores ja lë Gjin Bue Spates (Shpatës) dhe Petro Lioshes. të dy princat mbajnë nën kontroll Etolinë, Akarrnanine, kështjellat përrth me qëndër Angjelokastron dhe Artën. Tamam në këto kohë dalin në plan të parë të skenës historike qëndresa dhe pse jo supermacitë e principatave dhe princave arbërorë. Ata jo vetëm përballojnë por në shumë fusha betejash dominojnë dhe çfaqen në botën politiko-ushtarake si fuqitë më të kualifikuara. Forcat e latinëve, katalaneve, normaneve, serbeve, venecjaneve dhe të vetë despotëve të Bizantit të cilët ishin të mbushur me orekse të pafrenuara për pushtet dhe pasuri, ndeshen edhe me forca të Arbërit - dhe mbasi provojnë tehun e shpatës së tyre, i ftojnë ata në aleanca, i pranojnë në teritoret e tyre si bashkëbanore i thërasin për ndihma urgjente në fronte betejash të vështira.

Kështu, më 1380 Konti i Dhimitriadhës dhe arvanitët e tij mbrojtën qytetin e Negropontit nga sulmet e Navarëve nën udhëheqjen e Majet de Kokërell dhe Pedro de Siperon, duke

1. A. Kolia: "Arvanites që i katagogji ton elimon", Athinë 1983, f. 144

shpëtuar kështu jetën e shumë Thivasve dhe grekëve të tjerë të cilët kishin shkuar aty. Dhe ky shërbim që dhuron arvanitët, - kjo rracë e fuqishme me Greqi nuk ishte aq e para dhe as e fundit." ¹⁾

Rreth viteve 1370, arbërit zbritën thellë në Akarnani me lejen e sundimtarit të Akarnanisë pastaj u muarrën vesh midis tyre që të sulmonin grekët në mënyrë që të bëhej e mundur të shkonin edhe më përpara... kështu pikërisht në kohën kur sundimtari Isaak po kthehej nga gjahu, shqipatrët e sulmuan atë të udhëhequr nga Spata. Ky ishte burrë që dallohej mes shqiptarëve si shembull vrulli e guzimi. Ai ishte për ata i përshtatshëm dhe i denjë." ²⁾

Më 1402, Senati venedikas ligjëron vendosjen e shqiptarëve në Eube për banim dhe aleatë ushtarakë me ta, për të përballuar synimet e ekspansionit ushtarak të fjoorentinasve në aleancë me Dukatin e Athinës. ³⁾

Në vitin 1383, ftohen në Atike fushën e Apsosit arbër të fiseve Liosha, Mazareka dhe Mallakaset nga ana e katallanëve, të cilët i zgjodhën ata si aleatë të përzgjedhur dhe me interes. në po këto teritore kemi zbritje të tjera të kësaj popullsise edhe në vitet 1418 e 1420.

Perandori bisantin Jan Kantakuzino (1341-1354) thirri më 1349 nga Arbëria jugore grupe shqiptarësh nën udhëheqjen e princave të tyre, për inkursione ushtarake. Mbasi e realizuan këtë perandori i la ata të vendosen në këto anë në More (Pelopon). ⁴⁾

Po ashtu më 1373-1382, Raniero Acciaiuoli, Duka i Athinës vendosi disa koloni shqiptarësh ushtarakë në Atikë, Argolidhë dhe Isthm të Korrinthit. ⁵⁾

Më 1381 arvanitët i gjëjmë edhe në Kontene e Solones

1. W. Miller: *The Latin in the Levant.*, Faqe 311

2. Dok. Per. Bizant. për Hist. Shqip., Halkokondili, Faqe 323

3. K. Satha: *Mnimia tis eleniqis historias*, Vell II, faqe 79

4. E. Çabej: *Studime gjuhësore*, Vell V, f.571. Po aty

5. Po aty

në aleancë me katalanët kundër venecjanëve.

Më 1382, mbreti i katalanëve ifton shqiptarët të vendosen është Atikë rrëth Athinës) duke u premtuar çlirimin nga taksat përdy vjet.

Më 1388, gjejmë një tjetër vendosje masive shqiptarësh në Athinë dhe në krahinat përrëth saj në Atikë ku zot i vendit ishte Nerio Axahjoli.

Në vitet 1380-1407, me lejën e Princit Teodorit të Parë Paleologu vendosën në zonën e Argosit, Arkadi dhe Ilia, - zona që banohen edhe sot nga shqiptarë, - rrëth 10 000 shqiptarë me familjet e tyre.¹⁾

Më 1189 Perandori i biznetit, Manuel Komneni emëron si arhond të Nafplios - Zguron. Po këtë personalitet të rendësishëm ushtarëk, perandori i ardhshëm Aleksi i III Angjelo, më 1199 e ngarkon të godasë dhe të zhdukë piraterinë që ishte bërë shqetësuese në zonë. Edhe mbas vdekjes së tij, të birin Leon Zguron e gjejmë princinë këto anë, ku ashtu sikurse edhe princat e tjera shqiptarë edhe ky Zguro duhet të jetë ftuar e vendosur së bashku me luftëtarët e principatës së tij arbërore.

Më 1405 kishin zbritur ne Peloponez rrëth 10 000 shqiptarë nga ata që ishin ndeshur me Karl Tokon në Etolia dhe Akarnoni. Këta për t'ju shmangur dhunës hakmarrëse të këtij princi barbar emigruan drejt jugut.

Kështu mund të renditen zbritje të tjera arbërisht nëpër territorët greke veçanërisht në këtë shekull. Ata janë të shumtë dhe të shtrirë kudo. Punojnë, ndërtojnë dhe ngrenë vendbanimet e tyre, fshatrat, rrugët, urat, stanet në male, etj. Fillon të përcillet në tokat e reja tradita e një popullsie të re në ndërtimtari, vreshari, moralin shoqëror e familjar, këngë, valle, morte, etj. Tokat dikur djerre, të braktisura dhe të egra fillojnë të punohen, të kultivohen. Gryka, brinjë, burime dikur të egra dhe të shkreta, të frikëshme dhe të harruara, gjallërohen dhe pagëzohen me emra nga gjuha e banorëve

1. Tito Johalla; *Mbi emigrimin e shqiptarëve në Greqi*, fq. 7

arbërorë. Nis kështu rrjedha e jetës normale dhe njerëzit bëjnë tokën dhe vendin të tyret dhe ajo nga ana e tyre u përshtaten e bëhet e njerëzve. Emërtimet e reja të vendbanimeve të krijuara, të grykave të tokave të reja që hapen e bëhen pronë e dikujt, të vreshtave, të burimeve apo puset që hapen, kanë edhe sot toponimi në gjuhën shqipe. "Vreshtëza", "Pusi" thatë, "Gura Lekës", "Grika ulkut", "Varri vashës", "Vendi i mir", etj.

Vend-vendosjet e popullsisë arbërore nëpër territoret e Greqisë Mesjetare

Sic e pamë popullsia arbërore zbriste në territoret e ralluar apo thuajt të zbrazura të Greqisë mesjetare, e ftuar nga prindërit që kontrollonin principatat, dukatet apo kontete, me ftesa a krisobila perandorake për shkak të cilësive dhe aftësive pa përjashtuar shkaqet ekonomike e politike.

Po cilat ishin këto veti të ralla luftarake të kësaj popullsie, dhe ç'tipare të veçanta të saj kishin tërhequr vëmendjen e strategëve ushtarakë në fushat e luftimeve?

Shumë studjues të kohës, strategë ushtarakë të cilët i patën thirrur në aleanca dhe luftuar krah për krah me ta, të tjerë që i patën parë me sytë e tyre në frontet e luftës si kundërshtarë dëshur ballë për ballë, kanë përcjellë kujtime tepër impresionante.

"Janë të armatosur shumë më lehtë nga frangjet dhe pothuaj pa torakse metalike - shprehet një bashkëkohës, - kanë një përgatitje të mrekullueshme për kalorësi dhe përdorimin e armëve. Janë të shpejtë, të rrezikshëm, të stërvitur dhe tepër të aftë për luftë. Veshja e tyre, armatimi i tyre, strategjia e tmerrshme dhe taktika luftarake që kanë përvetësuar është për ta një sistem që i dedikohet traditës së lashtë që kanë pasur dhe i bën ata tepër të veçantë.

Janë një rracë e qëndrueshme, dietpakët, të disiplinuar

dhe besnike ndaj besës-fjalës-së dhënë. Kur rrezikohet udhëheqësi i tyre janë gati më mirë të jasin jetën e tyre se sa të lënë atë të bjerë i gjallë në duart e kundërshtarit.

Veshja e tyre, armatimi tipik, instiktet luftarake dhe taktikat e tyre ushtarake që atyre u ishin bërë një lloj natyre, duket se janë të përcjella nga një traditë e thellë e së kaluarës së tyre"¹⁾

Autori Coriolano P.Cippico, i cili i njohur arbërit nga afër në Pelopones në shërbim të venecjanëve thotë: "Në shumë vende që mbahen në zotërim të venecjanëve shërbejnë shumë shqiptarë kalorës që çfaqen me emrin "stratiotes" - burra kurajoze dhe të aftë për çdo lloj operacioni. Me sulmet e tyre të rrufeshme kaq shumë shkatërruese e kthyen Peloponezin e pushtuar nga turqit, pothuaj të shkretë".⁽²⁾

"Për nga natyra këta burra pëlqejnë goditjet e rrufeshme, sulmet e shkëputura dhe të befasishme se sa reshitimet tipike ushtarake në betejat frontale. Kanë hushta, hark, topuz dhe shpatë. Të paktë janë ata që mbajnë një toraks të vogël metalik, ndërsa pjesa më e madhe mbajnë torakse pambuku, me të cilët mbrohen nga goditjet e kundërshtarëve..."³⁾

Një tjetër historian i kohës, italiani Marino Sanuto sjell këto dëshmi me interes për tiparet e veçanta luftarake të shqiptarëve: "Kanë shpatë (në formë kame), ushte me flamur në fund të kokës metalike, shumë pak prej tyre mbajnë torakse, ... pjesa më e madhe mbajnë kapele të pambukta të qepura në një mënyrë krejt të veçantë. Kuajt e tyre janë të mëdhej, të mësuar me vështirësi, vrapijnë dhë lëshohen aq shpejt njëloj si zogjtë. Mbajnë përherë kokën lart dhe u kalojnë të tërëve në teknikën, mjeshtërinë dhe artin e luftës..."⁴⁾

1. M. Sanuto: *Diary* F.27

2. Coriolano P. Cippico: *Delle guerre de Veneziani nell'Asia dal 1470 al 1473. Venezia 1796*

3. Po aty.

4. Marino Sanuto: *Commentarii della guerra di Ferrara: Fq 115*

Po ky autor më tej shkruan: "Më 22 Prill 1482, mbritën anijet e para të cilat sollën shtatë luftëtarë nga Koroni. Ata me të zbritur në Lindo, bënë paradën tradicionale përpara popullit (spektatorëve) të cilët u mbrekulluan me shpejtësinë e kuajve dhe teknikën e kalorësve... Kanë kësula me majë, disa me torakse, mbajnë hushta në duar dhe varin në anë të brezit pallën. Vrapojnë si zogjtë dhe qëndrojnë fare të lirshëm në kuajt e tyre... Hanë pak dhe nuk pretendojnë gjëra të zgjedhura në ushqim, por kujdesen tej mase dhe u shërbejnë shumë kuajve të tyre. Të mësuar me grabitje shpesh plaçkisin Peloponesin. Janë luftëtarë të tmerrshëm dhe të suksesshëm kundërturqve, organizojnë në mënyrë të shkëlqyer sulmet plaçkitëse të papritura kundër armiqve, duke i mbetur përherë besnik prijsit të tyre. Nuk mbajnë robër, por u këpusin kokat atyre, duke marrë sipas traditës një dukat për çdo kokë.."¹⁾

Ajo çka ishte e veçantë, për të cilat frangjet nuk kishin fare idenë, ishte taktika që ata përdornin në inkursionet ushtarake, me anë të së cilës ata përhapnin panik në radhët e kundërshtarit, për të bërë më pas kërdinë mbi ta, apo ti zinin në befasi të hutuar si pulat. Organizonin zbulim (spiunazh taktik ushtarak) për të njohur forcat e kundërshtarit dhe pozicionet që ta kishin. Bënin njohjen e terrenit që të gjenin monopate dhe vendkalime të fshehta për tek armiku. Studjonin përherë planin e luftës në vartësi me rastet kontrete dhe me kuajt e tyre të stërvitur kalonin lumej dhe male duke e rrethuar apo goditur në krah kundërshtarit.

Në një tjetër dëshmi të vitit 1509, të dhënë nga Ludvig da Porto i cili luftoi përkrah tyre, thuhet: "Nuk mjaftoi që bënë marshimin e gjatë deri në Basano, Vikadia e Leniano nga ku u kthyen në darkë vonë, por akoma pa lënë armiqtë, të cilët ishin fare afër, të organizohen, kaluan me not Adan dhe Nixhan dhe hynë fshehurazi në male dhe mbritën kështu në zonën e Breshias. Prej aty me një sulm të papritur shkaktuan

1. Po aty. faqe 116

një përçarje dhe shkatërrim të madh. Nuk lanë asnijë rrugëdalje pa bllokuar. Dijetepaket por të qëndrueshëm, të tillë janë këta njerëz. Nuk pyesin as nga uria, as nga etja dhe as nga pagjumësia".¹⁾

Tek Kronika e Tokove apo e Janinës të shkruar nga murgjit Prokel dhe Komnen mes të tjerave na përcillët se me ç'britma shqiptarët suleshin dhe godisnin psikologjikisht kundërshtarin në fushat e betejës, apo kur e mabnnin atë të rrëthuar dhe e detyronin të dorëzohej. Kjo britmë e përcjellë që nga shekulli i 14-të, kur princat e famshëm Spata dhe Liosha kishin rrëthuar kështjellën e Janinës, vjen edhe sot ashtu e çuditshme "rua-rua ruaj, ruaj". Kjo lloj piskame që trondiste kundërshtarët, nuk përashtojmë të jetë ajo britmë që më pas është marrë edhe nga gjithë ushtritë e tjera si simbol dhe sinjal i nisjet në sulm, veç që sot shqiptohet "u rr a"!!!²⁾

Duka i Avrilisë, i shkruante kështu në shekullin e 16-të mretit të Francës Karolo, të cilit i kishte kërkuar ta ndihmonte ushtarakisht në Plakentia ku ai qëndronte i rrëthuar:

"I madhërishmi Mbret!"

Kemi predispozicionin dhe dëshirën për të ardhur me ushtrinë time dhe bashkrendohemi në një front të përbashkët në Plakenta, por të bëj të njojur se në Kampin e Dukës së Milanos ndodhen disa njerëz që u thërrasin "stratiote". Eshtë akoma e paqartë në se janë turq apo janë djaj. E them këtë mbasi na shkaktuan aq shumë dëme sa që ne nuk mundëm të dalim nga Navara. Na vrasin dhe vënë kokat e prera të njerëzve tanë në hushtat e tyre. Çdo ditë sulen me kuaj deri tek portat e mureve rrëthues të qytetit, ashtu siç plaçkisnim ne në Vesevenë. Kështu që ne e kemi të vështirë t'u vijmë në ndihmë.

Në qoftë se ne do të dalim jashtë mureve të qytetit do të përçahemi keq ose do të vritemi të gjithë prej tyre"³⁾

1. Ludovigo da Porta: "Lettere storische", nr.28

2. Dok Periudh. Bizan. Histor. Shqip; Faqe 242

3. Konstandinos Satha: "Elines stratiotis en ti dhisi", Fq 133

Aftësitë e tyre të veçanta luftarake dhe instiktet e tyre të çuditshme për të njohur dhe mandej për të goditur papritur dhe në mënyrë vdekjeprurëse kundërshtarin, kanë impresionuar edhe studjuesit e mirfilltë të artit ushtarak.

Vëmendjen e tyre ka tërhequr "pusia". Prita që arvanitet i thërrisin në gjuhën e tyre "hosia", sulmet e natës dhe artificat endryshme që ata organizonin për të shtënë në kurth kundërshtarin, dhe të gjitha përfundonin me një sulm të papritur që trondiste tërë kundërshtarët dhe shkaktonte tmerr dhe panik tek ata. Një nga variantet më të preferuara të tyre kur ballafaqoheshin me kundërshtarin, ishte tërheqja sikur gjoja po mundeshin dhe kur kundërshtarët i qepeshin nga pas në ndjekje, ata papritur ktheheshin dhe i suleshin pas si skifteri. Kjo taktkë e tmerrshme lufte që ishte kaq lehtë e praktikueshme nga ana e tyre shkaktonte tmerr. Nuk arritën dot frangjet të shpjegonin se ç'lloj njerëzish ishin ata që luftonin në atë mënyrë. Emri i tyre i tmerrshëm u përhap ngado aq sa në gjuhët e huaja - arvaniti - stratjot - merrte kuptimin e një luftëtarit të papërmbarjt - satanik.¹⁾.

Ishte vërtet një fat i madh dhe mrekulli për çdo kundërshtar që arrinte t'u shpëtonte atyre nga revani i kuajve që përdornin, nga goditjet e topuzit, hushtës apo shpatës. Ata nuk i mbanin robërit dhe nuk pranonin mëshirim kur ata u a kërkoni këtë. Të gjithëve u këpusnin kokën... vetëm komandantët e zënë rob i mbanin të gjallë dhe i binin në kampin e tyre për t'ua bërë dhuratë prijsve të tyre që këta t'ua kthenin kundërshtarëve përsëri në këmbim të shumave të konsiderueshme. Në kthimet e tyre triumfale nga betejat, sillnin të mbërthyer në majë të ushtës një kokë kundërshtari armik dhe në se do të ishte e mundur një kokë komandanti a ushtaraku madhor, në se në fushën e betejës ata do ta kishin arritur një gjë të tillë.

Këto dy zakone të veçanta të tyre - prerja e kokës se kundërshtarit dhe - mbartja e tyre në majën e hushtës, krijuan

1. Kosta I. Biri; "Arvanitës - I doriis tu neoteru elenismu qe..."
F. 168

vërtet një ndjenjë tmerri tek europjanët.¹⁾

Veç rasteve të tjera që gjenden në kronikat e asaj kohe, tipari i mbajtjes gjallë të prijsave kundërshtarë dhe kthimi i tyre pas në këmbim të shumave të konsiderueshme, evidentohet edhe në "Kronikën e murgut Komnen dhe murgut Prokel" (kronikë kjo që u botua për herë të parë nga konsulli francez pranë Ali Pashës - Fransua Pukevil). Po kjo kronikë na bën të njohur: "Gjini (është fjalë për Gjin Zenevisin zotin e Gjirokastrës - I.K.) duke i ndjekur ata i mundi tërësisht dhe despoti i u dorëzua atij. Ishte ditë e mërkurë 9 Prill 1399. Izaun (fjorentinasi Izau Buondelmonte ishte në atë kohë despot i despotatit të Janinës) dhe arhondet e tij, Gjini i vuri në pranga dhe i mbylli në burg.

Të afërmit prej gjaku që despoti Izau kishte ndërmjet arhondeve të nderuar të qytetit të madh dhe të lavdishëm të Firencës shkuan tek komandanti i Venedikut. Mbas pyetën për despotin shkuan tek bajli i ishullit të Korfuzit dhe e nxorrën Izaun nga Gjirokastra kundrejt 10.000 floriash..."²⁾

Fenomeni i rendjes pas përfitimeve pasurore në fushat e betejave apo mbas mbarimit të tyre e gjejmë edhe tek autorë të tjerë. Rrëmbimin e "plaçika"-ve siç e gjejmë të pasqyruar që në dokumentet mesjetare çfaqet edhe tek autorë të tjerë. një tipar të tillë të shqiptarëve, megjithëse në formë më të zbatur dhe jo fare të dallueshëm na e jep vite më vonë edhe historjani ynë i madh Marin Barleti në veprën e tij "Historia e Skënderbeut". Në betejën e parë kundër turqve, të mbas kthimit të Skënderbeut në atdhe, fill mbas fitores së bujshme mbi ta, luftëtarët shqiptarë lëshohen të papërmblajtur mbi plaçkën e luftës sa edhe vetë Skënderbeu me sens dhe ndjenjë humor i kritikon duke u thënë "Ç'është kështu? Sikur t'ju shikonte tani nga ndonjë vend në këtë katandi Ali Pasha bashkë me mbeturinat e ushtrisë së vet të dërmuar, duke

1. Po aty F. 169

2. Akad. Shkençave-Inst. Historisë: "Bur. Tregimtarë Bizan Hist. Shqip." Faqe 250

tërhequr raqe kafe të ndyra, shpërblime të një ushtrie të pangopur, a nuk do ti vinte turp, e çfarë turpi për një ngadhnjer kaq të pacipë. A nuk do ti shante ushtarët e tij frikamanë që u mundën nga njerëz të tillë dhe që jua lanë lavdinë e luftës juve?"¹⁾

Ata çkan na bien autoët e huaj, që përmendëm më sipër, për zakonet dhe insiktet e shqiptarëve në fushat e betejës, me interesështë të përmendim edhe atë çka na i pohon edhe ne Barleti ynë, duke konfirmuar kështu ato çka na bien autorët latinë dhe ata bizantinë në kronikat dhe shkrimet e tyre të atyre kohëve. "Kudo gjak dhe vrasje, kudo s'dëgjohej tjetër veç ulëriam e atyre që po jepnin shpirt. Një palë po u hidhni prangat robërve, një palë të tjerë duke e lënë të shëmtuar trupin e armiqve, i merrnin kokat dhe e ruanin si dhuratë të veçantë për komandantin e vet. Më të shumtët po plaçkisnin kampin sepse njerëzit lakojnë më tepër plaçkën."²⁾

Pikërisht kjo popullsi aktive dhe vitale, me këto cilësi dhe vyrtute të veçanta luftarake ftohet nëpër pothuaj tërë territoret e Greqisë mesjetare. Siç është theksuar edhe më parë, më 1290 gjëjmë dokumentacionin konkret të ftësës dhe vendosjes së shqiptarëve në Peloponez (rreth 10.000 vetë nën kujdesin dhe dëshirën e Theodhor Paleologut). Këtë fenomen e gjëjmë të përsëritet edhe më pas në vitin 1348. Mesa duket zbritjet e koloneve të parë e kishin dhënë efektin dhe rezultatin e kërkuar. Në këtë vit Despoti (princi) i parë i Despotit të Moresë, Manuil Kantakuzino për të forcuar dhe siguruar këtë despotat nga inkursionet dhe rreziqet e vazhdueshme që i kanoseshin nga katalanet dhe turqit, të cilët filluan përherë e më tepër të çfaqen në territoret ballkanike, fton dhe vendos në territoret djerë të këtij despotati në Peloponez rreth 10.000 shqiptarë të tjerë.

Mbas inkursioneve të serbëve nën udhëheqjen e Stefan

1. Marin Barleti: *Historia e Skënderbeut*, Faqe 116

1. Po aty, Faqe 115

Dushanit dhe pushtimit të kësaj zone nga ana e tij, këta shqiptarë të cilët i bënë një rezistencë aktive, detyrohen të largohen dhe vendosen së bashku me familjet e tyre në Despotatin e Moresë.

Pak vite më vonë në po këtë Despotat, në territoret që lidhin atë me pjesën kontinentale, pranë Korinthit, dhe në Argos, peshkopi i këtij vendi mbledh në këtë zonë një masë tjetër shqiptarësh dhe i stabilizon këtu. Në vitin 13285 në një letër që ai i shkruan vëllait të tij Neriu Anxhelo Axhajoli (kardinal në Firence) ndër të tjera i thotë: "Mblodha burra luftëtarë të armatosur ku munda... reth 800 kalorës shqiptarë dhe shumë këmbësorë".¹⁾

Studjuesi grek i cili ka përllogaritur se ç'numur total përbën masa e tëtëqind kalorësve duke u shtuar atyre pjestarët e familjes, konklidon se në këtë zonë, Argos duhet të kenë shkuar në vitin 1385 rreth 3200 vetë.²⁾

Sic kemi bërë të njojur edhe më parë, në vitin 1405 gjejmë të dokumentuar një zbritje masive shqiptarësh, prej 10 000 vetësh me familje, gra, fëmijë dhe pasuri në zonën e Korinthit.

Por, kuptohet që jo të gjitha zbritjet dhe vendosjet e koloneve shqiptare janë evidencuar dhe fiksuar në dokumentacionin e kohës. Eshtë e pranueshme gjithashtu të thuhet se jo të gjitha dokumentet dhe arkivat e kohës janë shfletuar. Në këto rrethana shumë zhvillime të atyre kohëve, lëvizje popullsie, vend-vendosjet e tyre, kontratat dhe kushtet e vendosjes, numri i koloneve, etj, -flenë në raftet e arkivave duke pritur të shohin dritën e shfletimit dhe të botimit të tyre.

Kështu në se mësipërfolëm përnjë vendosje shqiptarësh në zonën e Argosit, rreth 800 kalorës, po në këto territore - në kështjellën e Bardhunit, në Jeraqi, të Lakonisë, por dhe më tej akoma gjejmë zonat e Ahaisë, Ilidhes, Trifilisë dhe Mesinisë të mbushura me fshatra arvanitësh që jetojnë sot e

1. Grigorovio - Lambro: *Istoria ton Athinon*, Vëll II, Faqe 643
2. Kosta Biri: *Arvanites - i dori tu neoteru elenizmi*, Faqe 143

kësaj dite. Po kur erdhën këta banorë dhe u vendosën në këto territore? Të ftuar nga kush dhe nën emrin e kujt prijesi ata u vendosën në këto anë. Padyshim një studim i kujdeshshëm dhe i vëmendshëm edhe i atyre pak të dhënavë që gjenden edhe sot, - sa në toponiziminë e vendbanimeve të tyre, të emrave dhe mbiemrave të banorëve dhe të atyre të dhënavë historike të përcjella tek këta banorë mund të ndriçohen jo pak çështje të së kaluarës së tyre historike.

Kështu në zonën e Ilias gjemë: Kagadhi, Kakaruka, Karatula, Kokla Kurtesi, Krikuqi, Likuresi, Gortina, Lopesi, etj. në zonën e Korinthit gjemë fshatrat: Mazaraqi, Mezi, Gerbeshi, në Arkadia: Bedeni, Borgji, Sguro-hori, Basta, Suli, Spata në Patra: Gerbeshi, Kalenxhi në Trifilia: Kakava, Kuçi në Mesinia: Kavashi, Likuresi, Maneshi, Basta, Haikali, Lopsi.

Po gjatë këtyre viteve gjemë edhe një numur tjetër vendosjesh të popullsisë shqiptare në territoret e Peloponesit pranë kështjellave apo territoreve nën zotërimet e Venecjanëve. Kështu, më 1401, fillimi si me një lloj rezerve, venedikasit pranojnë pranë kështjellave të Methonit dhe Koronit 12 kalorës arvanitas. Pak më vonë vjen në shërbim të venecjanëve nga Arkadia një prijs shqiptar i thirrur Bua Kuqi së bashku me gjithë pasuesit e tij. Këta përbënë një numur jo të vogël njerëzish. Vendosen në këto anë dhe formojnë kështu katër fshatra.¹⁾

Në vitin 1425 gjemë të dokumentuar një zbritje tjetër masive shqiptareshne teritoret e Peloponezit. Nën drejtimin dhe udhëheqjen e prijsave të tyre, shqiptarët kërkojnë nga venecjanët të vendosen në dy nga kështjellat që ata porsa kishin marrë nga Melpiniano; në atë të Milonit dhe Shën Ilias dhe më tej akoma në Zoglo dhe Nikel.

Mbi bazën e kësaj kërkese të parashtruar nga prijsat shqiptare, më datë 22 Maj të këtij viti, Senati Venedikas miraton vendosjen e tyre në këto anë të kërkuara nga ata,

1. K. Satha: *Mnimia tis eleniqis historias*, Vëll I, Faqe 151

duke shtuar: "Muarrëm shkresën tuaj ku na bëni të njojur.... lutjen e parashturar nga dy udhëheqës (prijsa) shqiptarë, për të ardhur së bashku me bashkëatdhetarët e tyre nën mbrojtjen tonë, nën teritoret tona. Nga ata njëri (prijs) do të vijë me 5 000 kuaj (nënkupto burra lufte me armatimin e tyre - shënim i ynë) ndërsa tjetri me 500 kuaj... do t'u jepen terrene, toka pune e livadhe si dhe mjete të tjera të nevojshme që të mund të përballojnë nevojat e jetës dhe qëndrojnë në ato vende... në se do të ishte e nevojshme, apo do të vlerësohej e tillë, këta njerëz do të kishin mundësinë të shtinin në duart tona, nën pushtetin tonë tërë teritoret e atdheut të tyre - Moresë, duke amrrë përsipër ta ruajnë dhe mbrojnë atë sa nga turqit aq edhe nga të tjerë... përvendosjen e tyre në Zoglu, në Shën Ilia, në Milon dhe Nikla".¹⁾ Po për këtë rast studjuesi grek K. Biri na bën të njojur se përllogaritja e përgjithshme e numrit të popullsisë shqiptare të vendosur në këto zona duhet të jetë rreth 22 000 vetë.

Një zbritje tjetër e shqiptarëve në Peloponez u realizua edhe në periudhën e viteve 1373 - 1382 nën orjentimin dhe nxitjen e Dukës së Athinës Raniero Acciaiuoli, i cili krijoj disa koloni të tillë edhe në Argolidhe e Istm të Kornhit.²⁾

Çvendosje të popullsisë shqiptare nëpër trojet dhe hapsirat e Peloponezit gjemë edhe në kohë të tjera, por këto janë më të mëdhatë dhe të shumtët në numur. Kur themi këto, nuk kemi fjalën në ato çka kemi parashtruar ne deri më lart, por është fjala për shpërnguljet shqiptare në teritorët e Peloponezit në periudhën e këtyre dy shekujve. Gjatë periudhës së pushtimit turk ndodh fenomeni i kundërt, ai i largimit të një mase të popullsisë shqiptar nga këto vende. Por ka edhe ndonjë rast të veçantë që bën përjashtim nga kjo dukuri e përgjithshme. Kështu, "një shpërngulje e mëvonëshme evidentohet gati mbas dy shekujsh e gjysëm. mbas atyre të para, në prag të fushatës së Françisko

1. Po aty Vell I, Faqe 176

2. Egerem Çabei: Studime gjuhësore. Vell V, Faqe 56

Morozinit në Atike më 1687, atëherë një masë e madhe fshatarësh të zonave malore, vendosen në Istme dhe në Argolide...”¹⁾

Vite më vonë në territoret e Peloponezit zbrit një valë tjetër e madhe emigrantësh shqiptarë, e cila deri tani është fare pak e njojur në materialet historike. Eshtë fjala për zbritjet e koloneve shqiptare nga rrëthet e Prevezës, ato të Dibrës dhe ngazona e Myzeqesë. Kjo valë emigrimi realizohet në vitet 1770 dhe vendosen në Lala dhe Bardhuni.²⁾

Veç territoreve të Peloponezit, një nga zonat e cila u synua dhe tërroqi një masë të madhe të koloneve shqiptare në këta shekuj ishin edhe territoret e Atikës (krahina dhe fshatrat rrëth Athinës) dhe Beotisë (krhaina dhe fshatrat në vazhdim, rrëth Thivës). Në dokumentacionin e Arkivit mbretor të Barcelonës gjenden materiale të tillë të cilat bëjnë të njojur pikërisht këtë fenomen. Nga familjet shqiptare të vendosur në Thesali më 1350, një pjesë e tyre u detyrua të largohet mbas ndeshjeve të ashpra dhe të përgjakshme me ushtrinë e Stefan Dushanit. Mbas pushtimit të Thesalisë nga ana e hierarkut serb, një masë e madhe e kësaj popullsie, për t'i shpëtuar ndëshkimit hakmarrës të tij largohet dhe vendoset në Ftiotidhe, një pjesë në Dukatin e Athinës dhe një pjesë tjetër në atë të Nea Patronit.

Po në këto vite ka dëshmi të shumta për prezencën e shqiptarëve jo vetëm në krahinat periferike të Atikës rrëth Athinës, por edhe vetëm në qytetën, apo më saktë garnizonin ushtarëk të Athinës. Në vitin 1379 Dukati i Athinës i cili isht në duart e katalnëve, kalonte një periudhë të vështirë për shkak të goditjeve të vazhdueshme ushtarake që pësonte dhe së fundi të atyre të organizuara nga ana e navarezeve. Alfonso Fadrigues së bashku me komandantin e garnizonit ushtarëk të Athinës, shqiptarin Dhimitër Rendi organizojnë

-
1. *Jona M.Paidhusi; Ta Vilia tu Qitherona që ta arvanitika tragudhia tus. F.44*
 2. *T.Johalla: Mbi emigrimin e shqiptarëve në Greqi. F.11*

mbrojtjen e qytetit nga sulmi dhe rrithimi navarez. Në këtë kohë gjemjë të vendosur në Athinë dhe në garnizonin e saj 1500 kalorësh shqiptarë të ardhur nga zona e Livadhjasë dhe Thivës. Rezistenza, dhe mbrojtja e organizuar nën drejtimin e Dhimitër Rendit detyron navarezat të tërhiqen të thyer keq.

Në këtë rast tërheq vëmendjen figura e komandantit të garnizonit të Athinës Dhimitër Rendit, i cili çfaqet vazhdimisht në kronikat e këtyre kohëve si aleat i katalaneve dhe një nga figurat qendrore ushtarake dhe politike të kohës. Ai vendoset vërtet si një burrë që për ato kohë ndikon për rrjedhat e lëvizjeve politike të rajonit. Mjaft studjues, si A.Kolia, K.Biri dhe S.Llambros etimologjinë e fjalës Rendi e spjegojnë me shqipen i rëndë, - gur i rëndë, peshë e rëndë.

Gjenden dokumente në arkivin mbretëror të Aragonës ku bëhet e njojur se në dhjetor 1382 shqiptarët marrin leje për t'u vendosur në Atikë. Kërkesën për një të tillë e ka nisur pararendësi i Dukës të Athinës Vilanoves, - Rokaberti. Shqiptarët e ardhur këtu zënë vend jashtë qytetit të Athinës, rrëzë shkëmbit të Akropolit në anen veriore të tij - nga ku vijnë zakonisht inkursionet ushtarake për pushtimin e tij.¹⁾

Në kërkesën e dërguar nga duka katalanas i Athinës, mbretit të Argagones, ndër të tjera thuhet: "Ju bëjmë të njojur se ndjejmë të nevojshme vendosjen këtu të banorëve, qofshin greke apo shqiptare, duke u dhënë toka nga ato të Dukatit të Athinës, duke i çveshur nga taksat për dy vjet... "²⁾

Në po këto vite, Ipatia dhe dukati i saj ishte nën zotërimin e katalanasve. Në vitin 1383 prijsi i këtij dukati, Ramon de Vilanova, për të siguruar krahinën e Beotisë nga ana veriore e saj, mori nga territoret e Ipatias një numur shqiptarësh së bashku me familjet e tyre dhe i vendosi në këto zona duke u dhënë prona e tokë me kushte të njëjta si të emigrantëve të

1. Aristidhi Kolia: "Arvanitë që i katagogji ton elinon..."
F. 130

2. A.Rubio Y Lluch: "Los Navaros en Grecia", Faqe 112

tjerë që ata vendosen pranë kolonive të tyre. ¹⁾ Padyshim edhe në këtë rast vendosja e shqiptarëve në këto territore u bë me dekretin përkatës së mbretit katalanas Pedro i 4-t.

Shqiptarët e vendosur në këto anë formuan një numur të madh vendbanimesh të cilat i gjemjë edhe sot e kësaj dite në një numur të përafërt prej 30 fshatrash. Të tillë janë Qirjaqi, Zerki, Zagara, Mazi, Martino, Elikona, Hostja, etj. ku në mjaft prej tyre edhe sot flitet gjuha shqipe. ²⁾

Megjithëse ende nuk kemi dokumente që të na bëjnë të njojur se si dhe kur shkuan shqiptarë në zonën e Salonës, në një dokument që i takon vitit 1377 gjenet se katalanet që kontrollonin këto territore kishin aty si notar një qyter të thirrur Kosma De Durazzo (nga Durrësi). Dhe ky nënpunës i administratës katalanase nuk është i vetëm. Në këto dokumente gjejte evidencuar edhe shqiptarë të tjerë me emra që i takojnë vetëm kësaj kombësie si Kola, Noti, Pano Panushi, Nushi, Tane, Nasho, Taçi, Gogo, Dede, Laska, Laskari, Leka, Xhima, Lako, Ziko, Maro, Vjena, etj. ³⁾

Një pjesë tjetër e vendosjeve të popullsisë arbërore në teritorët e Atikës, Mesogjisë dhe në periferitë e qytetit të sotëm të Athinës është përmendur perkitazi edhe më parë. Të tjera grupime erdhën dhe u vendosën nën ftesat e venecjanëve, të Kantakuzinos, të Acciajuolit, etj. Ashtu sikurse në teritorë të tjera kontinentale apo ishullore të Greqisë edhe në këtë zonë, të Atikës dhe në vetë periferinë e kryeqytetit - Athinës gjenden një numur i madh fshatarash, më saktë pjesa dërrmuëse e tyre që janë të banuara nga arvanitas. Në këto vendbanime, relativisht moshat e ritura dhe pleqtë, pa përashtuar në fshatrat e thellësisë edhe të rinxjtë dinë dhe flasin edhe sot gjuhën shqipe.

Duke iu referuar viteve të mëparshme mbi strukturat demografike të këtyre zonave dhe të vetë qytetit të Athinës,

1. Po aty.

2. K.Biri, "Arvanitës qe i katagogjii ton elinon, Faqe 89

3. Po aty, Faqe 113

mësojmë se "brenda në qytetin e Athinës dhe në tërë zonat bujqësore rrëth tij, nuk banojnë popuj të tjerë veç turqve, grekëve dhe arvanitëve. Brenda në qytet ka fare pak frangë."

Në vazhdim të kësaj pasqyre, konsulli anglez i asaj kohe John Ziro na bën të njohur: "Turqit kanë pjesën më të madhe të arave si dhe një pjesë të vreshtave dhe të ullijve. Grekët kanë pjesën më të madhe të tokave me vreshtha dhe ullij, ndërsa arvanitët kanë pak ara. Afërsisht, para 30 vjetësh arvanitët ishin zotër të të tërë arave rrëth fshatrave. Por kur turqit filluan të venë njëra pas tjetrës taksa që arrin në masa 30 e 40 përqind... arvaniti i varfër duke mos pasur me se të paguajë taksat, u dha mjaft toka atyre..."

Në këtë mënyrë gati dy të tretat e tokave të arvanitëve tani ndodhen në duart e turqve. Për punimet e tyre ata tani përdorin ish pronarët e tyre, arvanitët." ¹⁾

Në një dokument tjeter të pak viteve më vonë bëhet e njohur se (1687) "...arvanitët e të ashtuquajturës Plakë, vazhdojnë të jetojnë në atë vend dhe thirren plakej".

Me interes është të përmendim në këtë rast dëshminë që na bie gati një shekull e gjysëm më vonë, për qytetin e Athinës, konsulli i njohur francez, Pukevili. Ai ndër të tjera shkruan: "Në Athinë banojnë 4 000 arvanitë, grekë 3 000 dhe turq 3 000 të tjerë."

Vetë emërtimi i lagjes "Plakë" (e cila emërtohet kështu edhe sot e kësaj dite) për shumicën dërmuese të autorëve spjegoitet me gjuhën shqipe "Plakë" e plakur, e vjetër. E argumentojnë kështu edhe me faktin se ky vend është konsideruar lagjia më plakë, më e vjetër, bille deri mbas revolucionit të vitit 1821, shumë banorë të këtij qyteti e thërrisin këtë lagje Athinë e vjetër." ²⁾

Prania e shqiptarëve, apo arvanitëve siç u thiren dhe vazhdojnë të thirren nga vendasit ata, - ka qenë vazhdimit tepër e madhe në të gjitha kohët dhe kryesisht në tërë zonat

1. Shkrimet e konsullit anglez John Ziro - 1674 - F.17
2. Kosta Biri: "Arvanitës" faqe 131

që përmendim pa mënjanuar këtu tërë teritoret e tjera greke. "Kur lexojmë shkrimtarë të huaj si Giraud, Guilletiere, etj. që shkruan për Atikën, krijohet përshtypja se këta njerëz nuk takuan në këtë zonë veç fshatra shqiptare dhe banorë shqiptarë. Por kjo nuk do të thotë se elementi vendas nuk kishte mbetur nga e kaluara, apo humbi në periudhën e kolonizimit të Atikës nga shqiptarët".¹⁾

Ashtu sikurse në krahina dhe hapsirat e tjera të Greqisë mesjetare, edhe në nguljet e saj në teritoret e Atikës, Mesogjios, rreth Athinës dhe ne vetë Athinë, popullsia shqiptare emërtoi me fjalë nga gjuha e saj vendbanimet e reja, fshatrat, vendkalimet, mjaft ara, burime, kodra etj.

Kështu në zonat Jugore e juglindore gjemë fshatrat: Spata, Lopsi, Koropi, Kaliva, Qeratea, Markopullo, Kuçi, etj. Sikamino, Bujati, Kamateru, Hasi, etj, Avlona, etj.

Nga veriu: Liosha, Skurta, Krora, Kavasila, Kakonishkiri, Shkurta, etj.

Në rrugën Lindje-Perëndim (Thive-Elefsine) shtrihen fshatrat Mazi, Krikuqi, Asopo, Kundura, Mandra, Elefsina, etj.

Disa nga vendbanimet që dikur kanë qenë fshatra rreth qytetit të Athinës dhe banoheshin nga arvanitë, me zhvillimet e mëdha urbane që ka marrë ky qytet dekadat e fundit këto fshatra tanimë janë kthyer në lagje të kryeqytetit. Lagje të tilla janë Varri, Qifisja, Imito, etj.

* * *

Sic kemi përmendor edhe më parë, shqiptarët në këta shekuj i gjemë të shpërngulen dhe vendosen edhe në territorë të tjera. Të tillë janë ishujt e Egjeut, Zaqintho, Qefalonja, Lefkadha ku aty u vendosën me ftesat e

1. J.M.Paidhusi: *Vilia.tu Qitherona që ta arvanitika tragudhia tis. F.46*

venecjanëve.

Gjithashtu ka patur shpërngulje dhe vendosje në numur të madh i shqiptarëve, rrëth Halkidhes dhe pothuaj në tërë territoret e ishullit të Eubesë. Vendbanimet e shumta arvanite në këtë ishull të cilat përllogariten të mbulojnë deri 60% të të gjithë territoreve janë lënë larg vëzhgimeve apo hulumtimeve shkencore. Me përashtim të një a dy rasteve të dokumentuara, nga ku mësojmë për vendosjen e shqiptarëve në dy koloni venecjane, për vendosjen e kësaj popullsie në territoret e tjera dhe veçanërisht ato jugore ku ajo gjendet me shumicë, nuk ka të dhëna së nga erdhi dhe si u vendos në to ajo.

Shtrirja dhe vendosja e kësaj popullsie përfshin edhe ishujt jugorë të Mesdheut dhe të Egjeut. Kështu vendosja "dhe kolonizime të rëndësishme nga shqiptarët janë kryer në Qikladet dhe në gjirin e Saronikos. Grupe të mëdha kolonesh shqiptare rritën ishujt e Andros, Hidas, Specias, Poros, Salaminas, Egjinjas, Angjistras ku edhe sot akoma stërnipërit e tyre përbëjnë një pjesë të rëndësishme të popullsisë së këtyre vendeve ruajnë ende mbiemrat e familjeve të tyre.

Grupe më të vegjël kolonesh shqiptare shkuant edhe në Kea, Kithnos, Hios,..." "...grupe të tilla u vendosën edhe në Samos, Psara, Kos dhe Skopellos... në to duhen parë deri emërtimet që ata u bënë vendbanimeve, fshatrave të tyre si Leka, Ano dhe Kato Arvanitas, Morja, etj." ¹⁾

"Deri aty rrëth viteve 1700 banorët e Arnas dhe të Amollokos dhe të ishujve përreth mbanin dhe përdornin akoma veshjet e tyre tradicionale shqiptare dhe jetonin me mënyrën e tyre të jetësës, pa ju nënshtuar pushtetit të pushtuesve turq dhe pa qëndruar besnikë të fesë". ²⁾

Nga disa njoftime të cilat vijnë nga fillimet e shekullit të 16 bëhet e njohur se edhe ishulli i Hidrës deri në këtë kohë ka qenë, i pabanuar. Por, mbas betejës së Nafpaktos më

1. Apostol Vakalopoulos: *Historia tu neo Helenizmi*, Vëll I, Selan 1964, F.29

2. Turneferd: "Relation...", Faqe 133-134

1571 e më konkretisht më 1580, kur udhëtari Andre Teretmasi kaloi aty, na bën të njohur se shumë familje shqiptarësh erdhën dhe u vendosën aty nga disa territorë greke bile deri nga krahinat jugore të vendit tonë si Vlora, Suli, etj.

Shumë nga banorët e sotëm të këtyre vendeve ruajnë edhe sot mbiemrat e stërgjyshëve të tyre të zbritur nga territoret e arbërit. Ndër to mund të përmendim: - Manesi, Pepiza, Dale-s, Lale-ja, Lalejani, Tolias, Toja, Krie-la (krye-lart), Mazi, Kumis, Guma, Tunda, Valma, Gjika, Gjikaqis, etj.¹⁾

* * * *

Pa dashur të rikthehem i tek vendosjet e familjeve ushtarake të shqiptarëve në ishujt Joniane, nën ftesat dhe vendimet e Senatit venedikas, me interes ishte në këtë rast përmendja e një pjese të mbiemrave të banorëve të këtyre ishujve. Kështu, në Zaqintho, Zguro, Matosi, Makri, Dushmani Marmori, Doksara, etj. në Qefaloni: Kladha, Menaja, Lukisa, në Korfuz: Buo, Buziqi, Barbasi, Veruha, Golemi, Gerbeshi.

Pikërisht nga këto dokumente, të arkivave venedikase evidencohet prezenca e kolonëve shqiptarë edhe në territorë të tjera ishullore të Greqisë si në Kretë, deri shumë thellë në Mesdhe, në ishullin e Qipros. Në vendim të Senatit që mban datën 30 Prill 1541 ndër të tjera thuhet:

"...të vendosen katër njësitë ushtarake të kalorësisë shqiptare me komandante prijsat Pavillo Bua, Repush Buziqi, Jorgji Gerbeshi dhe Aleksandër Gabriera... dhe të urdhërohen rangjet (funksionarët) tonë në Qipro, Kretë, Zaqintho, Qefaloni, Kretë dhe ishuj të tjerë për t'i ndihmuar... me toka, prona... etj".

1. Apostol Vakalopoulos: "Historia tu neo Helenizmu", Faqe 113

* * *

Valët e kolonizimeve shqiptare në periudhat e mesjetë përfshinë edhe territoret e Greqisë verilindore. Studimi i kujdeshëm i këtyre vendbanimeve është me interes për shumë arsyë, por veç të tjerave ai do të sqaronte në të kontaktet dhe lidhjet mes popullsisë së Arbërisë së jugut dhe territoreve të Maqedonisë klasike fillojnë në shekujt që përmendim apo shtrihen më herët, që nga periudhat e kohëve klasike? Në se vemosjet e popullsisë shqiptare në këto territorë janë realizuar në ato kohë kur ndodhën emigrimet e mëdha nëpër territoret e tjera të Greqisë mesjetare apo shtegëtimet në këto anë janë të kohëve dhe periudhave të tjera? Sa dhe si ndikoi në këtë çështje arteri i lëvizjeve të mëdha urbane - "vija egnatia" në proceset e lëvizjes dhe emigrimit të kësaj popullsie? etj.

Megjithëse janë të pakta materialet e shfletuara deri tanë nga kancelaritë bizantine, evidente është kudo fakti që të paktën që prej shekullit të 15-të dhe më pas gjemë në zonat e Greqisë Lindore dhe më gjërë praninë e shqiptarëve.

Kur udhëtarë Bellon kalonte në mesin e shekullit të 16 në këto zona ndeshi aty në grupe të mëdha punëtorësh dhe fshatarësh shqiptarë në zonat e Maqedonisë, Thrakes dhe Azisë Vogël... ata ishin ndërtues, mjeshtër apo tregtarë. Vendasit u thërrisin atyre mastorohorja." ¹⁾

Në shekullin e 19-të, në zonat e Maqedonisë, Likobiqia, Pangeon, etj gjendet e vemosur një masë e madhe emigrantesh shqiptare, të ardhur nga Shqipëria, Thesalia dhe Epiri. Veç këtyre në këto zona ka edhe punëtorë sezionale shqiptarë që thirrën "gege". ²⁾ Siç thekson studjesi Gerlach "ata (shqiptarët janë ndërtues të mirë, ngrenë kisha të mrekullueshme, saraje dhe hanë...")

1. A. Vakalopoulos: "History of Macedonia", Faqe 151
2. Po aty, Faqe 152

Një dëshmi me interes është ajo e shekullit të 15-të, philigrim Rus, ku Isaiah referon se priftëritë e Halqidhiqisë dhe të manastideve të atyshme merreshin vetë me punë të ndryshme deri me kultivimin e tokës rrëth këtyre manastireve, objekte kulti këto nga të cilat gjysmat, janë shqiptarë dhe gjysmat sllave.¹⁾

Njoftimit të mësipërm i shtohen edhe të dhëna të tjera mbi këtë zonë tepër interesante sa nga pikpmja relixhioze aq edhe nga ajo kulturore dhe historike për vendin tonë. Në terrenet e shenjtë të Agjio Orosit ku gjenden manastiret e famshëm mesjetare, siç u tha më sipër, një pjesë e madhe e tyre kanë qenë manastirë shqiptarë. Ndër ta bën pjesë edhe ai i Shën Dhimitrit, i cili është më i madhi i tyre. Ditëkrijimi i tyre është tepër i hershë. Ato filluan të ndërtohen që prej shekuje të 11-të dhe me të rrijtë u ndërtuan në shekujt e 17-të. Eshtë e kuptueshme që këto manastire u ngritën jo thjesht për nevoja dekorative, por për t'u shërbyer nevojave shpirtërore të banorëve të aytre anëve. Nga ana tjetër këta manastirë nuk ka se si të ishin shqiptarë, në se popullsia që kishte nevojë për ta dhe subvenciononte për ngritjen e tyre nuk ishte shqiptare. Këtë detyrohet ta pohoje edhe vetë A. Vakalopunos i cili bën të njohur se në zonën e Halqidhiqisë ka pasur një numur fshatrash me popullsi shqiptare... Kështu edhe Manastirët e Karakallut dhe Filotheit që ndodhen në Athos pranë manastirit të famshëm të Lavrës së Madhe, ajnë manastire shqiptare që u kanë shërbyer dhe u shërbejnë shqiptarëve të atjeshëm.

Për kohën se kur shkuan dhe u ngulën këto koloni shqiptare në këto anë ende nuk është shfletuar ndonjë material konkret, por në se do t'u referohemi datave të ndërtimit të tyre, në mënyrë të kuptueshme do të pranonim se të paktën që nga koha e ndërtimit ka pasur vendbanime me popullsi shqiptare në këto anë.

Duke i u referuar pak jetës dhe aktivitetit relixhioz të

1. Klitrevo - Halqidhiqi - Faqe 259

Këtyre manastireve do të bënim të njojur së liturgjitetetetarë
në shqip në to kanë qenë të vazhdueshme deri para pak
dekadash. Në njërij prej tyre, këto rite në gjuhën tonë
vazhduna deri aty rrëth viteve 1960, kohë në të cilën vdiq
prifti i fundit, i cili nuk u zëvendësua nga dikush tjetër.

Praktika zyrtare e veprimtarisë së këtyre manastirëve ka qenë e tillë që çdo manastir sipas përkatësisë etnikë që kish (sepse në këto anë ka edhe manastir rumun, me murg rumun, edhe manastir rus me murg rus, edhe manastir shqiptar me murg shqiptar... etj.) të dërgonte në mënyrë periodike priftërij dhe murgj për të zëvendësuar ata që vdisnin, pér të ruajtur kështu vazhdimësinë dhe realizuar detyrimet ndaj popullsisë së atjeshme.

Eshtë me vlerë të përmendet se pjesa më e madhe e manastireve të Agjio Orosit kanë një dokumentacion arkival të pasur që nga koha në krijimit të tyre. Nga sa njohim të paktën njëri prej këtyre manastireve shqiptare ka materiale shkrimore arkivale, i cili padyshim do të jetë me interesa jo të vogla shkencore dhe historike, pa përashtuar edhe ato relixhioze.

Këto territore mbajnë në gjirin e tyre edhe mijtë monumente me vlera të pallogaritshme për kulturën shqiptare në përgjithësi dhe për artet figurative në veçanti. Në manastirin Kryesor të këtyre vendeve të shpallura - të shenjta - në atë të Lavrës së Madhe, në terrenet përreth tij gjendet varri i njërit prej gjigantëve të muzikës së bizantit, të reformatorit që bëri epokë në këto fusha, ai i Jan Kukuzelit. Do të ishte me vlera hulumtimi i faktit se përsë ky kolos i muzikës, në kulmin e novacioneve të tij u largua nga metropolia e oborreve perandorake dhe u vendos në këto vende të largëta dhe disi i braktisur. Interesant është se ai shkoi e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij, deri sa vdiq pikërisht në këto ambjente ku rrëth e rrotull tij duhet të ketë pasur popullsi shqiptare.

Në po këtë Manastir dhe në mjaft të tjera kanë mbetur të gdhendur me penelata magjike portretet dhe kompozimet e mahnitshme të piktorit tonë të madh Zografo dhe të të bijve të tij. Vetë kupola qendrore e Lavres është ilustruar pikërisht

nga ky talent i papërsërishëm i artit figurativ bizantin dhe në fund me dorën e tij ai ka lënë shënimin se: "...tabloja është realizuar në kujtim të qytetit nga vij-Korçës". E shkruar në alfabetin grek (cirilik) është interesant se fjala - Korçë - , nga autori është shkruar pikërisht siç e shkruajmë dhe e theksojmë ne atë dhe jo si e shkruajnë dhe shqiptojnë grekët - Korica.

Studjuesi i historisë së territoreve të Maqedonisë greke, Vakalopulo na bën të njohur se "zbritja e shqiptarëve dhe e sllavëve në Maqedoni dhe Thrakë është një karakteristikë e dukshme... dhe veçamas kjo e ndjeshme në shekullin e 14-të dhe të 15-të, pra pragun e fillimet e pushtimeve turke." ¹⁾

Një valë e re shpërnguljesh në këto territore çfaqet edhe në shekullin e 18-të. "Në periudhën e viteve 1769-1779 e më vonë, evidentohet përmes dokumentacionit një valë e re shpërnguljesh nga Epiri dhe Shqipëria, - nga Nikolica, Voskopoja, Korça, etj. - përnë drejtim të Maqedonisë Jugore... Ata ishin kryesish artizane, robaqepës, argjendarë, etj.

Në anët perëndimore të Krushevos ishte formuar një zonë e tërë vendbanimesh me familje shqiptare (shqipfolësish) të ardhur nga Vithkuqi e Opari të cilët zbritën në këto territore të drejtuar nga priftërijtë Efstatio dhe Janaq. Këta emigrantë merreshin kryesish me tregëti. Kushtet në të cilat ata ndodheshin dhe kontaktet e vazhdueshme vetëm me banorët e fshatrave jo shqiptare, bëri që ata të humbasin gjuhën e tyre shqipe." ²⁾

Popullsinë shqiptare e gjejmë të vendosur në mjaft territorë të Maqedonisë dhe të Thrakes - greke. Domethënësë është prania e saj numerikisht e madhe edhe në vetë qytetin e Selanikut. "Në fillimin e shekullit të 18-të më 1787, në kohën e rebelimit të Pashait të Shkodrës, Mahmutit - biri i Mehmetit, kur ai mori Manastirin dhë me ushtrinë e tij iu drejtua Selanikut, brenda në këtë qytet ishte shpallur alarmi edhe përfaktin se aty banonin rreth 3 000 shqiptarë, të cilët nuk

1. A. Vakalopoulos: "The history of Macedonia", Faqe 167
2. S. Bellas: Istorya tu Kryshevo. Faqe 19

përjashtohej të ndihmonin nga brenda qytetit Mehmetin i cili kërcënonte...”¹⁾

Pothuaj përtë njëjtën periudhë kohë ka një dëshmi tjetër me interes e cila përforcon shifrat e dhëna për popullsinë shqiptare në këtë qytet me rëndësi dhe më të madhin e territoreve lindore të Greqisë. Në kohën e revoltave dhe të operacioneve të vazhdueshme të komiteve, - çetat dhe formacionet e mëdha të komiteve në pjesën më të madhe të tyre siç do të shohim përbëheshin nga shqiptarë edhe në këto krahina, - “komandanti turk Abdi Pasha, në vitin 1779 me mbi 1 000 ushtarë, qëndroi në Selanik përtë përfunduar misionin që kishte nisur me kohë para tij Kaptan Pasahi dhe përtë nxjerrë jashtë territoreve të këtij qarku shqiptarët. Por, numri i shqiptarëve që jetonin në këto zona si dhe brenda qytetit të Selanikut ishte jashtëzakonisht i madh... Konsulli francez i kësaj kohe bën të njojur se shqiptarët në Selanik ishin rrëth 4 000 vetë”. (në qytet)²⁾ Kjo shifër merr vlerën e saj reale duke pas parasysh se numri total i banorve të qytetit është atë kohë ish rrëth 9.000 vetë.

Veç ngulmimive shqiptare në territoret e mësipërme, një masë prej gati 14 000 banorësh e shtrirë nëpër fshatra të tjerë gjendet edhe në kufij me Turqinë pranë Aleksandropullit dhe Ksanhit. Kjo popullsi nga sa spjegojnë edhe vetë banorët e atyshëm ka një periudhë më të re ngulimi. Ajo është vendosur në dy shekujt e fundit dhe një pjesë tjetër e saj vetëm njëqindvjeçarin që vijon. Një pjese ka shkuar dhe është vendosur aty nga territoret jugore dhe juglindore të vendit tonë, ndërsa pjesa tjetër e tyre është popullsi shqiptare e rishpërngulur fillimisht nga Shqipëria në Turqi dhe mandej nga këto territorë në vendbanimet aktuale. Kjo popullsi në Turqi ka qënë më banim në fshatrat e buzë detit të Zi si Ibrik Tepe, etj prej ku u shpërngulën edhe fmailajrët dhe të afërmët e Fan Nolit. Vetë motra dhe nipi i këtij të fundit banonin

1. A. Vakalopoulos: *The history of Macedonia*, Faqe 475
2. Po aty, faqe 340

pikërisht në këto ambjente dhe po aty vazhdojnë të jetojnë pinjollët e tjerë të kësaj dere.

Që prej shekujve 14-15 në zonat e Maqedonisë greke dhe të Thrakes greke, veç ngulmimive të hershme shqiptare dhe atyre të vendosura më vonë, nëpër to kanë qenë prezent në mënyrë periodike një numur tjetër i madh shqiptarësh sezionale. Ata vinin në periudha të caktuara të vitit, për punë stinore bujqësie apo edhe për ndërtime e artizane dhe mbas një qëndrimi disa mujor riktheheshin në vendin e tyre.

Nga një dëshmi që na vjen nga shekulli i 16, ndërt të tjera thuhet; "nga vitet 1530 në 1560 gjendeshin në zonën e (Seresit) Siderokastros mbi 6 000 punëtorë kryesisht shqiptarë, grekë, çifutë, etj. Ata punonin nëpër minierat e argjenti, të floririt si dhe në furrat e shkrirjes së këtyre metaleve që ishin me dhjetra në këto zona..." ¹⁾

Në këtë masë punëtorësh të minierave dhe të furrave të shkrirjes ne nuk arrijmë dot të mësojmë se sa prej tyre ishin vendosur me banim dhe sa të tjerë ishin punëtorë sezonalë, megjithatë kjo nuk përjashton mundësinë e vendbanimeve me popullsi shqiptare në këto zona, t'ë cilat nuk kanë qenë larg vendbanime të natyrshme të shqiptarëve në ato kohë.

Për praninë e vazhdueshme të emigrantëve sezionale ekonomike në këto territor kemi edhe dëshminë e udhëtarit anglez Beloni i cili rrëth gati 4 shekuj më parë na bën të njojur se në thellësitë zonave të Selanikut ai pa "grupe të mëdha shqiptarësh punëtorë dhe fshatarë që ktheheshin për në atdheun e tyre. këta ishin punëtorë sezonalë që emigrasin për të punuar vetëm gjatë muajve të verës. ishin tmerrësisht të varfër, gati të gjithë të zbathut por punëtorë të mirë dhe ekonomiqarë. Me kursimet e tyre të verës, ata mbanin familjet e tyre gjatë dimrit". ²⁾

Ndërsa, "në zonat e Halqidhqisë deri në fillimet e shekullit të 20 kishte vazhdimisht punëtorë sezionale shqiptare, të

1. A. Vakalopoulos: *The history of Macedonia*, Faqe 155

2. Belon: "Observations", Faqe 62-63

ashtuquajtur "gege" të cilët punonin kryesisht për nevojat e punëve në bujqësi..."¹⁾

Emigrimi dhe zbritjet shqiptare në këto territore, në dallim nga tërë krahinat e tjera të shtetit grek, kanë qenë periodikë dhe megjithëse në numur të vogël ato kanë qenë të pandërprera. Mund të themi se deri në periudhën e viteve 1940 emigrantë punëtorë shqiptarë kanë shkuar në zoant e maqedonisë greke rregullisht, kryesisht në periudhat e vetes, për punë ndërtimi, bujqësie apo fusha të tjera të artizanatit. Kontributi i tyre në fushën e ndërtimitarisë të mjaft objektesh kulti, banimi, etj është pothuaj i pastudjuar. Mjaft ndërtime karakteristike, kryesisht në objekte kulti, ushtarake si dhe banesa që sot në Greqi konsiderohen si monumente kulture vlen të zbulohet kontributi i mjeshtave shqiptarë. Ndër to mund të përmendim objekte në formë kulle apo konstruktione të tjera të cilat edhe nga vendasit vlerësohen si objekte me tipare shqiptare. Ndër to si më të freskëta mund të përmendim ndërtimet e fshatit Pilion mbi qytetin e Vollosit i cili u ndërtua nga mjeshtër shqiptarë mbas tërmetit të njohur të dekadave të fundit. (Ndërtyesit e këtij fshati të veçantë dhe tanimë turistik ishin shqiptarët dhe muratorët e njohur të fshatit Negovan, rrëth viteve '50).

Një masë e madhe punëtorësh sezionale që shkonin në mënyrë periodike në Halqidhiqi ishin druvare dhe një pjesë tjetër, të cilët nijhen edhe sot si të tillë, ishin qymurbërës. Në tërë këto zona të thella e krahina greke ka një numur fshatrash shqiptare ku edhe sot flitet gjuha shqipe, e braktisur dhe e lënë si një relikë të brezit të vjetër.

1. A. Vakalopoulos: *The history of Macedonia*, Faqe 152 Nik.

Ekonomidhi; "Punëdhënësit grekë, punëtorët sllavë në Halqidhiqi dhe puna e tyre në periudhë, pushtimit turk.
F. 194

Pikërisht nga kjo popullsi me virtyte të veçanta luftarake, e zbritur dhe shpërndarë në tërë trojet greke ishte e natyrshme të lindin personalitete ushtarake qe do të bënин emër në këtë perandori. Ndërsa ne do të përmendim vetëm dy prej tyre të cilët dualën nga radhët e shqiptarëve të vendosur në territorët greke në këta shekuj të emigrimeve të mëdha.

SGURUA - është një nga ushtarakët shqiptare të cilin perandori i Bizantit Manuel Komnino me 1180 e caktoi atë Princ (arhond) të Nafplio një bazë dhe pikë e rëndësishme detare-toksore strategjike. Në dokumentacionin e kohës deri më sot nuk arrijmë të gjejmë emrin e tij.

Ajo qe tërheq vëmendjen në karjerën e këtij personaliteti është realizimi i operacioneve ushtarake të suksesshme kundër piraterisë. Në vitin 1199, perandori bizantin Aleis i III Angjelo ngarkon pikërisht Sguron përtë realizuar këtë detyrë, të luftojë dhe zhdukë piraterinë detare e cila ishte përhapur dhe përbënte rrezik dhe shqetësimin kryesor për ato kohë. Falë natyrë dhe aftësive të tij në realizimin e këtij misioni, perandori ngarkon banorët e zonës të paguajnë për këtë detyrë Sguron.

Deri më sot nuk kemi shumë të dhëna të tjera për këtë figurë, vetëm atë që ky princ i ashëpër vdes më 1213. Por, ato të dhëna të pakta të biografisë së tij plotësohen nga biografia e pasur dhetronditse e të birit LEON SGURO, i cili zëvendëson të jatin fill mbas vdekjes së tij.

Kur nuk kishte ende kohë që kishte marrë në trashëgim që froni nga i jati, duke menduar se djaloshi i ri kishte ende të pakonsoliduar pushtetin, se eksperiencia e tij politike dhe ushtarake ishte e pamjaftueshme, - rivalet e tij të afërt politike menduan ta godasin atë menjëherë pa i lënë shumë kohë dhe terene fuqizimi. Nikollau, Peshkopi i Korinthit, që ishte në të njëjtën kohë edhe zot i kësaj Principate duke dashur të shtrijë dhe zgjerojë kufijtë e principatës duke futur në territorët e saj edhe Argosin e Nafplion, sulmon me forcat e tij këto anë.

Mbas betejasht ë ashpra, Leon Sguro arrin të shkëpusë nga duart e Peshkopit Nafplion dhe Argosin dhe e rrëthon atë vetë pa i lënë asnjë shpresë dhe shteg shpëtimi. Ky Peshkop i tmerrshëm duke parë se fundi i tij ishte i pashmangshëm, pa shpresa të mëtejme shpëtimi, dorëzohet pa lavdi të Leon Sgurua.

Megjithë gjestin e mësipërm dhe mëshirës së kërkuar prej tij, Leoni nuk e fal ate. Ai shpall se përkurajon që ai kishte marrë dhe kish sulmuar territoret e tij, Peshkopi të verbohet. Dhe jo vetëm kaq po mbas këtij gjesti, Leoni urdhëron dhe despoti mandej mbytet i gjallë në det.

Ky gjest i tmerrshëm i Leonit mbas fitores së tij mbi Nikollaun, u përhap me llahtar në mjafë ambjente dhe gjen pasqytim në shumë shkrime të kohës.

Më 1202, në kundërpërgjigje Leon Sgurua i drejtohet me ushtarët e tij Principatës së Athinës. Despoti i saj, Princi Mihal mbas dështimit në betejën e hapur, tërhoqet dhe mbylljet në garnizonin e përforcuar-kështjellën e Akropolit. Por Sgurua e ndjek, djeg dhe shkatërron Athinën duke lënë të mbullur brenda në akropol Mihalin.

Mbas fitores mbi Athinën, me ushtrinë e tij Leoni i drejtohet Tebes. Me operacionete tij të suksesshme ushtarake arrin të marrë edhe këtë principatë duke i zgjeruar edhe më tej territoret e zotërimeve të veta.

Pa humbur kohë ai sulmon territoret e Thesalisë. Arrin të dalë fitimtar edhe mbi to duke i nënshtruar dhe shpallet zot i Larisës. Në vitin 1207 ai shpallet dhe njihet si Sevastokrat dhe i jepet vula.

Në vitin 1207 Leon Sguro ndeshet në beteja të ashpra me ushtritë e Lombardeve. Si përherë i suksesshëm edhe në këtë rast ai del fitimtar mbi ta duke i thyer e shpartalluar keqas tërësisht. Duke i ndjekur në shpartallim me kalin e tij, ai goditet nga pas me një shigjetë e më pas vdes.

Përkëtë figurë tepër vitale, me një dinamizëm të veçantë, me aftësi të përzgjedhura ushtarake, me kuraje vërtet luanindeshen mjafë shkrime e komente nga bashkëkohës apo historjanë të periudhave të ndryshme në bizat. Ai çfaqet

në këto shkrime një figurë kontradiktore. Në disa prej tyre ai vlerësohet si një figurë e tmerrshme barbari - kryesisht e motivuara kjo përfaktin se ai arriti jo vetëm të ngrëjë dorë por të godasë dhe të ndëshkojë deri me vdekje një njeri të kishës siç ishte Nikollau-kryepeshkopi i Korinthit. Padyshim, kjo ndërmarrje e tij nuk ishte një akt i lehtë edhe para pushtetit politik qëndror bizantin. Dihet që kisha në këta shekuj kishte një pushtet të padiskutueshëm. Ndëshkimi i saj, si një pjesë e fuqishme e administratës shtetërore bizantine do të sillte reagime të paktën në fushën e letrave dhe të kancelarive, siç e gjejmë de faktō edhe sot.

Por jashtë kësaj indicjeje, historjane dhe analiste realiste dhe të pavarur e shpallin dhe e vlerësojnë këtë figurë komplekse ushtarake dhe politike një fenomen të veçantë me vlera dhe tipare të dallueshme kurajoze ndoshta më i përgjedhuri në periudhën e shekujve 12-14.

Një tjetër figrë interesante që rrjedh nga radhët e figuzimit arbëror të këtyre shekujve, të vendosur në teritorët greke, që ka krijuar emër dhe lënë gjurmë të thella në këto kohë është ajo e shqiptarit të Athinës Dhimitër RENDI.

Dhimitër rendin e gjejmë rreth viteve 1379 si aleat të katalaneve në bmbrojtje të qytetit të Athinës dhe te kështjellës së saj kur ajo sulmohet nga falangat e frangëve.

Pikërisht në këtë kohë gjejmë Rendin si aleat të katalaneve dhe jo vetëm kaq por edhe drejtues e frymëzues përtë. Ai së bashku me komandantin katalanas të garnizonit të Athinës, organizon mbrojtjen e qytetit. Nën drejtimin e tij forcat katalanase jo vetëm arrijnë të përballojnë sulmet e koalicionit franko-bask, por mbas rrezistencës aktive të tyre, ato kalojnë në ofensive jashtë mureve të akropolit. Në këto përleshje forcat katalanse arrijnë të mposhtin kundershtarët nën udhëheqjen e Rendit.

Në vitet 1379-1380 legjione të fuqishme navaresh shtrinin operacionet e tyre ushtarake në territorët greke. mbasi ishin bërë zotër të territorëve të Beotisë, me insistim ata synojnë të shtien në dorë tërë dukatin e Athinës. Keshtu, at anisin marshimet e tyre duke nënshtruar territorët përreth derisa

arrijnë pranë mureve të qytetit të Athinës. Edhe në këtë rast organizimin e mbrojtjes së qytetit e realizon Rendi i cili edhe një herë çfaq tipare tjetër të dalluara të organizimit, rrezistencës, durimit, qëndresës heroike dhe së fundi të sulmeve të papritura me anë të të cilave ai arrin ti godasë keqas e mposhtë dhe përfundimisht ti largojë nga tërë territoret e atikës, mavarezet.

Mbas ndeshjeve të ashpra me fjorentinasit nën komandën e Neriu Axhajolit, të cilët kishin zgjeruar zotërimet e tyre rrëth Atikës, kur shpresat e këtyre të fundit duket se ihsin prerë për të marrë Athinën e cila mbrohej nën komandën e Rendit, tamam në këtë kohë shohin vejza e Rendit të bëhet bashkëshorte e Axhajolit. Rrethanat e kësaj martese disi të çuditshme mbeten ende të paspjegueshme. Nuk dihet në se ky ishte një veprim i rrafinuar i Rendit për të larguar kundërshtarin e tij të rrezikshëm apo është ndonjë rrëmbim i mundshëm i vajzës nga fjorentinasi për të realizuar paqen me Rendin, mbasi gjuha e shpatës me sa dukej ishte pa frute për të.

Pikërisht për shkak të shërbimeve të tij ndaj interesave katalanse, sukseseve dhe fitoreve që ai u dhuroi atyre jo vetëm në ato ndeshje që pamë por edhe në të tjera të mëvonshme, Mbreti i Argones Pedro i Katërt, në prill të vitit 1381 nga Saragosa, u dërgonte gjithë shqiptarëve të vendosur në territoret greke dhe Dimitër Rendit një letër përshëndetjeje dhe falenderimi.

Jo vetëm kaq por studjesi spanjoll i ekspansionit katalan në territoret e ballkanit Lluch evidenton në materialin studimor të tij vec të tjerave dhe pronat që i u dhuruan këtij aleati dhe frymëzuesi të katalanasve nëpër territoret e Atikës dhe ato të Beotisë.¹⁾

Në materialin historik të periudhës së invazioneve

1. A.Rubio y Luch: *Los Navarros en Grecia y el Ducado Catalan de Atenas de su invasion.* Barcelona 1886, Faqe 262.

katalane në territoret greke gjendet një lenede mjaft e pasur për këtë figurë të rëndësishme të kohës që ka luajtur një rol aktiv në zhvillimet politike dhe ushtarake të këtyre trevave dhe veçanërisht për realizimin e konsolidimin e hegemonisë në këto anë.

* * *

Në këtë periudhë shekujsh në materialet arkivale gjenden edhe një numur tjetër jo i vogël figurash me rëndësi të veçantë politike, ushtarake, kulturore, etj. të shpërndarur a emigruar në territoret e Ballkanit jugor. Mund këtu vetëm të përmendim VRANAJT, - Marino Vranen Gjeneral i Konstandinit, Monomakut, - Mihal Vrana gjeneral i Manuil Komnenes, - Nikolla Vrana, etj. Gjergj Vrana gjeneral i Manuil Komninos, Aleks Vrana gjeneral i Isak Komnenit, etj.¹⁾.

Një numur i madh nga familja e Bujave, çfaqen kudo nëpër territore greke si strategë ushtarakë të rëndësishëm që vendosin për fatet e lëvizjeve politike dhe ushtarake të principatave të ndryshme të bizantit. Por, pinjollët e kësaj dere të madhe vazhdojnë rrugën e tyre edhe në shekujt e ardhshëm duke lënë gjurmë jo vetëm ne territoret greke por edhe më gjërë nëpër Evropë.

Nëpër analet ushtarake, politike dhe diplomatike të këtyre kohëve çfaqen herë pas here mjaft figura luftëtaresh shqipëtare apo me origjinë nga vendi ynë. Shumë prej tyre fatkeqsisht kanë mbetur të parëmuar nga radhët e fashikujve apo kronikave të kohës duke lënë kështu të mangët kronikën biografike të vendit për ato kohë, të tjerë janë prekur vetëm kalimthi. Megjithatë kemi bindjen se koha do ta bëjë vërtetësisht të sajën dhe pasjonet shkencore e patriotike do të nxisin edhe më tej stjudesit të ngulmojnë në gjetjen,

1. A.Kolia "Arvanitët", F.140

qemtimin dhe hapjen para kësaj bote të ngjarjeve me rëndësi kombëtare dhe të personaliteteve të ndritura që i udhëhoqën dhe glorifikuan ato, duke shtuar fondet e altarit të krenarisë tonë kombëtare.

PUSHTIMI OSMAN I TERRITOREVE GREKE, DHE QENDRESA E POPULLSISE ARVANITE

Me përpjekje të guximshme, me këmbë përherë në yzngjitë e luftrave, me shpirt kurajoz dhe të panënshtuar përballë invazioneve dhe inkursioneve barbare, popullsia shqiptare zbriti dhe u vendos nëpër territoret e braktisura dhe gjysëm të braktisura të Greqisë. Veç të tjerave ajo synonte, të rilindë jetën në këto territore që dikur kishin difuzuar kulturë, politikë, filozofi, art dhe shkencë ndër botën mesdhetare dhe më gjërë. Tokat ku u vendosën arbëreshët ata i konsideruan si një atdhe të ri, duke mbajtur të gjalla vetitë dhe tiparet e mbrijtura në tokën arbërore.

Mbas shumë vitesh e dekadash lufte, qëndresë, gjëzimesh dhe hidhërimesh, nga kjo popullsi kishin lindur tanimë edhe gjeneratat e reja në këto territore. Këto brezni tanimë ndjenin se ndodheshin në tokat dhe atdheun e tyre dhe gjithçka që synonte apo cënonte këto territore, lidhej drejtpërdrejt me të dhe fatet e saj. Fillimisht kjo popullsi kishte detyrimet ushtarake të stratiotit. Me kohë, për vetë zhvillimet politike, kushtet ligjore ishin shfuqizuar shumë shpejt dhe popullsia qëndronte në këto anë si një banore e mirfilltë pa kushte politike të dallueshme nga vendasit autoktonë.

Nga natyra e saj kjo popullsi dallohej në radhën e popujve të tjerë të Ballkanit edhe për tiparet e saj të mosnënshtimit para synimeve skillavëruese dhe për shpirtin

e saj të lirë e luftarak.

Për këto arsyen qysh në fundin e shekullit të 14-të dhe fillimin e shekullit të 15-të, atëherë kur osmanët zbritën me inkursionet e para ushtarake në territoret greke, njësitë e para që u ndeshen me ta ishin ato të shqiptarëve.

Sic bëhet e njojur nga analet historike, osmanët zbritën fillimisht në këto territore të vendeve ballkanike të ftuar nga vetë princi i ballkanas, të cilët në grindjet e vazhdueshme me njëri-tjetrin, thirrën për ndihmë reparte osmane. Duke pasur synime krijimin e një perandorie osmane me përmasa tepër të mëdha, këto reparte nuk kursyen të vinin fillimisht për nevoja inspektimi dhe njojjeje të territoreve, që më pas ata do t'i pushtonin.

Mbasi osmanët ishin përgatitur për një mësymje totale mbi territoret ballkanike përfshi dhe ato greke, filluan operacionet e tyre ushtarake nga toka apo nga deti. Duke iu drejtuar fillimisht pikave më të rëndësishme strategjike ata synonin të krijonin lehtësi për zgjerimin e territoreve të perandorisë së ardhshme. Por, sic kemi bërë të njojur nëpër këto zona të ndjeshme me rëndësi strategjike ishin vendosur dh kishin krijuar "katunet" popullsia shqiptare. Kështu, që në fillimet e operacioneve të para ushtarake osmane, në territoret e Greqisë gjejmë ndeshje shumë të ashpra dhe të përgjakshme mes osmanëve dhe popullsisë shqiptare.

Popullsia shqiptare ishte ndeshur me këto njësi që zbrisnin nga Anadolli që në vitin 1358, në fushën e Ahelout, kur aleanca greko-serbe-osmane e drejtuar nga Niqifor Angjelo u ndesh me repartet e luftëtarëve shqiptarë të komanduara nga Karl Topia e Gjin Bue Spata. Në këtë rast forcat osmane ishin thërritur në aleancë nga princi i greke. Pak kohë më pas reparte jeniçerësh u thërritën për ndihmë nga princi i serbë Uroshine. Edhe Paleologët, perandorët e Bizantit në rënim i thërrasin në shumë raste konfliktesh të brendshme. Aq prezente bëhen trupat osmane nëpër territoret greke, sa kur vetë princi që i patën ftuar ato kujtohen një ditë t'i largojnë, mbasi misioni i tyre kishte mbaruar, repartet osmane jo vetëm nuk pranojnë por edhe kërcënojnë dhe

godasin vetë despotët grekë.

Kështu, në vitin 1397 osmanët zbresin të përqëndruar me një forcë prej 60 000 vetësh dhe fillojnë fushatën e tyre ushtarake kundër territoreve greke, duke goditur së pari Argosin në Peloponez. Ky operacion i ashpër drejtohej nga Gjenerali Ejup. Në përlleshjet e përgjakshme dhe të pabarabarta turqit osmanë arrijnë të fitojnë kundër forcave vendase, numrin më të madh të cilave e përbënë shqiptarët e vendosur në këto anë. Si hakmarrje ndaj rrezistencës aktive të vendasve, ai merr me vehte rreth 30.000 vetë robër dhe i çon ata në Anadoll.¹⁾

Që në inkursionet e para të reparteve osmane, popullsia shqiptare kishte reaguar energjikisht dhe ishte e qartë se "kjo popullsi në këto vendbanime të reja të gadishullit Helenik dhe në Peloponez nuk do të nënshtrohej heshturazi operacioneve pushtuese turke...me vyrtute të tillë, të shkëlqyera të përcjella nga një vend krenar..." ata do të luftonin dhe qëndronin heroikisht duke bërë një histori të veçantë në biografinë e lavdishme të tij.²⁾ Në këtë mënyrë, kjo rracë me tipare të veçnata nationale, lindit një popull herojsh që përmbi 400 vjet të çfaqur si stratjote. armatolle dhe klefte (kaçakë) qendroi dhe luftoi burrërisht kundër dinastive osmane në tokë dhe në det me heroizëm dhe me lavdi, duke tronditur, mrekulluar dhe prekur tërë botën e qytetëruar..³⁾

Në periudhën e gjysmës së dytë të shekullit të 14-të, kur formacionet ushtarake osmane filluan operacionet e drejtpërdrejta për pushimin e territoreve greke, popullsia shqiptare formonte një komunitet të rëndësishëm nacional dhe përpos kësaj një rezerve të madhe dhe të fuqishme ushtarake., Dokumentet e kohës njoftojnë se vetëm në

-
1. *Mihail Lambrinidhi: I Allvani kata tin qirios Eladha qe tin Peloponison* , F.9
 2. Po aty.
 3. *Mihail Llambrinidhi: I allvani kata tin Eladha qe tin Peloponesion*, Faqe 10

Peloponez numëroheshin mbi 30.000 burra nën armë. Ishin pikërisht këto forca nën komandën e princave bizantine e shqiptare të tillë si Dimitër Muhli, Johani Spanjoli, Petro Bua, Manuil Kantakuzino... Korkodil Kladha, etj.¹⁾ ato që u bënë barierë e parë ndaj agresorit aziatik.

Dera e Despotëve Paleologë, të cilët në fillimin e shekullit të 15-të, ishin kthyer vërtet në jerarki despotike, -hasi në reagime dhe kundërshtime të fuqishme të masave të arvanitëve dhe të popullsisë vendase kundër taksave dhe punëve angari. Këto revolta të shqiptarëve, - bën të njohur Franxhis, - orjentuan despotët Bizantinë të këtij vendi të thërrasin për ndihmë Sulltan Mehmetin, i cili në përgjigje të kësja aleance dhe ndihme do të merrete shpërblime të majme.”

Që prej vitit 1448 ishin ngritur shqiptarët e vendosur në Mistra dhe Patra kundër despotëve bizantinë, për të kriuar një principatë autonomeme në krye Zotin e tyre arvanitin Teodor Bohalin. Po në këto kohë, në Halandria dhe territoret përreth ngrihen shqiptarët e këtyre anëve nën komandën e arvanitit Centurjon Zaharia - (megjithëse vajzën e Centurjonit e kish marrë për grua Despoti grek Dhimitër Paleologu) - dhe krijon Principatën e Ahaisë dhe të Ilisë.

Despoti Theoma Paleologu duke parë rezikun e shtrirjes së revoltave edhe në territore të tjera, me ndihmën e njësive osmane dhe ato të vëllait të tij godet të “rebeluarit” dhe arrin t'i nënshtrojë përkohësisht revoltat e arvanitëve të këtyre anëve. Mbas fitoreve të mësipërme, orekset e Paleologëve shtohen për hegemoni maksimale në Peloponez dhe për shtrirjen e pushtetit të tyre në gjithë territoret e tij.²⁾

Duke parë rezikun eminent që u kanosej principatave të tjera të këtij rajoni, arhondet e Peloponezit kundërreagojnë duke marrë masa urgjente. Një i tillë ishte Zoti i Manit, Manuil Kantakuzino, i cili duke parë orekset e papërbajtura të vellezërve Thoma dhe Dhimitër Paleologu, të cilët synonin të

1. Po aty Faqe 11

2. Kosta Biri: *Arvanites i dori tu neoteri elenismu*”, Faqe 125

shpallnin vehten Zotër të të gjithë grekëve, afrom pas vehtes shqiptarët e zonës së Manit. Lakonisë dhe Arkadisë. Jo vetëm kaq, por duke njojur aftësitë luftarake të tyre, ky princ i njojur arrin deri aty sa të bëjë një gjest të rrallë, emrin e tij grek e kthen në shqiptar. Pra, nga Manuil e bën GJIN dhe e shoqja nga Maria në Kuça. Me këtë gjest ai vërtet fiton edhe më tej simpatinë e popullsisë shqiptare të Peloponezit. Në aleancë me të renditet edhe një tjetër komandant shqiptar i Peloponezit së bashku me luftëtarët e tij shqiptarë, Petro Bua Sklepa.¹⁾

Në këto rrethana, në vitin 1453 ngrihen në revoltë pothuaj tërë arvanitët e Peloponezit dhe nën komandën e Petro Bue Sklepes (Topallit) rrethojnë kështjellën e Misteres. Despotet Paleologe të zënë ngushtë dhe pa rrugëdalje para forcave të konsiderueshme dhe të revoluara të arvanitëve, kërkojnë ndihmë nga turqit osmanë, të cilët nuk vonojnë të përgjigjen pozitivisht dhe të vijnë menjëherë në ndihmë. Nga zonat e Thesalisë, të cilat ishin tanimë të pushtuara prej osmanëve, nisen formacione të mëdha ushtarake të komanduara nga Turhani. Misioni i tyre ishte shtypja e revoltave të shqiptarëve në ndihmë të Paleologëve.²⁾

Shqiptarët, duke parë realisht se ç'rrezik përbënин për ta dhe më gjërë përfatet e vendeve fqinje ky potencial dhe arsenali madh ushtarak osman, i u drejtuan europjanëve, dhe në veçanti venecjanëve. Goditja e drejtpërdrejtë e interesave të ballkanasve ishte cënim i drejtëpërdrejtë i interesave politike dhe ekonomike të tyre dhe kolonive të shumta që kishin në këto anë, spanjollët, napolitanë, sicilianët, venecjanët, etj. Nga ana tjetër shqiptarët e Greqisë e dinin mirë se ndjenjat kristiane të europjaneve do të sensibilizoheshin përparrë rrezikut që u kanosej popujve të këtyre anëve, këtij vendi, dhe kristjanizmit të tij.³⁾

1. Kosta Biri: Faqe 126

2. Po aty: Arvanites i dori tu neoteri elenismu. Faqe 127

3. Kosta Biri; "Arvanites i dori tu neoteru elenismu", Fq 128

Duke parë gjendjen në rajon mbas diskutimesh të shumta, Senati venedikas dërgoi një misionar special në territoret e Peloponezit për të parë gjendjen nga afër. Ky misionar quhej Nikolla Kanale. Ai, pasi pa nga afër gjendjen në territoret e Peloponezit shkoi në dy fortesat Venecjane (Methon dhe Koron) dhe u takua me komandantët venedikas të garnizoneve. Ai i porositi të zhvillojnë bisedime dhe të zgjeronin më tej marrëdhëniet me kryengritësit arvanitë dhe t'i mbështesin ata në rastet e konflikteve të armatosura me despotet Paleologë.

Në këto rrethana, Paleologët e rrezikuar seriozisht prisnin ndihmën e aleatëve të tyre osmanë, të cilët nuk vonojnë të vijnë. Në betejat e vitit 1453 turqit osmanë fitojnë mbi kryengritësit shqiptarë të Peloponezit duke u dhanë një ndihmë të madhe Paleologëve. Por, duket që arvanitë nuk u tërroqën mbas humbjeve të para. Pothuaj tërë shqiptarët e Peloponezit ringrihen në revolta të armatosura dhe godasin forcat e vëllezërve Thoma dhe Dhimitër Paleologut, të cilët tërhiqen dhe mbyllen në kështjellat e Patrës dhe të Mistres. Prej këtu despotët u drejtohen përsëri për ndihmë turqve. Arvanitë duke parë konfrontimin e ardhshëm të tyre me turqit si një betejë me pasoja të tjera të rënda, fitojnë në aleancë dhe kërkojnë ndihmë nga gjenovezët dhe katalanët.

Nga ana e tyre venecjanët duke parashikuar pasojat e rënda dhe goditjet që do të merrnin në tërësi ata vetë dhe interesat e tyre politike në brigjet e Jonit, Egjeut, etj. ndryshojnë qëndrimin ndaj rrezistencës dhe revoltave masive të arvanitëve. Ata nga mbështetës të tyre, marrin tanimë pozicionin e ndërmjetësit mes arvanitëve dhe Paleologëve. Synimi i tyre ishte: një bashkim i mundshëm i këtyre dy forcave për të përballuar kështu tendencat ekspasioniste të osmanëve, ekspansion ky që tanimë hapur drejtohej edhe ndaj vetë pronave, interesave politike, ekonomike dhe hegemoniste venecjane.

Por, në këtë nismë të tyre venedikasit dështuan.

Nga ana e tij sulltanati ndiqte me vëmendje tërë lëvizjen e diplomacisë venecjane dhe nuk kish si të mos shqetësohej

nga përpjekjet dhe synimet e saj që tentonin në bashkimin e forcave drejt një fronti unik antiosman. Në këto rrethana sulltani gjykon se ishte kohë e përshtatshme përnjë ndërhyrje dhe goditje të menjëherershme për të parandaluar synimet venecjane dhe për të vënë më mirë këmbët e tij në këto territor.

Në tetor të vitit 1454, Sulltani dërgon në territoret e Moresë forca të mëdha ushtarake nën komandën e Turhanit dhe të dy bijve të tij, të cilët godasin në Isthmo dhe në anën jugore të Peloponezit.

Duke parë goditjet e suksesshme dhe avancimet e ushtrisë osmane në thellësi të territoreve të vendit, Paleologët fillojnë të shohin qartë se këto ushtri dhe operacionet e tyre tanimë nuk kishin qëllime ndihme apo filantropie. Në të kundërt ato kishin filluar të vetvepronin me synimet të parapara pushtimi. Despotet greke tronditen seriozisht, por tanimë është tepër vonë!

Ata u bëjnë thirrje turqve osmanë që të térhiqen, mbasi edhe "misioni" i "ndihmës" së tyre ishte realizuar. Turqit jo vetëm që nuk i bindën dhe nuk i dëgjojnë, por në të kundërt u bëjnë edhe vetë Paleologëve thirrje, që të rreshtohen së bashku me trupat e tyre në fushat e betejës për të goditur kryengritësit arvanitë.


Në vazhdim të operacioneve të tyre, osmanët rrethojnë një nga vratat e tjera të kryengritësve arvanitë Barbicen, ku ishin strehuar edhe familjet e luftëtarëve. Mbas luftimeshët e ashpra turqit arrijnë të nënshtrojnë kryengritësit dhe në përfundim të betejës marrin rrëth 10 000 vetë robër dhe i çojnë në Azinë e vogël. Në vazhdim të këtij operacioni ushtarak të përbashkët, aleancën e tyre me osmanët, Paleologët e përdorin edhe në përlleshjet e përgjakshme kundër arvanitëve në Aetu dhe Trifilica, forcat e të cilëve komandoeshin nga Centurjoni. Marshimet e suksesshme të reparteve turke mbuluan pothuaj tëre sipërfaqet e Peloponezit. Operacionet ndëshkruese, osmanët nuk i drejtuan vetëm kundër arvanitësve kryengritës, por edhe kundër bënorëve autoktonë grekë. Këta ata i kthyen në barij

të thjeshtë të tufave të bagëtive që kishin grabitur nga të mundurit, ndërsa Princave u kërkuan si shpërblim përndihmën e dhenë 12 000 florij të menjëhershëm dhe një pagesë të veçantë vjetore prej 6000 florijsh.

Ofensiva osmane nëpër territoret e Greqisë në vazhdim futet në fazën e finalizimit të operacioneve të saj pushtuese. Nga territoret e Thesalisë e cila kishte vite që ishte nën pushtimin turk, nisën për në drejtim të jug-perëndimit formacionet e pashait që zotëronte këto anë, Omarit. Ky i drejtohet fillimisht Atikës dhe mbasi nënshtron rezistencën e organizuar nga arvanitët dhe banorët vendas, vazhdon goditjet duke iu drejtuar mureve të Athinës. Gati mbas një muaji, ai arrin ta nënshtrojë dhe ngrë flamurin gjusmëhënë mbi Akropol. Gjatë tërë operacioneve ushtarake për pushtimin e Atikës e deri të Athinës. Turqit bënë raprezalje dhe kryejnë masakra masive e rënqethëse. Megjithëse nuk gjendet dokumentacion shumë i gjërë për rezistencën e popullsisë shqiptare të këtyre anëve, genocidi barbar që trupat e ushtrisë osmane bënë mbi këtë popullsi është një nga argumentet e tjera që nënkupton se edhe shqiptarët e këtyre anëve i u përgjigjën si edhe më parë me majën e shpatës sulmeve pushtuese osmane.

Që rezistencë e princave dhe Zotëve shqiptarë të këtyre anëve ishte e fortë dhe aktive argumentohet edhe me faktet se: në vendbanimet e njohura shqiptare të këtyre zonave, mbas operacioneve pushtuese osmane nuk gjejmë më banorë që mbajnë për mbiemra familjarë ato të zotërve që krijuan katundet apo të vetë katundeve. Kështu, në fshatin Qurke nuk gjejmë më familje me mbiemrin Qurka, në Bua apo Buaj nuk gjejmë më Buaj, në Lopës nuk gjejmë me Lop-sa, në Mallakastra nuk gjejmë më familje me mbiemrin Mallakastrioti, në Kavasila - Kavalisi, në Mazi-Mazi, në Kalanxhi - Kalanxhiu, në Kaparel - Kapareli, në Shimatari - Shimatari, në Spata nuk gjejmë më familje me mbiemrin Spata.¹⁾

1. Kosta Biri; Arvanitës i doris tu neoteru olenizmu, Fq 132



Duket që arhondet, zotët dhe komandantët e njojur shqiptarë të këtyre vendbanimeve të mëdha dhe të një rëndësie të veçantë strategjike, mbas rezistencës dhe ndeshjeve të ashpra janë tërhequr në zona të tjera më të thella. Një pjesë tjetër u lidh në anelancat e mëvonëshme me venecjanët dhe u rindesh me osmanët në kështjellat bregdetare që kontrollonin venedikasit. Disa të tjera kaluan ujrat e Jonit dhe Adriatikut dhe shkuan pranë territoreve napolitane, fjorentinase, venecjane duke u ofruar shërbimet e tyre zotërve të rij. Eshtë kjo arsyaja që mjaft nga emrat e njojur të këtyre familjeve që kishin bëre emër kudo në sheshet e luftrave, apo pinjollët e tyre i gjejmë më vonë nëpër oborret mbretërore të mbretërive europiane.

Mbasi trupat turke nënshtruan edhe territoret e Atikës, në hartën e pushtimeve u erdhi radha ishujve të Egjeut, të Jonit si dhe një sërë kështjellash bregdetare, të cilat ishin koloni venecjane e ndonjë dhe katalanase. Duhet thënë se mbas marrjes së Atikës, osmanët pothuaj kishin nënshtruar plotësisht gjithë vendin.

Megjithatë, shqiptarët e panënshtruar prej kohësh ishin ringritur në revolta dhe kishin rimarrë mjaft nga territoret e sulmuara nga repartet armike. Deri në vitin 1458 pjesa më e madhe e territoreve të Peloponezit ishte pothuaj përsëri jashtë kontrollit osman. Jo vetëm kaq por forcat e princave shqiptarë dhe atyre vendas përbënë realisht një potencial të konsiderueshëm dhe serioz kundër osmanëve. Ishte pikërisht kjo arsyaja që po ketë vit, Sulltani dërgoi në Peloponez një ushtri tepër të madhe që përbëhej nga një kalorësi me 80 000 vetë pa përllogaritur këmbësorët, me misionin që të lante një herë e mirë hesapet me kryengritësit e këtij rajoni. Falangat e ushtrisë osmane marrin Eksamilitin dhe nënshtrojnë Tarsën dhe Nemean. Paleologët tmerrohet nga ajo çka ndodh, por është tepër vonë. Turqit pushtojnë dhe zotërimet e principatave të tyre. Dy udhëheqes të kryengritësve arvanitë Dhoksa dhe Dusha-i, organizojnë qëndresë derisa myllën në këshstjellën e Eksamilit dhe bëjnë një rezistencë aktive për ditë të tëra duke përballuar vështirësi, deri etjen e zgjatur për

shkak të mungesës së ujit. Forcat turke kishin zbuluar vendburimet e ujit dhe rrugëkalimet e furnizimit të kështjellës dhe i ndërprenë ato. Të rrethuarit, në kushtet ekstreme. Stërmundimi filluan të përdorin gjakun e kafshëve që therrnin për të zëvendësuar sadopak ujin, duke vazhduar ndërkokë qëndresën heroike. Në kushtet e demeve të shkaktuara dhe pamundësisë për të nënshtuar kryengritësit, agresorët pranojnë të nënshkruajnë një marveshje paqeje me arvanitë.

- Sipas kushteve të paqës turqit lëshojnë rrethimin me kushtin që të lejojnë pa prekur kryengritësit. Në këtë rast osmanët i përbahen kushteve të paktit dhe jo vetëm kaq por ata i nderojnë herojtë e qëndresës me kushtin që ata të mos riktheheshin në fushat e betejave për t'i bërë rezistencë ushtrive turke kudo që ata do të çfaqeshin.

Në vazhdim të operacioneve të tyre pushtuese turqit osmanëndeshen me kryengritës arvanitë në zonën e Rupeles. Mbas betejave të pergjakshme ata rrethohen në kështjellën e këtij vendi dhe vazhdojnë aty qëndresën për një kohë të gjatë. Në kohën kur forcat pushtuese e shohin se ballafaqimi me këta kryengritës të mbrojtur e fortifikuar miaft mirë, është pa rezultat dhe gjykojnë të largohen, përfaqësues të të rrethuarve kërkojnë nga rrethuesit një kompromis armëpushimi. Padyshim, osmanët e mirpritën kërkesën dhe lirojnë të rrethuarit, të cilët kishin ditë pa rezerva ushqimore, të largohen të lirë për të mos u çfaqur më në betejat antiosmane. Nga të rrethuarit arvanitë ndalohen 20 vetë të cilët ishin të evidentuar si luftëtarë aktivë kundër forcave turke në rrethimin e ashpër që ishte organizuar kundër kështjellës së Torsos. Nga kjo kështjellë forcat arvanite kishin dalë pa pasoja, mbas paktit të paqes me forcat osmane, por me kushtin që luftëtarët e dalë nga ky konfrontim të mos ngrinin më shpatën kundër forcave osmane. Këta 20 luftëtarë "rebelë", që kishin shkelur kushtin e imponuar, pak kohë më parë, dënohen publikisht. Ndëshkimi i tyre ishte - thyerja me çekan e kyçeve të duarve, këmbëve, brinjëve dhe në fund të kokës.

Tragjeditë dhe dëmet e mëdha politike, ekonomike që

pësonte Peloponezi mbas aleancave të Paleologëve me osmanët dhe ftesave të përsëritura që këta u kishin bërë kësaj fuqie në ekspansion të papërmbarjatur, duket se tnamë kishte zgjuar edhe Paleologët. Në mënyrën se si kishin lëvizur dhe ishin rrokullisur ngjarjet, ishte larguar përfundimisht edhe hija më e vogël e iluzionit se osmanët mund të tërhiqeshin një ditë nga ato territore që kishin shkelur dhe vendosur strukturat dhe njësitë e tyre ushtarake. Nga ana tjetër princa, arhondet dhe kryengritësit vendas dhe shqiptarë u ribëjnë thirrje dy vëllezërve Paleologë të ndrojnë rrugë, të prishin sa më parë aleancat me osmanët dhe të ndërtojnë një aleancë të madhe e përbashkët me ta pér të përballuar revanshin osman. Në këtë rast ata i kujtojnë Paleologëve rastin tipik të fqinjët verior - skënderbeut që ata të marrin shembull prej tij¹. Paleologët mbeten në dilemë...

Në vitin 1459 kryengritjet dhe rezistenca e popullsisë shqiptare dhe asaj vendase në Peloponez merr përmasa të mëdha. Në muajt e pare të këtij viti kryengritësit (shqiptarë) arvanitë të zonës së Ahaisë rrethojnë Kalavriten dhe mandej kështjellën e Patrës dhe forcat turke të vendosura në të. Këto pasohen nga revoltat e armatosura të arvanitëve në Arkadi dhe Lakoni. Përmasat e luftimeve të reparteve kryengritëse zgjerohen edhe më tej me revoltat e arvanitëve të Manit, të Muhlit, Karitenes, Shen Gjergjit, Bardhunës, Kastrit, Kallamatës, Zarnatas, Lefktras, etj.

Duke parë me shqetësim zgjerimin e përmasave të kryengritjeve dhe të rezistencës masive antiosmane, vetë Sulltani pér të shtypur revoltat dhe vënë nën kontroll tërë Peloponezin, zëvendëson komandantin e njësive turke pér Peloponezin me një njeri tjetër të përshtatshëm që kishte dhënë prova të mëdha pér aftësitë e rralla ushtarake, shqiptarin Hamza Zenevisi. (Mbas goditjes së parë që muarën shqiptarët e principatës së Gjirokastrës nën komandën e

1. Kosta Biri "Arvanitës i dori tu neoteru elenizmu", Fq 135

Zenevisit-Princit të tyre, në materialet e deritashme historike thuhet se dera e Zeneviseve nuk çfaqet më në analet e historisë dhe asnjë pinjoll i tyre që prej fundit të shekullit të 14 nuk evidencohej asgjëkund. Por personazhi që përmendim më sipër rrëzon atë çka thuhet. Shqiptari i mësipërm i turqizuar duhet te jetë pinjoll direkt i kësaj dere, në mos i biri i princit të njojur të Gjirokastrës Zenevisit).

Zenevisi me të marrë detyrën menjëherë fillon operacionet e tij të ashpra dhe të përgjakshme kundër kryengritsve. Me trupat e tij i drejtohet Patres dhe godet arvanitët që mbanin atë të rrethuar duke shpëtuar forcat e garnizonit turk brenda saj. Mandej ai vazhdon fushatën e tij ushtarake duke shkuar nga një fushë betejë në tjetrën, nga një gjakderdhje tek një tjetër masakët. Ai brenda një kohe relativisht të shkurtër arrin të nënshtrojë pothuaj tërë vratat e revoltës së kryengritjeve arvanite dhe të kontrollojë pothuaj tërë situatën në More.

Paleologët që ishin reshtuar me forcat kryengritëse, duke parë rrjedhen e ngjarjeve, i tradhëtojnë përsëri arvanitët dhe me paturpësinë e njojur të tyre politike nisën drejt Sulltanit pér t'i rënë përsëri në gjunjë. Sulltani i pranon dhe u imponon të paguajnë haqaçe tepër të rënda në flori. Mandej ai e pret edhe vetë në audiencë Thomanë (Paleologun) me nderime të veçanta e të mëdha dhe në përfundim e burgos atë. Për gjithë territorët e principatave të tij ai urdhëron Zenevisin t'i rrëmbejë dhe vendosë nën pushteitn e tij ushtarak.

Në fushatën e vitit 1460, të drejtuar nga komandanti Zagano, turqit godasin Ahainë e mandej Arkadinë dhe Lakoninë, zona këto që ishin kthyer në vatra të lira të rezistencës arvanite. Nënshtrojnë Muhlin dhe arvanitët nën komandën e Andrea Griçes. I drejtohen Monemvasisë. rrrethojnë kështjellën e Kastrices, e cila i takonte farës së njojur arvanite të Bohaleve. Në komandë të të rrethuarve qëndron arvaniti Prinokoka. Gjatë luftimeve, forcat turke gjejnë burimete furnizimit me ujë të kështjellës dhe i ndërpresin ato, në këto rrethana të rrethuarit pranojnë të dorëzohen me kushtin që të lejohen të lirë. Mbasi pranojnë kushtet e

mësipërme, osmanët nuk i përbahen paktit. Komandantin e forcave kryengritëse Prinokokën e ndalojnë dhe e rrjepin të gjallë ndërsa 300 luftëtarë aktivë arvanitë i ngulën në hunj dhe i therrin publikisht. Në përfundim forcat turke shkatërruan kështjellën ndërsa gratë dhe fëmijët që ishin strehuar së bashku me luftëtarët brenda saj i muarrën si skllever për t'i çuar në Anadollin e largët.

Në kështjellën e Gardhiqit forcat osmane mbajnë të rrethuar rreth 6 000 forca kryengritëse kryesisht arvanite. Pas shumë dite rrezistencë, kryengritësit të mbetur pa ushqime dhe ujë detyrohen të dorëzohen. Ndëshkimi për ta ishte shumë i ashpër. Turqit osmanë duke përjashtuar vetëm luftëtarët arvanitë të komanduar nga Bohali, gjithë të tjerët, përfshi këtu edhe gratë e fëmijët i therrën. Veçimin për Bohalet e bëri sepse këto njësi arvanite pak muaj më aprë ishin ndeshur me forcat e Paleologëve - të cilët për turqit tanimë ishin kundërshtarë të dështuar dhe papersonalitet. Ishin këta arvanitë, komandantin e të cilëve Teodor Bohalin, Thoma Paleologu e kishte verbuar.

Fushatën me operacionet e tyrë masakruese, turqit osmanë e shtrijnë drejt Bardhunës dhe Manit. Këtu ndeshen me forcat e luftëtarit të njohur arvanit Korkodil Kladha i cili së bashku me bashkëpatriotët e tij qëndron përnjë kohë të gjatë me trimëri. Por duke parë se përpara kishte një potencial aq të madh ushtarak dhe qëndresa do të ishte me pasoja të pariparueshme, tërhiqet në thellësi të territoreve të Moresë, përtu riçfaqur përsëri në fushat e luftimeve brenda dhe jashtë kufijve të Greqisë.

Forcat e komanduara nga vetë sulltani godasin territoret e qipari siut (Peloponëz), nga ku ai emrr rreth 10 000 vetë robër, mes të cileve një numur i madh arvanitë. Duke zbritur më poshtë, në zonën e Kalavrites ai ndeshet me forcat kryengritëse arvanitase të komanduara nga komandanti i njohur Dusha, i cili ishte përleshur edhe dy vjet më parë me njësitë osmane dhe ishte liruar të delte nga rrethimi me kushtin që të mos ndeshej më kurrë me këto forca. mbas përleshjeve të përgjakshme, osmanët arrijnë të thyejnë

arvanitët dhe të zënë rob Dushën. Hakmarrja ndaj tij në këtë rast ishte e papërmabjatur. Si ndëshkim sulltari urdhëroi ta rrjepin të gjallë.

Në vazhdim të fushatës së tij, vetë Sulltani i drejtohet kështjellave të Patrës dhe Egjinës, të cilat kishin rënë përsëri në duart e kryengritësve dhe komandoheshin nga arvanitasi Nikolla Griça. Mbas shumë luftimesh që zgjaten për ditë të tëra, rrethuesit arrijnë t'u presin ujin kryengritësve, duke imponuar marrjen e një pjese të qytetit. Nga qytetarët, apo më saktë gratë dhe fëmijët që dalin për t'u dorëzuar, turqit marrin vetëm djemtë të cilët i çojnë në Stamboll për t'i përgatitur si jenicerë në repartet e tyre të përzgjedhura. Përpjekjet e sultanicës së cili drejtonte vetë operacionet, vazhdojnë edhe më tej për të detyruar të rrethuarit të dorëzohen. Por, rezistenca nën komandën e Griçes nuk mposhtet. I propozohet të rrethuarve të dorëzohen me kushtins e do të falen. pranohen kushtet e paktit dhe ndërsa fillojnë lëvizjet për realizimin e tij, Griça dyshon në një kurth të perqatitur për ndëshkimin e tyre fatal. Në këto rrethana ai tërhiqet menjëhere dhe vazhdon rezistencën kundër forcave të Sultan Mehmetit. Kur rrethuesit shikojnë se përpjekjet përmarrjen e kështjellës janë të kota, largohen nga muret, duke lënë aty njësi të tjera deri të impononin gradualisht kryengritësit të dorëzohen. Mbas shumë muajsh rezistence, në pranverën e vitit 1461, turqit osmanë u propozojnë kryengritësve të dorëzohen se vërtet ata do të lejoheshin të largoheshin të lirë. Kryengritësit, në pjesën më të madhe të tyre arvanitë, me në krye Griçen duke parë që qëndresa e mëtejme ishte pa qëllim e domethënje, pranon kushtet dhe del nga muret e kështjellës. Largimin e tyre turqit osmanë e shoqërojnë me nderime në shenjë të njoħjes së trimërisë dhe heroizmit të tyre të veçantë.

Komandantin Nikolla Griça, që udhëhoqi këtë rezistencë aktive të të rrethuarve përmajt të téré dhe që tërroqi vëmendjen e kohës, e gjejmë përsëri mbas katër vjetësh, në vitin 1464 në Qefaloni, si komendant të njësive ushtarake arvanitë që mbroni këto baza venecjane, nën emërtimin

"spectabile Nikola Griza".¹⁾

Mbas rënies edhe të këtyre vatrave të fundit të rezistencës antiosmane, pothuaj tërë territoret greke u përfshinë në kufijtë gjeopolitike të perandorisë turke, duke përjashtuar disa "qenta të kufizuara kontinentale dhe disa ishullore të cilat mbeteshin në duart e venecjanëve. Shumë nga këto fortesa tanimë ishte përforcuar ushtarakisht mbasi në to kishte shkuar një numur i madh luftëtarësh arvanitë. Ata mbas përleshjeve të ashpra me pushtuesin ishin thërritur apo kishin pranuar ofertat venecjane me kushtin që bashkarisht t'u bënин rrezistencë goditjeve te mundshme osmane. Arvanitët, po aq sa edhe vendasit grekë e shikonin aleancën me venedikasit si një mjet të nevojshëm dhe me shpresa për të arritur qëllimet e tyre çlirimtare.

Këtë aleancë, të cilën turqit osmanë e kishin provuar mirë nëpër fushat e betejës, jo vetëm që e panë me shqetësim por menjëherë ata filluan përgatitjet për ta goditur sa s'ishte vonë. Ata kurrsesi nuk mund të lejonin bazat venecjane të Thermises, argosit, Nafplios, Koronit, Methonit dhe Navarinos të vegjitonin dhe rrezikonin brenda oqeanit osman.

Në vitin 1463 turqit nisin vezirin Muhamet në krye të një ushtrive të madhe në numur për të goditur territoret rreth bazave venecjane. Në operacionet kundër Argosit ata veç masakrave kundër popullsisë vendase muarrën si skllevër rreth 30 000 vetë. Ndërsa në betejën e ashpër rreth bazës së njohurtë Nafplios, arvanitët të cilët ishin aleatë të venecjanëve i shkaktojnë ushtrive osmane dëme të mëdha dhe i detyrojnë këta të fundit të largohen. Gjatë tërheqjes në Divia, osmanët në shenjë ahkmarrje mbledhin gjithë banorët arvanitë dhe i therrën.²⁾

Gjate përleshjeve të këtyre kohëve, një pjesë e popullsisë arvanite u tërroq në thelli të vendit, në zonat malore dhe të vështira për të shkelur. Një pjesë tjetër jo e vogël e tyre

-
1. Kosta Biri: Arvanitës i dori tu neoteru elenizmu, Faqe 140
 2. L.Halkondili; 51.Kritovulos XIV, 3

kaloj nëpër ujrat e Egjeut në ishujt Hidra, Specia, Poros, etj.

Në prill të po këtij viti (1463) për të përballuar operacionet e vazhdueshme dhe insistuese të osmavë, Republika nisi në drejtim të bazave të saj njësi ushtarake nën komandën e gjeneralit Bartoldo Estini. Ky mbasi mblodhi informacione të gjëra nga banorët vendas të jugut të Peloponezit filloj operacionet kundër njësive pushtuese. Në mbështetje të venedikasve ishin edhe banorët vendas arvanitë dhe grekë. Forcat e rregullta kryengritëse kishin si komendant Petro Buan, i nipi i Komandanti të famshëm arvanit Petro Bua të Hollin. Së bashku me ta rreshtoheshin edhe forcat e Mihal Ralit. Në dy ndeshjet e tyre në rrethet e Nafplios dhe të Argosit forcat që luftonin në flamurin venedikas të Shën Markut e thyen kundërshtarin duke e ndjekur atë deri ne zonën e Isthmos.

Këtu ishin përqëndruar njësitë e tjera të mëdha të gjeneralëve osmanë të territoreve të tjera greke. Në betejën e ashpër dhe të përgjakshme venecjanët u thyen dhe u detyruan të tërhiqen dhe te strehoen brenda kështjellës së Nafplios.

Ndër njësitë ushtarake më të zgjedhura që përbënin forcën mbrojtëse të kësaj baze venecjane, ishin arvanitët nën komanden e Teodor Bua Griçës dhe ata të kapedanit tjetër arvanit Meksi Buziqi. Forca të tjera kryengritëse që ishin pranë tyre të udhëhequra nga Krokodil Kladha vazhdonin të lirë rezistencën kundër pushtuesve osmanë.¹⁾

Por, përfundimisht edhe për venedikasit tanimë ishte bërë e qartë se ishte e pamundur të përballohej ekspansioni i kësaj superfuqie në lulëzim, e cila nuk kishte ëndrra vetëm një bazë apo një port. Orekset e saj synonin ndoshta një Europë të tërë. Në këto rrethana venecjanet detyrohen të ulen me turqit osmanë në tryezën e bisedimeve dhe të nënshkruajnë me ta Traktatin e Paqes të vitit 1481.

1. M. Lambrinidhi: "I allvnai kata tin qirias Eladha qe tin Peloponision", F. 13

Në kushtet e konfrontimeve të vazhdueshme antiosmane, kur arvanitët kishin synuar përherë vetëm rrugën e rezistencës për lirinë e trojeve të tyre, në kushtet edhe kur aleatët e tyre njëri pas tjetrit ishin tërhequr, atyre nuk u mbetej tjetër veçse të vazhdonin edhe më tej rrugën e vështirë të përpjekjeve dhe luftrave të përgjakshme shekullore për pavarësi. Edhe ajo pjese popullsie që u tërhoq nga territoret e bazat venecjane të cilat ranë në duart e osmanëve, u çvendos në zona të tjera të vendit apo shkoi për t'u ofruar përsëri shërbimin e tyre të çmuar venecjanëve, në ato baza që u kishin mbetur. Të tjerë me anijet e ushtarakëve venecjane a napolitane u larguan për në brigjet italiane dhe u ngulën në zonën e Puljas, Brindizit, Kalabri, Sicili, në Venecje, Napoli e gjetkë.

Shpirti i qëndresës shqiptare (arvanitë) mbijetoit në gjithë territorët e Greqisë ku jetonte kjo popullsi. Një pjesë jo e vogël e saj iu shmang qëndrave urbane për të mbetur e pavarur nga administrata dhe pushteti osman. Përherë në bashkësi dhe në vendbanime të përbashkëta ajo shkoi edhe në zona të thella e të thyera malore. Duke u bërë të njojur situatën në këto anë mbas pushtimit osman, komandanti venecjan Verduço Mino informon Dozhet e Venedikut se në malësitë e Arahneut, në krahinat e Midheas, Prasimneas, etj ka kasolle bujqish shqiptarë, nga ata që ishin të parët në organizimin dhe pjesmarjet e rezistencës antiosmane, nga ana që muarrën pjesë në betejat e njojur të Argolidhes që prej viteve 1397. Këta njerëz tanimë janë vendosur në zonat malore për të jetuar të lirë dhe merren me punë bujqësie.¹⁾

Detyrimet e Venetikut pas nënshkrimit të Traktatit të Paqes ishin tepër të rëndë. Në vitin 1481 ata i detyroheshin ti paguanin Portës së Lartë 100 000 florij dhe për çdo vit në vazhdim nga 10000 të tjerë, si dëmshpërbllimë lufte. Brenda këtyre kushteve imponuese, turqit merrnin nën kontrollin e tyre edhe një numur bazash të rëndësishme venecjane si atë

1. Mihail Lambrinidhi: "I allvani kata tin qirias Eladha qe tin Peloponision", Faqe 16

të Nafpaktos, Nafplios, Monemvasisë, Methonit, Koronit, Pilios, etj.¹⁾

Veç sa ishin larguar nga këto vatra rezistence luftetarë së bashku me familjet e tyre mbas pushtimeve të territoreve greke, me rënien e kështjellave dhe bazave venecjane një numur tjetër i madh njësish ushtarakësh arvanitë me familje u larguan dhe u ftuan nga latinët. Në mjaft raporte venedikase të kohës përmenden familjet e këtyre emigranteve, prijsit ushtarakë deri luftëtarët e thjeshtë arvanitë, të renditur përkrah venecjanëve në mbrojtje të bazave të tyre apo të ftuar nga këta të fundit për t'u strehuar në tokat e përtej Adriatikut. Në to përmenden si aleatë venedikas dhe njerëz të nderuar. Gerbeshi, Maneshi, Bardhi, Kriebardhi, Panariti, Kuçi, Karakalla, etj.²⁾

Largimet më masive nga këto baza realizohen në vitin 1479. Po në këtë kohë ndër dokumentet e tjera gjenden edhe ato që bëjnë fjalë për komandantin e njohur shqiptar Korkodil Kladha, të cilin Senati e kishte ftuar edhe kohë më parë për t'u vendosur me nderime në Venedik për vetë ndihmën dhe kontributin që ai i kish dhënë kësaj Republike, por ai nuk kish pranuar. Po këtë vit venedikasit e urdhërojnë Kladhën t'u dorëzojë turqve kështjellat e Shën Gjergjit dhe atë të Barhdunës të cilat ishin ishin nën kontrollin dhe komandën e tij. Korkodili refuzoi ti bindej propozimeve dhe urdhërave të nënshtimit përfundimtar ndaj okupatorit. Në këto rrethana ai shpallet nga Senati si i jashtëligjshëm. Nga ana e tyre turqit dërgojnë një forcë ushtarake të përbëra nga 6000 vetë për të nënstruar një herë të përgjithmonë këtë vatër të pabindur. Por, Kladha në ndeshjen e ashpër pranë Bardhunës mundi të shkatërrrojë totalisht forcat osmane. Ndërkohë, turqit rigrupojnë një numur tjetë rtepër të madh forcash për të rigoditur kryengritësit.

Kladha duke parë se rezistenca e mëtejme ishte e kotë

1. K.Satha: *Turkokratumeni Ellas*. Faqe 27

2. M.Lambrinidhi; *I allvanikata tin...* Faqe 17

dhe pa shpresa për një qëndresë të gjatë dhe zgjerim të flakës kryengritëse, e cila pothuaj ishte venitur, tërhiqet fillimi i thëllësi të territoreve të vendit e mandej pranë mbretërvë latinë, napolitanë, venecjanë etj.¹⁾

Po ky personalitet me përmasa dhe tipare të çuditshme qëndrese, kryengritës dhe liridashës shkon në ndihmë të të birit të heroit tonë kombëtar Skënderbeut, - Gjonit në betejën që u zhvillua kundër turqëve në Durrës.

Për aftësitë e tij të rralla ushtarake, cilësi të dhe instiktet e çuditshme që karakterizojnë këtë njeri, venecjanët e afrojnë atë përsëri. Mandje këta bien dakort me Kladhen që ky të rikthehet ne Peloponez i mbështetur edhe nga forca të tjera përtë organizuar rezistencë dhe rimarrë territorë më interesa të veçanta strategjike për Republikën.

Mbas disa betejash Korkodili arrin të thyejë forcat turke dhe të çlirojë një numur kështjellash të këtyre anëve dhe ua kthen ato venecjanëve.

Ndërsa në një betejë të vitit 1490, mes turqve dhe venecjanëve, Kladha zihet i gjallë nga forcat turke dhe në shenjë të hakmarjes së thellë ndaj tërë atyre çka u kish bërë osmanëve ky burrë trim, ata e rrjepin të gjallë.

Epopeja e qëndresës së arvanitëve dhe popullsisë vendase në Greqi padyshim është shumë e gjérë. Kontributi dhe përpjekjet e kësaj popullsie në një rezistencë të pabarabartë, ka përmasa të tillë që vështirë të përmblidhen në një kalim të tillë kronikash. Me rëndësi është të thuhet dhe evidencohet roli i veçantë i kësaj popullsie që edhe mbas pushtimit të plotë të territoreve greke, vazhdoi betejat dhe rezistencën aktive kundër Portës së Lartë me forma të luftës partizane, me formacione të vogla komitësh apo siç u thirrën me gjuhën e popullit dhe vetë administrata osmane "çeta hajdutësh".

Interesante eshtë se në këtë rezistencë të armatosur, deri në pragun e revolucionit për pavarësinë e Greqisë me

1. M. Lambrinidhi: "I Allvani kata...". Faqe 17

1821, elementi vendas - arvanit bashkëpunoj edhe me çetat e komitëve - kaçakëve shqiptarë që zbrisnin nga territorjet e Shqipërisë, duke u bërë në këtë mënyrë për Portën dhe administratën e saj një rrezik real dhe permanent.

RIEMIGRIMET E SHQIPTAREVE (ARVANITEVE) NGA GREQIA NE ITALI MBAS PUSHTIMEVE OSMANE

Rezistenca aktive, lufrat e vazhdueshme për dekada të tëra, disfatat e humbjet jo të vogla që pësuan legionet osmane në muret e qëndresës arvanite, i shtynë shtabet ushtarake turke të hartojnë projektet për një hakmarrje të pashembëllt kundër kësaj popullsie rebele. Në dokumentacionin e luftës të kronistëve osmanë ishin evidencuar qartazi princat arvanitë, kryekomandantët, komandantët e deri luftëtarë të thjeshtë-heroj të papërmabjatur të fushave të betejës. Një pjesë e tyre e kishin pësuar ndëshkimin më makabër duke urrijepur të gjallë, të tjerët ishin ngulur në hunj, etj.

Kur tërë gadishulli Ballkanik dhe popujt e tij ishin thyer dhe mbi ta qëndronte shpata ndëshkruese e pushtetit osman, grupe të tëra luftëtarësh, komandantë dhe ushtarë të thjeshtë, me familje dhe me fëmijët e tyre, largoheshin drejt një vendi të panjohur, përtëj detit, paditur se këto anë do të bëhen ishin për ta një ditë atdheu i tyre i ri.

Nga qëmtimi i dokumentacionit të kohës evidencohet se vajtjet e para të popullsisë arvanite në republikat italike duhet të kenë fillaur aty nga vitet '60 të shekullit të XV. Dekada dhe gati dy shekuj më parë vendet e Italisë Jugore kishin filluar të shkeleshin në mënyrë periodike nga popullsia e Arbërisë sa për motive politike - aleanca politike e ushtarake, aq edhe për nevoja tregëtare. Në mënyrë graduale dhe në grupe të

vogla, aty ishin vendosur emigrantë nga brigjet përballë.

Duke marrë për bazë kohore mesin e shekullit të 15-të, kur Perandoria Osmane kishte nënshtruar një pjese të madhe të vendeve ballkanike dhe të Arbërisë, historjanët llogarisin shtatë shpërngulje kryesore, nga vitet 1448 deri me 1825. Ka pasur edhe emigrime sporadike të cilat shtrihen nga shekujt e 13 në atë të 15-të. Këto qenë kryesisht trupa ushtarësh në dispozicion të princërve lokalë, ku ndër më të famshit njihen ato të Xhakomo Matarangës në Sicili. Pas tij ai më i organizuari ushtarakisht ishte emigrimi i udhëhequr nga komandanti Rere me dy bijtë e tij Gjergji dhe Vasili. Këto trupa të cilat u ftuan në Sicili nën komandën e Reres kishin për detyrë të mbrojnë vendin nga sulmet e Anzhivinëve...¹⁾

Shpërngulje masive e popullsisë arvanitase, që ndoshta përllogaritet ndër më të mëdhatë në territoret e Italisë së Jugut, vlerësohen "shpërngulja e katërt e njojur me emrin e Moresë dhe Koronit (Koronit, Modenës, Nafplios, Methonit, etj)... dhe e vendosur në Bazilikate, Shën Konstandin, Shën Pal - në Pulje, në Sicili... pas një marrëveshje me mëkëmbësin e Mbretit të dy sicilive. Don Pedro të Toledos".²⁾

Një shpërngulje tjetër, ajo që vlerësohet si e pestë, ndodhi më 1647 "në kohën kur në ato vende sundonte Filipi i IV. Kjo masë emigrantësh përmblidhë popullsi të ardhur kryesisht nga krahina e njojur e Manit (Peloponezit) kryesisht nga Lukani, Queti dhe u vendos në Toronto...³⁾

Emigrimi dhe vendosja e popullsisë arvanite në territoret e Italisë Jugore ishte disi në rrethana më të favorshme, basi ajo gjente në këto ane strehë të parapërgatitura nga bashkatdhetarë të tyre të ardhur aty vite më parë ku bile ata kishin krijuar dhe kolonitë e njojura. Aleancat e njojura të Skënderbeut me Mbretin e Napolit, ndihmat ushtarake që i

1. L. Conti - O Marquet: "Shpirti mbretëror në veshjet e gruas arbëreshe", F.55

2. Po aty. Faqe 56

3. Po aty. F.57

pat dhënë atij, eksedita ushtarake e vitit 1461 që ai ndërmori dhe realizoi me sukses për të ndihmuar Alfonsin e V të Aragonës kur ai çlroi krahinat e Tranit dhe të Barilletës duke forcuar kështu pozitat e katalanasve në këto anë - i dhanë atij shpërblime jo të vogla. Territoret dhe pronat që ai mori si dhuratë, u përdorën për t'u vendosur më pas emigrantët të cilët themeluan në to dhe krahina të tjera, kolonitë arbëreshe.

Krahas mbretërisë së Napolit arvanitët u vendosën dhe në Firence dhe Venetik. Kolonitë e kriaura mbeten të tilla për gjithë kohën dhe i gjemjë edhe sot në zona dhe bashkësi unike larg qendrave të zhvilluara urbane. Por, një masë e madhe e emigrantëve u vendos edhe në qytete ku krijuan shoqata dhe kolonitë me një dinamikë e vitalitet gjurmëlenës në tërë fushat e jetës. Ata u dalluan në këto ambjente për tiparet e tyre të veçanta, veçmas si ushtarake të përkryer, si artistë me tipare kulturore origjinale, etj.

Megjithë kontributet e veçanta që kishtë dhënë kjo popullsi në vendbanimet e saj për interesat e mbretërive latine, vendosja e tyre në vendbanimet e reja nuk ju la rastësisë dhe as dëshirës. "Zgjedhja e vendbanimeve të të mërguarve me shumë se nga një zgjedhje plotësisht e lirë u përcaktua nga politika e sundimtarëve spanjollë (të cilët kishin në atë kohë nën zotërimin e tyre Siciliane dhe krahina jugore të Kalabrisë) - të shtyrë nga mirënjojja, por edhe nga nevojat ushtarake dhe ekonomike të vendit, nga ekzistenca e abative bizantine në Itlainë Jugore, nga vendvendosja e mëparshme e paraardhësve të Skënderbeut dhe nga martesat e lira me princat autoktone.

"Përgjithësisht atyre u dhanë vende të izoluara që mund të mos bashkoheshin dhe formonin një fuqi të rrezikshme. Këto toka i kishin lënë popullsi të dikurshme ose kishin qenë të shkretuara nga fatkeqësítë e natyrës. Zotërinjtë vendas do t'i shfrytëzojnë të mërguarit Arbëreshë për t'u dhënë përsëri jetë dhe gjallëri këtyre vendeve të rënuara..." ¹⁾

1. L. Conti, O. Marquet: "Shpirti mbretëror në veshjet e gruas arbëreshe" F.50

Kjo popullsi me vlera të veçanta ushtarake, e cila kishte dhënë prova para latinëve, - napolitanëve, fjorentinasve, venecjanëve, - spanjollëve, etj. joshi dhe imponoi komandat dhe shtabet e luftës t'i têrhiqnin dhe ftonin këtë rracë si aleatë për t'i dhënë zgjidhje situatave të vështira ushtarake. Arti i luftës ishte bërë për shqiptarët më shumë se gjithçka tjetër "një mjeshtri e veçantë për të cilën ata u shquan në Itali dhe... gjetiu në Europën Perëndimore..., ata u bënë të dëgjuar si ushtarë mercenarë me emrin stratjote... dhe u shquan sidomos si kalorës "Epirotarum equites". Këta ushtarë rekrutohen në kolonitë shqiptare në Itali, një pjesë prej Moreje dhe një pjesë nga vetë Shqipëria"¹⁾

Pikërisht, mbas rënies së kështjellave të fundit të rezistencës antiosmane dhe emigrimit të detyruar, arvanitët detyroheshin të braktisin atdheun e ri Greqinë në të cilin ishin ngulur prej gati 50, 100 apo diçka me shumë vite. Aty kishin themeluar vendbanime, kishin gjalluar jetën kishin lindur dhe kishin varrosur të parët e tyre. Ata kishin mbrojtur heroikisht trojet e rilindura nga invazione të egra, kishin begatuar vendin dhe lindur brezni, kishin begatuar vendin dhe lindur brezni, kishin qarë të rënët në luftë me vajet e tyre karakteristike dhe kishin thurrur këngë. Të gjitha këto kujtime emigrantët arvanitë i merrnin me vehte përtetje deteve.

Vargjet dhe tingujt e këngës më të njojur arbëreshë, një eleji e finesave të papërsëritshme që të trondit shpreh realitetin e kohës.

*O e bukura More
Çë kur të lash
Më nuk të pash
Atje kam u zotin tatë
Atje kam u mëmën time
Atje kam u tim vëlla*

Kjo këngë këndohet nga arbëreshët e Italisë dhe veç të tjerave ajo mbart një fakt historik domethënës. Ajo i kushtohet

1. E. Çabej: *Studime gjuhësore*, Rilindja 1976, F.92, Vëll.4

kujtimeve që kishte popullsia arbëreshë që vinte nga Moreja - pra Peloponezi. Pra, i dedikohet kujtimeve që merrte me vehte popullsia shqiptare, e cila ishte vendosur prej kohësh në territoret greke të Peloponezit.

Në se do t'i hedhin njësy folklorit të hershëm të arbëreshve të Italisë të mbledhur nga De Rada, Krispi, Kamarda, etj do të evidentohen mjaft fakte interesante që lidhen pikërisht me gjeografime e këngës popullore dhe burimet ku ajo eshtë krijuar. Kështu, kënga popullore arbëreshë thotë:

*të çanjë diert të hekurta
ndë kastele e Anapulit (Nafplios)
e të vë flamurin tim.*

.....
*te kasteli Anapulit
Te Anapulit e Methonit
e te Koronit fushëmirë.¹⁾*

Edhe në këtë rast në vargjet e këngët popullore janë mpiksur kujtimet dhe malli i arvanitëve të Greqisë të cilët mbas rrezistencës heroike antiosmane detyroheshin të braktisinë kështjellat e fundit të Nafplios, Methonit dhe Koronit në Peloponez dhe vendoseshin përtej deteve në brigjet italike.

Fakte interesante me vlera historike na jep jo vetëm puna kërkimore folkloristike e De Radës por edhe krijimtaria e tij. Ky personalitet i kulturës shqiptare kish mbledhur dhe njihte në të njëjtën kohë në mënyrë të përkryer këngët popullore arbëreshë, gojdhënën dhe traditat e kësaj popullsie. Në poemën e njohur "Këngë e sprasme e Balës", poeti ka derdhur brenda saj materialin origjinal të gurës arbëreshë dhe mjaft figura e personazhe në veprën e tij nuk janë thjesht pjellë e fantazisë së tij apo, të popullit, por figura e personazhe historike, të cilët patën jetuar, luftuar dhe rënë në fushat e betejave, krahas bashkëatdhetarëve të tyre. Kështu herojtë e poemës Pal Golemi apo bila (bija) e Lalës, janë personazhe

1. "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar", Vëll I, Fq 190

historike të cilët i gjejmë edhe në këngët popullore por edhe në realitetet e kohës. Lala ka qenë kapedan arvanit, por është edhe sot e kësaj dite krahinë, fshat dhe toponim, vendi në Pelopones.

Pra, nëse do të studjohej nën këtë këndvështrim kënga popullore arbëreshe, ajo do të zbulonte mjaft mirë dhe vendlindjen e saj, meridianin gjeografik, krahinën e deri fshatën prej nga ajo erdhi apo i kushtohet. Deri me sot ende nuk është bërë një studim konkret për të njojur konkretisht se cilët nga fshatrat e kolonive arbëreshe janë themeluar nga emigrantët të ardhur aty nga Arbëria dhe cilët nga arvanitët e Greqisë. Studimi i folklorit nën këtë kënd vështrimi do të ishte njëri prej çelësave që do të zgjidhte këtë problem. Themi se folklori do të ishte një nga rrugët mbasi krahas saj qëndrojnë "onomastika, ndryshimet fonetike dhe gramatikore të të folmeve të ndryshme,,, antroponomia... etj. të cilat dëshmojnë për shumëlojshmërinë e shpërnguljeve. Aktet e Sharteve janë dokumente me vlerë "që zgjerojnë edhe më tej mundësitë e zgjidhjes së kësaj çështjeje.¹⁾

Studimi i folklorit të arbëreshëve të Italisë i parë nën këto interesa na jep edhe fakte të tjera interesante. Kështu, në to mbarten kujtimet jö vetëm të personaliteteve të njoitura historike si të Skënderbeut, Lek Dukagjinit, Muzakajve por edhe të një sërë vendeve prej nga ishte shkëputur vala e të emigruarve. Duhet të theksohet se në të gjejmë edhe emra vendesh deri qytetesh, të cilat aktualisht janë shuar dhe nuk ekzistojnë më në hartat bashkëkohore gjeografike.

Kështu, qytetin mesjetar të Danjes të cilin e gjejmë në kronikat historike mesjetare si një qendër urbane të zhvilluar dhe më vonët e shuar plotësisht, kënga popullore arbëreshe na e bie përmes kujtimeve të rapsodëve:

*Dukagjini zemërgur
Trimit me i preu kriet*

1. L. Conti, O. Marquet: "Shpirti mbretëror në veshjet e gruas arbëreshe". F.53

*dhe e vu te mala e shpatës
hiri në Danj kaluar¹*

Me interes, për njohjen e kulturës dhe të moralit të popullsisë arbërore të këtyre shekujve, eshtë edhe studimi i fjalëve të urta dhe prozës popullore. Në to janë reflektuar në mënyrë të koncentruar karakteri, tiparet, vyrtytet, zakonet dhe traditat e këtij populli të cilat e dallonin atë në raport me popujt e tjerë të Ballkanit. Duke krahasuar informacionin që gjejmë tek arbëreshët e Italisë apo tek arvanitët e Greqisë, me folklorin e mbledhur në vendin tonë, shohim se një pjesë e madhe e tyre gjendet në të tre këto treva gjeografike ku banon kjo popullsi e një gjaku. E thënë me fjalë të tjera, permes tyre konkludohet se "datlindja" e fjalëve të urta, pra moralit, traditave, etj., ka qenë formuar të paktën në këta shekuj mesjetarë apo më saktë shumë më përpara se fillonin emigrimet. Në këto rrethana, një popullsi, me këto tradita të lashta, me këto vyrtyte morale të ngjizura, me këto tipare të veçanta të botës së saj shpirtërore, kish ngritur godinën e shkollimit kombëtar, që do ta bënte atë të paasimilueshme si para invazioneve të fuqive më të mëdha europjane aq edhe nëpër rrugët e emigrimeve.

Natyrisht, kjo mbijetesë do të kishte edhe përjashtimet e saj. Por, fakti që ndër të emigruarit nga Greqia në Italinë Jugore veç masës së arvanitëve pati edhe një masë popullsie greke, të cilët në ditët e sotme i gjejmë pothuaj plotësisht të asimiluar, tregon që mbijetesë e popullsisë arbëreshe në tërë harkun kohor të 4-5 shekujve lidhet pikërisht me subkonshencën e formuar nationale e kulturore.

Megjithatë le t'i kthehem emigrimit dhe vendosjes së arvnaitëve në territorët e republikave italike.

1. Mbledh. Hershëm Folk. Shqip. V.II, F.113

* * *

Gjatë gjithë periudhës së mesjetës, Italia e ndarë në Republikë e mbretëri të veçanta vuante vazhdimisht nga grindjet dhe përcarjet e vazhdueshme. Po kjo situatë mbizotëronte edhe në shekujt e 15-të dhe 16-të dhe jo vetëm kaq, por konfrontimeve mes tyre u shtohej jo rrallë edhe rreziku që u kanosej herë pas here nga fuqitë e tjera europiane si gjermanet, francezët, spanjollët, etj. Të gjendur para këtyre kërcënimeve të vazhdueshme, ato filluan të tërhiqnin pranë vehtes në aleanca të përkohshme a të përhershme forca luftëtarësh të njohur dhe dalluar për cilësitë e tyre ushtarake. Pikërisht në këto kohë, kancelaritë e Mbretërisë së Napolit, shtëpia e Mediçeve të Republikës Fjorentinase apo senati Venedikas filluan të shpallin përherë e më shumë dekrete që ligjëronin aleancat me formacione luftëtarësh shqiptare apo vendosjen e tyre në zonat dhe territoret e republikave respektive.

Një pjesë e luftëtarëve arvanitë kishte shkuar në këto republika që mbas ndeshjeve të para me ushtritë osmane, ndërsa një pjesë tjeter e tyre u thirr për të shërbyer në aleanca ushtarkae në bazat ushtarake detare që ishin koloni të latinëve në Egje dhe në Jon. Nga dokumnetet e kohës bëhet e qartë se këto baza ishin trampolini i fundit i emigrimeve të mëdha arvanite nga Greqia në Itali në fundit e shekullit të 15-të dhe gjatë shekullit të 16-të. Në aleancat ushtarake më latinët, arvanitët shkuan mbi bazë kushtesh dhe marveshjesh dypalëshe të përcaktuara që më parë prej tyre. Në to përcaktohej se për çdo luftëtar, më saktë ushtar të thjeshtë, shpërblimi mujor ishte 2 deri 8 dukate në muaj, ndërsa për komandantët e tyre deri në 12 dukate. Në mjaft nga këto dekrete përcaktohen edhe të drejtat pasurore që ata do të gëzojnë: - tokë në pronësi pa të drejtë shitjeje, çvishen nga taksat dhe punët angari, me detyrimin të jenë të gatshme për çdo shërbim ushtarak brenda dhe jashtë kufijve", etj.

Të njohur qe më parë prej latinëve, veçmas për afësitë

e tyre të rralla ushtarake, karakterin dhe qëndrueshmërinë, arvanitët u priten me interes të veçantë në tërë territoret italiane ku ata emigruan dhe u vendosën. Ne kronikat e kohës gjëjmë mjaft dëshmi që paraqesin pikërisht këtë interes, vëmendjen që tërroqën këta emigrantë dhe në të njëjtën kohë respektin dhe kortezinë e veçantë që paraqitën qarqet zyrtare dhe masat e thjeshta para kësaj rrace, bëmat e së cilës kishin tërhequr vëmendjen e Europës.

Ja si i paraqet një dëshmitar okular i kohës vajtjet e para të arvanitëve në këto anë:

“... Në vitin 1482 mbritën në Venecia luftëtarët e parë shqiptarë të ardhur nga Argosi dhe Nafplio. Ata u priten me nderime dhe respekt të veçantë dhe mbas pak kalorësia e dëgjuar e tyre u dërgua në frontin e Ferarës ku ata dualën fitimtarë...”¹⁾

Dëshmi të tjera për efektet që shkaktuan vajtjet e luftëtarëve të parë shqiptarë nga territoret italiane na japid edhe historiografet e tjera të kohës C.P. Cippico dhe M. Sanuto të cilët theksojnë habinë që shkaktuan këta njerëz sa me paraqitjen e tyre të veçantë aq edhe me veprimet e tyre të mahnitshme ushtarake në paradën e mbrritjes para qytetarëve latinë.²⁾

Me të njëjtin repsekt u priten edhe të emigruarit shqiptarë të cilët shkuan në këto anë nga territoret e Shqipërisë. Një dëshmi interesante na bie në këtë rast Barleti ynë, ku ndër të tjera na bën të njobur: “...Ne shkodranët, siç mbetëm të mërguar, erdhëm në Venedik, shtatqind burra, njëmijë e treqind fëmijë dhe aq gra... ne si të hutuar qëndronim përmbyt te këmbët e frontit të Dozhes. Pamë dozhe dhe senatorë të prerë në fytyrë dhe me lot në faqe, lot që për ne qenë shpëtim dhe për ata qenë nder, shenjë dhemsurie dhe jo vuajtjeje. Aty për aty na ngritën në këmbë na ngushëlluan

1. C.P.Cippico dhe M.Sanuto: *Delle guerre de Veneziani... Commentari della guerra di Ferrara...* F.342

2. Po aty, F.270

me dashuri dhe mëshirë, na përqafuan me gjithë zemër... Na bënин gjithfarë mjekimesh sipas rastit dhe na pyesnin në se dëshironim të tjera..."¹⁾

Por më të mbritur, fati do t'i conte këta njerëz të fortë dhe të ashpër përsëri në fushat e përgjakshme të betejave, jo vetëm nëpër territorët e gadishullit Apenin por edhe më gjërë nëpër tërë kontinentin europian. Kontributi dhe bëmat e shqiptarëve në frontet e luftrave europiane, në ndeshjet mes mbretërive dhe principatave, nga Spanja në Belgikë, nga Sicilia në Francë e Gjermani, janë të shumta, dhe gjurmëlënëse në shumë kronika, raporte dhe analiza ushtarake të kohës. Historia dhe kontributi i luftëtarëve shqiptarë të emigruar në mesjetë e shtë tepër i gjerë dhe pothuaj në këtë këndvështrim fare i pastudjuar.

Këto njësi ushtarake të vlerësuara si vendimtarë për vendosjen e fatit të luftimeve në fushat e betejës, në shumë raste ndryshuan rrjedhat e ngjarjeve politike dhe ushtarake mes vendeve të Europës. Mjaft prej njësive të luftëtarëve shqiptarë u përzgjodhën si njësitë e nderit dhe reparte të gardave perandorake deri në fund të shekullit të 19. Komandantë të shquar shqiptarë me luftëtarët e tyre u dekoruan dhe u lauruan me tituj, grada dhe flamuj si rrallë kush tjetër në Europë.

Pati nga ata që përmes fushatave të përgjakshme ushtarake arritën në Japoninë e largët, duke përgjunjur Samurajt e shumëdëgjuar.

Këto dukuri nuk janë objekt i vëzhgimit tonë dhe ne nuk do ndalemi gjatë në të. Sidoqoftë nuk mund të rrimë pa evidencuar ngjarje, bëma dhe personalitetë të ndryshme të emigracionit shqiptar, i cili tërhoqi vëmendjen e kohës.

"Pak më vonë venedikasit ftuan përsëri shqiptarë të tjerrë nga Greqia dhe siguruan kështu një masë tjetër prej 1000 burrash së bashku me kuajt e tyre të kalorësisë. Nga Zaqintho erdhen fillimisht 200 kalorës dhe mandej 200 të tjerrë së

1. Marin Barleti: "Rrethimi i Shkodrës", Faqe 157

bashku me komandantin e tyre kapedanin Dhimitër Laskari (Laska). Mandej erdhi komandanti i njohur Petro Buziqi me 520 kalorës, ndërsa nga Nafplio dhe Peloponezi erdhen 800 të tjerë. të gjitha këto forca u dërguan së bashku me njësitë e tjera ushtarake venedikasish në fronitn e luftimeve kundër mbretit të Francës.

Në këtë betejë, shqiptarët treguan një heroizëm të pashembull që i ngjau mrekullisë për aplikimin e taktikës ushtarake dhe duke u shkaktuar kundërshtarëve pasoja të rënda, tronditje dhe llahtare...¹⁾

Nga materiali i kohës gjendet dokumentacion ku kronistë, vëzhgues ushtarakë si dhe pjesmarrës të tjerë të fronteve të luftimeve përshkruajnë çuditë dhe habinë që krijuan këta njerëz para europjanëve. Kurajua, aftësitë dhe përmë tepër morali me të cilin ata luftrojnë i veçon ata nga mercenarët e tjerë të fronteve të luftravë europiane.

"Natyrisht, ata emigruan përti i shpëtuar pushtuesve dhe përtë siguruar para dhe plaçke. Ata luftrojnë përlavdinë e tyre dhe të atdheut të tyre. Siç thotë Mërkur Bua, - ai lufton që të njohin burrërinë e tij, trimërinë, ta nderojnë dhe vlerësojnë..."²⁾

Po këtë ideal e gjejmë të pasqyruar edhe në mjaft këngë epike të kohës si në folklorin e arvaniteve të Greqisë aq edhe në atë të arbëreshëve të Italisë. I tillë gjendet i përcjellë ky lloj mesazhi deri në shekujt e mëvonë...

*Vemë e vdesim ne dhe tene
Atje tek e patëm thënë
Vdesim me pallë në dorë
si dhëndurë me kurorë.³⁾*

Vetë Dozha i Venedikut duke falenderuar arvanitin Mërkur

1. K.Biri: "Arvanitët..." Faqe 165

2. Po aty, Faqe 164

3. Mbledh të her. të folk. shqip. Vëll II, Faqe 106

Bua për shërbimet e shquara të tij ndaj republikës, kontributet e ralla në fushat e betejave, i drejtohet atij duke i thënë: "Çdo vend dhe krahinë duhet të të nderojë. Edhe vendi yt do ta marrë këtë gjësim".

"Asnjëherë këta luftëtarë nuk kërkuan nga prijsat e tyre mëshirë apo te zgjasnin duart drejt tyre për lëmoshë e bukën e gojës. Në të kundërt ata kërkonin vetëm lavdinë që u takonte dhe njohjen publike të bëmave të tyre".¹⁾

Që mbas betejave të para në territoret italiane, latinët i "vlerësuan ata si heroj. Vetëm rregulli përkundesa si dhe veshja me armatim që mbronte jo vetëm ata por edhe kuajt e tyre tregonte se ata ishin miq të kafshëve (kuajve). Jo vetëm të mbrojtur mirë por edhe tepër të pamshëm si petrita, megjithatë vlerat e tyre të vërteta luftarake qëndron tek ndjenja e tmerrit që ata i shkaktonin kundërshtarit që në paraqitje".

Në të vërtetë veshja e tyre e luftës, me pamje të tmerrshme i mbronte sa nga kundërshtari aq edhe për të mos u ndikuar psikologjikisht nga plagët e vdekjes".

Jashtë vëmendjes së latinëve natyrisht, nuk mbeti as veshja e zakonshme e shqiptarëve. Ajo tërhoqi vëmendjen e vendasve për finesën, ornamentet dhe motivet e punuara në ar. Në shumë studime konkludohet për origjinin arhondiane a mbretërore të tyre. Aq të forta ishin efektet e shijes së hollë te kostumeve të kësaj popullsie sa autorë të kohës e vlerësojnë atë "si një gjë të rrallë gati-gati skenike. Kjo veshje të sillte në mendje heroin e betejave në legjenda mitike".

Kostumeve të grave apo të burrave në ato vite të mesjetës apo më pas i janë kushtuar një numur i madh gravurash dhe tablosh nga mjaft artistë në zë të rilindjes italiane apo të periudhave të mëvonshme. Mjafton të kujtojmë këtu tablonë e njohur "Shqiptari i Venedikut", e cila ndodhet në galerinë Tretjalkov të Moskës dhe qëavidencon pikërisht një shqiptar,

1. M. Sanato: Diary L. VI, Faqe 143

ndoshta nga radhët e emigrantëve për të cilët flasim, në sheshet e Venecjas. Pa dashur të bëjnë aspak koment figurës tepër tërheqëse të këtij shqiptari, ende nuk kemi të dhëna për identitetin e tij. Tablo të tjera kushtuar shqiptarëve dhe bëmave të tyre në këto periudha gjenden në mjaft muze të Italisë, Francës, Greqisë, Anglisë, etj. një pjesë e tyre janë punuar nga piktorë në zë deri të tillë si Tician, Karpaçio, Hjuz, Lir, Hobhauz, etj. Këto padyshim mund të jenë një pjesë fare e vogël e atij thesari të madh që mund të gjendet në pinakoteka personale nga fonde të panjohura familjesh e galerish.

* * *

Duke iu kthyer fatit të mëtejme që ndoqi arvanitët në emigrimet e tyre dhe kryesisht kontributit të tyre të veçantë si ushtarakë dhe luftëtarë të njohur në tërë fushat e betejave, vëmendje tërheqin edhe tiparet e tyre të veçanta fizike dhe psikologjike.

"Sa të tmerrshëm u çfaqën ata në zbritjet e para në këto vende si luftëtrë, aq përshtypje të tjera krijuan ata si njerëz kur jetuan brenda gjirit të popullit italian. Jeta me pretendime të pakta, dietë të kufizuar, karakteri i ashpër, hija e tyre e rëndë, serioze dhe dorike, natyra rezistene e përmrbajtur, reagimet befasuese, ishin tiparet me të cilat ata u çfaqën para italianëve dhe europianëve në përgjithësi. I qëndrojnë deri në fund fjalës së dhënë. Kur rrezikohet komandanti i tyre janë gati të japid jetën e tyre se sa ta braktisin atë, të ikin apo të dorëzohen..."¹⁾

Në këto vende ata u njohën me emërtimet "stratiote apo Epirotarum e equites... Venediku pati në shërbim të tij shumë stratiotë e kalorës epirotë. Disa nga këta zunë grada me

1. Marino Sanuto: *Commentari della guera di Ferrara*, F. 116

rëndësi, psh, Merkur Bua prej Moreje, me origjinë siç duket prej Himare, arriti të bëhet komandanti i ushtrive të Republikës dhe një nga gjeneralët e njohur të kohës...^{"1)}

Konstatimi i Çabeit në këtë rast është me vlerë, me rezervën që Mërkuar Bua për të cilin ai flet nuk gjejmë të ketë atë origjinë që ai nënvizon. Siç do të shohim hollësisht më pas këtë figurë, ai është pinjoll i familjes së njohur të Bujave të zbritur nga Arta në Peloponez në shek. e XIV, dhe prej andej i emigruar dhe i vendosur me luftëtarët e tij në shërbim të venecjanëve.

"Janë të armatosur lehtë në raport me franget e mbuluar tërë hekur. Pothuaj të gjithë janë pa torakse metalike. Përdorimi i kalit nga ana e tyre është pothuaj në shkallën e përsosmërisë dhe në përdorimin e armëve janë shumë të shpejtë, të rrezikshëm, tepër të përgatitur dhe të aftë për luftë.

Shumë nga tiparet e mësipërme studjuar të ndryshëm i veçojnë si trashëgimi të përcjella brez pas brezi tek këta njerëz ngalashtësia e tyre. Dalmatini Carolino Cipiko shkruan: "...janë të aftë përfardolloj operacioni... për nga natyra këta burra parapëlqejnë rrëmbimin dhe sulmet shkatëruese kalimare në raport me sulmet frontale..."

Ndërsa Sanuto (historjani italian) na bënte të njohur: "...kanë shpatë, një hushtë të gjatë me flamur në majë dhe topuz të metaltë. Shumë pak prej tyre mbajnë torakse, dhe përgjithësisht mbajnë kapela pambuku të qepura në një mënyrë të veçantë... kuajt e tyre janë të mësuar në vështirësi, vrapojnë si zogj, mbajnë përherë kokën lart dhe u kalojnë të tërëve në tekniken e luftës..." ...organizojnë në mënyrë të përkryer sulmet e shpejta dhe plaçkitjet, duke u lëshuar fare papritur mbi armiqëtë. Nuk zënë robër, por presin kokat duke amrrë për çdo të tillë sipas traditës dhe rregullit të tyre një dukat. Hanë pak dhe çfardo lloj ushqimi, por u bëjnë shumë

1. E.Çabej: *Studime Gjuhësore*, Vëll III, F.92, Rilindja-Prishtinë

shërbim kuajve të tyre."

"Do, të ishte vërtet një mrekulli për cilindo që mund të arrinte ti shpëtonte shpjëtësisë së kuajve të tyre (shqiptarëve)... goditjes së topuzit apo shpatës. Ndjekja dhe afrimi i tyre ishte njëlloj i barbartë me ndjekjen apo afrimin e vdekjes... X

...Ajo që ka më shumë rëndësi dhe që përtë cilën frangjet nuk kishin idenë ishte taktika që ata aplikonin në operacionet e tyre luftarake. Përmes këtij arti ata arrinin të përhapnin panik, të bënин kërdi dhe të kapnin kundërshtarin të hutuar. Organizonin zbulimin përtë njohur forcave armikut, pozicionet që ata kishin zënë, bënин studim të kujdeshëm të terrenit përtë gjetur monopate dhe vendkalime të panjohura që të çonin tek kundërshtari. Bënин përherë studimin e kujdeshëm të planit të luftës në vartësi të mundësive të tyre... kalonin male dhe lumej përtë bërë të mundur rrëthimin e plotë të kundërshtarëve.¹⁾

"... Sulmet e natës dhe mashtrimet e përsosura që ata aplikonin përtë'u afroar kundërshtarit, përfundonin të gjitha me një sulm të papritur dhe të papërmbarjat që binte vetëm shkatërrim.

Ndër variantet më të preferuara të tyre në taktikat luftarake ishte inskenimi i varjantit sikur që në ndeshjen e aprë ata thyheshin dhe mbas kësaj "fillonin të têrhiqeshin të trembur e në panik". Kuptohet, që kundërshtarët viheshin në ndjekje duke prishur formacionin e rregullt të reshtimit të tyre. Tamam në këtë kohë ata ktheheshin me shpejtësi dhe papritur lëshoheshin mbi kundërshtarin si skifterë duke shkaktuar tmerr dhe panik mbi ta. Variantet e tyre luftarake nëpër fushat e betejave tronditën vërtet jo vetëm frangët me të cilët u ndeshën të parët por edhe europianët e tjera. Emri i stratiotit me të cilin ata u njohën nëpër fushat e betejave mori në atë kohë nëpër Evropë kuptimin e "luftëtarit të tmerrshëm".²⁾

1. Lodovig da Porta: *Lettere Storiche*, F.28

2. Po aty F.56

Duke iu referuar vetëm shkurtimisht një dokumenti ushtarak të kohës përmes të cilët Duka i Avrilisë i dërgon Mbretit Karl të Francës, i cili e pat thirrur për ndihmë në zonën e Plaketës i shkruan: "In al madh nushëm Mbret! Mora urdhërin tuaj për të ushtrinë dhe bashkuar me ju në Plaketa, por, sinqerisht ju bëj të njojur se në kampin luftarake të kundërshtarit tonë - Dukës së Milanoz gjenden disa njerëz të cilët thirrën "Stratiotë" që nuk dimë në janë turq apo djaj, të cilët jo vetëm nuk na lanë të dalim nga muret e keshtjellës tonë të Navarës por na shkaktuan edhe dëme të mëdha. Ata vrasin ushtarët tanë dhe venë kokat e prera në majat e hushtave të tyre. Çdo ditë i sulen dhe u afrohen deri portave të qytetit. Në se më parë arrinim të çanim me mundim dhe të vinim deri në Besevenë, tanimë kjo gjë është e pamundur mbasi ushtarët tanë janë **tmerruar** dhe nuk duan të dalin përtej mureve të qytetit. Dhe vërtet, në se do të dalim jashtë mureve të qytetit, ata do të na shpartallojnë dhe do të na vrasin të gjithë".¹⁾

Këta luftëtarë të tmerrshëm për të cilët shkruan në letrën e tij Duka i Avrilisë, janë pikërisht njësitë ushtarake të arvanitëve nën komandën e kapedanit të njojur Petro Buziqi (Buzi) i ardhur nga territoret e Peloponezit. Ndeshjet e para ai i zhvilloi në frontet e Novarës kundër francezëve. Efektet e veprimeve të tij luftarake janë të mëdha. Në dokumentet e njësive ushtarake të kohës janë evidencuar deri veprimet e tij të para përballë kundërshtarit. "Ja të shohim - thotë ai - në se kundërshtari ynë ka zemër të na përballojë. I afrohen kampit të kundërshtarit fare afër "për të parë çfarë lloj njerëzish janë këta francezët...". Dhe vetëm me párarojën fare të vogël të tij ai avancon duke u ndeshur me 40 kalorës të mbuluartérësish në hekur, 100 këmbësorë dhe 3 harkëtarë. U sulet papritur duke vrarë 9 vetë, 12 kuaj, dhe zë robër 26 vetë duke detyruar pjesën tjetër te têrhiqet në panik të plotë.

1. K.Satha: "Elines stratiotis en ti Dhisi", Faqe 45

Nga Vezevene i drejtohet Kazuolit ku ndeshet përsëri me francezët duke vrarë 22 kalorës të tyre. Me forcat e tij të vogla ai rrrethon kështjellën e Vilanovës ku ishin përqëndruar 12 000 forca franceze. Kjo rracë luftëtarësh të papërmbajtur me një paraqitje të tmerrshme dhe vrulle stuhie imponon francezët të dërgojnë përfaqësues dhe të kërkojnë të dorëzohen tek ata me kushtin që ata të falen dhe mos ndëshkohen. Të njëjtën ditë njësi të tjera arvanitësh arrijnë të marrin kështjellat e Çeranos dhe të Trakanos.

Ushtritë franceze të cilat kishin pushtuar në atë kohë një pjesë të mirë të territoreve italiane përmblidhnin një numër tepër të madh trupash. Ata kishin depërtuar deri në Italinë qëndrore me një këmbësori e cila i kalonte të 200 000 vetëm dhe rreth 100 000 kalorës. Çfaqja në këtë kohë e luftëtarëve shqiptarë brenda formacioneve të princëve italianë, betejat e tyre të para të suksesshme dhe befasuese, krijuan raporte të reja morale dhe psikologjike në radhët e italianeve. Dështimet e njëpasnjësshme dhe tronditëse të njësive franceze, rëniet e disa kështjellave dhe qyteteve nga forca të pakta luftëtarësh shqiptarë, si dhe përpjekjet për bashkim të një numur mbretërish italianë kundër pushtuesve francezë, imponoi këta të fundit të térhiqnin ushtritë e tyre me urgjencë dhe të kalonin sa më parë Alpet, pa arritur që forcat vendase ti mbyllnin atyre shtigjet dhe rrugët e kthimit. Por, forcat e para prej gati 700 shqiptarësh u dalin atyre para në fushën e Parmës, në Podi të Fornovës dhe në momentin e përshtatshëm hidhen në sulm dhe i godasin ata rufeshëm duke u kthyer përsëri në pozicionet e tyre të mëparshme me 40 koka ushtarësh francezë të vrarë. Po këtu forcat e shqiptarëve rigrupohen dhe godasin përsëri trupat franceze duke u shkaktuar dëme të mëdha dhe duke i detyruar ato me në krye vetë Karlin të largohen të dëmtuara dhe në panik të kthehen në Francë.

Mbas betejave kundër francezëve, nën flamurin e venedikasve, arvanitët e Dhimitër Laskarit (Laska) me një forcë goditëse prje gati 400 vetë - kalorës rrethojnë dhe çiriljnë Pizën. Mandej këto forca drejtohen të godasin

Fjorentinasit dhe prej këtu rikthehen në Venecia ku priten me nderime të shumta. Komandanti Dhimitër Laskari merr titullin e Mega Dukës - Duke i Madh. Këtë komandant shqiptar e gjejmë edhe në beteja të tjera nën venecjanët përtej kufijve italikë, përherë të suksesshëm në krye të bashkëatdhetarëve të tij.

Në këto fushbeteja dhe kronika, raporte ushtarake, evidenca për njësitë dhe përbërjen e tyre, gjejmë emrat e komandantëve të tyre të dëgjuar dhe të mjaft ushtareve të thjeshtë të bërë të njojur në shumë luftime. Ndërsa, dalin më në pah Andrea Muriqi, Dhimitër Buzaqi, Dhimitër Laskari, Millakastro, Petro Buzaqi, Kosta Kondo, Jorgo Lepiti, jani Jatrako, Theodhor Shtrala, Jakov Mamaluko, etj.

Por, ai që mori përmasat e një heroi, ai që u dekorua më shumë se çdo ushtarak tjetër i asaj epoke, që u ndesh më shumë se çdo ushtar në fusha betejash dhe nga çdo rast doli i sukseshëm së bashku me njësitë e tij të lavdishme shqiptare mbetet e Mërkur Bua.

Mërkuri është një nga pinjollët e familjes së famshme të Buavje, princave të njojur shqiptarë të cilët në mesjetë zotëronin krahinat më jugore të Arbërisë: Arta Preveza, Angjelokastrë dhe Janinën. Emri i tyre gjendet në Kronikat e Tokos dhe dokumente të tjera të kësaj periudhe si të murgut. Prokleti Kronistëve Bizantinë. Kantakuzino, Halkokondili dhe **materiale** të tjera të periudhës bizantine. Mbremri i tyre **kryesish** jepet Bua por në raste të veçanta e gjejmë edhe **Buna**, **Buja** dhe si toponim edhe Bujana e Buena. Ka ndonjë **shkrim sporadik** të autorëve të huaj, të cilët duket se në përpjekje për të spjeguar etimologjinë e mbiemrit të fisit, duan të argumentojnë se kjo farë princërore ishte e ardhur nga Arbëria qëndrore apo ajo veriore. Por, asnjë nga materialet historike që janë konsoliduar deri më sot nuk flet në favor të këtij shpjegimi. Në të kundërt i gjithë dokumentacioni historik na bën të njojur se ajo është trashëgimtare e hershme dhe vazhduese e derës së despotëve pararendës Bua të Arbërisë jugore apo të jugut të Despotatit të Epirit.

Edhe në pohimet e pinjollëve të kësaj dere dhe në

dokumentacionin mesjetar të familjes pohohet me krenari se ata janë vazhdues të drejtpërdrejtë të derës dhe gjakut mbretëror të Pirros së Epirit dhe zotërues të një feudi fundit bregdetar në Jon, Buena ose Bua. Nën këtë pretendim në flamurin e familjes princërore të Buajve zinte vënd përherë një stemë e Mbretërisë së Pirros dhe e legjendës që rrëfente se kur ai ishte i mitur, kishte mbytur gjarpërin, si dhe një stemë me valë deti që tregonte pronësimë mbi territorët bregdetare - Buena

Mërkuri siç kemi përmendur më sipër, nuk emigroi, drejtpërdrejt nga territorët e Arbërisë në ato italiane. Familja e tij ishte larguar që prej disa dekadash në territorët greke të Moresë - (Peloponez), mbasi kishte lënë vendbanimet stërgjyshore të Artës, Angjelokastrës, Prevezës. Në çështjen e autoktonisë shqiptare në këto territorë të Epirit të Jugut (Despotatit mesjetar të Epirit të Jugut) është çfaqur edhe ndonjë mendim i gabuar se në këto territorë rrëth shekullit të 13-14 filluan të vendosen fshatarë të lirë shqiptarë... Kjo tezë e pabazuar bie ndesh me dokumentacionin historik të kohës dhe pohimet e kornistëve bizantinë. Kështu, të paktën që prej fillimit të shekullit të 14-të, Buajt gjenden të evidencuar në dokumentet e kohës si zotër të kështjellave dhe territoreve të Epirit të Jugut, - Angjelokastrës, Artës, Ahelout, Katohisë, Aetout dhe Etolo Akarnanisë. Sidomos beteja e Spatajve kundër koalicionit serb, latin, turk dhe fitorja e tyre e bujshme në luginën e Ahelout konsolidoi edhe më tepër pushtetin e Spatajve, dhe i bëri ata të njojur në Europë. Këto zotërimë edhe mbas vdekjes së princit të famshëm Gjin Buea mbeten në duart e pinjollëve të njojur të kësaj dere Muriq Buas, Mërkurit, Pavllos, Zguros, etj, të cilët për më tepër se një shekull bënë emër dhe ndërtuan historinë e zhvillimeve të kësaj ane të Epirit. Që shqiptarët dhe prijsat e tyre të këtyre anëve të kenë qenë të ardhur, nuk evidentohet në asnjë dokument apo burim historik të këtyre shekujve, të mëparshëm apo të mëvonë. Në të kundërt, autorë të ndryshëm bizantinë pohojnë se këtu banonte një pak popullsi e përzier dhe me dominim të ndjeshëm të shqiptarëve.

Kështu, më 1336 kur princi i Etolo Akarnanisë vdiq dhe vendi ishte përfshirë nga revoltat e banorëve vendasve shqiptare, në drejtim të tyre, për t'i nënshtruar ata niset Androniku i III Paleologu. Në të thuhet: "...meqenëse perandori e dinte se Ilirët ... bashkëjetonin me dinakëri, mendonte se edhe tani do të ishte e vështirë dhe pengesë në ekspeditën e tij kundër akarnanëve dhe etoleve. Për këtë njoftoi që të vijnë 2000 mercebarë nga turqit që banonin në Izmir..." ¹

Kontakuzino bën të njohur se fill mbas largimit të Perandorit të Bizantit, Andronikut të III, i cili mori pjesë në shtypjen e këtyre revoltave shqiptare, këta të fundit ringrihen përsëri në rezistencën e tyre antiperandorake.

Në një tjetër dokument, në "Kronikën e murgur Komnen dhe Prokel", thuhet se në vitin 1358 "Mbreti Simeon (Uroshi) duke treguar kujdes vetëm për vllahinë, krejt Etolinë u a la shqiptarëve. E gjithë krahina e Etolisë u nda në dy pjesë. Nga popullsia shqiptare aty, u caktuan dy despotë, njëri i quajtur Gjin Buja që u bë zot i Ahelout dhe vendeve përreth me gjithë Angjelo kastren, kurse tjetri që quhej Pjetër Liosha u bë zot i Artës dhe i Rogisë..." ²

Fakte me interes që mbështesin autoktoninë shqiptare në këto anë bie edhe Kronika e Tokove, në të cilat mes të tjerave thuhet: "...në ato vite shqiptarët sundonin despotatin, Artën dhe Aheloun, bashkë me Akromerin dhe Nafpaktion... Vendim morri gjithashtu fisi shqiptar të kryejë një veprim e një sulm të hyjë në Lefkadhe".

Në po këto dokumente bëhet e njohur se kur Karl Toko kërkoi të nënshtrojë princin Pavllo Bua, filloji të grumbullojë ushtri mercenare frange, greke, serbe dhe shumicën shqiptare..."

Një tjetër kronist bizantin, Anonimi na bën të njohur një fakt tjetër me rëndësi, duke nënvizuar se, "...vendin që prej

1. *Dok, Periu. Bizant për Hist e Shqip., Faqe 215*
2. *Po aty Faqe 241*

Etoleve dhe deri tek Thesprotet e Molloset, domethënë krahinën e Epirit jo të gjithë, por edhe një pjesë që gjendet në Ahene, atë që shtrihet nga lumi Ahelo deri në Evin. Në gjithë atë vend në zonat bregdetare banonin grekë, kurse në ato më sipër dhe në brendësi si në të kalaurën edhe tani banonin barbarë.... në krejt atë vend që në kohët e vjetra, ka qenë i ndarë në fise Etole, Akarnane, Amfilohe, Kasiope, Dolope, Ambrakiote, Atamane, Thesprote, Mollose e Kaoone që shtrihen në malet Akrokeraune. Këto fise të vjetra e të shumta që në të kaluarën kishin burra të shumtë dhe trima tani janë pushtuar nga një varfëri e madhe... Edhe tani gjithë ai vend, Epiri banohet në mënyrë të shpërndarë, në grupe të vegjël dhe në fshatra shqiptare popullsi ilire.”¹⁾

Pikërisht në këto territore, të populluara në dominim nga shqiptarët lindën dhe bënë epokë nga një gjeneratë në tjetrën fara e Buajve. Kjo derë e madhe dhe e fuqishme në fillimet e shekullit të 14-të prezantohet në kronikat historike nga katër vëllezërit Spata, dy prej të cilëve na jepen edhe me emër Gjin dhe Zguro. Më pas, pothuaj në gjithë harkun kohor prej gati një shekull e gjysëm, (1300-1450) gjenden në planet e para të zhvillimeve historike të Epirit, Greqisë dhe më gjëre nëpër Europë, pinjollës pasardhës të kësaj dere Pavllo Bua, djemtë e tij Petro dhe Muriq Bua, dy vëllezërit e tjerë Dhimo dhe Jagup Bua, e shumë e shumë të tjerë.

Gjatë përpjekjeve për ekspansion të latinëve në Ballkan dhe kryesisht me fushatat e ashpra të dukës Karl Toko, disa prijsa të kësaj dere, së bashku me popullsinë shqiptare që banonte në këto anë të Epirit, emigrojnë dhe vendosen në Thesali, Peloponez dhe në Atikë.

Një numur i madh historjanësh dhe kronistësh, bashkëkohës bizantinë e latinë janë marrë dhe kanë trajtuar këto figura të mëdha dhe komplekse. Edhe më pas historjanë të periudhës moderne u janë rikthyer dhe trajtuar pinjollët e

1. Anonimi: *Shqiptarët në Epir (1427-1446)*, F.318

kësaj dere tepër stoike. Ka nga ata të cilët i kanë kushtuar deri vepra të plota bëmave të tyre siç eshtë poeti arbëresh Manol Bleshi në shek e XVI apo historjani grek Xane Koroneos.

Por pa mëdyshje një ndër figurat më të shquara të kësaj dere ishte komandanti Mërkur Bua (ardhur nga Nafplio e Poloponezit). Mërkuri ishte stërnip i Mërkur Buas Zguros dhe nipi i Petro Buas, i cili kishte qenë komandant i forcave kryengritëse arvanite në Peloponez kundër turkut.

Në poemën e tij, historjani grek Xane Koroneo e vlerëson atë si "pasardhës të mbretit Piro të Epirit, trim si Akili, Hektori, Enea dhe Aleksandi", sa i përket dijeve ai e krhaason atë me Nestorin dhe për nga bukuria me Parin".¹⁾

Bëmat dhe personaliteti i tij filloi të çfaqet më dukshëm në vitin 1496 atëhere kur ai u ndesh me fjoventinasit, të cilët kishin sulmuar dhe marrë Pizën. Mërkuri së bashku me trupën e luftëtarëve shqiptarë prej 300 kalorësisht, në aleancë me venecjanët, godet fjoventinasit dhe del fitimtar mbi ta, në fushën e Agronopolit. Një tjetër betejë, që shtoi edhe më tej interesin ndaj këtij personaliteti ushtarak ishte ajo që u zhvillua në vitin 1497 kundër Mbretit Karli i VIII të Francës në Lombardi. Edhe në këtë betejë Merkur Bua së bashku me luftëtarët e tij arvanitë "tregoi trimëri të madhe dhe aftësi strategjike t shkëlqyera si një arvanit i tmerrshëm"²⁾

Në vitin 1498 në Francë vdes Mbreti Karl i VII dhe në fron hipën Ludoviku i XII-të. Ky mbasi mobilizon forcat e tij ushtarake risulmon dhe pushton Milanon. Mërkur Bua i ngarkuar për të goditur forcat pushtuese, ndeshet me ta dhe i thyen frangët duke i detyruar të largohen nga qyteti. Në vazhdim të operacioneve të tij ushtarake, Mërkur Bua me forcat e tij çliron Pavian, Biçevanon, dhe Navarën nga forcat franceze.

Në vitin 1502 Mbreti Ludovik i XII-të u bë sundimtar i

1. X. Coroneo: *Bua anthagathimata...* Faqe 2-6

2. X. Coroneo: *Bua andhragathimata...*", Faqe 6

Lombardisë dhe lidhi aleancë me Markezin e Mantovës. Forcat e bashkaura të kësaj aleance këtë vit ndeshen me spanjollët. Në këtë betejë, përkrah forcave të aleancës u renditën edhe Mëkur Bua me 400 kalorësit e tij, megjithse jo shumë kohë më parë ai ishte ndeshur me francezët. Arsyja që Mërkuri pranoi këtë bashkëveprim ishte se ai kishte miqësi të ngushtë me Markezin e Mantovës. "Qenia e tij si prijës mercenar nuk e pengonte atë të kalonte nga një gjendje të tjeter, sepse besa shqiptare e detyroi atë të tregonte besnikëri dhe vemtohim për eprorin dhe mikun e tij të ri". Veprimet luftarake të tij në fushën e luftimeve e befasuan dhe e mahnitën mbretin e Francës. I entuzjazmuar nga fitorja që i dhuroi ky aleat në betejat kundër spanjollëve, monarku francez i dhuroi atij dy krisobula që i dhanë atij titullin e Kontit dhe gradën e Gjeneralit, gjithashtu ai u bë komandant i kavalerisë së lehtë franceze që në atë kohë përbëhej nga 6000 kalorës.¹⁾

Mbreti i Francës mbas ndeshjeve dhe fitoreve të bujshme mbi spanjollët e ftoi Mëkur Buan në Paris. Për nder të tij ai organizoi në pallatin mbretëror një pritje madhështore ku mbas fjalimeve të zjarra kushtuar bëmave të këtij heroi e mbushi atë me dhurata të shumta. Në poemën e tij kushtuar kësaj figure Xane Koroneo thotë:

*I vari në qafë kollanin e artë
 e veshi të tërë në të arta
 shumë njerëz me gisht e tregonin
 dhe njëri-tjetrin pyesnin
 por mbasi e njohën thanë:
 Mëkur Bua është, dhe i thanë
 "Ty të shikon kollani
 Ti duhet të jesh kont"²⁾*

1. X. Coroneo: *Bua andragathimata...* ", F.24

2. Po aty, F.29

Në vitin 1506, Ludoviku i XII-të e dërgoi përsëri Mërkur Buan në Itali për të ndihmuar Papën e Romës në luftën kundër Bedivolios, i cili ishte ngritur në revoltë dhe kish arritur të merre Bolonjën. Në betejën që u zhvillua në afërsi të këtij qyteti Mërkur Bua me trupat e tij doli fitimtar. Papa në shenjë mirënjoje për këtë nder të madh që i bëri Bua, i dhuroi atij një brez të artë, i dha një shumë prej 1000 florijsh dhe e bekoi atë me dorën e tij.

Një vit më vonë kur territoret italiane të Gjenovës ngritën krye për të larguar prej andej trupat pushtuese franceze, Ludoviku i XII niset në fushatë ushtarake kundër tyre duke pasur në radhët e ushtrisë së tij edhe njësitë e shqitparëve të Mërkur Buas. Në kronikat ushtarake që përshkruajnë betejën thuhet që me trupat e tij Mërkuri asgjesoi në fushën e betejës rrëth 2000 ushtarë të kudnërshtarit, plagos 1000 të tjerë dhe zuri robër rrëth 500 fisnikët ë cilët i dërgoi në Kampin e francezëve ku i priste vetë Mbreti Ludovik. Ky i fundit e priti me një entuziazëm të madh kapedanin shqiptar, por Bua pa pritur për ceremoni të mëdha niset menjëherë për në drejtim të kështjellës së Gjenovës. Në ndeshjet e ashpra që u zhvilluan në atë vend, Bua me forcat e tij asgjesoi 4000 ushtarë dhe arriti të largojë në panik gjithë të tjerët që kishin mbetur gjallë. Në këtë mënyrë Mërkuri arriti të marrë Gjenovën dhe t'ja dhurojë atë Mbretit Ludovik XII-të. Për trimërinë dhe dhuratën e paçmuar që Mërkuri i bëri mbretit të Francës, ky i fundit e emëroi kapedanin e njohur shqiptar komandant të qytetit të Gjenovës dhe i dhuroi atij feudet bregdetare dhe Portin e Murizit. Pas kësaj Mërkuri rikthehet përsëri në Francë.¹⁾

Eshtë e njohur historikisht se në vitin 1509, një numur princash dhe mbretërish europjanë e italianë lidhin aleancë ushtarake për një fushatë të përbashkët kundër Republikës Venecjane. Nën këtë aleancë përfshiheshin forcat gjermane të Perandorit Maksimilian, ato franceze të Mbretit Ludovik i

1. X. Coroneo: "Bua andragathimata...", Faqe 36

XII-të, forcat e Mbretit të Spanjës, të Papa Julit të III-të si dhe forcat e shumë princave të tjerë italianë të cilët synonin dobësimin dhe nënshtrimin e kësaj fuqie të madhe detare. Formacionet e para ushtarake që u nisën për në drejtim të Republikës ishin ato të mbretit të Francës në përbërje të të cilave ishin edhe njësitë e shqiptarëve të Mërkur Buas të përbëra nga 500 kalorës. Ato kaluan lumin Ada dhe po aty u ndeshën me forcat venecjane të cilat u kishin dalë përpara. Në ndeshjen me forcat e Mërkurit forcat venecjane u thyen keq dhe detyrohen të tërhiqen në panik.

Mbas suksesit të forcave të aleancës, kur emri i Mërkur Buas kishte marrë tanimë përmasa dhe ishte bërë i njohur kudo, Perandori i Gjermanisë, Maksimiliani i kërkoi Mbretit të Francës, që në shenjë miqësie t'i jepte atij Mërkur Buan me njerzit e tij shqiptarët, përt'i përdorur ata për disa operacione ushtarake që ai i vlerësonte me rëndësi. Mbreti i Francës e pranoi këtë kërkesë dhe i propozoi Mërkurit që t'i ofronte shërbimet e tij ushtarake mikut të tij gjerman. Mbas mësoi nga Maksimiliani objekzionet ushtarake që ai kishte, Mërkuri u nis për në Flandër përt'u ndeshur me kalorësin Karlo Egmon, i cili kishte ngritur krye dhe kishte marrë dukatin e Geltherit. Në betejën që u zhvillua në ato anë Bua mundi t'i thyejë keq kundërshtarët dhe kthehet prej andej fitimtar tek Mbreti i Gjermanisë Maksimiliani. Ky e priti shqiptarin trim me dhurata dhe nderime të mëdha.

Në vazhdim të shërbimeve të tij pranë Maksimilianit, Mërkur Bua realizon një tjetër betejë të suksesshme në Dukatin e Bavarisë kudnër Kontit Baladino, i cili kishte marrë pushtetin në këto anë dhe kishte vendosur si zot aty një njeriun e tij.

I befasuar dhe i entuzjazmuar së tepërmi për këto dy fitore të njëpasnjëshme të Mërkur Buas, Mbreti Maksimilian organizoi një pritje dhe ceremoni madhështore në të cilën i akordoi atij titullin e Kalorësit, i dha një feud dhe i vuri në brez një kollan të çmaur me vlerë 1000 florij. Në vazhdim të ceremonisë Mbreti gjerman e veshi atë me dorën e tij me një pelerinë të qëndisur ne ar, e puthi atë përpara të gjithëve dhe

e shpalli Gjeneral të Parë të tij.¹⁾

Një tjetër shërbim që Bua i bëri Mbretit Gjerman ishte beteja që ai zhvilloi dhe fitorja që arriti kundër Gjeneralit venecjan Andrea Griti, i cili kishte ngritur në revolte popullsinë e Padovës. Mërkuri së bashku me forcat e tij dhe vetë mbretin gjerman që merrte pjesë në ketë betejë rrethoi dhe mori qytetin. Pa humbur kohë ai iu drejtua Kastel Nuovës, kaloi në mes të dimrit lumin që ndan këtë kështjellë, vetë i pari, kapi rob komandantin e fortesës De Kamionin dhe arriti të pusthojë qytetin. Në vazhdim, duke u kthyer nga Padova, Bua sulmoi dhe rimori Riminin.²⁾

Ne vitin 1510, Perandori i Gjermanisë Maksamiliani prishi aleancën e lidhur me Francën dhe së bashku me tërë trupat e tij tërhiqet për në Gjermani. Bashkë me trupat gjermanë u tërhoqën nga këto anë edhe njësitë e Mërkurit të cilat në atë kohë kishin në zotërim kështjellën e Veronës. Gjatë periudhës që Mërkuri qëndronte në këtë vend (Verona), njësitë e tij ushtarake, godisnin herë pas here forcat venecjane. Gjatë operacioneve të tillë forcat shqiptare kishin arritur të zinin mjaft robër, mes të cilëve edhe luftëtarë "shqiptarë të cilët shërbenin në radhët e forcave venecjane. Për ta thueht se Mërkuri të gjithë i falte dhe i lironte se i vinte keq", ose u propozonte të rreshtoheshin në radhët e njësive të tij ushtarake.³⁾

Gjatë luftimeve të viteve 1510-1511 venecjanët arritën të rimarrin Veronën por njësitë e Mërkurit të dërguara në këtë front arritën ta rimarrin këtë qytet. Të suksesshme ishin veprimet e tij luftarake edhe gjatë vitit të fundit që aleanca qëndroi e bashkuar.

Një vit më vonë pasi francezët u larguan nga aleanca dhe nënshkruan armëpushimin me venecjanët, iu drejtuan Anglisë për ta sulmuar atë. Mbas bisedimesh me

1. X. Coroneo: "Bua andragathimata..." F.32-40

2. Po aty

3. Po aty

Maksimilianin e Gjermanisë, francezët têrhopën në këtë fushatë edhe Mërkur Buan me njësitë e tij si aleate. Gjatë rrugës për në Francë, Mërkuri ndeshi me forcat e gjeneralit venecjan Bartolemeo Albiano në brigjet e lumi Adixhe.

Të dy komandantët njiheshin nga afër me njëri-tjetrin, që prej kohës kur ata së bashku si aleatë, (kur Mërkuri shërbente në njësitë venecjane) kishin përballuar kundërshtarë të përbashkët. Në momente emocionale ata takohen me njëri-tjetrin, rikujtojnë të kaluarën e tyre, atdheun, gjakun e përbashkët dhe në përfundim, Mërkur Bua bie dakort që ai të kthehet në shërbim të venecjanëve përsëri. Të dy gjeneralët me ushtritë e tyre marrin rrugën për në Venecia.

Lajmi i rikthimit të Buas me njësitë e tij në shërbim të venecjanëve ngjalli gëzim dhe entuzjazëm të papërshkruar. Senati me vendim të veçantë e ftoi atë zyrtarisht si hero dhe falenderoi njëkohësisht gjeneralin Albiano "që i riktheu Republikës një forcë të tillë si mërkur Bua". Më 1512, kur Mërkuri mbrinte në qytetin e Venecjas me njësitë e tij të kalorësisë turma të tëra njerëzish të entuzjazmuar kishin dalë dhe e prisin atë si triumfator. Mes tyre ndodhej edhe Dozha Lorendano, i cili me fjalë të ngrohta i shprehu atij mirseardhjen.

Mbas bisedave të para me drejtuesit ushtarake të Republikës, Bua kërkoi që numuri i kalorësve të njësive të tij ushtarake të rritej në një forcë prej 600 vetësh dhe që ata të ishin shqiptarë. Senati i Republikës kërkesën e tij e mori menjëherë në kosideratë dhe dha urdhër që nga ishujt e detit Jon (të cilat ishin koloni të venecjanëve dhe ku kish njësi ushtarësh shqiptarë) të rekrutoheshin ushtarë të rinj dhe të dërgoheshin aty.¹⁾

Duke qenë i rrezikuar seriozisht nga shumë aleanca armike dhe nga vatra të tjera lufte, Venediku planifikoi të përdorë shumë shpejt këtë komandant të jashtëzakonshëm

1. X. Coroneo "Bua andragathimata..." Faqe 43

për të rivendosur balancat e nevojshme ushtarake në ato vende ku kish dështuar. Kështu, në rrethanat kur Gjenerali Bartolemeo Albiano, mik i Buas ishte rrethuar në Pedova nga Regjenti i Napolit Rajmondi, Merkuri me një njësi prej 120 luftëtarësh nën manovra të mrekullueshme arriti ti fusë në kurth kundërshtarët dhe t'i shpartallojë ata. Pas kësaj fitoreje, Bua me rreth 80 fisnikë të cilit i kish zënë rob, u kthyte në Venedik ku hyri triumfalish dhe ia dorëzoi robërit Dozhes.

Mbas kësaj fitoreje të bujshme, Senati vendosi që t'i jepej ati çfardolloj shpërblimi që ai do të kërkonte. Kur Buas i thanë sa sipër, ai për vehte nuk kërkoi asgjë vetëm që luftëtarët e tij të merrnin atë që vërtet e meritonin në të holla.

Gjatë këtij viti trupat gjermane kishin avancuar dhe kishin mundur të arinin deri pranë Padovës të komanduara nga gjenerali Prespare Kolone. Forcat venecjane të komanduara nga ushtaraku i njohur, gjenerlai Bartolemeo Albiano merr masa dhe bëhet gati t'i godasë. Mërkur Bua duke parë në tërësi situatën, raportet forcave, vendndodhjen, kushtet e terrenit të cilat ishin të disfavorshme për një operacion të tillë e këshillon Albianon të mos ndërmarrë këtë veprim mbasi ai do të ishte me pasoja për të. Dhe vërtet në thyen plotësisht dhe jo vetëm kaq por mbas kësaj fitore, gjermanët avancua edhe më tej, duke pushtuar Adixhen. Nga ana e tij Mërkuri me një forcë prej rrëth 100 luftëtarësh, mbasi kishte tërhequr nga fusha e luftimeve Bartolemeo Alvianone i sulet dhe çliron Trevozon dhe prej këtu rikthehet në Padova duke prurë rob edhe vetë Dukën e Temrinos.

Në vitin 1515, mbas vdekjes së mbretit Ludovikut të XII dhe hipjes në fron të Franceskos së I-rë, Franca nga një kundërshtare e venecjanëve kthehet në një aleate e saj dhe kështu me forca ushtarake të bashkuara godasin forcat e aleancës napoletano-fjorentinase, të komanduara nga gjenerali Sforca. Ndërsa përballë tyre forcat venecjane komandoeshin nga dy gjeneralët Mërkur Bua dhe Bartolemeo Albiano. Në përleshjen te Marinianit, Mërkur Bua u hodh i pari në sulm me trupat e tij duke asgjesuar rrëth

4000 trupa të kundërshtarit, zuri mjaft topa luftë dhe 6 flamuj të kundërshtarit.

Këtë vit vdes bashkëluftëtari i Mërkurit, Bartolemeo Albiano, me gjithatë ai së bashku me rreth 200 luftëtarët e tij të zgjedhur godet forcat e ushtrisë të perandorit gjerman Maksimilian të cilat i thyen keq dhe i detyron së bashku me Maksimilianin të kthehen në Gjermani.

Në betejën kundër napolitanëve ne Lodi forcat e tij zunë rob kryekomandantin e tyre, tre gjeneralë dhe rreth 300 ushtarë zviceranë. Mbas tre ditëve nën komandën e tij Mërkuri sulmon dhe merr Peskaren e prej këtu kthehet në Breshia ku pritet me nderime të mëdha.

Gjatë qëndrimit në qytetin e Breshias mes luftëtarëve shqiptarë lindën kontradikta të ashpra, kryesisht mes dy fiseve më të mëdhej dhe të dëgjuar Buajve dhe Bohaleve. Grindjet u nxitën kryesisht për shkak të kushteve të rënda të jetës në emigracion dhe të jetës së vështirë e përherë në rreziqe të luftëtarëve, të cilët porsa përfundonin një betejë hidheshin tek tjetra. Jeta e rëndë dhe tensionet të zgjatura përvite e vite me radhë u bënë shkas që Bohalet të kërkonin të ndaheshin nga formacionet e Mërkur Buas dhe të ktheheshin në atdhe pranë familjeve të tyre. Megjithë lidhjet e krushqisë që kishin Buajt me Bohalet (Mërkuri kishte marrë gruan nga kjo derë) kontradiktat e tyre u kthyen në përpleshje të përgjakshme dhe Mërkuri duke mos dashur të lejojë të largohen luftëtarët e njohur Bohali nga radhët e njësive të tij të kalorësisë, ndeshet me ta dhe vret disa prej tyre. Ndërkëq kryetari i këtij fisi dhe luftëtarëve të kësaj dere Kosta Bohali ikën përfundimisht prej tij.¹⁾

Në vitin 1517, Mërkur Bua me funksionin e kryegjeneralit 'në ushtrinë venecjane ndërmerr disa operacione ushtarakë dhe në fund të tyre çliron dhe Breshian.

Nën goditjet e vazhdueshme dhe të suksesshme të venecjaneve - në radhët kryesore të të cilëve qëndronte

1. X.Coroneo: "Bua andragathimata...", Faqe 107-118

kryegjenerali Bua dhe njësitë e tij të dëgjuara, - Perandori gjerman Maksimiliani detyrohet të nënshkruajë paqe me republikën e Venedikut.

Mbas tërheqjes së gjermanëve, Bua me luftëtarët e tij shqiptarë kthehen në Venecja ku pritet nga autoritetet e vendit dhe populli me nderime madhështore. Vetë Dozha i Venedikut shtroi për të përmendorin një darkë solemne dhe i beri atij mjaft ceremoni e nderime publikisht, derisa ai u largua së bashku me ushtarët e tij nën ovacionet dhe brohoritjet e popullit që e shoqëronte.

Në vitin 1527 Bua organizoi dhe mori pjesë në operacionet ushtarake në Pavia. Veprimet luftarake u realizuan me sukses dhe me humbje të ndjeshme të kundërshtarit. Pikërisht fitoja e tij e njohur në Pavia mbylli me lavdi karjerën e lavdishme luftarake të këtij legjendari apo luani të tërbuar të fushbetejave, siç e thirrën në atë kohë.

Bëmat dhe veprimitaria e tij ushtarake i ngjan vërtetë legjendave të herojeve mitologjike. Mëkur Bua mbetet një ushtarak i përmasave të papërsëritshme për atë epokë.

Ajo çka na bën të kthehem i ndalemi gjatë tek ky luftëtar legjendar, veçsa të imponojnë aftësitë si ushtar dhe strateg ushtarak, jeta e tij e suksesshme përballë fuqive dhe gjeneralëve më të mëdhej të kohës, cilësive dhe veticë të tij organizuese në frontet dhe terrenet e luftës, emri që ai mori nëpër shtabet e luftës së vendeve më të fuqishme të Evropës, sidomos është fakti që nuk pushoni së menduari edhe për atdheun e tij të robëruar.

Kështu, në vitin 1533, Kur Mëkur Bua kishte disa vjet që për shkak të moshës së thyer i kishte lënë fushat e betejave, tregohet përsëri i gatshëm të rikthehet dhe të ngjeshë armët e luftës në se do të vendoset që të organizohet një front antiosman. Këtë vit u bënë përpjekje ndërmjet Dozhes së Venedikut, perandorit të Gjermanisë, Mbretit Karli i V-të i Spanjës dhe Papa Kelmentit të XII që të krijohet një aleancë e fuqishme ushtarake për të përballuar dhe goditur forcat e Perandorisë Osmane të cilat kërcënonin Evropën Perëndimore. Në analizën e organizuar nga këshilli ushtarak

i kësaj aleance ku merrte pjesë edhe Mërkur Bua, Duka i Orvinjit i cili ishte kryekomandant i forcave venecjane bëri të njohur se forcat e tyre ishin të pamjaftueshme për të realizuar dhe përballuar synime dhe plane të tilla që mendonte aleanca, kundër formacioneve dhe potencialeve të mëdha ushtarake që zotëronin osmanët. Në këtë moment Mërkua Bua gjë rastin e përshtatshëm për të paraqitur planin e tij të luftimeve përmes të cilit ëndërronte "edhe çirimin e atdheut të tij. Jo vetëm kaq por ai propozoi që në krye të betejave kundër osmanëve të ishte vetë, duke qenë i bindur se tërë forcat shqiptare që banonin në ato anë do të ngrihen në mënyrë të befasishme në luftë kundër psuhtuesve. "Mos kini aspak dyshim zoti duke - i tha Mërkur Bua atij, - sado forcë të vogël që të tregoni se ju kini, nga Moreja dhe Mani do të ngrihen në këmbë aq shqiptarë dhe arhonde kundër turqve dhe do t'i jasin aq ndihmë shkëlqesisë tuaj, sa ju vetëm gishtin të ngrini, do të shihni se ata të gjithë së bashku do t'u jasin fitore me figurë. Kështu do të ndodhë edhe në pjesën tjetër të vendit..."¹⁾

Padyshim gjithesa përmblodhëm më sipër janë vetëm një kronikë tepër e shkurtër e jetës dhe bëmave të këtij luftëtarit të shqipëtarëve. Vlerësimet e bashkëkoësve dhe veçmas të specialistëve ushtarakë janë përherë superlativë dhe që tërheqin vëmendjen në raport me ushtarakë, gjeneralë, apo strategë të tjera që u dalluan dhe bënë emër në ato kohë. Specialistët e fushave të luftimit i studjuan me kujdes veprimet luftarake të njësive të tij të luftës. Në shumë prej tyre theksohet se arti i veprimeve të tyre ushtarake është një trashëgimi e përcjellë nga të parët e tyre. Aq të përsosur janë ata në veprimet taktkike sa duket tanimë që reagimet e tyre janë bërë instiktive. Njohja dhe studimi nga afër i kësaj figure kaq komplekse që plotëson vargun në gjeneratën e luftëtarëve dhe burrave që nxorri nëpër shekuj dera e famshme princërore e Bujave, është me mjaft interes edhe për kuadrin e

1. Xane Coroneo: "Bua andragathimata...", Faqe 176

personaliteteve të shqar që ka nxjerrë kombi i Arbërit në këto periudha të turbullta të mesjetës.

Kjo farë luftëtarësh të paepur dhe trashëgimtarët e mëvonshëm të saj rilindën vazhdimisht burra të cilët bënë emër dhe tërroqën vëmendjen e opinionit të kohës për trimërinë e tyre dhe atdhedashurinë. Kështu në vitin 1684 kur perëndimorët synuan të godisnin në kufijtë e saj perandorinë osmane, së bashku me komandantin e këtij operacioni Françesko Morozini evidencohet luftëtari dhe komandanti shqiptar Komneno Bua së bashku me 80 kalorës shqiptarë.

Në vitin 1770 evidencohet një tjetër kapedan i deteve, i cili bëhet shqetësues dhe tmerr për anijet osmane në Egje. Ky është Leon Bua, i cili bashkëvepron më pas me kryengritsin shqiptar Mitro Leka apo siç njihet në dokumentacionin historik të kohës dhe në këngët popullore të popullit grek Mitromara.

Në luftën për pavarësi të popullit grek të vitin '21 deri në betejën e Mesllongjit gjemjë në radhët e para të frontit të luftës Klejment Buan së bashku me një nipin e tij Andro Buan, e shumë të tjerë që çfaqen deri në kohët moderne në analet historike.

Mëkur Bua, për të cilin folëm më sipër vdiq në vitin 1560 në qytetin e Trevizos dhe u varros po aty në kishën e Shën Mërisë, në "Maggiore". Në epitafin përkushtimor janë gdhendur: "MERCURIO BUA COMITI E PRINCIPIBUS PELOPONNE SI EPIROTARUM EQUITUM DUCTORI QUI LISDEM E. REGNO NEAPOLEOS DIMICANTIBS SAEPIUS PISANIS LIBERTATE DONATIS..."

Ndërsa memorialin e varit të tij e punoi për gati dy vjet skulptori i njohur i kohës Antonio Lombardi.

Duke u ndalur në biografinë e këtij shqitpari që vinte nga radhët e arvanitëve të Greqisë gjykojmë se është me vlerë të citojmë atë përkushtim biografik që atij i dedikuan europjanët dhe që Coroneo përmet Sathës na e bie të plotë. "Ky shqiptar i lavdishëm Mëkur Bua, luftëtar i paepur, strateg i shqar, me shpirt të papërbajtur, i gatshëm për të shërbyer kudo për bashkatdhatarët e tij, i babartë mes shumë strategëve të

Europës, gjatë tërë jetës përherë flamurtar në Ifutra të paprera, gjithmonë u kalli tmerrin armiqve dhe falangave kundërshtare, ai ktheu balancën e fitores drejt atyre që e kërkuan për ndihmë dhe aleancë, kundër Flandrineve, Bavarezeve, Spanjollëve, Francezëve... duke rrëmbyer kaq e kaq flamuj kundërshtarësh, i dekoruar me urdhëra Kalorësi, mbretëror, Perandorak, me urdhërin e Kometes, në Republikën Venecjane me titullin e Kryegjeneralit... ”¹⁾ (shih fig. nr.3)

Gjithë lavdinë dhe emërin e tij ky luftëtar i shquar shqiptar e ngriti përmes bashkëluftëtarëve që e rrethonin, shpatës dhe mendjes së tyre, trimërisë dhe guximit që karakterizoi njësitë e luftëtarëve shqiptarë, të ardhur nga teritorët greke - pra të thirrur arvanitë, apo të tjerë të emigruar direkt nga Arbëria. Në një nga relacionet e luftës së kohës, gjejmë të evidencuar një togë prej luftëtarëve me emrat e tyre, që Bua kishte në përbërje të formacionit të tij kalorsiak. Emri dhe lavdia heroizmat dhe bëmat, titujt dhe dekoratat që Mërkua Bua fitoi nëpër betejat e panumurta burojnë edhe nga shpirti dhe gjaku i këtyre luftëtarëve që ndoshta rastësisht çfafen në analet e historisë dhe që ne po i rendisim siç ata përmenden në dokumentacion: “Toga e dytë e shqiptarëve... Gjin Renesi, Lazar Komi, Gjergj Koreshi, Petro Varkezini, Lazar Barkezini, Gjergj Reneshi, Stathi Komi, Gjin Barketimi, Gjergj Renesi, Teodor Kajadhis, Gjergj Kajadhis, Lazar Barbani, Dhimitër Maneshi, Jakov Mazaraqi, Trobuqi, Cakura, etj.

Pikërisht këtyre herojeve, bashkëkohësi dhe bashkëpatrioti i tyre Manol Bleshi, edhe ky arvanitas i emigruar nga territorët greke në Itali, në vitin 1571 u kushtoi një poemë e cila u botua në formë libri dhe bëri jehonë në republikat dhe mbretëritë italiane të kohës. Vetë Bleshi pretendonte me krenari se ridhte nga dera e dëgjuar shqiptare e Sgurajve dhe se ishte stërnip i princit të famshëm Leon Sguros. Në poemën kushtuar luftëtarëve shqiptarë, poeti shkruan për ta:

1. K.Satha: “Elenika anegdhoda”, Faqe 87

*Ku është Klementi i madh
Komandant i Ushtrisë
Po Gërbeshi trim mbi trima
Që i dha drithmën turqisë*

.....
.....

*Ku është Shtino dhe Konaqi
Meksi, Lopsi dhe Barbatë
Po Andruco mustaq'gjati
Petro Bua dhe Stamati*

.....

Poema e bukur e Bleshit, pak e studjuar dhe publikuar, e shkruar pothuaj në të njëjtën kohë me veprat e M. Barletit, në latinisht, duhet të radhitet bashkë me to në fondin e veprave të para të letërsisë shqipe. Fondi i letrave të shqipes nuk ka asnjë arsyë ta braktisë apo konsiderojë autorin apo veprën e tij si të huaj, ashtu sikurse nuk konsideron të huaja krijimet e autorëve të diasporës shqiptare jashtë trojeve tonë si ato të De Radas, Darë, etj. etj.

Padyshim, rruga dhe bëmat, kontributi dhe vlerat që shfaqën dhe shpalosën shqiptarët e emigruar nga territorët greke në Itali, nuk mund të përmblidhen në pak rreshta, as duke qëmtuar dhe shfletuar figurën e një apo disa heroje të njojur. Në radhët e njerëzve të shpatës mund të renditen një numur mjaft i madh luftëtarësh dhe personalitetesh, bashkëkohës të Mërkur Buas të mëparshëm apo të mëvonë. Karrjera e tyre ushtarake shtrin dhe kapërcen kufijtë italikë dhe Europjanë. Një i tillë (të cilin e përmendi pak kalimthi më parë) Bartolemeo Albiano, të cilin historiani Satha e vlerëson si një ndër figurat e shqiptarëve të shquar në frontet e luftës dhe që me Mërkur Buan luftuan përkraha njëri-tjetrit për rreth 10 vjet, merr emër dhe famë deri në inkursionet e tij të guximshme dhe kurajozë në Lindjen e Largët, deri Japoni prej nga ai kthehet i suksesshëm.

Kontributii i emigranteve shqiptarë të larguar nga territoret greke apo nga ato arbërore në tokën italiane nuk qëndron vetëm tek vlerat që ata përcollën në fushat e betejave dhe tek figurat që ata nxorrën në lëmijtë e artit ushtarak. Shumë prej tyre dhanë shpirtin, pasionin dhe talentin e madh në fushat e shkencës, artit figurativ, kulturës, muzikës dhe letërsisë.

"Dy gjëra, nga të gjitha tiparet e veçanta të jetës së tyre karakteristike krijuan impresione befasuese dhe gjurmëlënëse tek të huajt. "Vallja Çame", të cilën të parët e tyre e kishin prurë nga atdheu prindëror në Greqinë Jugore - Peloponez dhe këngët.

Muzikantët italianë gjetën tek ato këngë, prototipin e ritmit dhe të valles si dhe melankolinë e ngrohtë të tingujve të këngës. Por, ajo që veçanërisht i mallëngjeu dhe frymësoi ishte vija melodike që vërtet i bëri për vehte ata".¹⁾

Duke iu referuar një pritjeje diplomatike, ceremonia e të cilës u zhvillua në sallën e Kardinalit Griimani, në vitin 1505, historjani Marino Sanuto na bie në shkrimet e tij një episod të vogël por me shumë interes për pjesmarrjen e emigrantëve shqiptarë në jetën kulturore të Venecjas dhe jehonën që kishte bërë kënga e tyre tradicionale. Ai thotë: "Hyri në sallë shqiptari i cili thirrej Barleta (apo Baleta), i veshur me kostum të zbukuruar me punime ari dhe me një tamburo në duar të punuar në argjend. Ai shqoërohej nga një shok i tij i cili mbante në dorë një lirë (lahutë) të vogël. Ata filluan të interpretionin të dy së bashku në të njëjtin ritëm disa këngë tepër tërheqse, ishin shumë me ndjenjë dhe tepër të këndshme".²⁾

Shpirti i pasur dhe prodhues i kësaj popullsie, ndjenjat e holla dhe krijimtaria me vlera tipike që dallohej përherë nga ajo e vendasve, janë tiparet me të cilat ajo lëvizi dhe u

1. K.Biri: "Arvanites i doris tu neoteru elenizmi". Faqe 191

2. K.Satha: "Elines stratiostis en ti Dhisi" 1886, F.87

identifikaur në detin e gjerë kulturor italik. Në krijimet e kësaj popullsie përherë ka spikatur shpirti i saj lustarak e liridashës dhe atdhedashuria. Motivet e mallit për atdheun dhe lirinë e tij, kanë shoqëruar jo vetëm këngën popullore dhe folklorin e tyre në përgjithësi por edhe krijimtarinë e poetëve dhe shkrimtarëve të cilet kanë dalë nga gjiri i këtij populli. Për këto motive të cilat dominojnë në krijimtarinë e kësaj popullsie, Gofredo Ruxherio shkruan: "Ne italiane në krijimet poetike nuk kemi këngë kombëtare dhe popullore me përashtim të himnit të Garibaldit që është i zbehtë, por që u ngrit lart për shkak të rrethanave siç ndodhi me Marsajezën... Të tilla janë këngët e shqiptarëve. Subjekti i tyre janë Skënderbeu dhe kapedanët e tjerë trima, luftrat fitoret dhe fatkeqësítë e kombit të tyre. Karakteri i tyre popullor i bën edhe më të mrekullueshme sepse ato janë të ruajtura në kujtesë dhe të përcjella nga vendi i tyre i largët me shekuj, e megjithatë ato janë kënduar dhe këndohen nga masa e popullit me dashuri dhe entuzjazëm".¹⁾

Tiparet e veçanta të traditës së tyre të ruajtura dhe përcjella në brezni me xhelozit të veçantë, mbrojtjen këte popullsi nga fenomenet e ashpra erozive të asimilimit. "Jeton andej-këtej mbi malet e Kalabrisë një popull i cili prej 400 vjetësh është në kontakt me jetën italiane dhe i ka mbrojtur deri në ditët tona të pandryshuara zakonet e tij të lashta, gjuhën, karakterin, sikur dje të kishte vdekur Gjergj Kastrioti i tij dhe kishte ardhur pastaj per të vendosur tendat e tij, gati për t'i hequr dhe për t'u rikthyer në atdheun e ëmbël dhe të paharuar. Në ceremonitë fetare, në ato te kultit, në veshjet e tyre, në karakter deri në formimin e kafkës ndryshojnë qenësisht nga ne italianët... dhe nuk ka fshatar sado i pagdhendur që të ejtë që të mos dijë të festojë me këngë tradicionale festat e njerëzve të tij, t'u këndoje lavdisë së heroje që ata kanë..."²⁾

1. Gofredo Ruggiero: "*Saggi di canti albanesi*". Cosenca 1876, F.10

2. Alfio Moccia: "*Zëri arbëreshëve*", nr.5-6 1973, faqe 13

Në vitin 1774 peshkopi Tria shprehet kështu për arbëreshët e kolonisë së Molizës - "Ata që janë të kombësisë shqiptare mbajnë akome të njëjtat zakone sikur porsa të kishin ardhur nga atdheu i tyre, me ndjesi krenare dhe luftarake dhe vazhdojnë të përdorin gjuhën e tyre shqipe... Kur shkojnë në gjyq të kërkojnë të drejtën dhe nuk u a japid, ata thërrasin - do ta kërkoj dhe do ta gjej vetë..."¹

Tamam nga ky terren nuk kishte si të mos lindinin, ashtu siç lindër patriotët, poetët, shkrimitarët dhe studjuesit e talentuar, lëvrues të vërtetë të penës. Ata dhanë kontributin e tyre në ndriçimin e vlerave shpirtërore, etiko-morale, traditave, zakoneve dhe karakterit të kësja popullsie e cila kontribonte përmes këtyre vlerave edhe në fondacionet e kulturës vendase. Duke filluar nga poeti dhe stratioti i dëgjuar Manol Bleshi (1505) tek Barleti, Karpaçio, G. Dara, A. Sanatori, De Rada, V. Dorsa, D. Kamarda etj, të gjithë këta muarrën pjesë aktive në zhvillimin politik dhe letrar të atdheut italian pa humbur aspak ndjenjën e thellë të dashurisë për mëmëdheun e tyre".

Kontributi dhe veprimitaria e gjallë e kësaj popullsie nuk reshti edhe në kohët moderne. Gjeneratat e kësaj popullsie muarrën pjesë aktive në momentet kyçe të zhvillimeve politike të Italisë dhe veçanërisht kontributi i saj është monumental në luftën e njohur përbashkimin e gatishullit. Në këto vite heroizmi dhe sakrificash sublime, popullsia arbëreshe u gjend në krah e në radhët e para të barikadave të Garibaldit të madh. Nga radhët e saj dualën luftëtarë kurajozë që përkohën u ktheyen në simbol, të tillë si atentatori i monarkut Burbon, Axhezilao Milano, mikudhe bashkëluftëtarë i afërt i Garibaldit - Domeniko Damsi dhe shumë e shumë të tjera të cilët tanimë janë bërë të njohur.

Eshtë pikërisht kjo arsyje që në përgjigje të një letre që Dora d'Istrio i pat bërë Garibaldit, ky i fundit duke iu përgjigjur asaj, i thotë: "Çëshja shqiptare eshtë edhe çështje e ime,

1. Mateo di Lena; "*Gli albanesi di molise*", F. 109

sigurimisht për te cilën unë do të ndjehesha i lumbur ta përdormja aq sa më mbetet ngajeta ime në dobi të këtij populli trim... Diplomacia evropiane që peshon mbi çështjen e lindjes nuk don kryengritje por po të ndodhte kjo, diplomacia do të pranonte jo vetëm faktet e kryera nën shtytjen e opinionit botëror por do të detyrohej edhe ta favorizonte atë."

Tiparet e veçanta të kësaj popullsie kanë tërhequr vëmendjen e të huajve dhe të studjuesve vazhdimisht. Ndër ato tipizime të cilat tërheqin vëmendjen janë përcaktimet që lidhen me karakterin e tyre, zakonet dhe në tërësi jeta që ata bëjnë "Pasioni i lavdisë është tipar mbizotëruesh i karakterit të tyre... është një rracë e fortë e hekurt si shkëmbijtë ku ajo bnaon. Ata janë të gjallë, të gëzuar, të matur, bujarë e heroikë kur është puna përmbrojtjen e rracës së tyre, të tokës së tyre. Këta kanë qenë ushtarët më të guximshëm të Pirros, të Lekës, të Dioklecianit, të Skënderbeut dhe më në fund të sulltanëve të Bizancit".¹⁾

Veçanërisht në Italinë e Jugut, në krahinat e ashpra dhe të varfëra të saj ku arbëreshët ndërtuan rrugët e tyre të mbijetesës dhe të fatit, padyshim ata dhanë e mburren shumë me popullsinë vendase latine. "Italianët e jugut janë djemtë e pabindur të Italisë, janë kryengritësit, hakmarrësit dhe mafjozët. Megjithatë janë këta që i japin Italisë identitetin e veçantë dhe finesën. Karakteri tipik i Italisë duket nga Napoli e Poshtë. Dhe këtë ndofta e dinë më mirë artistët italianë dhe veçanërisht regjisorët që kërkojnë të veçantën italiane, finesën dhe karakterin në këto anë."²⁾

* * *

Duke ju referuar ngulmimive shqiptare në Itali dhe specifikimeve se cila prej tyre është populluar me shqiptarët e emigruar nga territoret e Greqisë, megjithëse deri më sot

1. *Lavalle: Historie della Turquie*", Vell I, faqe 82
2. A.Kolia: *Arvanitët*, Faqe 229

nuk është bërë ndonjë studim i veçantë, mund të parashtrojmë se vendbanimet e kriaura nga emigrantët e Shpërnguljes së Katërt (e njojur si emigrimi i Moresë dhe Koronit) dhe të Pestë (me emigrantë të ardhur nga Mani) janë fshatra të themeluar nga shqiptarët e Greqisë, arvanitët. Në përcaktimin e saktë të origjinës së krijimit të këtyre vendbanimeve, veç faktorit të mësipërm një ndihmesë do të jepte dokumentacioni bashkëkohor historik - cili evidencon kohën e ardhjes, vendin e ardhjes dhe se ku u vendos kjo popullsi, - emërtimi i vendbanimeve; shumë emra i prunë nga prej nga ata erdhën dhe në kujtim të tokave të tyre të braktisura; - toponimia e ambjenteve dhe territoreve ku ata jeotjnë - në të shumtën e rasteve mbart emërtime të prura nga vendbanimet prej të cilave ata zbritën. - Krijimtaria popullore dhe gjuha - janë mjete të tjera të cilat përcaktojnë terrenet prej nga ata zbritën. Në folklorin e majft fshatrave arbëreshe gjenden këngët të cilat bien kujtime të vendbanimeve prej nga ata erdhën - fusha e Koronit, Methonit, Zaqinthi, e bukura More, etj. Kjo popullsi që njeh këto këngë duket që ka ardhur nga këto anë përsa bie kujtimet e këtyre zonave. Një tjetër popullsi e cila nuk ka jetuar dhe nuk i njeh këto anë nuk ka si t'i këndoje vendeve të panjohura. - Ekzistanca e fjalëve greke; në të folmet e disa ngulmimive arbëreshe është një tjetër burim i cili do të tregonte se vendbanimet e saj para se të vendosej në territoret italiane kanë qënë territoret greke ku ajo huazoi fjalë të tilla.

Megjithatë, popullsia arbëreshe pavarësisht nga rrugët e largimit të saj e gjendur në territoret italiane, në atdheun e saj të ri, u ndërfut tek njëra-tjetra pa paragjykuar rrugët e ardhjes. Ajo njeh që atdheu "ku janë mbuluar tata, mema, vëllau dhe motra" është Arbëria, vendi që u dha gjakun, gjuhën, toka që u formoi karakterin, traditat dhe që u dha emrin e tyre arbër, arvanit, arbëresh...është Arbëria.

QENDRESA E POPULLSISE ARVANITE GJATE OKUPACIONI SHEKULLOR OSMAN

Represioni dhe masakrat e mëdha që ushtruan osmanët kundër popullsisë arvanite, për shkak te rezistencës aktive te saj, në prag dhe gjatë pushtimit të gadishullit, nuk e mposhti dhe nuk e tërroqi atë nga qëndresa dhe lufta përliri. Gjatë tre shekujsh e gjysëm të robërisë osmane, janë të panumurta ndeshjet dhe betejat e njësive dhe çetave kryengritëse, klefteve dhe armatolleve, - siç thirreshin çetat kryengritëse dhe ato të luftëtarëve të detit. Eshtë shumë interesante, por është në të njëjtën kohë fakt historik që në këtë periudhë, në çdo ndeshje apo përpjekje përliri kundër pushtuesve është i pranishëm elemenetit arvanit dhe ai shqiptar. Jo vetëm kaq, por ai ishte element dhe faktor me rëndësi përkrahja mbijetese në historinë e popullit grek. "Historjanë tanë të mëdhenj këta vitet e fundit që nga rënia e Peloponezit deri në vitet 1821 i kalojnë telegrafisht, kur në fakt këta janë vitet që fshehin thelbin e helenizimit moder. Por kjo ndodh ndoshta se këta janë vitet që fshehin thelbin e helenizimit modern. Por kjo ndodh ndoshta se këto vitet dëgjohen vetëm arvanitët dhe Maniatet - Kladha, Meksi, Buziqi, Grivajt Mollamat, Pavllo Drakua, Buajt dhe shumë të tjera që ngritën popullin të dëbojnë Turqinë. Dhe me siguri skllavëria nuk do të ishte kaq e gjatë po që se turqit nuk do të ndiqnin dy taktika të sofistikuarë dhe asnjësuese përgjegjëse përgjegjëse. Njëra ishte përkrahja që ju dha klerit ortodaks duke i njojur atij çdo pushtet mbi popullsinë e krishtere, duke arritur kështu të përfshirët hendekun me perëndimorët, me krishtërimin dhe të krishterët europianë, duke evitar aleanca të rrezikshme me ta - dhe tjetra ndërrimet e shumta të fesë së grakëve dhe arvaniteve..."¹⁾

1. A.Kolia: "Arvanitet...", Faqe 193

"Rezistenca dhe lufta arvanite për çlirimin e Greqisë nuk pushoi kurrë. Që nga dita që turqit shkelën në Peloponez deri në pragun e 1821-shit, kemi qindra levizje kryengritëse, mijra viktima dhe të emigruar, mijra të tjerë që organizojnë dhe riorganizojnë qëndresën antiosmane. Këto janë faqet më historike të helenizmit modern që bëjnë të ndërgjegjshëm dhe konkretizojnë vetë ekzistencën dhe të ardhmen e tij." ¹⁾

Peloponezi dhe Thesalia, Epiri, Atiko- Beotia, malet e Olimpit dhe tërë maqedonia greke u kthye në vr-atra aktive të rrezistencës antiosmane. Çetat e kleftëve goditnin vazhdimisht njësit dhe reparte osmane nëpër garnizonet e tyre apo në lëvizje, në pika dhe zona të rëndësishme. Aq e gjërë dhe masive ishte pjesmarrja e arvanitëve në këtë lëvizje sa në një letër që konsulli francez në Athinë Jean Giro i shkruan Markezit - de Nauntel më 1674, mes të tjerave i thotë: "Kleftët kudo që janë rreth qyteteve apo deri në More (Peloponez), të gjithë janë arvanitë".

Gjithashtu në këta shekuj të një lufte të ashpër për rezistencë dhe pavarësi nëpër teritorët greke, gjejmë një numër jo të vogël çetash luftëtarësh shqiptarë, të cilët zbresin në teritorët e Greqisë dhe bashkëveprojnë me komitët, kleftët dhe armatollët arvanitë e grekë, Bashkëveprimi dhe lëvizjet e tyre në operacionet luftarake nuk njojin kufij dhe nacionalitet. Këto çeta operonin në të gjithë dimencionet gjeografike ballkanike, nga Sofja në Manastir, nga Agjo Orosi në Shkup, prej këtu në Dibër, Labëri e Peloponez. Kudo elementi shqiptar ishte tepër shqetësues për administratën ushtarake osmane. "Për ne perëndimorët - shkruan Robert Cyprien - një fakt i vetëm del në mënyrë të qartë nga kaosi i analeve shqiptare: që në të gjitha kohët populli shqiptar duket se eshtë destinuar të formojë rrugën e fundit të lirive greko-sllave. Eshtë ai që u rrezistoi romakëve më shumë se të tjerët i sulmuar para grekëve dhe megjithatë ai u thye më vonë se këta. Asnjëherë ai nuk u fut plotësisht

1. Po aty fq. 194

nën zgjedhën e Sulltanëve. Kur dinakëria otomane e ç'organizoi atë, ai derdhi në luftë të gjithë energjitet e tij dhe në fushat e betejave u bë shumë herë tmerr i lindjes dhe i perëndimit.”¹⁾

“Arvanitët e Atiko-Beotisë dhe të Peloponezit, shkruan një autor, - kur bandat e komitëve, kleftëve muarën përmasa të mëdha, u rreshtuan në to masivisht dhe me trimëri duke krijuar përshtypjen që tërë këto njësi komitesh në të dyja zonat përbëheshin vetem nga shqiptarë”.²⁾

Udhëtar francez George de la Guillitere që vizitoi Greqinë më 1675 dhe njoihu nga afër çeta komitesh, kujton; “Janë një rracë e papërkultur dhe komite-kleftë të vendosur...veçanërisht Vilitotet (Krahinë që banohet kryesisht nga arvanitë) që ishin qendra e dervenohoreve...” Në pikpamjen nationale Peloponezi, në shekullin e 17-të banohej nga grekë, shqiptarë e turq. Shqiptarët banonin tërësisht tërë zonën veriore të Peloponezit si dhe pjesën qendrore e juglindore të tij. Ata ishin kryesisht barij të tërë, bujq, blektorë-tutorë, - bën të njobur Barbie du Bocage.

Rezistenca e arvanitëve kundër pushtuesve osmanë u shtri dhe mori përmasa aq të mëdha sa në mesin e shekullit të 18-të ajo mori dimensionet e një kryengritje të përgjithshme popullore. E ndodhur përpara një rreziku eminent me pasoja tepër të rënda, për këto anë të Perandorisë, Porta e Lartë dërgoi kundër kryengritësve forca të mëdha ushtarake dhe në vitin 1775 ajo mundi të shtypë këtë revoltë të armatosur në mënyrë të përgjakshme”. Mbas kësaj kryengritjeje komandanti i forcave turke Musun Oglu dha urdhër të mos lejojë aty asnjë shqiptar (arvanitë), mbasi ishin ata që kishin përgjakur, djegur dhe bërë shkrumb sanxakun e tij - Morenë. Prandaj, ai urdhëroi që shqiptarët t'i zbonin nga Isthmo dhe t'i kthenin pas ata. Të tjerët në se e lipte nevoja të vriteshin

1. Cyprien Robert: “Les slaves de Turquie”, 1852, Faqe 189
2. Jona Paidhusi: “Ta qitherona...” Faqe 29

duke u marrë tërë pasurinë dhe plaçkat e tyre"¹⁾

Kjo revoltë mbarëpopullore me pjesmarrjen masive të arvanitëve gjen një pasqyrim të gjerë në folklorin grek. Megjithëse, kryengritje e njojur e Peloponezit e mesit të shek.18 përfundoi në disfatë, këngët e bucura popullore që përshkruajnë atë nuk janë disfatiste, ato karakterizohen nga nata të një epizmi optimist. Vargjet e një këngë popullore që këndohen në shqip nga arvanitët thonë:

.....
Shumë herë u mundëm

*Por kurrë nuk u përgjunjëm.*²⁾

Edhe në zonat e tjera rrezistenca kundër pushtuesve osmanë mbeti përherë e ndezur. Shumë krahina të banuara nga arvanitë - Thesalia, Maqedonia Lindore (greke) dhe Thraka, Halqidhiqia dhe ishujt e Egjeut etj., nxorrën në këto vite shumë bij që për vite të tëra u bënë tmerr i Portës dhe formacioneve ushtarake osmane. Gjithashtu në këto anë gjenden në këta shekuj një numër i madh emigrantësh shqiptarë të përkohshëm (sezonalë) apo grupe të tërë fshatarësh nga Shqipëria e jugut e deri ajo veriore që vendosen në këto anë përgjithmonë. Kështu, kur udhëtari Belon kaloi në zonat e Maqedonisë (greke), Thrakes dhe Azisë Minore, në mesin e shekullit të 16-të, ndeshi në këto anë grupe të mëdha mjeshtësh dhe fshatarë shqiptarë... Ata,- pohon ai, ishin ndërtues, mjeshtër apo tregëtarë. Vendosit u thërrisin atyre)mastorohorja" (mjeshtërtë vendit - të ndërtimeve).³⁾

Për këta njerëz studjesi Gerlach, i cili i pa dhe njuhur ata nga afër, thotë, se: ata janë ndërtues të mirë, ngrenë kisha të mrekullueshme, saraja dhe hane...".

Deri në shekullin e 19-të, në zonat e Maqedonisë, Likoviqia, Pangeori, etj. gjendej një masë e madhe emigracioni

1. Jona Paidhusi "Ta Qitherona tu...", Faqe 12

2. A.Kola: "Arvanitet..." Faqe 330

3. Vacalopulo: "The history of Maced...", Faqe 151

e ardhur dhe vendosur aty nga Shqipëria, Thesalia, Epiri. Këta dallohen nga punëtorët sezonale shqiptarë që qëndronin këtu përkohësisht dhe thirreshin "gege".¹⁾

Edhe në pikpamje nationale në këto anë gjendet përherë edhe në shekujt e mëparshëm një përzjerje popullsie, e thënë më saktë një popullsi jo e vogël shqiptare e shtrirë dhe e shpërndarë në tërë këto treva - që fatkeqësisht ka qenë fare pak apo aspak e studjuar demografikisht.

Në shekullin e 16-të (1530-1560) "në zonën e Siresit (Sederokastrës) numëroheshin mbi 6000 punëtorë shqiptarë, greke, çifutë, etj. Ata punonin në minierat e argjendit dhe të floririt si dhe në furrat e shkrirjes që ishin me dhjetra në ato anë. Kështu, në vitin 1787 në kohën "e rebelimit të Pashait të Shkodrës, Mahmutit të birit të Mehmetit (Bushatlliu) kur ai mori Manastirin dhe iu drejtua Selanikut, brenda në këtë qytet u shpall alarmi. Shqetësim i madh u krijuar përfaktin se aty banonin 3000 shqiptarë të cilët nuk përashtohej ta ndihmonin nga brenda qytetit Pashanin e rebeluar shqiptar Mahmutin..."²⁾

Ky pohim që na jep historiani grek Vakalopulo është me mjaft vlera për njohjen e përbërjes demografike të Selanikut dhe të vendit të rëndësishëm që zinte popullsia shqiptare në këtë qytet. Duke pasur parasysh faktin që numri i përgjithshëm i popullsisë rreth 1/3 ishin shqiptarë ishte rreth 8000-9000 banorë.

Një numuri madh banorësh shqiptarë gjendet i pranishëm që në vitet e hershme të mesjetës edhe jashtë këtij qyteti, në krahinat dhe fshatrat përrreth, veçmas në tërë territorët e Halqidhiquisë.

Prezenca e shqiptarëve në këto anë ka vazhduar deri në ditët tona dhe jo vetëm kaq por deri në pragun e Luftës së Dytë Botërore këtu vinin periodikisht emigrantë sezonale shqiptarë si druvarë, ndërtues, qymyrxhij, etj.

1. Po aty, Faqe 152

2. Vacalopoulos: "The history of Macedonai", Faqe 475

Në periudhën e viteve 1769-1779 dhe më vonë evidentohet përmes dokumentacionit edhe një valë e re shpërnguljesh nga Epiri dhe Shqipëria, nga Nikolica, Voskopoja, Korça etj për në Maqedoninë Jugore greke. Ata ishin kryesisht artizane, argjendare, robaqepës, etj. Ndërsa, "në anën perëndimore të Krushevos ishte formuar një zonë e tërë nga familje shqiptare të ardhura nga Vithkuqi dhe Opari (i Korçës), të cilët zbritën të drejtuar nga priftërijtë Evstathio dhe Janaqi. Këta njerëz merreshin kryesisht me tregëti. Pór, kushtet në të cilat ata ndodheshin dhe kontaktet e vazhdueshme vetëm me banorët e fshatrave të tjerë bëri që ata të humbisnin gjuhën e tyre shqipe." ¹⁾

Ashtu sikurse në territoret e Peloponezit dhe Atikobëtise dhe në keto anë të Greqisë qëndrore e lindore gjatë shekujve të pushtimit otoman, popullsia vendase dhe arvanitet bënë një rezistencë dhe luftë të pamposhtur kundër pushtuesve. Ata krijuan çeta "Kleftesh" apo komitesh dhe lëviznin nëpër territoret e këtij kontinenti duke patur përherë objekt të sulmeve të tyre garnizonet dhe njësitë ushtarake osmane, karvanet e tregëtarëve të mëdhej që vinin nga Perëndimi drejt Lindjes. Arteri kryesor i lëvizjes së këtyre karvaneve vija "Egnatia", ishte bërë objekt i sulmeve të përhershme plaçkitëse, ashtu si edhe anijet e mëdha tregëtare që qarkullonin në brigjet e Egjeut.

Njoftimet e para për veprimtarinë e këtyre çetave vijnë nga shekulli i 16-të, atëhere kur Porta e Lartë vendosi hegemoninë e saj plotësisht në Ballkan. Numri i tyre merr përmasa në shekullin e 17-të bile deri në atë shkallë sa ato bëhen shqetësim serioz përpushtetin qendorosman. Pohimi i një vizitori, i cili qëndroi pranë një njësie luftëtarësh Kleftë, dëshmi të cilën ne e gjejmë të shkruar tek kronisti osman. Evlija në vitin 1661, na bën të njojur se ai kish takuar luftëtarët të cilët arrinë deri në 500-600 vetë. Ndoshta udhëtari ka fryrë numrin real të kësaj njësie, por ajo që eshtë

1. Ballas: "Istoria tu Krushevo", F.19

me vlerë është se ai na jep një përshkrim të përgjithshëm dhe konkret përtë. Përmes saj mësojmë emrin e saktë të kapetanit të tyre të thirrur "Pano (apo Bano), i cili para se të dilte komit kishte punuar si çirak ambulant duke shitur shërbet... Panua për të cilin flet kronika është identifikuar me komitin e famshëm shqiptar Pano-Bano Mejdan".¹⁾

Në të gjitha kronikat historike që evidentojnë rezistencën antiosmane të popullit grek, theksohet se: "në pjesën më të madhe të çetave të komiteve, ato janë të mbushur plotësisht me luftëtarë shqiptarë se arvanitas, në masën dërmuese luftëtarët janë të kësaj kombësie. Nga vitet 1700-1800, bandat e brigandeve mbushnin radhët e tyre me muslimanë dhe ortodokse... pjesa më e amdhe e tyre që vepronin në Maqedoninë greke dhe atë të Shkupit, vinin nga krhainat e varfëra dhe malore të Shqipërisë apo Maqedonisë veriore. Ata nuk ishin të rracës turke por shqiptare dhe sllave të konvertuar në fenë muslimane.²⁾

Kështu, 100 shqiptarë të konvertuar në fenë muslimane, nga krahina e Matit (Shqipëri) në vitin 1712, godasin forcat turke dhe marrin qytetin e Manastirit.

Në fundin e shekullit të 18-të dhe fillimin e shekullit të 19-të në gjithë zonën e Greqisë qëndrore dhe lindore, përgati tre dekada e tronditën operacionet luftarake dhe goditjet e komitetit legjendar që njihej me pseudonimin Nikoçara, arvanit nga Hasi i Atikës (Athinë). Ky kleft ka zënë vend qendror në historinë e rezistencës antiosmane të popullit grek. Pë të janë thurrur e kënduar shumë këngë popullore, janë shkruar mjaft libra.

Gjatë tërë jetës së tij ai u ndesh dhe goditi njësitë ushtarake osmane. Porta ndërmori operacione ushtarake, organizoi prita përtë goditur dhe neutralizuar atë. "Me një forcë të vogël luftëtarësh shqiptare dhe greke Nikoçara i Olimpit zbarkoi në Starosi në Halqidhiqi duke kaluar lumin

-
1. *Macedonia, A.C. - Athinë, Faqe 389*
 2. *Macedonia. A.C. - Athina, Faqe 390*

Srimon dhe synuar Ziknen. Në këtë vend Ismail Beu i Seresit, komandantë rreth 8000 ushtarë. Shqiptarët luftuan këtu tre ditë të rrighthuar. Ndërkojë, Nikoçara organizoi një çarje të guximshme përmes kordoneve të rrighthimit gjatë natës me rreth 100 burrat e tij. Mbas përleshjeve të ashpra dhe vështirësive të shumta pjesa më e amdhe e komiteve mundi të çajë rrithimin dhe të mbrijë në malet e Olimpit.

Në një betejë të mëvonshme me osmanët, në qershori të vitit 1807 në Litohoti Nikoçara u vra. Shokët e tij u tërroqën nga fusha e betejës dhe mandej, siç kishte porositur vetë ai, bashkëluftëtarët trupin e tij ja dogjën dhe e varrosën në Skiatho. Pikërisht për shkak të guximit të tij mbinjerëzor dhe organizimit mahnitës të operacioneve sulmuese, Nikoçara mbetet një shembull i rallë i udhëheqësve popullorë të çetave për çlirim.^{“1”}

Gjatë qëndrimit antiosmanë rrugët dhe grykat, fshatrat dhe qytetet e këtyre krahinave greke kanë pasur përherë të pranishme çetat e klefteve greke dhe shqiptare. Në radhët e kapedanëve, prijsave dhe çetave klefte gjenden një numur mjaft i madh figurash nga radhët e arvanitëve dhe shqiptarëve të pastudjuar dhe njohur deri më sot. Ata nuk gjenden të pasqyruar as në folklorin e hershëm shqiptar dhe as në dokumente të tjera. Një pjesë e mirë e këtyre komiteve zbriste nga territoret shqiptare të jugut apo veriut dhe bashkëpunonte me çetat klefte të territoreve greke. Në mjaft raste ne gjejmë për këta luftëtarë apo çeta veprime dhe bëma të atyre përmasave që vërtet ata kanë tronditur kohët, por shpesh në dokumente jepet vetëm emri, apo fakti që ai është “shqiptar” dhe asgjë më shumë. - Studimet më të hollësisht me arkivave apo dokumentacionit të pashfletuar do të zbulonte se nga vinte, identitetin e plotë të tij, etj, etj. Në një numur dokumentesh osmane apo greke gjenden të fiksuarë mjaft nga aktiviteti luftarak, aksione kundër administratës, tregime, gojdhëna popullore për bëmat e tyre dhe vetëm fakti që ishte

1. Macedonia C.A. - Athina - Faqe 393

shqiptar, pa u identifikuar plotësisht se për cilin komit bëhet fjalë. Historia greke e mesjetës për këta shekuj është e mbushur me plot figura të tillë, në atë masë sa ato dominojnë kete histori. Tek ne një masë e konsiderueshme ende nuk kanë arritur të evidentohen dhe të bëhen të njohura. Gjurmimi i tyre eshte vërtet një domosdoshmëri mbasi ajo do të plotësonte atë pjesë të historisë së përndritur që vërtet e kanë bere shqiptarët. Nga historiografia greke përmenden se çetat me të déguara ishin ato të shqiptarëve. Ndër to permenden "Komiti i famshëm Vergo, babai i të cilit ishte një fshatar grek, ndërsa nëna shqitpare, kishte luftuar 36 vjet rrjesht me çetat e luftëtarëve të tij kundër Portës së lartë. Ai kishte mardhënje edhe me komitë të tjera që vepronin në territoret e Ballkanit. Ai mbeti përherë i suksesshëm deri sa u plak. Duke i u referuar shifrave që na jep Jahjai, për të cilat gjykojmë se duhet të jenë disi të zmadhuara, - Vergo gjatë betejave me luftëtarët e tij kishte vrarë 2000 spahij dhe jeniçere. Në një numër rastesh ai pat plaçkitur karvanet turke duke u marrë tërë mallrat, veshmbathje dhe sende të tjera..." Për rastet e mësipërme, dokumentacioni i kohës i administratës turke i paraqet si veprime të bandave të hajdutëve pa ideal dhe që qëllim të vetëm të jetës kanë vetëm vjedhjet. Por, nga informacione e burime të tjera pretendimet e administratës osmane rrëzohen.

"Vergua ka shpërndarë të gjitha mallrat e marra karvaneve të tregetarëve turq, të varfërve dhe manastirëve të Malit të Shenjtë. - Duke i referuar gjithashtu studjuesit Levakoviç, - Vergua mbante kontakte gjithashtu edhe me çerat e komiteve të vendeve të tjera të Ballkanit dhe kryeisht veriorët. Shpesh ai aplikonte për ndërlidhjet me ta modelet antike të sinjaleve me zjarre".¹⁾

Në moshën 72 vjeçare ai takoi Jahjanë të cilit në konfidencë i ekspozoi mendime dhe oservacione të vlefshme të eksperiencës së tij të grumbulluar ngajeta e gjatë dhe plot

1. Anatoljak: "Sultan Jahja", Faqe 132

shqetësimë. Ai veç të tjerave i parashtroi atij si mund të shtrihej në përmasa ndërballkanike një luftë e suksesshme kundër pushtuesve osmanë...

Mbështetur në atë ç'kish përjetuar drejtpërdrejt dhe në mendimet edhe të komitit të famshëm Vergo, Jahja i dërgoi në vitin 1639-1640 një momerandum Papës së Romës në të cilën i parashtronë atij idenë e një kryuengritjeje të përgjithshme me pjesmarrjen e grekëve, shqiptarëve, bullgarëve, serbëve, etj. Por siç dihet rreth kësaj iniciative nuk u bë asgjë.

Në fillimin e shekullit të 17-të, 1622-1645 të tjerë komitë shqiptarë ishin aktivë me operacionet e tyre luftarake, në veriperëndim të zonës së Maqedonisë dhe Thesalisë greke, bile veprimet e tyre shtriheshin edhe përtëj kufijve te sotëm grekë. "Më 1639 bandat e të famshmit komandant-kleft Ali Bendo bënë një operacion në qytetin e Manastirit, sulmuan burgun që ndodhej brenda garnizonit turk, dhe çliruan tërë të burgosurit." ¹⁾

Çetat e komiteve-klefte shqiptare në territorët greke në dekada të caktuara muarrën përmasa të tillë dhe u bënë aq shumë shqetësuese, sa pushteti qendoror osman u detyruat të ndërmerrete fushata dhe operacione ushtarake masive. Një shembull tipik i kësaj natyre ishin njësítë e komitit shqiptar Mustafa Molla, i cili vite më parë kishte shërbyer si Vojvodë i qytetit të Verjas. Më pas ai u rebelua dhe ngriti krye kundër Portës duke filluar aktivitetin e tij kundërshtar si brigant-komit, duke mbledhur rreth vehtes në çetat e tij një numër të madh luftëtarësh shqiptarë. Ai veproi në një numër të gjërë zonash, rreth Verias... Aq të tmerrshme ishin bërë veprimet luftarake dhe goditjet e armatosura të këtij brigandi dhe të luftëtarëve të tij, sa edhe brenda qytetit të Selanikut gjithçka ishte bërë e pasigurt.

Në 10 tetor 1759, vetë Konsulli venedikas në ketë qytet Dhimitri Caida i dërgonte këtë mesazh qendrës së tij: "...gjykoj

1. Matkovski: "The Haydutks", 1964, Faqe 154

të shes gjithçka që kam këtu dhe të shkoj diku gjetkë. Jeta këtu është bërë plotësisht e pasigurt".¹⁾

Në përfundim të operacioneve ushtarakë, njësitë turke arritën të rrethojnë atë dhe të përleshen në afërsi të Kozhanit. Në betejën e përgjakshme që u zhvillua në këtë vend u vra heroikisht ky kapedan.

Por, megjithë goditjet që dha porta e lartë kundër këtij komiti dhe çetave të tij, ajo e shikonte me shumë shqetësim dhe gati pa shpresë perspektivën e vendosjes së qetësisë në këto anë. Pikërisht për këto arsyen ajo lëshoi qarkore dhe jepte urdhër që të shpopullonin me forcë vendet që banoheshin nga shqiptarë nëpër këto krahina. Pikërisht në këto vite, përmes dokumenteve bëhet e njohur edhe veprimitaria e një numri tjetër çetash të komiteve shqiptarë që qarkullonin në këto anë dhe më gjërë si në Epir, Thesali, etj. Ndër ta përmenden Veli Bei - i ati i Ali Pashës, dhe një i ri i cili është bërë tepër i njohur për aktivitetin e tij i thirrur Jani Prifti, i cili qarkullonte me çetën e tij në tërë këto zona.²⁾

Në vitin 1770 në zonat e malit të Olimpit, rreth krahinës së Grevenasë (apo siç njihet në folklorin tonë... qeraxhi i Grebenasë) vepronte një tjetër komit i njohur Dhimitër Toçka (ndoshta Toska) me çetën e tij dhe tre djemtë Qirjakon, Sterjon dhe Varkin. Ai luftoi për shumë vite kundër administratës turke derisa në një përleshje me forcat osmane të Kurt Pashës u vra në fshatin Derviçjan të Gjirokastrës.³⁾

Nga dokumentacioni që ka për këtë komit mësohet se varri i tij në këtë fshat ka qenë aty të paktën deri në fundin e shekullit të 19-të.

Ahmet Delia ishte një tjetër kaçak shqiptar i cili vepron me çetën e tij në territoret e greqisë Gadishulllore, në Thesali dhe Magnesi. Ai kishte në dispozicion të tij tetë varka të vogla lufte. Më 29 korrik 1785 ai përshkonte brigjet e Zagorisë dhe

1. Vasdravellis: "Arqeon Verias-Nausis", Faqe 170

2. Joani Lamprides; "Ipirotika Meleti", Faqe 17

3. Po aty Faqe 69

shkoi në drejtim të Kasandrës dhe Valtos ku goditi dhe u përllesh me forcat turke. Mbasai ai vau një numër ushtarësh të njësive që mbulonin këto territore u largua prej andej dhe shkoi në Pilio.¹

Në vitet që pasuan ky komit shqiptar u bashkua me komitin dhe piratin e njojur arvanitas Andrucon - i jati i kapedanit të njojur të revolucionit grek, Odisea Andruco. Bashkarisht ata organizuan sulme mbi Livadhja dhe Almiro duke goditur garnizonet turke në këto anë dhe duke u shkaktuar dëme të medha atyre. Mbas këtyre ngjarjeve Porta orgnizoi një operacion të gjerë ushtarak kundër tyre, por kapedan Delia u largua dhe u kthye në Olimp ku u bashkua me çetën e kleftit tjetër të njojur - Llaz-o, ndërsa pirati tjetër Andrucua u largua në det prej ku vazhdoi të godasë dhe plackisë anijet e tregëtarëve të mëdhej që kalonin në ato anë.

Një tjetër kaçak shqiptar që merr emër të madh dhe bëhet tronditës përgjithësisht garnizonet turke të Greqisë qendrore dhe lindore, në fundin e shekullit të 18-të, fillimin e shekullit të 19-të. Ky eshtë kapedani Biko, emri i vërtetë i të cilit gjejmë që është Beqir Xhokadori. Ai mbante përherë krah të djathtë një tjetër kapedan i cili thirrej me emrin Naum. Të dy këta luftëtarë vepronin në zonat e Ostrovës, Follorinës, Edeses dhe Starigolit dhe si bazë kryesore të tyren kishin Karatasin.

Në përgjithësi çetat e kleftore filluan të përdornin taktikën e komitit arvanitas Andruco, i cili mbas goditjeve kundër garnizonëve turke, përti shpëtuar ndjekjes së tyre ktheheshin në det, ku mbasi i hipni anijeve të tyre vazhdonin piraterinë. Shumë fshatarë të këtyre krahinave dhe veçanërisht ata të Litohorit të cilët kishin barkat e tyre, përherë e më shumë filluan të bashkëpunim me kleftet. Megjithëse, ata nuk ishin luftëtarë të rregullt të cilave vinin në dispozicion mjetet e tyre të lundrimi dhe jo rrallë merrnin pjesë edhe vetë në operacionet e çetave të luftëtarëve. Numri i goditjeve në det

1. Vesdrevellis; "Armatoli qe kleftes", F. 108

që jepnin piratët e këtyre anëve u rritën aq shumë sa në vitin 1795 një numër i madh i tyre i organizuar goditi edhe qytetin e Vollosit. Vetë Sulltani këtë vit urdhërotne admiralin e flotës së tij Huseinin që të ndiqte dhe të asgjesonte me çdo kusht barkat dhe mjetet e tjera të kryengritësve në det.

Po këtë vit, më 14 korrik 1795 konsulli venedikas në Selanik e paraqet kështu situatën në këto anë: "...piratët të cilët veprojnë në ujrat e këtij gjiu janë të panumurt. Ata nuk përdomin vetëm barka të vogla për operacionet e tyre por edhe anije të mëdha e të armatosura mirë të cilat janë në gjendje të ndërmarrin çdo lloj aksioni kudoqoftë. Kam frikë se ata mund të ndërmarrin veprime dhe kundër anijeve tonë nuk marrin masa kundër këtyre pirateve, ata janë komplet të pafuqishëm dhe apatikë para forcës së tyre".¹⁾

Në territoret e këtyre krahinave dhe ato të Epirit, vepronin çetat e dy luftëtarëve të tjerë të njohur ajo e Kaçandonit dhe e Kiço Boçarit (babai i heroit të revolucionit grek Marko Boçarit). "Në vitin 1806 çetat e këtyre dy komiteve të famshëm Nikoçara. Gjatë muajve të dimrit ky komit pat kaluar nga Sporadet në Hidra dhe së fundi në ishujt Joniane, ku komitet vepime të organizuara dhe të koordinuara luftarake kundër pushtuesve osmanë".²⁾

Në Greqinë qendrore dhe jo rallë edhe në atë jugore Hasja e Atikës. Në çetën e tij të komitëve kishte 60 luftëtarë dhe vetë Thimi ishte prift. Në veprimet dhe luftimet e klefteve të tjerë të këtyre anëve çeta e Bllahavës është përherë e pranishme dhe e evidencuar kudo.

Në fundin e shekullit të 18-të dhe fillimet e shekullit të 19-të shpërthen konflikti i njohur russo-turk. Rusia e cila ishte e

1. Aleksandër Lavrioti: "To Aggio Oros", Faqe 164
2. Inglezis: "Ta armatolika", Faqe 16

interesuar për ndezjen e vatrave të tjera të zjarrit në territoret ballkanike kundër Turqisë dërgoi një numur misionarësh për kontakte me komitë të ndryshëm, të cilët vepronin nëpër territoret e Greqisë. Ndër të tjera ata u takuan dhe me komitin Nikoçara.

Vite më pas, kryekomandanti i forcave kryengritëse të revolucionit grek Teodor Kollokotroni, në shtator 1821 kur kish goditur me Ifutëtarët e tij dhe kishte çliruar Tripolicen, duke iu referua Nikoçarës, të cilin ai kish pasur fatin ta njihe në dimrin e vitit 1806 në ishujt Joniane theksoi se - Nikoçara ishte një nga luftëtarët e vetëm të Olimpit që i dha vlera të jashtezakonshme revolucionit dhe në fund u shua për interesat e tij..."

Veç sa cituam më sipër, në keta shekuj në historiografinë greke numërohen edhe një numur tjetër i madh luftëtarësh dhe komitësh, kleftë, shqiptarë. Ndër ta mund të përmendim kaçakun Sulo Proshova, i cili vepronte në zonën e Larisës; Veli Gjeka, Tafil Buzi dhe asllan Beu në Thesali, Shaban Gjika nga Mati me çetën e tij i cili zbret deri në Selanik. Në vitin 1803 çeta e komitit Banush nga Kolonja dhe Nurkës së Përmetit që përbëheshin nga 150 luftëtarë shqiptarë godasin Gradeshnicën, Xhavellet, Boçaret e shumë e shumë të tjere vepronin përherë e më tepër në territoret greke.

Lëvizjet e këtyre luftëtarëve të panënshtuar, krijuar situatën dhe klimën që pruri pranverën e pritshme - revolucionin grek për pavarësi të vitit 1821. Këto çeta nga veprime të shkëputura, filluan të bashkëveprojnë me njëra tjetrën dhe nga një zonë e izoluar nëpër tërë territoret greke. Ato u lidhën me rebelin e Portës, Ali Pashën, me iluministët, mendimtarët dhe frysuesit e revolucionit Filipi Eterine, me filohelenë dhe mendimtarë e personalitete të mëdha të kohës si Bajroni, dhe kështu të gjithë bashkarisht, shkuar në barikadat e Mesolongjit.

* * *

Veprimet e çetave të shkëputura të komitëve dhe hajdutëve, të cilat më pas muarrën formën e një lëvizjeje masive antiosmane, të mbështetur dhe përkrahur nga populli ishin shtrati i rezistencës së armatosur të popullit grek dhe pothuaj i të gjithë popujve të tjera të Ballkanit, të cilët vuanin nën robërinë shekullore osmane. Këte rezistencë e pasqyrojnë dokumentet e administratës turke, aq dhe folklori, që i përcolli këte faqe të historisë nga brezi në brez.

"Në kushtet e robërisë së përbashkët nën Perandorinë Osmane, kur popujt e ndryshëm rezistonin kundër sunduesve dhe shtypjes të të gjithë formve që ai përdorte, vetë robëria i ka bashkuar masat e gjera të të gjithë këtyre popujve në frontin e rezistencës duke zgjuar shpirtin liridashës dhe revolucionar të tyre dhe duke siguruar vulën e kohës dhe të ngjarjeve të saj në poezinë popullore epike."¹⁾

Nuk është aspak çudi që çetat e kaçakëve shqiptare vepronin nëpër tërë territoret e Greqisë, të maqedonisë dhe deri të Bullgarise. Ato kanë zhvilluar dhe luftime të përbashkëta me luftëtarë grekë, maqedonë apo bullgarë. Misioni dhe ideali i përbashkët i tyre ishte liria. Në folklorin grek rapsodet i kënduan me po aq ndjenjë kapedanëve shqiptarë që luftonin në ato anë, po aq sa rapsodët shqiptarë u kanë kënduar luftëtarëve grekë që luftonin për idealin e madh të lirisë dhe pavarësisë të atdheut. Frymëmarrja e kësja kënge është tepër e gjerë. Ajo nuk ngushtohet tek paragjykimi i ngushtë i kufijve nacionalë. Ajo shtrihet në përmasa gjeografike të mëdha, duke i dhënë të tjera përmasa imazhit dhe shpirtit kryengritës të popujve. Ja ç'thotë kënga popullore shqiptare:

1. Fazli Syla; Semin.ndërkomb.për gjuh,letërs, dhe kult shq. 1982, nr. 7

*Kapetan Çelo Picari
O shejtan Veis Vasjari
Ku shkoje të dridhej mali
Në Athinë tu ngre pazari
Nde Nebaht të vate nami*

.....¹⁾

Këta luftëtarë u kënduan dhe u qanë njëlloj nga popujt e këtyre anëve. Ata i u dhimsen njëlloj nënave dhe ftymëzuan njëlloj shpirtin e rapsodëve:

*Qaj e qaj e qaj me lot
Bilbil Sakon se gjej dot
Deli moj Janinë e shkretë
Të shikoni Bilbilejtë
Varrure degë më degë*

.....²⁾

Ideali i lirisë kurrë nuk ka pasur barjera krahinore, në të kundërt shpirti i atdheut të bashkuar i ka gjetur luftëtarët në çdo moment në një llogore apo rrëzë shkëmbi e prite të vetme..

*Thonë doli sadrazemi
Ngrehu Shqipëri t'i vemi
Zylyftari i Podës
Dërgoi kartë Shkodrës
Edhe Shkodra i dërgoi
N'Manastir u ngrit e shkoi*

.....

Folklori ynë popullor i ka ndjekur këta trima të lëvizjes së madhe antiosmane nëpër tërë trevat Ballkanike, kudo ku ata derdhën gjakun e tyre, kudo ku trupi i tyre u mbulua. Për ta ai dhe që mbulonte trupat e tyre ishte tokë e lirisë, kushdo që të ish dhe kudo qe të ish...

1. Mbledh të hersh. të folkl shqipt. Faqe 121

2. Po aty, Faqe 203

*Nde Athinë e nd'Allamane
Janë shumë kapedanë*

.....
*Musa beu ka Livadhine
Tareja lufton Athinë*

Kontributi i shqiptarëve në këtë luftë heroike u kthye e mori përmasat e legjendës në betejën e famshme të Mesolongjit. Vëllazërimi, qëndresa dhe vdekja dorë për dorë muarrën përmasa rënqethëse. Aty u mpleks edhe një herë në përmasa çudibërëse gjaku i arbërit, arvanitë, suliotë, lebërt, kolonjarë, korçarë deri shkodranë e dibranë përkrah kryengritësve greke shkruan me gjakun e tyre fillimin e epokës së madhe të popullit grek.

*Djemtë e Sulit me vulë
Markon mbe dorë e prunë*

.....
*Mesollongji u helmua
Derdhi lotët si krua*

Në këte thesar të madh këngësh dhe tinguish mbushur me epizëm dhe tragjizëm, folklori ynë mbart të gdhendur emrat e shumë herojeve dhe luftëtarëve të njojur, kapedanë të çetave kryengritëse që bënë emër dhe shkruan histori, të tillë si Marko Boçari, Foto Xhavella, Çelo Picari, Zylyftar Poda, arvaniti Karaiskaj, Kollokotroni, Shahin Qafzezi, Gjon Leka, Rrapo Hekali, Hodo Leka, Tafil Buzi, luftëtarja arvanite Laskarina Bubulina, etj.

Krahas figurave të njoitura, në vargjet e këtij thesari populor ne gjemjë edhe emra luftëtarësh të tjera që fatkeqësisht nuk mësojmë më tej nga ç'na jep kënga për ta, jetën dhe bëmat e tyre, veç emrit. Ata humbasin diku mes historisë dhe folklorit duke na ardhur tek ne ai anonimë, ashtu sikurse rruga e gjatë e luftrave mbuloi njerëz që ende nuk u dihet vari.

Duke parë nën këto vështrime këngën tonë folklorike të

këtyre shekujve dhe mesazheve që ajo përcjell në to, veç të tjerave ndjehet shpirti i qëndresës, shpirti i solidaritetit, sakrifica sublime për idealin, kontributi për interesat e popujve të tjerë. Bile në tiparin e fundit kënga e jonë popullore është shumë e çveshur nga pasionet e ngjyrave nacionale apo shtrivogëlsitë, në raport me krijimtarinë e popujve të tjerë ballkanikë.

"Në disa këngë popullore të popujve të tjerë të Ballkanit, kaçakët shqiptare nuk përfaqësohen mirë, atyre u mvishen veti cubash, rrëmbyesish, keqbërësish. Ka raste kur përkatesia muslimane e kaçakëve shqiptare është kundruar edhe me një farë everzioni, prandaj mund të themi që ky element është keqpërdorur në disa raste në folklorin e popujve të tjerë. Në anën tjetër duhet theksuar që poezia popullore shqiptare përfat të mirë nuk i merr në gojë për të keq popujt e tjerë dhe as të arratisurit e tyre si hajdutët, kleftët, komitët, etj.

Folklori ynë i trajton çështjet pa kurfarë ngarkesash të ngushta kombëtare e përshëndet çdo zgjerim të aktivitetit të kaçakëve tek të gjithë popujt e ballkanit në luftë kundër armikut të përbashkët".¹⁾

Ajo çka referuam pak më sipër, fatkeqësisht nuk gjendet vetëm me ndonjë këngë popullore të popujve përreth, notat e rasteve të përcëmimit nacional apo përbuzjes dhe keqtrajtimit i gjejmë herë-herë edhe tek studjues e shkëncëtarë të këtyre vendeve. Në se ka pasur në ato kohë cuba, apo hajdutë në kuptimin e vërtetë të fjalës, në radhët e shqiptarëve kjo nuk përbën thelbin e fenomenit, mbasi cubë dhe hajdutë deri vrasës të pamëshirshëm kanë pasur edhe këto vende. Pa dashur t'i referohemi faqeve të errëta të historisë këto vende kanë pasur deri formacione shoviniste që kanë kryer masakra dhe krime barbare kundër shqiptarëve. Për ta mbyllur sa sipër do të përmendim rastin e shqiptarit Ali Faumaqi i cili sakrifikohet se nuk pranon t'u dorëzojë turqve bashkëluftëtarin

1. Fazlli Syla: "Këngët pop....", Sem.Ndërk. F.7

e tij grek Teodor Kollokotronin, i cili më pas u bë komendant i forcave kryengritëse të revolucionit përvavarësinë e Greqise. Këtij gjesti, kënga popullore greke dhe ajo shqiptare i këndon:

*Gjithë bota le të thonë
U se jap Kollokotronë
Jam Ali Farmaqi u
Që shpje gjakun der në gju.*

Kjo periudhë nuk ishte vetëm periudhë e pallës dhe e dyfekut siç mund të mendohet në ndonjë rast, sepse dyfekë dhe palla merren në kohë të caktuara dhe për ideale dhe qëllime të caktuara. Që të ngriheshin kaçakët, të delnin çetat e komiteve dhe hajdutëve duheshin frysuesit, ideatorët, pranjerëzit e mendjes, të dijes dhetë kulturës. Dhe Shqipërisë nuk i munguan në këto kohë as këta njerëz të cilët dhanë kontributet jo të vogla në territorët e vendit tonë dhe më gjërë në trevat Ballkanike apo ato Europiane.

Në fushën e arteve figurative shumë piktorë shqiptarë bënë epokë veçanërisht në pikturën murale dhe tablot e artit bizantin-ortodoks. Një pjesë e mirë e krijimeve të piktorëve mesjetar shqiptare renditen në "fondin e artë" të artit të madh bizantin. Në botimin e fundit të albumit ilustrativ me kryeveprat e artit bizantin nëpër botë "Aggio Grafies", të përmblledhur në vitin 1989 nga Kumundhureas-Athinë, rrëth 15 përqind e tyre janë tablo të autorëve shqiptarë, Selenicasit, Onufrit, Zografas, etj. Një vlerësim i tillë i piktorëve mesjetarë shqiptarë dhe veprave të tyre eshtë padyshim një fakt që rendit vendin dhe kulturën tonë në nivele që rallë e kanë vende të tjera të Europës e të botës.

Krijimtaria e artistëve shqiptarë nuk u kufizua vetëm brenda territorëve të Arbërisë apo Sanxhaqeve shqiptare. Ata kapërcyen këto anë përtë derdhur artin e tyre në qendra dhe monumente të rëndësishme kulti, kudo ku ata ndërtoheshin apo i gjendeshin. Veprat e tyre shtrihen nga **Kostandinopoli** në manastiret e famshëm të Agji Orosit - **Malin e Shejtë**, në Ohër, Kostur, në Thive, në Korçë, Shpat

të Elbasanit, etj.

"Në vitet 1560, për tre dekada rresht, një grup piktorësh të një famijeje çfaqet në zonën e Maqedonisë greke, në fshatrat rreth Kosturit dhe veçmas nga Linotopi në Gramoz. Përmes tabllove të tyre ne mësojmë vetëm emrat Nikolla, Mihal dhe Kosta. Veprat e tyre gjenden edhe në zonat e Epiriti, Maqedonisë greke dhe Greqisë qëndrore. Ndërpunët e para të këtij grupei piktorësh nijhet ajo në Palatista afër Verias, ku në vitin 1570 Nikolla punoi bazilikën e shën Dhimitrit".¹⁾

Megjithëse, kritika dhe studjuesit e artit bizantin heshtin apo i shmhngen prononcimit për origjinën dhe nacionalitetin e këtyre krijuesve, krijimtaria e të cilëve vlerësohet si ndër më të arrirat e fondit të këtij arti, ka shumë të dhëna bile edhe ndonjë mendim të shprehur që të tre piktorët janë shqiptarë. Një tjetër argument është se edhe vetë vendbanimi i tyre apo më saktë vendlindja në ato shekuj ka qenë vendbanim shqiptarësh.

"Piktura të mrekullueshme gjejmë në Vatapodhi, të shoqëruara nga një numuri madh mbishkrimesh... në kapelen e Virgjëreshës Kukuzelica në Llavren e Madhe (vend ku kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij, vdiq dhe u varros Kukuzeli ynë i madh), një mbishkrim tanë i shtuar, na bën të njojur se piktori i saj ishte Davidi nga Vlora dhe mban datën 1715. Po ky piktor është autor i tablosë në bazilikën e Shën Nikolles në Voskopojë... Në Llavrën e Madhe gjendet një mori e madhe e veprave të tij, mes të cilave ajo me karakter laik e titulluar "Kori hyjnor", "Mrekullitë e Shën Thanasit", "Këshilli Ikumenikal", etj."²⁾ Për të treguar se si vlerësohej talenti dhe potenciali i këtij artisti të madh mund të themi vetëm faktin që atij i janë besuar për të ilustruar një nga institucionet më të rëndësishme në mos më i rëndësishmi siç është kapela dhe ambientet e tjera të Lavrës së Madhe -

1. Macedonia S.A. Athinë 1983, faqe 420

2. Po aty, faqe 422

qendër shpirtërore e riteve ortodokse.

"Në vitin 1765, dy vëllezër të tjerë piktorë Kostandin dhe Athanas punuan në manastirin shqiptar të Filotheit pranë Malit të Shenjtë. Në vitin 1783 punuan në Kseropotamo dhe me 1766 në "sketen" e Ksenofondes. Ata kanë evidencuar qartë në tablot e tyre se ishin nga Korça". Në këtë rast është fjalë për dy vëllezërit piktorë të mesjetës të cilët ne i thërrasim vëllezërit Zografo-qe në fakt nuk duhet të jetë mbiemri i tyre por thjesht profesioni që ata ushtronin - zografo - piktori.

Në radhën e këtyre artistëve dhe të krijimtarisë së tyre padishim renditen edhe shumë figura të tjera të përnditura në fushat e letrave dhe kulturës. Etja për dije dhe kulturë ka shoqëruar vazhdimit edhe në këto shekuj të errësirës së egër dhe mizore otomane shpirtin e popullit tonë.

Eshtë shumë sinjifikativ rasti i gjetur nga studjuesi Vakalopulo mbi shkollën e parë greke të hapur gjatë pushtimit otoman në zonën e gregisë qendrore, në vitin 1821, dhe të një dokumenti të nxënësit e parë të saj. Bëhej fjalë për një mesazh, të shkruar në formë poezie nga tetë nxënësit e parë të kësaj shkolle që porsa e kanë mbaruar atë. Ata në shenjë mirënjojje u dedikojnë këtë promemorje mësuesve dhe kryesisht banorëve të qytetit të Kozhanit, të cilët gjatë viteve të studimeve i trajtuan ata si bijtë e tyre. Në fund të këtij mesazhi prekës dhe me ndjenjë nxënësit kanë vënë emrat e tyre. Ajo çka vërtet e bën interesant këtë dokument është se nga tetë nxënësit e kësaj shkolle që kanë nxënësit kanë mbiemrat e tyre dhe përpiluar mesazhin e mirënjojjes katër apo pesë janë shqiptarë të ardhur nga krahina të Shqipërisë për t'u shkolluar në këtë vend të largët. Eshtë vërtet për t'u habitur se si kanë mundur këto familje të mësojnë për hapjen e kësaj shkolle kur ajo ishte ende gjysëm e fshehtë nga amdinistrata turke, nuk dimë ç'përfaqësojnë ata dhe kush ishte fati i tyre i mëvonë.

Në dokumentin e përpiluar prej tyre thuhet:

"Ne nxënësit, që kemi ardhur nga vende të ndryshme

duke ndjerë për detyrë prezantimin e atyre çka muarrëm dhe përfituan u bëjmë të njohur se ne jemi tetë vetë gjithsej që ndoqëm mësimet në këtë qytet me dëshirën të bëhemë përhapës të arsimit. Disa prej nesh janë nga Epiri, disa të tjerë nga Shqipëria, disa nga Thesalia dhe Maqedonia; Por, ishte Kozhani për këto kohë atdheu dhe shtëpia e jonë, u jemi mirënjojës edukatorëve të shkollës të cilët shërbyen si pjedestal për progresin tonë. Për dashurinë e derdhur për ne, për respektin e admirueshëm që ju treguat, duke na konsideruar vërtet si fëmijët tuaj ne u shprehim nderimet dhe respektin e pakufishëm dukye u ndjerë se përpara jush do të mbetemi përherë të detyruar për gjithçka bëtë”¹⁾

Mes tetë emrave sikurse thamë gjenden edhe katër shqiptarët ndoshta edhe një i pestë për të cilin nuk jemi të sigurtë:

.....
Kostandin Apostoli nga Përmeti

Jani Anastasi nga Këlcyra
.....

.....
Jani Athanasi, Vithkuqari

Vasil Xhelio, Fratariti

Jani Zoi nga Zagoria (por nuk dimë në se ështe Zagorie e Gjirokastrës apo Zagorie e Janinës).

Vërtet ne nuk dimë për fatin e mëtejme, të këtyre pionerave të arsimit shqiptar, por dimë se nga këto anë lindën shkollat e para të rilindjes tonë, lindën mendimtarët dhe luftëtarët e penës që udhëhoqën, frymëzuan dhe më pas muarrën pjesë me armë në dorë në lëvizjet e mëdha për pavarësi.

1. A. Vakalopoulos; *History of Macedonia*, Faqe 440

Kontributi i popullsisë arvanite, në tërësinë e rrjedhave historike, zhvillimeve dhe konsolidimit të shtetit modern grek, është i përmasave të tilla që vetë ky vend dhe ky popull nuk mund të kuptohet pa prezencën e saj, nuk mund të lëvizë pa bashkëlëvizjen e saj dhe nuk mund të vinte këtu ku është sot pa mundin, gjakun, heroizmin dhe mendimin që ai jetërsoi në atë vend.

Kjo pjesë e popullit shqiptar, që zbriti nëpër mugëtirat e shekuje dhe u shpërndë thellë në tokën e lashtë greke, ishte si ajo fara e mbarë, e cila hidhet në një tokë djerre kur mbi të ka rënë hija e harresës mbas shumë tragedish dhe fatkeqësish historike. Arvanitet, më të zbritur rigjallëruan atë tokë, i dhanë së pari jetën dhe frymëmarrjen e shumëpritur.

Qëndresa, lufta dhe përpjekjet e tyre për të mbajtur dhe ruajtur atë tokë, qe për ta ishte atdheu i tyre i ri, nga sulmet dhe invazionet e shumta dhe sidomos qëndresa përpara agresionit osman ngritën emrin e kësaj popullsie në përmasa ballkanike dhe europiane. Luftrat e saj deri në vëtmohim është një kontribut i rëndësishëm që arvanitet dhanë për Greqinë dhe historinë mesjetare të saj.

Por, ajo që përdriti emrin e kësaj popullsie krenare dhe që i dha vërtet një vend të veçantë në historinë e këtij vendi, ishte kontributi dhe energjitetë masive që ajo derdhi në revolucionin për pavarësinë e Greqisë të vitit 1821. Ky eveniment i madh për popullin dhe historinë e Greqisë e nxorri atë nga sklavëria shekullore osmane dhe dha sinjalët e para në Ballkan për popujt e tjerët të këtij rajoni të godisnin dhe këpusnin vargojtë e huaj. Fitorja e pavarësisë që në fillimet e shekullit të kalaur dhe formimi i shtetit të parë të pavarur e ingranoi këtë vend në rrjedhat e modernizimit dhe qytetërimit europjan. Ajo i dha këtij vendi shumë shpejt mundësinë të gjejë vëvehten, të njoħë të kaluarën dhe të shikojë në optimizëm të ardhmen.

"Kontributi që dhanë arvanitët në këtë epokë, padyshim, është i përmasave të veçanta. Kjo sa për pjesmarrjen e tyre masive në betejat e ashpra, komendantët dhe udhëheqësit popullorë aktivë, sakrificat e pashembullta në beteja ku vareshin fatet e popullit dhe të revolucionit, sakrifilijet deri në vetmohim dhe mbi të gjitha besnikëria e dhënë ndaj ideali të lirisë, të cilës ata i qëndruan legjendare dhe të palëkundur deri në fund..."¹⁾

Një ndër studjuesit dhe hsitorjanët grekë më të njohur të shekullit të kaluar Furiqi duke iu referuar historisë së vendit të tij thotë: "...asnje përfundim nuk mund të arrihet për helenizimin mesjetar nëqoftëse nuk studohet me vëmendje dhe me hollësi ajo që ka të bëjë me popujt fqinje dhe veçanërisht me popullin shqiptar, me të cilin populli grek jetoi pranë shekuj të tërë, luftoi bashkë me të! U pushtua dhe u çlirua bashkë me të, rron pranë me të dhe do të jetojë pranë me të".

Të trajtosh revolucionin për pavarësi dhe kontributin e madh e të veçantë që dhanë arvanitët në të është e vështirë dhe një ndërmarrje e përmasave të mëdha. Kjo popullsi që në atë kohë barazohej për nga numri me popullsinë greke apo dominonte mbi të ishte shtyllë e fuqishme e kësaj lëvizjeje popullore të armatosur. Historia greke tanimë ka evidencuar zhvillimet dhe lëvizjen e kësaj kohe. Deri 90 përqind e kapedanëve që drejtuan çetat kryengritëse nga toka apo nga deti ishin të gjithë arvanitë. Pjesa më e madhe e njësive të luftëtarëve kryengritës përbëhej pikërisht nga kjo pjesë e popullit dhe betejat vendimtare e më të përgjakshme u përballuan nga këta heroj.

Për këtë çështje do të qëndrojmë shkurtazi vetëm tek disa nga figurat qëndrore të këtij revolucioni dhe moemntet më kulmore deri sa mbi tërë tokat e Greqisë ranë këmbanat e lirisë.

1. Dh. Grillo: Arvanitët, Faqe 23

Si datë e fillimit të kryengritjes së madhe greke që u zhvillua me moton "Lefterja i thanatos" (Liri a vdekje), njihet 25 Marsi i vitit 1821, por kuptohet që veprimet luftarake të kryengritësve kishin filluar më parë. Terrenin e një kryengritjeje në përmasa të mëdha e kishin përgatitur çetat dhe luftëtarët e njojur të thirrur klefte, brigande, komitë, etj. E para që rroku flamurin e kryengritjes ishte Specia. Që ditët e para, me 3 prill 1821 speciotet rrethuan dy kështjella të Peloponezit Nafplios dhe Monemvasia. E para që shkoi në rrëthimjn dhe goditjen e Nafplios ishte arvanitsja, Laskarina Bubulina së bashku me luftëtarin tjetër arvanit Manol Lazrin.

Bubulina është një ndër figurat më të shquara të kryengritjes për pavarësinë e Greqisë. Ishte e bija e komitetit dhe brigandit të njojur arvanitas Stavro Pinocit nga ishulli i Hidrës. Stavrua mbas disa vitesh lufte dhe aksionesh kundër turqve u kap nga ana e tyre dhe u burgos në Stamboll. Në një rast kur bashkëshortja e tij shkoi për ta takuar atë në dyert e hekurta të qelisë, e mbarsur me urrejtjen dhe emocionet e mëdha ashtu e tronditut dhe e përlotur siç qe, e zunë krizat e lindjes. Tamam aty, në maj 1771, në qelitë e egra ku dergjeshin dhe martirizoheshin luftëtarë kryengritës nga vende të ndryshme të Ballkanit, si për të sfiduar prangat dhe vdekjen, lindi ajo kriesë e cila do të kthehet më pas në simbol të lirisë. Emri i saj është Laskarina por gjatë viteve të revolucionit dhe në përgjithësi ajo u thirr Bubulina. Këtë mbiemër, i cili e shoqeroi më pas si emër e mori nga burri i saj i dytë kapedani arvanit Dhimitër Bubulina nga ishulli i Specias, i cili u shqua si luftëtar në det. Disa studjues mbiemrin Bubulina e spjegojnë me fjalën shqipe - Bubullima. Dhimitri ridhte nga një familje e pasur megjithatë ai i u kushtua që herët lëvizjes për pavarësi deri sa vdiq. Pasurinë e tij të madhe, e trashëgoi Bubulina e cila pa hezitim e vuri atë në shërbim të kryengritjes. Ndër të tjera, me një pjesë të

pasurisë ajo ndërtoi fregaten e luftës që e emërtoi "Agamemnon" duke vënë jo vetëm atë por edhe gjithçka ajo kish në shërbim të idealeve të çlirimit kombëtar. U lidh që në fillim me "Filiqi Eterine" dhe mori pjesë në betejat më të mëdha detare kundër forcave turke. Ajo luftoi në mënyrë të barabartë krah përkrah burrave dhe në shumë raste me kurajën, trimërinë dhe heroizmin e saj, u bë simbol i shpirtit dhe qëndresës së luftëtarëve.

Së bashku me Kollokotronin, kryekomandantin e forcave kryengritëse dhe me Pllaputën, Bubulina përshkroi tërë Peloponezin duke luftuar përkrah tyre në tërë betejat e mëdha që u zhvilluan në këto anë, si në luften e Dervenase kundër Dramaliut, në rrethimin dhe fitoren mbi Tripolice ku vetë kjo trimëreshë çau dhe u fut e para në qytet hipur në një kalë të bardhë.

Aftësive të rralla të saj si kapedane e deteve i dedikohen një numur aksionesh dhe betejash detare që u organizohen kundër anijeve të flotës ushtarake turke. Drejtonte, komandonte, udhëhiqte dhe hapte vetë zjarr nga anija e luftës me një shpir dhe kurajë që mahnistë. Deri në betejat e fundit çlirimitare të revolucionit grek ajo mbeti një luftëtarë legjendarë. Gjatë viteve të luftës ajo veç luftëtarëve të saj arvanitë, njuhu dhe luftoi krah për krah edhe me një numur luftëtarësh shqiptarë, të cilët dhanë pa u kursyer kontributin e tyre për interesat e lirisë të popullit grek. Trimëria e tyre e pat mahnitur atë. Një ndër luftëtarët shqiptare që e kish befasuar ishte komiti i njuhur nga Kolonja Musa Qafzezi. Aq shumë e kishte ipresionuar trimëria e këtij burri, sa kur Bubulinës i çuan lajmin e vrasjes së tij ajo pa u druajtur pohoi:

*"Sihariq moj Bubulinë
Se e vranë Qafzeslinë*

.....
*Të ma sillkeshit të gjallë
Burrë e keshë për ta marrë
Të bëja një çupë e një djalë
Se janë soj kordhetarë*

Edhe vetë Bubulina u vra në vitin 1825 në Specia, në rrethana të dyshimta ashtu sikurse edhe disa kapedanë të tjerë të revolucionit grek, të cilët u dënuan apo u vranë mbas revolucionit. Ajo u qëllua në dritaren e shtëpisë së saj dhe thuhet se vrasja ishte për motive personale.

Ai që drejtoi, organizoi dhe bashkërendoi forcat kryengritëse në vatrat dhe përleshjet më te mëdha e të rëndësishme të kësaj epopeje ishte arvaniti tjetër i shqar Teodor Kollokotroni. Origjina e tij nga gjaku shqiptar tanimë pranohet jo vetëm nga sa historjanët kanë hulumtuar për të kalaurën e tij por edhe nga vetë pohimet e tij. Ai i ka konsideruar shqiptarët ortodokse apo muslimanë përkrah tij në frontet e luftës si "ata janë vëllezërit e mij të një gjaku". Duke rendur për të nxjerrë origjinën e largët të tij dhe të parëve, vetë studjues dhe historjanë grekë kanë gjetur se rrënjet e origjinës së tij janë nga lagjia "Mëhallë" e Delvinës, e cila tanimë është zhdukur. Largimi i të parëve të tij nga këto anë vlerësohet të jetë bërë mbas pushtimeve turke të territoreve shqiptare aty nga shekulli 16 apo fillimi i shekullit të 17.

Një varjant interesnat mbi origjinën e Kollokotronit ka dhënë edhe studjuesi Dhimitër Grillo. Duke rendur mbas mbiemrit Kotron i cili ka ekzistuar deri vonë në fshatrat e bregut dhe tanimë si toponim, ato çka bien në kujtimet e tyre banorë të moshuar të këtyre anëve, dhe shumë detaje dhe elementë të tjerë plotësues, nuk përjashtojnë varjantin e dhënë mbi zbritjen prej këtu te pinjollëve të parë te Kolo Kotronit.¹⁾

Ky kryengritës i papërkulur filloi që në moshë të re veprimtarinë antiosmane. Ai mori pjesë në disa njësi luftëtarësh klefte dhe ishte ndeshur shumë herë me njësitë dhe garnizonet e pushtuesve turq. Siç pohon edhe ai vetë që në këto vite - të rinisë - ai lexoi historinë e Skënderbeut e cila e befasoi vërtet dhe vazhdimisht e mbushte më besim për

1. *Dh. Grillo: Arvanitët dhe shqiptarët në luftën...*", f.89

luftën e tij. Ende pa lindur dhe u konsoliduar plotësisht ideja e një kryengritje të përgjithshme të armatosur për pavarësinë e Greqisë, Kolokotroni ndoshta është ndër të parët që kishte përpunuarnë mendjen e tij dhe kishte filluar veprimet konkrete për të materializuar këtë ide të madhe.

Kontaktet e tij me luftëtarin e njohur Ali Farmaqi, përpjekjet e tyre të përbashkëta për t'u lidhur me francezët, realizimi i kontakteve dhe i idesë së parashtuar prej tyre për një front të përbashkët antiosman, vlerësohen si platformat e para për një luftë të përgjithshme të armatosur për çlirimin e Greqisë.

Kollokotroni u përpoq së bashku me vëllamin e tij Ali Farmaqin të ngrinin tërë Peloponezin në luftën e armatosur me qëllimin final të shkëpusnin atë nga kthetrat e Portës duke e shpallur një shtet të pavarur.

Duke rendur dhe luftuar vazhdimisht me èndrrën e madhe të pavarësisë ai kontaktoi pothuaj me tërë komitët dhe kleftet më të dëgjuar të asaj kohe që luftonin kundër Portës. Luftoi përkrah tyre me njësitë e luftëtarëve të tij, i nxiti ata për veprime të përbashkëta e të koordinuara, u propozoi idetë konkrete të frontit të përgjithshëm mbarëpopullor për pavarësinë e vendit, shkoi nga territoret e Greqisë kontinentale në ato ishullore, nga pjesët lindore të saj në perëndim, u njoh nga afër me tërë ata komitë e luftëtarë të cilët më pas u bënë herojtë e vërtetë të revolucionit për pavarësi.

U lidh nga afër dhe u bë vllam me luftëtarin arvanit të Peloponezit, Ali Farmaqi. U njoh nga afër, luftoi përkrah tij, udhëtuan ditë të tëra, çanë rrethimet bashkarisht, shtruan idetë e mëdha të çlirimt të vendit dhe u bë vllam edhe me një nga figurat më të përnditura të revolucionit shqiptarin nga Suli, Marko Boçarin. Njohu nga afer dhe luftuan përkrah me njëri-tjetrin me Karaiskaqin, Odisea Andruca, Bublinën, Kanarin, Pllaputen e shumë të tjera.

Kollokotroni ishte ndër luftëtarët kryesorë në goditjet e para të organizuar për çlirim kombëtar. Bashkë me kapedanët

e tjerë përpunuani idenë dhe goditen me Bubulinën Tripolicen, të cilën e çliruan. Morri pjesë dhe komandoi veprimet e kryengritësve për çlirimin e Patrës, kështjellës së Nafplios, Argosit, e mjaft garnispneve turke në Peloponez. Veprimet e tij u shtrinë edhe në Greqinë kontinentale e deri në Athinë.

Ishte ai që ideoi dhe shpalli në momente tepër të rëndësishme pér fatet e Greqisë mobilizimin e përgjithshëm nga mosha 15 deri 65 vjeç dhe pjesmarrjen e tyre totale pér luftë. Luftoi dhe punoi me insistim kundër dasive fetare që përballonte populli grek pér shkak të ekzistencës së dy feve.

Megjithëse Kollokotroni mbeti figura më e madhe revolucionit pér pavarësinë e Greqisë, ai sikurse edhe mjaft figura të tjera herojsh të kësaj epoke, mbas fitore nuk u vlerësuan nga pushtetarët e qeverive te pasrevolucionit. Por, atë që nuk u bënë pushtetarët e atëhershëm e bëri populli grek dhe historia që pavarësish nga planet që ata thurrën nën rrogos, ata mbeten vërtet "nën" dhe kurse Kollokotroni mbetet në qendër të Athinës "mbi" pjedestal, "mbi" kalë.

Odisea Andruco, lindi në fshatin Livanat. Ishte i biri i komitit të njohur Andruc Verushi, i cili siç kemi bërë të njohur më parë ishte bërë vllam me Ali Pashën e Janinës. Mbas një jete të mbushur me luftë dhe ndeshje me portën Andrucin e kapën venecjanët kur kalonte nga Peloponezi në Korfuz. Mbas torturash të shumta, venecjanët ja dorëzuan atë turqve, keta të fundit e flakën dhe e mbytën në Bosfor. Ky komit i tmerrshëm që përfundoi në këtë mënyrë tragjike në popull dhe në historiografi ka mbetur i njohur me emrin "Luan i Rumelisë".

I biri i tij Odisea që në moshë të re shkoi në oborrin e Ali Pashës, ku vazhdoi dhe mbaroi shkollën ushtarake në Janinë (që ishte e vetmja e këtij lloji pér territorët perëndimore të perandorisë). Mbas përfundimit të saj, ai i shërbuej me besnikëri Ali Pashës në shumë fronte luftrash dhe beteja kuu dallua si një luftëtar me tipare të veçnata trimërie. Por fill mbas përpjekjeve dhe lëvizjeve të para të kryengritjeve pér

pavarësi, ai u përfshi së bashku me luftëtarët e tij në këto lëvizje dhe ju kushton tërësisht revolucionit për pavarësi. Në vitet 1820 dhe 1821 ai mori pjesë në betejat kryesore kundër ushtrive turke në Peloponez dhe në Greqinë kontinentale. Po këtë vit ai u caktua edhe komandant i tërë forcave kryengritëse për Greqinë Lindore. Ai organizoi dhe përpiloi planet e luftimeve për shumë beteja të rëndësishme që u zhvilluan kundër forcave turke, pro sidomos zgjidhja me zgjuarësi që ai projektoi me kapetanët e tjerë në betejën e ashpër dhe të lavdishme të Mesolongjit e ngriti atë në radhën e ushtarakeve dhe luftëtarëve më në zë. Odise Andrucua mbetet një nga herojtë e betejës se ashpër të Grabjes dhe e miaft betejave të tjera të rëndësishme që përcaktuan rrjedhjen e mëtejshme të revolucionit.

Gjatë viteve të kryengritjes së madhe ai nxiti dhe tërroqi pranë vehtes për interesat e pavarësisë mjaft komitë të njojur si Panurjas, kapetanin e njojur Athanas Dhjakon, Panadrea, Gurra, etj. Aq të forta ishin lidhjet e tij me ta sa kur Gurra u kap në një përlleshje nga turqit, Odesea kapi dy ushtarakë të lartë turq të cilët i përdori me kushtin e lirimit të Gurrës. Odesea ishte aktiv deri në fund të revolucionit dhe mori pjesë në frontet e para të luftimeve deri në pavarësinë e plotë të vendit. Mbas fitores së revolucionit, më 1825, Andrucua u arrestua dhe u mbull në burgun e akropolit në Athinë. Në vitin 1825 ai u pushkatua... Megjithatë në altarin dhe panteonin e lirisë së Greqisë figura e Andruco renditet ndër të parat.

Ali Farmaqi është një ndër udhëheqësit luftëtarë të tjerë arvanitë të Peloponezit që renditet në radhën e herojve të revolucionit për pavarësinë e Greqisë. Ishte nga krahina e njojur e Lalës të banuar nga arvanitë dhe e dalluar në traditat e saj luftarake kundër pushtuesve osmanë. Tradicionalisht familja e tij ishte dalluar për luftëtarët dhe komitet e njojur qe kishte nxjerrë. Vetë Aliu ishte që fëmijë shëndetlig dhe i tillë ai mbeti deri në frymëmarrjen e fundit, megjithatë qysh në rini iu përkushtua luftës kundër pushtuesit.

Familja e tij kishte lidhje të hershme vllamërie me të parët e Teodor Kollokotronit.

Kishte një çetë me luftëtarë arvanitë të cilët qarkullonin neper territoret e Peloponezit duke goditur perherë njësitë turke. Edhe atëherë kur operacionet ushtarake turke, të komanduara nga Veli Pasha arritën të nënshtrojnë dhe thyejnë qendresën e çetave komite të Peloponezit, Aliu me luftëtarët e tij u ndesh në disa raste me këto reparte por nuk u nënshtrua. Edhe më 1809 kur ishte shpallur nga ky pasha se Peloponezi ishte nënshtruar, Ali Farmaqi me çetën e tij vazhdonte përpjekjet dhe luftimet pa u tërhequr. Organizoi një sërë betejash të suksesshme edhe me luftëtarin e njohur Kollokotronin. Të dy së bashku ideuan dhe shpallën krijimin e një mbretërie greko-shqiptare të Peloponezit. Për ketë ata bënë përpjekje që të tërhiqnin edhe ndihmën e fuqive europjane dhe kryesisht të Francës. Të dy së bashku takuan në Korfuz përfaqësuesit e Francës dhe i parashtruar atij idenë e kryengritjes së përgjithshme ne Peloponez. Francezët ranië dakort edhe me ndihmën që ata duhet t'u jepnin, por rekuilisja e shpejtë e ngjarjeve dhe largimi i francezëve nga këto anë, bënë që plani i tyre të mos realizohej. Në projektet e Kollokotronit dhe të Farmaqit parashikohej që qeveria e Peloponezit të përbëhej nga 12 përfaqësues arvanitë dhe 12 greke.

Ali Farmaqi vdiq në agimin e atyre viteve të cilët trokisinin në pragun e kryengritjes së madhe. Ai u qa dhe u varros nga arvanitët ortodoksë dhe muslimanë të Lalës dhe të krahinave të tjera të Peloponezit. Megjithëse, në atë kohë Kollokotroni ishte në ilegalitet me çetën e tij të luftëtarëve dhe ndiqej nga forcat turke, ai shkoi dhe e qau vëllanë e tij në shtëpi kur i bëheshin homazhet e fundit. Pra, Kollokotroni e qau Ali Farmaqin, ashtu sikurse Ali Farmaqi i kishte kënduar atij në çastet më të vështira të jetës, kur ishte rrethuar nga forcat turke...Kënga popullore thotë:

*Gjithë bota le të thonë
Se se jap Kollokotronë*

Jan Ali Farmaqi u

Që shpje gjakun gjer në gju.

Një tjetër hero i revolucionit të vitit 1821 për pavarësi dhe jo vetëm kaq por një nga udhëheqësit e tij është edhe Kosta Kanari. Deri pak vite më parë. Kanari njihej dhe vlerësohej si arvanit nga ujdhesa e Psarës. Ai mori pjesë që në moshë të re si luftëtar në Çetat e kleftëve. Me fillimet e para të përpjekjeve për organizimin e një kryengritje të armatosur, ai u vu në krye të tyre dhe i qëndroi besnik deri në fund idësë për pavarësinë e vendit. Mori pjesë në betejat më kryesore në Greqinë kontinentale, por u dallua veçanërisht si detar dhe luftëtar i shquar në betejat kundër flotës turke. Ishte komandant i njësive të anijeve të vogla të luftëtarëve, të cilat godisnin në befasi apo digjinin anijet e flotës turke. Në një betejë të tillë vetë Kosta i ka vënë zjarrin anijes së admiralit të flotës turke dhe të nënadmiralit ku gjetën vdekjen rreth 2300 ushtarë turq. Me anijet e vogla të kryengritësve para, në prag dhe gjatë revolucionit, Kanari përshkoi pothuaj tërë brigjet e Egjeut dhe të Jonit deri në ujrat e detit të Zi duke ndjekur dhe goditur anijet e flotës turke. Përballimi i forcës goditëse të ushtrisë së Portës nga ana e detit dhe neutralizimi në një shkallë të konsiderueshme i misioneve të saj kundër kryengritësve, i dedikohet kryesisht operacioneve të suksesshme të këtij luftëtarri, i.cili thirrej nga populli dhe ka hyrë në histori me emrin "admirali". Ndërsa admirali frances De la Gravie e ka vlerësuar atë si një nga burrat më të zot që përmend historia e kohëve tona".¹⁾

Por, për figurën e këtij heroi legjendar të detit dhe njërit prej udhëheqësve të revolucionit është me interes të qëndrojmë pak dhe t'i rikthehem problemi të origjinës së tij. Ndërsa historia kishte montuar në rrjedhat e saj origjinën nga Psara të Kanarit, pak vite më parë disa fakte të reja jo vetëm tronditën por rrëzuan tërësisht pretendimin e së kaluarës.

1. Dh.Grillo: "Arvanitet dhe shqiptarët në luften clirimtare të popullit grek", faqe 167

Historiani grek D.Gatopoulos, të cilit ju lejua për herë të parë të hapë dhe publikojë vetëm një pjese të vogël të ditarit dhe shënimeve personale të Kanarit, bëri të njojur dhe shpalli se Kanari nuk është nga Psara, por ai është i lindur dhe rritur në Pargë-Çamëri. Jo vetëm kaq por historjani grek publikoi edhe disa pasazhe të nxjerra nga shënimet personale të Kanarit. Në to përmendet rasti kur ai së bashku me mikun e tij Aristotel Valaoriti, në vitin 1863 duke shkuar për në Kopenhangë për të marrë dhe vendosur në fron princi danez Xhorxh, ndaluan në qytezën e Pargës. "Valaoriti dhe unë - shënon në kujtimet e tij Kanari, - zbritëm dhe u drejtuam të vizitonim shtëpitë tona prindërore këtu në Pargë. Kështu, filluam t'u ngjitemi rrugëve të përpjekta të shtruara në kaldrëm duke kujtuar fëmijérinë tonë dhe përpjekjet e panënshtruara që patën bërë të parët tanë nëpër shekuj..."¹

Në këtë rast për ne korigimi i historisë është i vogël, - origjina e Kanarit nga arvanit kthehet në shqiptar prej qytezës e bukur bregdetare të Pargës. Nuk dimë se ç'gjëra të tjera me vlerë përbledh dokumentacioni i gjerë personal dhe i fmailjes së Kanarit, mbi rrënjet dhe të parët, ç'fakte historike me vlerë për shqiptarët e këtyre anëve fshihen në to...?! Ato nuk janë lejuar të hapen dhe në këtë mënyrë nuk mund as të paragjykojmë dhe as të hamendejojmë, por një gjë mund të themi me siguri që ky mund të jetë dokumentacion i gjerë arkival i breznive të një familjeje shqiptare nga krahinat më jugore të kësaj popullsie. Le të presim se një ditë ky dokumentacion do të shfletohet para nesh dhe ne do të mësojmë gjëra me interes për familjen shqiptare Kanari nga Parga dhe për heroin e pavarësisë Kosta, për bëmat dhe trimëritë e të cilit shkroi edhe shkrimitari i madh francez Hygoi.

Një tjetër detar i tmerrshëm, që renditet në radhën e herojve të luftës së madhe për pavarësinë e Greqisë është

1. *Enqiklop Greece - History, Folklor - Athinë 1985 - Vëll.I, Fq 301*

edhe arvaniti nga Hidra, Andrea Mjauli. Lindi në këtë ishull të banuar kryesisht nga arvanitë. Që në rini u muar me detarinë dhe më pas u reshtua krahas komitëve dhe luftëtarëve të dëgjuar që luftonin kundër pushtuesve osmanë. Anijet dhe luftëtarët e tij u shquan në operacionet e suksesshme kundër flotës osmane. Në fillim të revolucionit ai u bë komandant i flotës kryengritëse të Hidrës. Mori pjesë në betejën e Mesollongjit duke mbështetur kryengritësit e rrrethuar nga deti. Gjatë viteve të revolucionit komandoi dhe mori pjesë drejtëpërdrejt në disa beteja detare kundër flotës turke dhe egjiptiane duke u shkaktuar dëme të mëdha atyre. Veçanërisht beteja detare e Navarinos ishte ajo që ngriti lart emrin e tij.

Numri i herojeve arvanitë në revolucionin për pavarësinë e Greqisë është natyrisht tepër i madh. Mund, gjaku, përpjekjet dhe vetmohimi i tyre shtrihet dhe gjendet në çdo pëllëmbë të tokës greke. Bëmat dhe kontributi i tyre eshtë mpleksur fort me atë vend dhe me historinë e tij ashtu sikurse dhe kjo diasporë e hershme historike, është natyralizuar në atë vend. Në se përmenden vetëm pak figura në radhën e shumë prej atyre që renditën në listën e herojeve të revolucionit, duhet thënë se krah tyre qëndrojnë me qindra dhe mijra luftëtarë arvanitë të thjeshtë, të njohur apo anonimë që derdhën gjakun e tyre.

Të kjo ngjarje e madhe historike protagonistë kanë qenë dhe shqiptarët nga krahinat jugore, lindore, perëndimore dhe deri veriore të Shqipërisë. Në listat dhe dokumentet historike të kohës në betejën që u bë simbol i qëndresës dhe revolucionit grek atë të Mesollongjit, evidencohet një numur mjaft i madh luftëtarësh shqiptarë nga të gjitha anët e Shqipërisë, duke filluar nga Çamëria e deri në Shkodër e Korçë. Aq i madh është ky numur sa, nuk do të shtonim aspak po të pohonim se numri dominues i luftëtarëve ka qenë nga ky vend. Rreth 500 vetë kanë qenë vetëm nga krahinat jugore të Shqipërisë nga Gjirokastra, Përmeti, Këlcyra, Kolonja, Korça, Vithkuqi, Voskopojë, Vlora, Himara.

Veç këtyre ka një numur luftëtarësh të tjerë nga Dibra, Kuksi dhe mjaft nga Shkodra. Një numur nizamesh të turkut të cilët ishin nga vise të ndryshme të Shqipërisë në betejën e Mesolongjit dhe në beteja të tjera u bashkuan me forcat kryengritëse duke braktisur repartet e tyre ku ata shërbenin. Shpesh gjatë këtyre viteve kur nizame shqiptare që formonin reparte të tëra në ushtrinë turke, mësonin se përballë tyre ishin luftëtarë arvanitë ata lidheshin me ta braktisin llogoret dhe renditeshin në barikada të përbashkëta. Jo rallë ka ndodhur që ata kanë komunikuar në shqip me njëri tjetrin dhe bashkërisht kanë ndërprerë zjarrin e luftës mes tyre. Aq të shumta kanë qenë dezertimet apo bashkimi i njësive turke të përbëra nga nizame shqiptarë me forcat kryengritëse, sa vetë porta urhdëronte që të largoheshin menjëherë ato dhe të goditeshin për dëmet e mëdha që po i binin ushtrisë osmane.

Në këtë përbledhje nuk futëm as kontributin e jashtzakonshëm të shqiptarëve suljotë dhe të kapedanëve të përndritur të tyre të cilët bënë vërtet një epokë te lavdishme në historinë e kësaj treve legjendare të Arbërisë jugore. Heroi i Mesolongjit Marko Boçari, Boçarajt e tjerë Kiço, Foti e Dhespo Boçari, dera e Xhavelljave, Fotua, Kiçua, Llambra, etj. Janë heroj që renditen në panteonin e lirisë për pavarësinë e Greqisë. Përkrah tyre renditen edhe herojtë Jorgo Drakua, Llambro Vejkua, Joti Dangëllia, etj. Ata janë të shumtë dhe siç thotë Bajroni ata janë shqiptarë që vijnë nga derë heroish.

Studjesi i talentuar dhe apasionuar arvanit Jorgo Maruga duke iu referuar kontributit të madh të arvanitëve në këtë revolucion dhe kryesisht të vendbanimeve arvatie rrëth Athinës bën të njojur; "Arvanitë rraca më e guximshme dhe më trime... kudo ku ata ishin Hidriotet, Speciotet, Kundurjet, Miauli, Bubulina, Kryezoti... Në pragun e revolucionit Elefsina nxori komandantin arvanit Jani Haxhimeleti, që ngriti në revolucion Megariden, Kundura nxori Dhimitër Kryekuqin, Perahora nxori Haxhimelet Rata, Kundura nxori gjeneral Thanas Laskën, Vila nxoti Thanas Kryemadhin, fshati Shkurta

nxorri Thanas Shkurtanjotin, Menidhi nxori Mitro Çeven, Hosaja nxori Melet Vasiliun...

Këta kryengritës shpërthyen të parët me të marrë sinjalin e revolucionit më 26 prill, kundër garnizoneve turke që ruanin Athinën. Ata formuan formacionin e madh kryengritës të përbërë nga 12000 vetë. Haxhimeleti ishte këtu komandanti i parë i Athinës.¹⁾

Në territoret e tjera, "në Trifilia udhëheqesi i kryengritjes përpavarësi ishte arvaniti trim dhe besnik Janaq Kerxhaliu...²⁾ Në ishullin e Andros komandanti i forcave kryengritëse me 150 luftëtarë ishte përsëri arvaniti Dhimitër Balli siç ishin arvanitë të gjithë luftëtarët e njësisë së tij.³⁾

Duke filluar studimin e tij mbi kontributin e arvanitëve në revolucionin përpavarësi, studjuesi i talentuar Jorgo Maruga nga Elefsina pyet:

"Çfarë i detyrohet Greqia arvanitëve?

Ju detyrohet, guxon të them - Lirinë e saj!⁴⁾

Dhe nëse me keto fjalë mund të përbledhim atë kontribut të madh që dha kjo rracë e papërkulur për Greqinë, me fjalët e Guvernatorit të parë të shtetit të athershëm të pas revolucionit (Proistamenos tis Eliniqis Politias) Dhimitër K.Ipsilanti, që përshëndeste fitoren e madhe të Greqisë, do të përbledhim atë kontribut të madh që dhanë shqiptarët në këtë epope: "Burra, luftëtarëve besnikë, komendantëve Ago Vasjari, Çeko Bei, Myrto Çali, Tahir Abazi, Sulejman Meto dhe Toskëve të tjerë... Ju drejtohem ju burra të toskërisë që shpirti juaj i madh s'ka asgjë të përbashkët me shpirtvogëlsinë e lindorëve, as me skithet e palavdishëm. Ju jeni pasardhës të stërgjyshëve tanë dhe herojtë e vërtetë të ditëve tona. Ju qëndruat pranë nesh në betejat për liri, prandaj ne ju konsiderojmë ju vëllezërit tanë..."⁵⁾

1. J. Maruga; *Kontributi i arvan. të Elefs...*, faqe 6

2. V. Stavropulos; "Janaq Kexhali..", Faqe 278

3. J. Psara: "O Ilias", f.94

4. J. Maruga: Po aty, faqe 1

5. M. Lambrinidhi; "I allvani en Eladha", faqe 86

TRADITAT DHE KULTURA E ARVANITEVE NE DITET TONA

Kështu zbritën nëpër hullitë e shekujve deri në ditët tona arvanitët, përmes tërë stuhive politike, ekonomike, kulturore e sociale duke qenë edhe objekt edhe subjekt tepër aktivë i tyre. Kjo popullsi vitale derdhi energji, vlera dhe tiparet e sajt është veçanta kombëtare në atë vend dhe natyrisht mori shumë nga bota greke ku jeton dhe pjesë e së cilës është. Megjithë përmasat kontributin dhe shkallën e ndikimit të saj në thesarin e artit, filozofisë dhe kulturës botërore, fare pranë saj, madje deri brenda saj, magjia helenike nuk mundi të asimilojë këtë emigracion të fuqishëm mesjetar që zbriti nëpër terrenet e saj nga Arbëria - që sot thirret arvanit.

Edhe sot e kësaj dite në një numur mjaft të madh krahinash dhe fshatarësh të Athinës, Mesogjis, Beotisë, Eubesë, Megarites, Korinthit, Peloponezit etj, banorët arvanitë të tyre flasin gjuhën shqipe. padyshim makineria asimiluese, veçanërisht ketë shekull, ka vepruar shumë më tepër për kufizimin e tipareve kombëtare të kësaj popullsie, e veçanërisht të gjuhës së saj. Neglizhenca, përcëmimi apo presionet për të penguar kultivimin dhe mësimin e gjuhës të të parëve, mungesa e literaturës në gjuhën autentike, trysnia e vazhdueshme e botës dhe e kulturës greke, ndjeshmëria dhe presionet për të mohuar të vërtetat historike për origjinën dhe gjuhën e tyre, janë faktorët që ndihmojnë procesin e asimilimit gjuhësor dhe kulturor në tërsi të arvanitëve. "Kjo pjesë e neohelenizmit që ka si gjuhë të perditshme atë arvanitase luajti rolin kryesor në krijimin e këtij shteti ku jetojmë sot sa nga pikpamja ushtarake aq edhe ekonomike. Atëhere pse evidencohen ë plane të para pjesë të tjera të popullsisë? - shkruan në një artikull të tij në gazeten Ethnos, gazetari Vasili Rafailidhi dhe shton, - Fallmerajeri i cili i simpatizonte shumë arvaitet shkruante se: - revolucioni grek

është në të vërtetë vepër e arvanitëve. Bile në shtetin që u krijuar menjëherë mbas 1821 të Kapodistrias dhe Othonit, pothuajse shumica e banorëve flisnin gjuhën arvanitase... Me kalimin e dhjetravjeçarëve arvanitët u bindën, ose u detyruan të binden, se e vërteta eshtë se "u bindën", se duhej të braktisnin gjuhën e tyre në se dëhsironin të bëheshin pasardhës të vërtetë të grekëve të lashtë dhe qytetarë të denjë të shtetit grek.

Ky sulm ishte frontal dhe në të gjithë nivelet. Ndryshuan emrat e fshatarëve. Kështu Kokla u bë Platea; Parapugja u bë Lefktra; Braçi u bë Tanagra... dhe Darimari u bë Dafni. Ndryshuan pra emëritimet e vendeve toponimia. Edhe mësuesit i ndiqnin fëmijët të mësonin arvanitika. Po ashtu arvanitët me "kulturë" - nëpunësit, redingotatanxhijtë i këshillonin fshatarët e tyre të mos u mësonin fëmijëve të tyre gjuhën arvanitë".¹⁾

Procesi i asimilimit veçanërisht ai gjuhësor ka qenë më tepër aktiv dekadat e fundit. Aq i fuqishëm ka qenë ai sa po të shohim dëshmitë që vijnë nga shekulli i kaluar apo fillimet e këtij shekulli me ato çka shohim dhe gjemjë sot padyshim çdonjëri do të ndjente dhimbje dhe në të njëjtën kohë mosbesim...

Miku dhe bashkëudhëtarë i Bajronit, Hobhauz duke kaluar në vitin 1809 nëpër fshatrat rreth Athinës, Atikë dhe më tej në Beoti-Livadhja shënon: "Ka shumë nga banorët e krahinave të Livadhjasë -Beoti dhe të Atikës - rreth Athinës, të cilët nuk flasin gjuhë tjetër veç gjuhës së tyre shqipe... gjuha qe përdorin këta fshatarë eshtë një dialekt i shqipes që flitet nga shqiptarët e Epit... Unë vetë u sigurova se shumë prej tyre nuk dinin të flisnin greqisht"²⁾ Ndërsa konsulli i njohur anglez Martin Leak, i cili qendroi për shumë vite pranë Ali Pashës, i cili kish shkelur në këto territorë për shumë kohë

1. *Gazeta "Ethnos"*, Vasili Rafailidhi: "Zbritja e shqiptarëve dhe soli... i tyre në krijimin e shtetit grek", 17.5.87
2. I.H. Pullu: "I epiqisis ton allvanon en Korinthia", Fq 92-93

dhe në disa raste na ban të njohur: "... edhe në Beoti apo në Greqinë e jugut apo në krahina të tjera shqiptarët kanë vendbanimet e tyre. Nuk besoj të ketë ndonjë fshatar shqiptar arvanitas që të dijë të flasë ndonjë gjuhë tjetër veç shqipes"¹⁾

Studjesi grek i fundit të shekullit të kaluar, K. Amantinos duke na folur për gjuhën shqipe të folur ndër arvanitët dhe fenomenin e rezistencës së saj para forcës asimiluese të botël helenike konkludon: "Pse nuk u asimiluan shqiptarët e Greqisë nga pikpamja gjuhësore?

-Gjuha greke është e vështirë përpara thjeshtësisë së shqipes,

-Shqiptari "pagdhendur" nuk çante kokën përtë mësuar gjuhën greke.

-mungesa e një imponimi shtetëror për mësimin e detyrueshëm të gjuhës greke,

-Vendosja e tyre në zona e vendkalime të pakalueshme, është e vëçuar nga popullsia vendase pa pasur lidhje zonore e gjelteve që larg çdo ndikimi kulturor e

Pamundur i analizat fenomeneve gjuhësore apo të tipant rezistençë shqipes para procesit apo proceseve asimiluese, ne sa ngrihen në këtë projekt platforme për shkuarjen e shqipes, mund të themi se:

-Gjuha shqipe nuk është më e thjeshtë nga gregishtja, siç pretendon studjesi grek, as në pikpamje të strukturave të saj, rrugëllat gramatikore, fonetike, etj.... ajo është vërtet më e thjeshtë për arvanitën mbasi është gjuha e nënës së tij.

Krahas të tjera, më lart kemi përmendur edhe një numur arsyesh të tjera të cilat e bënë rezistente dhe të qendrueshme këtë element para asimilimit siç janë faktoret kulturore dhe kombëtare, por duke vazhduar vetë Amantinos na ndihmon duke na dhënë edhe argumenta të tjera të cilat

1. M. Leak: "Travels in northern Greece, Albania", London 1853, V.II, F.67

2. K. Amantinos: "I vori gjitoni tis Eladhas", Athina 1923, F.183

i gjen në realitetin grek. Ai na bën të njohur se - kolonitë shqiptare (arvanite) në këto anë u vendosën në grupe të mëdha e zona të vështira, larg qendrave të zhvilluara urbane.

- Sa përmungesën e një imponimi shtetëror të mësimit të detyruar të gjuhës greke, që pretendon Amantinos, - do të thoshim se ndoshta do të sithe me vend të thuhej e kundërtë, se ka mugnesë të një përkujdesjeje shtetërore qoftë edhe minimale për të ruajtur gjuhën e saj kjo pjesë e popullsisë së Greqisë. Kjo përkujdesje nuk është aspak privilegji por një e drejtë minimale dhe elementare që duhet ta gjeljnë arvanitët, në emër të normave të botës së qytetëruar.

Megjithë vështirësitë dhe fenomenet erozive të asimilimit, shqipja tek arvanitët vazhdon të jetojë. Studjuesi A.Kolia veren; "Po a janë arvanitët e Atiko-Beotisë, të Lokrides, të Eubesë, të Korinthisë, të Ahaisë, të ishuje të Saronikut, të Hidrës, të Specias, të Argolidhes dhe të Mesinisë, pa iu referuar atyre të Greqisë veriore, - arvanitët e sotëm?... Çeva thotë: "Eshtë e ditur se gjatë luftës kombëtare për pavarësinë e Greqisë dhe pas saj deri në vitet 1880 në gjithë Atikën përveç qytetit Megara dhe të vetë Athinës flitej gjuha shqipe dhe vetëm shumë pak njerëz dinin dhe flisnin greqishten. Gjithashtu në krhainën e t'ebes përveç qyte tit të Thivës dhe të periferisë së Pyrit flitej gjuha shqipe dhe shumë pak flisnin greqishten... - por ja që si përinat të Çevas arvanitët e Atiko - Beotisë (nuk flisnin vetëm me 1880 shqip) vazhdojnë të flasin edhe sot e kësaj ditë gjuhën e tyre shqipe..."¹⁾

Por, në se për shekullin e kalaur dhe deri vitet e para të këtij shekulli kemi pohime përgjuhën e folur se sa ajo ishte e përhapru deri ku shtrihej studime të majtueshme përfolklorin, tiparet, zakonet, etj. sot ato janë të kufizuara ose mungojnë plotësisht.

Burimet dhe institucionet zyrtare apo shkencore qëndrojnë të heshtura plotësisht në këtë çeshtje. Në këtë

1. A.Kolia: "Arvanitët i dori tu neoteru elenismi", faqe 154

rast, për të plotësuar këtë mungesë do të biem ato të dhëna që kemi konstatuar vetë në mënyrët e drejtpërdrejtë gjatë viteve që kemi qëndruar në atë vend dhe konstatimet tonë të drejtpërdrejtë nga udhëtimet dhe bisedat e drejtpërdrejtë me këta njerëz. Pa dashur të futemi në tërë listat e vendbanimeve një për një, mbasi ato janë të shumtë, mund të themi se me përjashtim të zonave e vëndbanimeve të mëdha siç janë Athina, Pireu, etj. pjesa dërrmuese e fshatarëve të Atikës dhe Mesogjios deri në pikën më jugore të pjesës gadishullore, me përjashtime, fshatrat e këtyre anëve janë të banuar nga arvanitë në të cilat ku më shumë e ku më pak flitet gjuha arvanite. Padyshim që ka edhe fshatra ku gjuha është duke humbur.

Në Hasja, Në kuç, Në Mandra, në Avlona, në Mallakasa (Mallakastra i thonë vendasit), në Inofita, në Kapandriti, në Spata, në Palini, fshatrat rreth Thivës, në Beoti, ato rreth Livadhjasë, Qiparisja, Hosja, etj. në zonën e Korinthit deri poshtë në Nafplio, rreth Lutraqit, në zonën veriore të Peloponezit, në Qato, rrugës për Ksillokastro, rreth Patrës, fshatrat e Ahaisë, në zonën jugperëndimore rreth Methonit dhe Koronit e territorë të tjera të Peloponezit, gjithë fshatrat rreth halqidhës, në Eubenë qëndrore e jugore e shumë e shumë të tjera, krhaina e fshatra. Në dhjetra e dheiTRA fshatra të këtyre krahinave kemi kontaktuar drejtpërsëdrejti banorët e tyre arvanitë dhe kemi folur me ta, kemi miq për të cilët ruajmë respektin e thellë,

Fshatrat e arvanitëve jo vetëm që mbulojnë zona të tëra por ato vijnë deri në dyert e qyte tit të Athinës dhe e rrethojnë atë ngado. Jo vetëm kaq por edhe ato pjesë të vetë qytetit që tanimë janë lagje të tij, për shkak të vetë shtrirjes në përmasa që ka marrë ai kanë qenë fshatra arvanitë. Kështu, lagjia "Varri", dikur bile deri aty nga vitet 1965, ka qenë fshat arvanit me të njëjtin emër. Po kështu "Qifisja-ja", "Menidhi", "Kamateruja", "Dafni", etj. Edhe vetë lagjia më e njojur dhe më e vjetër, rrëzë Akropolit që thirret lagjia "Plakë" ka qenë e banuar nga arvanitë. Studjuesi A. Kolias na bën te njojur

për të: "Arvanitët e aprë që janë traditat e tyre të vjetra dhe ju nënshtruan ndryshimit të karakterit, tipareve të tyre janë arvanitët e Atikës dhe Ahaisë. Por, megjithatë mbeti deri para pak vitesh kujtimi i vajzave të ashpra dhe të bukura dhe krenare të lagjes "Plakë" - shqiptare... "Plaka", kjo lagje e shumëkënduar e Akropolti ishte deri para pak vitesh një lagje thjesht arvanite. nga plakjotët e vjetër arvanitë, pak pasardhës të tyre jetojnë edhe sot atje.

Mosasimilin e arvanitëve do ta shohim tek "plakjotët" dhe "plakjotat" shqitpare të famshme që ju kënduan jo vetëm për bukurinë e tyre por edhe për krenarinë e tyre. Ishte një ishull i vogël brenda një pellgu të huaj për 150 vjet. Tani tregtarët e të gjitha llojeve zaptuan edhe lagjen "Plakë" dhe është e sigurt se do të rënnon edhe vetë Akropolin që të ndërtonin hotele tregtare e turistike"¹⁾

Nga kontaktet dhe bisedat e drejtpërdrejta me shumë arvanitë të zonave dhe krahinave të ndryshme kudo në biseda me ta ndjejnë habinë që ata çfaqnin kur shikonin se flisin një gjuhë dhe që kuptoheshin fare mirë me ne. Aq e madhe ishte habia për ta në ndonjë rast, sa megjithëse bashkarisht kishim folur gjatë e për minrua të tëra lirshëm, ata përsëri të emocionaur më pyesnin; - po na kuptove fare mirë na!!!

Masa e njerëzve të thjeshtë që banojnë nëpër fshatra, dhe kjo masë përbën shumicën e tyre që e njohim dhe e flasin gjuhën, dinë fare pak për origjinën e tyre të largët. Kanë mësuar atë që dikur kanë zbritur nga vendi ynë, dinë që me shqiptarët kanë një gjuhë të përbashkët dhe asgjë më shumë. Brenda kësaj mase njerëzish ka edhe syresh të veçantë që nuk kanë pasur kurrë informacion për të kaluarën dhe gjuhën e tyre. Më kujtohet një rast i tillë që mund të ketë genë i dyti apo i treti në qindra e qindra biseda e kontakte me arvanitë, aty nga viti 1987. Shkoja me fëmijën tim në një

1. Aristidhi Klias: "Arvanites i dori tu neoteru...", Faqe 315-316

rrugë kodrinore të pyllëzuar drejt Koropisë. Ndaluam diku në një anë rruge për të blerë tek një fshatar që shiste fruta. Fëmija më foli në shqip se nuk donte mollë por dardhë,

Fshatari u hutua, la peshimin dhe filloi të dëgjojë bisedën e fëmijës tim me mua. Ashtu si i çorjentuar u drejtua nga unë dhe më tha:

- Të të rrojë, të të rrojë çé ka pësuar kaqë mirë gjuhën ténë...!!!

Po ka çvën i Atiqisë je?!

- Jo - i thashë, nuk jam nga Greqia, jam i huaj nga Shqipëria.

- Nga Allvania? Po ku e ke mësuar ti dhe fëmija it gjuhën ténë?

- Po kjo është gjuha e jonë, - i thashë dhe e sqarova mandej shkurtimisht. Ai bmeti i hutuar dhe tepër i befasuar. Me emocion më pyeti edhe disa gjëra të tjera rreth problemit dhe në fund më tha: - ...domethënë ne kemi një gjak dhe një gjuhë. O perëndi! - Puthi fëmijën tim i mallengjyer dhe u ndamë...

Sic përmend edhe më sipër këto janë raste të pakta dhe nuk përbëjnë të përgjithshmen. Masa dërmuese njeh mirë rrugën e ardhjes. Është krenare për origjinën e saj, etj. Këtu nuk flitet as për intelektualët e shumë të kësaj pjese të popullsisë, për kohëributin e tyre të shkëlqyer në kërkimin, grumbullimin dhe ekspozimin e vlerave të kësaj pjese të popullsisë së Greqisë.

Sa nga vlerësimet e studjuesve të huaj, të shekullit të kalaur apo të mëvonë si Hobhaus, Hahn, Fallmerajet, Reinhold, Çabej, etj. po aq edhe nga bisedat e drejtpërdrejta që mund të bëjë çdokush mund të konstatojë se ata flasin një gjuhë që i takon dialektit të jugut që njohim sot. Pra ata përdorin të njëjtën gjuhë që flet një 60-70 vjeçar nga jugu i Shqipërisë. Kuptohet, që në gjuhën e tyre gjen huazime greke për ato fjalë që shqipja nuk i ka pasur për vete zhvillimet në ato vite të mesjetës, kur kjo pjesë e popullsisë së arbërit zbriste në teritorët greke. Megjithatë, për shkak të

informacionit të pakët dhe të kontakteve të ralla, shpesh është menduar se arvanitët dhe gjuha e tyre duhet të jetë alrguar shumë gna gjuha e sotme shqipe. Por, e vërteta është krejt ndryshe. Me masën e gjërë të tyre mund të komunikosh shumë lirshëm dhe pa pengesë, bile të bën përshtypje se sa ndryshime të vogla ka pësuar gjuha e sotme shqipe nga ajo gjuhë që është përdorur tek ne në mesjetë, në shekujt e 14-15 kur kjo masë e populsisë së Arbërisë u largua prej këtu. Kuptohet që edhe gjuha shqipe e arvanitëve ka pësuar evoluime por padyshim që ato kanë qenë shumë më të vogla e të pandjeshme në raport me ato që kanë shoqëruar gjuhën shqipe në trojet tona.

Ndër hulumtimet dhe studimet e para dhe të ralla mbi gjuhën shqipe të arvanitëve mund të përmendim "Studimi i parë linguistik, pak i njojur nga albanologët i shkruar nga P.Kupitoris nga Hidra, mbi dialektin greko shqiptar të arvaniteve te Hidrës dhe përemrin vetor të vetes së tretë. Punimin më të plotë e ka shkruar P.Furiqis nga Salamina (arvanit edhe ky) redaktor i Qendrës së Fjalorit Historik Neogrek, - mbi dialektin greko-shqiptar të Atikës..." "...Teksti i parë i botuar në dialektin greko-shqiptar (gjuhën shqipe që përdorin arvanitët - shën.) është një përkthim anonim i ungjillit të Shën Mateut nxjerrë në Korfuz me 1824. Ndërsa në vitin 1827 u shtyp po këtu në Korfuz i tërë testamenti i Ri i përkthyer në shqip. Gjuha e këtyre teksteve të cilat pësuan korigjime shpejt nga redaktori Gregor - peshkop i Eubesë (që padyshim duhet të ketë qenë arvanit) është dialekt tosk, por me forma të dialektit arvanit... Me gjithë greqishtëzimet e shumta që ndeshen në këtë përkthim vepra ka ndikaur thellësisht në studimet shqiptare..."¹⁾ Më 1860 në Lamia doli një gazetë e quajtur "Pelasgios qe Fthiotis" nën drejtimin e A.Pikeos në të cilin u botuan shumë artikuj në gjuhën arvanitëve.

A.Kullurjotis dhe T.Evangelidhis mblohdhën këngë të

1. *Tito Johala: Studime albanologjike në Greqi, Fq 7-11*

dialektit të Hidrës. C.Sotiriu mblodhi me gjuhë të pastër folklor të Specias dhe Markopullos. Por ai që mblodhi në menyre sistematike, të studjuar dhe intesivisht folklorin e disa zonave të popullsisë arvanite, përrallat, këngët, fjalët e urta, etj ishte Petro Furiqi i cili mblodhi këto thesare në fshatrat Salamina, Lopesi, Spata, Koropi, Markopullo, Kalivia, Kryekuqi, Vila dhe Menidhi.

Fragmente me këngë popullore arvanite kanë mbledhur e bctuar më vonë edhe autorë të tjerë. Kështu, Anton Kanakaris botoi më 1961 "Litari i artë" ku prezantonte këngë te grumbulluara në fshatrat arvanite të Eubesë. Permbledhje te kesaj natyre botuan edhe Jani Gjika e Vllasis Mastrokostas.

Studime më të fundit për gjuhën folklorin dhe traditat e tyre janë punuar nga disa autorë të cilët vazhdojnë të punojnë me pasion në hulumtimin e thesarit arvanit. Të tillë janë studjuesi i palodhur Aristidh Kolia i cili ka botuar dhe vazhdon të punojë për botimin e një numri tjetër materialesh me vlera historike e shkencore për arvanitët. Botimi i tij "Arvanitet dhe origjina e grekëve", "Gjuha e perëndive", drejton shoqérinë e arvanitëve "Marko Boçari" dhe boton periodikun - revistë "Besa" e cila përbledh në faqet e saj këngë, fjalë të urta, përrallëza, zakone, tradita, shkrime për personalitete dhe kontributin e arvanitëve në historinë e Gregisë, etj.

Vangjel Lapi është një studjues i apasionuar e i palodhur i folklorit arvanit ka botuar dy përbledhje me këngë dhe fjalet e urta të banorëve arvanitë të zonave të Salaminës dhe Megaridhës. Boton periodikisht edhe në revistën "Besa" shkrime të këtij karakteri.

Thanas Moraiti - mbledhës dhe përpunuues i talentuar i këngës arvanite. Një djale me pasion dhe shpirt të madh artisti. Ka mbledhur këngët e zonave të ndryshme. Me një shije të hollë dhe virtuzitet ka përpunuuar mjaft këngë. Orkestrina e tij e cila mbështetet tek instrumentet e traditës ka krijuar një botë interesante dhe të këndshme muzikale. Ka botuar diskun e tij të parë me këtë këngë të përpunuara

arvanite dhe interpretuara me mjeshtëri; të titulluar "Ta arvanitika".

Jona Mike Paidhusi të cilën do ta vlerësoja si një bletë të urtë dhe të palodhur. Megjithë moshën e thyer të saj mbas botimit të librit "Fshati Vile i Qitheronës dhe këngët arvanite të tyre", përgatit për botim një tjetër libër mbi arvanitët, kulturën, gjuhën dhe traditat e tyre.

Krah tyre mund të renditen edhe mjart studjues të tjera të gjuhës dhe traditave të kësaj popullsisë.

* * *

Kënga dhe Vallja arvanitase

Tiparet e veçanta të arvanitëve, në raport me popullsinë vendase, historjane dhe studjues të zakoneve, traditave të tyre, i kanë gjetur edhe tek elementë të tillë siç është kënga dhe vallja. Boتا tepër e pasur dhe e veçantë e këngës dhe valles arvanite ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studjuesve, muzkologëve dhe helenistëve të shumtë. Ajo eshtë dalluar përherë në detin e kulturës greke dhe jo vetëm kaq por ajo nëpër shekuj është evidencuar dhe ka magjepsur të huajt dhe vendosit. Aq i amdh ka qenë efekti i saj sa nëpër kohë ajo eshtë shtrirë dhe përhapur kudo duke u bërë pjesë e vetë popullit dhe kulturës vendase. Kështu vallja "çamiko", pra vallja çame që kërcehet në tërë Greqinë dhe eshtë ndër më të preferuarat një perlë qe muarren me vehte në kohën e emigrimeve të tyre shqiptarët nga territoret e Arbërisë jugore në tokën greke.

Këto e shumë të tjera kanë pasuruar më tej fondin e kulturës greke. Studjuesi gjerman Arthur Milchoifer i cili pat vizituar shekullin e kaluar Greqinë dhe zonat e banuara nga arvanitët na bën të njojur: "Ka edhe një ndërprerje në jetën monotone të arvanitit dhe jo tërë koha kalon pa një pushim. Këto pushime bëhen dhuratë e festave të tyre tërë gëzim dhe të zhurmëshme... Radha e tyre rregullohet nga stinët e vitit

dhe punët e bujqësisë, gjë që të kujton kalendarin e lashtësisë. Në festat e njoitura shkojnë familje të tëra duke udhëtarit ditë me radhë, burra me fermalinë e stolisur dhe të zbuluar, me fustanellën e bardhë dhe të pastër, me festë të kuqe me xhukfë të mëndafshëtë në majë. Gratë dhe vajzat të veshura me fustane me ngjyra dhe në kokë e gjoks mbajnë të varura monedha, shpesh të floritë... Pjesa më e madhe e ditës kalon mes haresë dhe gëzimit. Ushqimi më i zgjedhur i kësaj dite është qingji që piqet në hell, ndërsa vera kalon dorë më dorë në një kuptë të drujtë.

Angazhimi kryesor i të rijeve në këto festa është vallja, të cilën e kërcejnë pa ndërprerje për orë të tëra. Valltarët lidhen me njëri-tjetrin si një zinxhir unazash ashtu sikurse ato që gjëjmë të gdhëndura në reliefet antike. Levizin ngadalë me një hap festiva para dhe pas. Vetëm heqsi (i pari në rresht) i valles lëviz me shumë dinamizëm.

Së fundi vjen efekti i verës së pirë, dëgjohen kudo këngë. Arvaniti karakterizohet nga dinamizmi, intuita dhe nuk mund të krahasohet as me italianët dhe as me ne - gjermanët. Një qetësi e çuditshme që të bën përshtypje sundon në tavernat e tyre dhe në kafene. Eshtë prezente dhe dëgjohet vazhdimisht muzika, tingujt e pipzës dhe të daulles të cilat shoqërojnë për orë të tëra vallen. Kënga e tyre është monotone dhe e lodhshme. Eshtë një melodi qe këndohet me ton të lartë dhe konstat e cila të kujton organon me tuba hidraulike, me timber druri apo metalik.

Vija melodike e këngëtarit të parë shoqëron mandolinë e cila i shkon përkrah ruajtjes së ritmit të vështirë të këngës.

Përsa i takon tekstit të këngëve, poezisë dhe vlerës që ato kanë, këngët e tyre popullore janë bijezime të lirikave të vjetra arvanite. Këngët lirike - të dashurisë dhe epike - të klefteve janë në përbajtjen e tyre dhe kjo është mbizotëruese për një shpirt të pathyeshëm liridashës dhe një ndjenjë të pastër e të thellë laike".¹⁾

1. Arthur Milchhofer: "Attica und seine..", Faqe 260

Në se do të ballafagonim skenën e mësipërme që na i bie udhëtari gjerman nga shekulli i kaluar me këngët dhe vallet tona të të njëjtës periudhë kohore të cilat i përshkruan me mjaft detaje dhe hollëis mjeku dhe studjesi anglez Henri Holland i cili vizitoi vendin tonë shekullin e kaluar do të shohim se sa afër qëndrojnë ritet e këngës dhe të valles mes arvaniteve dhe shqiptarëve. Ndër të tjera Holland shënon:

"Në darkë tek qendronim në dhomë na tërroqën vëmendjen tingujt e një kënge që vinin nga dhoma në qoshen tjetër të pallatit. Brenda në të gjeta një grup njerëzish të çuditshëm - dy çifutë të porsaardhur nga Janina, disa komandantë shqiptarë dhe rrëth 12-13 luftëtarë dhe punëtorë shqiptare..."

Na futën në dhomën e tyre dhe na ulën në divane me respekt. Një luftëtar shqiptar na qerasi me verë shqiptare të përzier me recinë, mandej na sollën kafe të shoqëruara me nargjiletë e duhanit. Ndërkohë muzika e cila ishte ndërprerë për pak çaste mbas hyrjes tonë rifilloi përsëri. Dy nga luftëtarët shqiptarë filluan të këndonin këngë popullore në gjuhën e tyre të shoqëruara nga një violinë, një fyell dhe një def. Këngët e tyre ishin kryesisht të natyrës së luftës. Shpesh dy zërat e këngëtarëve zbuteshin dhe nga varjante të veçanta bashkoheshin në një linjë të vetme dhe harmonike muzikore me tone herë të shtruara dhe herë të egërsuara. Fyelli ishte vërtet një mrekulli, Ai çfaqej si kalimtar dhe i ashpër. Dukej që ai rregullonte pauzat në momentet e ndalimit të zërit të këngëtarit të cilat ishin të gjata por të llogaritura më shumë saktësi. Ai rregullonte me shumë ndjenjë lidhjen harmonike të refreneve. Po ashtu ritmi i mbështejillë brenda zërave të këngëtarëve shpesh theksohej nga instrumenti dhe në çdo pauzë të shkurtër ai forcohej duke i dhënë tone ashpërsie dhe frikë muzikës.

Më pas luftëtarët u ngritën dhe filluan një valle shqiptare e cila ishte më shumë ekspressive nga ç'mund të imagjinohej një e tillë tek fiset e egra të Amerikës së Veriut. Ajo u ezekutua nga një valltar i vetëm, ndërsa defi dhe fyelli

shoqeronin lëvizjet e tij. Vallatari hidhet pas flokët e tij të gjatë që turfullonin, mbyllte sytë dhe pa ndaluar për dhjetë minuta rreshth ai mori tërë pozicionet dinamike dhe të paimagjinueshme që mund të shohë njeriu. Shpesh kthente fytyren e tij në njérën anë - në profil, pastaj binte në gjunjë për pak sekonda, rrotullohej fluturimthi, pastaj kryqëzonte duart me force rreth kokës së tij. Në se për ndonjë çast dukej se fuqite e tij kishin shteruar, forca e tingujve magjike të fyellit e eksitonte menjëherë dhe ai rrëmbyeshëm hidhej në lëvizje te tjera deri në atë pikë kur pothuaj tërë fuqitë e tij kishin mbaruar.

Kur çfaqja e tyre kishte përfunduar, muzikantët dhe valltaret më shoqeruan deri në dhomën time, njëloj sikurtë pershëndesnin në ndarje një prijesin e tyre.

Kjo valle kombëtare e shqiptarëve "Arvanitja" siç thirret përgjithësisht shpesh ekzekutohet nga dy vetë. Padyshim nuk dua të aludoj apo këmbëngul se sa ajo ngjan apo rrjedh nga e famshmja "Pirote" e lashtësisë, por elementë të afersisë së saj janë të lexueshëm para spektatorit. Thyerjet e papritura, të papërmabjtor dhe të çuditshme i japin asaj një karakter të veçantë¹⁾.

Edhe sot arvanitet janë tepër të dhënë pas këngës dhe valles Konstatohet menjëherë ndjeshmëria që ata kanë për to, porsa dëgjojnë tingujt e këngëve apo valleve të tyre. Ngrihen në valle me një entuziazëm original sikur aty do të realizojnë një vyrtyt të veçantë dhe me bindje se loja e tyre do të tërheqë vëmendjen dhe do të kënaqë të pranishmit. Kur u vjen radha të udhëheqin vallen përqëndrojnë tërë energjitet e tyre që të arrijnë të bëhen më tërheqës dhe evidentë në lëvizjet e tyre, me shkathtësinë, elegancën dhe forcën shpirtërore. Në raste gjëzimesh familjare apo trapeza të shtruarë për miq, në lokalet intime të fshatrave, vallja e tyre vazhdon gjatë e shoqeruar nga vera e lehtë që ata pijnë dhe që në gjuhën vendase thirret recina.

1. H. Holland: "A juorni through Albania", F.132

Arvanitët parapëlqeijnë kremitimin e festave të tyre në antyrë dhe bashkë me këngën dhe vallen ata shoqërojnë edhe pjekjen e mishit në hell. Ky është për ta rasti që u jep kënaqësi të veçantë. Vallja dhe kënga e tyre në këto ambjente u jep atyre një entuziazëm të brendshëm ku spikat sinqeriteti dhe dashuria për këto rite që marrin në këto raste gati vlera të shenjtë.

Kur interpretohet kënga në gjuhën arvanite, instiktivisht kthehen me vështrim nga këngëtari - kur janë në tavolinat e shtruara - marrin pamjen e një njeriu të etur që ka gjetur rrënjet e një burimi tepër të kërkuar. Menjëherë ngazellehen dhe fillojnë të shoqërojnë të lumturuar vargjet e këngës në gjuhën e tyre. Këngët më të përhapura dhe preferuara arvanite që njihen dhe kërkohen e këndohen me kënaqësi janë: "Do ta pres kocidhen", - "Ra kambana e Papandisë", - "Lule ti lule jotëmë", "Moj Mari e Kalivjote" - "Shkova poshtë nga Mavromati", "Kemi vashëza të mira", etj.

Këngët lirike të dashurisë kanë një çiltërsi dhe sinqeritet tepër të natyrshëm. Erotika banale është e papranueshme për këngët e tyre. Vajzës së dashur i shprehen dhe i këndojnë ashtu siç e ndjejnë atë:

.....
*Mema çë të bëri ti
Të kish bërë edhe njadi*

.....
*Mema çë të bëri ti
të kish bërë njezetëdi*

Ja dhe forca e karakterit të vajzës arvanite që e ka lodhur djalin dhe ai i thyer i këndon:

.....
*Tërë vreshtëzat i shkova
Rush te buza jote s'çova*

Në repertorin e këngëve arvanite gjejmë këngë për nusen, përdhëndrin, këngë trimërie dhe këngë që i këndohen

punëve. Duke u kthyer pak tek këngët e bukura të dashurisë do të përmendim vargjet e njërës prej tyre ku djali pa elozhe të shumta, pa përgjunje, pa banalitetë e fjalor të përzgjedhur, por në mënyrë solmene i drejtohet:

*Eja ti moj zonj e para
Tjatër nuk të del rëpara*

Dhe vajza plot krenari, jo e joshur tepër nga fjalët, nuk i përgjigjet thirrjes të drejtëpërdrejtë të djaiit me fraza të pritshme dhe steriotipe dashurie. Në përgjigje ajo e fton djalin:

*Eja zot të pish ni verë
Ndë kupë zonja do ta shjerë¹⁾*

Në vargjet e këtyre këngëve gjen edhe vuajtjen shpirtërore të vajzës e cila nuk e jep vehten se përsë ajo përlotet. Ajo nuk shfaqet në opinion dhe nuk i ankohet se përsë qan. E ka për turp karakteri dhe morali arvanit të ankohet. Një rast i tillë vlerësohet si i dobët dhe opinioni ndoshta do ta përbuzte në se ajo do ta jepte vehten.

*Ç'bën vajza para avlisë
Klan kulmet e shtëpisë*

*Shkela gurin, guri humpi
Ikën vajza nga katundi*

Në këngët arvanitëve gjejmë shpesh epikën dhe kthimin tek ngjarjet dhe bëmat e trimërisë. Ato sikur u bien oshëtimën dhe britmat e të parëve, të kaluarën e tyre të lavdishme. Në vargjet e tyre ka kuraje, thirrje për qëndresë dhe shpresë e besim tek liria:

1. "Besa": 1983, Faqe 52-53

*Mos rrini si tē vdekur
Malet tmarrim tor
Tvishemi nē hekur
T'marrim pallēn n'dor¹⁾*

Epika nē këngën popullore arvanite është tematika më e preferuar dhe më e lëvruar. Ajo është vërtet një univers, një histori e shekujve, një kronikë e historisë me përmasa tē tilla që këtu është e pamundur tē trajtohet.

Dasma

Ndër zakonet e tjera tē jetës së arvanitit që ka tërhequr vëmendjen e studjuesve dhe tē historjanëve dhe që e bën atë tē dallueshme nga ceremoni tē tilla tē vendasve, eshtë edhe mënyra e organizimit tē damsave. Ajo, ndryshe nga mënyra e realizimit tē popujve tē tjerë, nga pjesmarrësit nē tē, del jashtë kufijve tē rrethit tē ngushtë familjar. Pjesmarrja nē tē eshtë e gjërë dhe masive. Lëvizjet, kredencjali, veshjet, llojet e këngëve dhe valleve, mënyra e ardhjes së krushqve, veshjet e tē pranishmëve dhe deri lëvizjet e palëve në ceremoni, marrin nuanca dhe forma që duken se dalin jashtë botës dhe jetës njerëzore. Ato marrin herë-herë madhështinë e festave mitike apo tē ceremonive që organizonin dikur perënditë e lashta.

Ritet e tyre tipike, arvanitet i kanë ruajtur deri pak dekada më parë dhe pjesëza tē tyre ruhen si relike tē ralla deri sot. Në se do t'i referohemi pak tē kaluarës jo tē largët, nga shekulli i 18-të, konsulli anglez në Athinë, në atë kohë Joan Ziro i cili i pat ndjekur nga afér këto rite, shënon në kujtimet e tij:

"Kur arvanitet kanë dasmë, bëjnë një festë dhe çlodhje tē gjatë e cila shkon deri tetë ditë, tē mbushura tërë muzikë nën ritmin e një daulleje dhe tē fyeyve (pipzave). Kur shpinin nusen në shtëpinë e dhëndrit, e hipnin atë në kalë duke e mbuluar me një shami tepër tē bukur dhe vertet tē rallë. Kur

1. Revista "Besa", Faqe 467

përfundon dasma të gjithë arvanitët e puthin atë në ballë, por me fytyrë të mbuluar nga shamija dhe mandej hidhnin në një pjatë apo shporte monedha të argjënta, gjysma groshi apo çerekshë. Të varfër në jetë, të thjeshtë dhe kundërshtarë të hapur të tiranisë".

Edhe kur një masë e arvanitëve u konvertua në fenë muslimane, siç bëjnë të njojur shumë historjanë të kohëve, ata vazhduan të ruajnë miqësitë mes tyre duke bërë edhe lidhje martesore. Bile këto, lidhje i realizonin vetëm mes tyre dhe jo me kombësitë e tjera.

Aq tipike ka qenë riti dhe ceremonia festive e dasmës arvanite sa ajo jo vetëm ka tërhequr vëmendjen e vendasve dhe të të huajve por eshtë trajtuar vërtet si një spektakël i rallë dhe mahnitës. Një pëershkrim të plotë dhe të detajuar të saj na i bie piktori italian Simone Pomardi, i cili vizitoi Greqinë në vitin 1804 së bashku me arkeologun gjerman Doduell. Ai shkruan:

"Një numur i madh njerëzish ishin grumbulluar jashtë mureve të kishës së shën Apostolit, para portës së saj, për të ndjekur krushqinë. Papritur u duk një kalorës i cili në galop i u afroa drejt hyrjes. Ishte një i ri arvanit i veshur në të kuqe, me një jelek të qëndisur në ar dhe fije argjëndi. Nën to kishte një këmishë të gjatë që i varej deri tek gjunjëtë punuar nga cohe e bardhë. Kali i tij kishte për mbulesë një tip qilimi shumëngjyrësh. Djaloshi arvanit ishte lajmësi i cili binte njoftimin e afrimit të kryshqëve me nusen. Për pak mbriti një lajmës tjetër edhe ky i veshur në të kuqe. Ashtu i hipur në kalë, ai tundte në erë dhe valviste rrëth e rrotull një kordele të kuqe. Atë e shoqëronin disa të rinj të tjerë arvanitë djem dhe vajza edhe këta hipur në kuaj e gomerë të stolisur me mbulesa të bukura shumëngjyrëshe.

Mbas pak u duk një arvanit me një daulle të madhe një tjetër që i binte pipzës. Pas orkestranteve vinin një grup arvanitësh burra e gra hipur mbi kuaj e mushka, të cilët kishin në mesin e tyre edhe dy orkestrante të tjerë edhe këta me daulle dhe me pipëz. Pas tyre u çfaq një grup tjetër arvanitësh

të veshur shumë bukur në mesin e të cilëve ishin kushërijtë e nuses, bri të cilëve ishin dy orkestrante të tjerë. Së fundi u duk nusja e stolisur mbi një kalë të bardhë i cili simbolizon dlrësinë dhe virgjérinë e saj.

Nusja ishte e gjatë, me një mantel të bardhë e rregullaur dhe e veshur në mënyrë tipike arvanite. Mbante një vello në të kuq e punuar me fije të arta të cilat shkëlqenin në borduret e saj. Në kokë mbante një mbulesë ngjyre portokalli në formë kësule e qëndisur me lule të arta e cila i varej deri në supë. Nga kjo mbulesë në formë kësule binte një tantellë e madhe e bardhë deri në gjoksin e saj dhe që i mbulonte pothuaj tërë fytyrën. Balli i zbuluhej nga një radhë monedhash floriri dhe në qafë i vareshin radhë të tjera monedhash me të mëdha rgjendi të cilat binin deri në gjoksin e saj.

Kalin e nuses e tërhiqte për kapistalli një i ri arvanit i veshur i téri në të bardha. Ai hekte ngadalë ne krah të kalit duke mbajtur dorën e tij të djathtë në krifën e tij. Samari i kalit ishte mbuluar me një qilim të madh shumngjyrësh që varej shumë poshtë.

Në krah të nuses qëndronin dy gra të veshura bukur. Njëra prej tyre mbante dorën e majtë mbi mbulesën e kalit dhe dorën e djathtë tek këmba e nuses tek kyçi. Edhe gruaja, nga ana tjetër e nuses bënte të njëjtën gjë. Dukej që këto të dyja kishin për detyrë të ruanin nusen gjatë lëvizjes së saj nga ndonjë aksident i mundshëm.

Edhe vetë nusja shoqërohej nga krushqit të hipur në kuaj e mushka, të ngarkuar me çanta dhe kanistra. Në fund vinte një kalë i ngarkuar me kuverta dhe jastëk të bardhë e të kaltër. Ishte krevati i nusen. Njerëzit që shoqëronin nusen krijonin një pamje vërtet têrheqëse. Ishte natë, kur nusja mbriti tek shtëpia e dhëndrit. Përpara derës së dhëndrit shumë arvantië filluan të hidhnin vallë. Ata formuan një rrëth të madh me valltare duke tundur lart me dinamizëm një shami shumëngjyrëshe të cilën e kalonin herë në një dorë dhe herë në tjetrën. Valltarët, gra që ishin të martuara, dalloheshin nga të tjerat nga shamija e kuqe që u binte nga

koka në supë. Ndërsa vajzat e pamartuar dallohen në gjerdanët me monedha florëri dhe argjendi që u vareshin në gjoks".¹⁾

Ajo çka eshtë tepër interesante dhe që dukshëm përcjell e lidh orgjinën arbërore të riteve arvanite, eshtë zakoni i grabitjes së nuses. Kjo e drejtë morale dhe kanunore e meshkujve që duket se eshtë e përcjellë nga humbëtitrat e shekuve dhe merr forma gati gati mitike - dhe që Kadareja e përcjell deri tek rrëmbimi i Helenës së Trojës, nuk ruhej dhe nuk trashëgoj tek popullsia greke as të paktën në mesjetë. Ndërsa tek arvanitët ajo jo vetëm që ekzistonte deri vonë dhe nuk përjashtohej ndonjë rast në vitet e fundit, por ajo i nënshtrohej të njëjtave ligje si tek rastet e grabitjeve të parashikuara edhe nga kanuni i ynë i Lek Dukagjinit. Raste tipike të tilla evidencohen deri në dekadat e fundit të shekullit të kaluar nga disa studjues dhe historjanë, me stë cilëve ne po përmendim atë të një studjuesi gjerman-Milchofer i cili shënon:

"...pata rastin të dëgjoja dhe shihja ngjarje me pasoja tragjike e shkaktuar nga fenomeni i rrëmbimit të nsueve. Sipas rregullit zgjedhja e nuses i takon marveshjes reciproke mes prindërve. Por, nëse të dashuruarit dyshojnë se nuk ka shpresë për të marrë besimin për martesë apo shohim se është e pamundur t'u mbushej mendja njerëzve të së dashurës, djali merr vendim dhe e rrëmbej atë, pra e vjedh. Në biseda me arvanitët shpesh dëgjon të thonë për ndonjë vajzë të bukur, - Ja vlen ta rrëmbesh!"

"Në rast se do të dëgjosh një rast rrëmbimi, duhet të kuptosh se kjo gjë është përdorur për të siguruar fitoren mbi insistimin mohues të prindërve. Kur vëllezërit apo të afërmët e së rëmbyerës bien në gjurmë të rrëmbyesit në ndonjë fshat të Atikës dhe e rrethojë; aty çfaqet vajza papritur dhe bërtet - Unë e rrëmbeva!"

Por edhe në rastet kur rrëmbimi është bërë me dhunë,

1. "Besa", Athinë 1990, Faqe 587

pra pa dëshirën e vetë vajzës, shumë herë në këto rrethana e rrëmbyera shtiret ndryshe para të afërmve. Në këtë mënyrë udha e tyre për të ndërmarrë ndonjë veprim të dhunshëm dhe me pasoja, përpara këtij fakti ndërpritet. Por shumë herë këto lloj aktesh nuk arrijnë të përfundojnë me sukses për shkak të këmbënguljes dhe insistimit të fortë të vajzës. Në këto kushte dhe rrethana rrëmbyesi detyrohet t'i nënshتروhet krenarisë së saj.

Më kanë mbetur në mendje disa raste të kësaj natyre me fund tragik. Në fshatin Spata me 1886, njoha një familje së cilës burri i shtëpisë pra babai i vajzës së rrëmbyer (që më pas kjo vajzë ishte kthyer në shtëpinë e saj) ishte vrarë kur vinte për në Athinë. Ai ishte vrarë nga vetë rrëmbyesi i vajzës së tij dhe nga shokët që kishte me vehte (rëmbyesi) të cilët kishin kohë qe e ruanin dhe i kishin zënë pusi.

Karakteristike është frika me të cilën fshihen apo përpjekjet që bëhen përtë mos u a bërë të njojur raste të tillë të huajve. Me shumë këngulje ata mbajnë sekret dhe nuk ekspozojnë vendin se ku është kryer ky veprim. Por në se në atë fshat është e pamundur të mësosh për ngjarjen, në fshatin tjeter më të afërt mund të marrësh të dhëna të sakta për rastin konkret.

Pashë në fshatin Varri (nga koha që bën konstatimin autor i deri në vitet 1960 Varri ka qenë fshat i banuar nga arvanitë, në jugë të Athinës, ndërsa sot ai është bërë një lagje e këtij qyteti për shkak të shtrirjes së amdhe që ka marrë Athina, pra është lagjia me periferike kur del drejt Varkizës. - shënim i ynë) varrin e një vajze e cila kishte vrarë vehten para pak ditësh. Të vërtetën e asaj ngjarjeje e mësova në një vend tjeter.

Motivi i kësaj vrasje paraqet mjaft interes përmardhëniet, moralin dhe psikologjinë që kanë këta fshatarë, të cilët për këto çështje i karakterizon një ndjeshmëri e veçantë. Kjo vajzë ishte vrarë mbasi ishte cënuar krenaria e saj për çështje tepër delikate nderi. Dhe konkretisht ajo kishte shkuar për t'u rrëfyer tek një prift kallogjer në manastir, nga

i cili varej edhe vetë fshati Varri. Prifti i cili ishte në të njëjtën kohe vellai i vajzës nuk kishte pranuar të dëgjonte rrëfimin e saj. Ne keto rethana e prekur rëndë në dinjitet, vajza kishte vrarë vehten.

Njoha shumë njerëz, me mjaft prej të cilëve mu dha rasti te takohem fare rastësish dhe më pas të qëndroj me ta përdite dhe javë të tera. Në radhët e tyre bëjnë pjesë shumë prej te cileve m'u nevojiten në lëvizjet e mia si udhërrëfyes dhe orjentues qe në vetvehte përmua përbëjnë një koleksion të pasur tipash të tillë si bixhosxhinj, qitës, apo nisanxhij të mire kurjoze e pasionantë përtë mësuargjithçka, shakaxhinj, filozofe qe studjonin çështje fetare dhe shoqërore. Të gjithë keta janë larmia që plotëson imazhin e plotë dhe të gjerë të karakterit te këtij populli...¹⁾

Por do të ndalemi pak për t'i hedhur një vështrim ritit mortor i cili ka vlerat e tij dhe tipare të dallueshme në radhë e te veçantëve të tjera që ndërtojnë murin e godinës shpirterore të popullit tonë. Duke ndjekur procedurat e realizimit të kësaj ceremonie, çdo kush mund të aludojë përafersitë e dukshme të saj me mënyrën e realizimit të këtij riti ne vendin tonë, nga ku shekuj më parë kishin zbritur me arvanitët në Greqi.

"Kishin shtrirë të vdekurin mbi një shtroje para portës dhe i kishin vënë njérën anë kosoren dhe në anën tjetër dyfekun e tij. Këto ishin dy bashkëpunëtorët e jetës së tij, njëra në punë dhe tjetra në luftë. E qante me vargje e shoqja dhe kushëritë e tij. Përmes vargjeve ato e pyesnin se "përse ai iku dhe i la ato"... Çfarë i mungonte kur apratë e kursyera përrugën ishin në dispozicion të tij... edhe në se ai vetë nuk kishte, kishin ata përtë,... Më në fund dikush ngriti zërin. Po ja që vdekja nuk na pyet dhe kjo gjë ka marrë fund. Fol vetë me shën Pjetrin që do të të hapi protat e parajsës dhe pyete në se do të ndëshkohen këta qen turq të cilët na sundojnë.²⁾

1. K. Biris: "Arvanitët qe i katagogjii ton elinon", F.307-312
2. Po aty, F.312

Edhe sot krahas ceremonisë fetare kur prifti bën
kredencialin e përcaktuar sipas rregullave të ritit ortodoks,
arvanitët e vendosin të vdekurin në një nga dhomat e
shtëpisë ku gratë e mbledhura rreth e qajnë me vargje me zë
jo të lartë duke i përmendur virtytet e tij, se sa shumë e donin
të afërmit dhe sa shumë i donte ai ato, etj.

Për ceremoninë e gëzuar të dasmës arvanitët kanë një
numur të madh fjalësh të urta, urime tipike e karakteristikë,
vargje këngësh shumë të bukura një pjesë e të cilave i
këndohen dhëndrit, një pjesë nuses, krushqit të tjera dhe të
gjitha i jatin dasmës një ambient festiv, Pikërisht nga këto
vargje që këndohen për raste të tillë apo urime që
shkëmbehen mes miqve dhe çiftit do rendisim disa nga ato
që kemi mundur të mbledhim.

Ndërvargjet më të preferuara që përsëriten dhe i drejtojnë
si urim nuses dhe dhëndrit të gjithë të pranishmit që vijnë për
urim drejtohen:

*Rrofshi, rrofshi, lulëzofshi
Di herë mos u martofshi*

.....

Dhe në momentin e ndarjes së nuses nga shtëpia e saj
prindërore, krushqit fillojnë i thonë këto vargje nuses,

*Sallm mëmë uratënë
Se do ndroj vatrënë*

.....

Ndërsa krushqit që presin në shtëpinë e djalit nusen te
vijë përsërisin vargje këngësh dashurie....

*Rusu (bjer) mal e bënu prua
Të shoh vajzën çe e dua*

Dhe...kur ajo që pritet - nusja, hyn me kokën ulur në
shtëpinë e dhëndrit tërë të pranishmit fillojnë t'i këndojnë
këngë çiftit, djalit, dhe vajzës në vargjet e të cilave natyrisht
që ka elozhe sa për njërin dhe për tjetrin:

.....
*Shumë lule xuarr maji
Po ne juve ra sevdaji*

.....
*Nuse mori nuse gjegje
Erdhe ja mirse na erdhe*

.....
*Moj vetull përzier
Sa më ke pëlqyer*

Ndër vargjet e këngëve për dashurinë gjen edhe formulime për vajzat që kanë qenë çobane, ka vargje për të tjera qe mbylleshin në shtëpi e punonin në avelmend. Sipas rastit arvanitët kanë gjetur mënyrën dhe formën e goditur artistikisht për ta bërë këngën sa më të afërt me rastin e dashurisë:

.....
*Eja të të puth një çikë
Le ti hajë ujku dhité*

.....
*Prita moj e priturë
Deti të kej mbiturë?*

Dhe dhëndëri i drejtoshet vajzës me pak fjalë që të mos lëndojnë botën e saj të trazuar, dhimbjen që largohet nga dera e prindërve dhe atë të gëzuar që shkon pranë djalit që e do. Fjalët e vargjeve të kësaj këngë duket sikur thuhen me përkundrazi të japid shpresë dhe siguri....

*Eja vajzëzo me mua
U të ligën nuk të dua*

.....
Nga këngët e gëzuara të dasmës dhe dashurisë që kemi mbledhur përshtypje na kanë bërë dy vargjet e njërsë prej tyre të cilat shprehin për masat e finesës së shijes të

arvanitëve, shenjtërinë që i japin dashurisë së thelli shpirtërore dhe formës së përkryer artistike që i japin konceptit "E bukur"

*Moj e bukura nga t'terrë
She Meria të ka bërë*

Mikpritja - shtëpia

Po cila është shtëpia e arvanitit, ç'të ofron ajo, çbotë shpalosin këta njerëz përparrë mikut apo përparrë të panjohurit!!!! Në traditat morale të arvanitit zënë vend edhe ligje të ashpra, por në shpirtin e tyre ka një ndjeshmë dhe humanizëm që rrallë e provon njeriu në shtëpinë e një të panjohuri ku atij i ka qëlluar të ndalojë.

"Në se do të mendonim të hynim në një shtëpi (arvaniti) për ta vëzhguar atë, do të ishte e pranueshme të zgjidhni një orë kur aty të ishte edhe vetë i zoti i shtëpisë, domethënë herët në mëngjes ose në darkë. Burri është në kuptim e vërtetë të fjalës Zot i shtëpisë, prandaj nuk është e lehtë të heqësh sëkëlldinë, turpin dhe ndrojen e grave të cilat do të zëvendësonin burrin në shtëpi në rastin e mungesës së tij.

Do të ishte e pahijshme që dikush të hapte derën dhe të hynte menjëherë brenda. Edhe fqinji qoftë ky, i cili nuk trembet nga qeni i shtëpisë, respekton hijen dhe vlerën e rëndë që ka porta e shtëpisë, prandaj para se të hyjë bertet nga jashtë në emër të të zotit të shtëpisë, troket, pastaj hyn.

Porsa hyn në oborrin e shtëpisë të arvanitit do të gjesh atë të shtruar me pllaka guri dhe po në këtë ambient do të shohësh pusin dhe furën e pjekjes. Në muret rrethues të oborrit ashtu sikurse edhe nën strehë gjen të renditur e mbështetura sende të cilat të kujtojnë imazhin e një lashtësie të vërtetë. Aty gjen të vendosura vegla të ndryshme të punëve bujqësore, drutë e zjarrit të vëna stivë, shkopijtë e shkundjes së ullijve, shkurre, etj.

Ballëpërballë hyrjes së oborrit gjendet shtëpia njëkatshe e ndërtuar me gurë, me një verandë të drujtë dhe disa dritare

të vogla të mbyllura nga grila të drujta, nga përashta. Sipas zakonit në pjesën e brendshme të shtëpisë ka një kamare (të futur në mur) e veshur me plakë dhe me shtylla anësore, të nxira nga tymi. Në pjesën ballore të kësaj dhoma gjendet oxhaku sipër të cilët qëndron një kusi e varur në çengel. Nga kjo kusi, familja merr gjellën e gatuar dhe e shtron atë në një sofër të rrumbullaktë të drujtë që vendoset në një vend disi më të ngritur, aty ku zakonisht shtrohen më pas dyshekët e fjetjes. Shpesh mbulesat qylymat dhe robat palosen dhe mbështeten rrëzë murit. Një musendër në mur dhe disa dritare të vogla janë ornamentet dhe elementet e fundit të shtëpisë.

Nëpër trarët e zbuluar të tavanit varen napa me djathë deleje ose dhije, varge në formë gërvshete me qepë dhe hudhra. Tavolinat dhe karekllat tonë janë gjëra që ndeshen rallë. Fuçia e verës dhe qypi i vajit gjenden në anën tjetër përballë kamarës. Në shtëpinë e arvanitit ka gjithashtu edhe mushkë dhe gomar që mbahen jashtë, ndërsa pulat lëvizin brenda në kote...

Sa e thjeshtë dhe me mungesa është shtëpia e arvanitit, aq e thjeshtë dhe e reduktuar eshtë edhe vetë dieta e tyre. Arvaniti është njeri punëtor, punon shumë në tokat shkëmbore apo në vreshtat e tij duke u kushtuar shumë mund atyre. Dhe çfarë ha? - bukë, ullij, djathë të thatë, fasule, qepë dhe hudhra. Rrallë bakalaro apo peshk të thatë, shumë rallë mish.

Rrallë theret bagëti, ndërsa qingji vetëm në raste të gjëzimeve të veçanta apo festave. Vijnë së fundi kohët e krizave, shtëngesave të rënda dhe mungesat deri ushqimore, të cilat janë evidente në jetën e këtyre fshatarëve. Në këto kohë të vështira ndalohet përdorimi i vajit, ai kursehet ashtu sikurse edhe djathi dhe ulliri. Për gati 60 ditë përdoret buka të thatë apo bukevalja dhe ndonjë thierzë. Tamam këto kohë përkijnë me ditët para pashkëve kur fillon edhe qilizma e vreshtave. Realisht kjo punë e rëndë dhe e lodhshme nuk mund të kryhet pa ndihmën bamirëse që ofron qepa, hudhra

dhe vera e fortë që prodhojnë vendasit".¹⁾

Shtëpia e arvanitit sot kuptohet që i është nënshtuar zhvillimeve urbane bashkëkohore. Megjithatë shumë gjëra që evidencojnë studjesit e dekadave të mëparëshme, i gjen të ruajtura edhe sot në fshatrat dhe banesat e tyre. Kështu, në oborrin e shtëpisë ata kanë dëshirë të kenë dhe mbajnë pula dhe jo rallë lepuj apo lopë. Mbajnë dhe ruajnë më shumë nostalqji shumë nga orënditë e vjetra dhe mijete pune që kanë përdorur të parët e tyre si relike dhe shpesh përmes tyre kanë qef të tregojnë për të kaluarën e vet apo të prindërve. Edhe sot është vështirë të gjesh një shtëpi që nuk ka në bodrume apo në ndonjë kasolle në kopshtim e shtëpisë bidona me verë të lehtë që e bëjnë nga vreshtat e tyre apo fuçitë e vajit.

Kur shkundin dhe mbledhin ullijtë zakonisht thërrasin edhe fqinjin apo mikun e tyre për të përballuar punët e shumta, pra nxjerjen e vajit. Kur të servirin në trapezën e tyre nga vera e bërë vetë apo vaji dhe ullijtë e përgatitur me duart e tyre, marrin një pozicion solmen dhe të tregojnë më kënaqësi se ato i kanë bërë me duart e tyre dhe nuk janë të industrializuara. Të yshthin duke thënë - pi dhe pak, është verë e mirë... Dhe pothuaj është traditë që kur largohesh do të japid se s'bën me vehte një shishe nga vera që kanë nxjerrë. Bile kënaqësia e tyre është më e madhe kur shishet i mbush tek rubineta e fuçisë në prezencën tënde. "Nuk të bën dëm, mirë të bën". Përfundon arvanitasi duke të përcjellë.

Në rastet kur të ftojnë në shtëpitë e tyre, për të plotësuar trapezën dhe nderur mikun ftojnë edhe të afërmit apo miqtë e tyre. Me gotat e tyre në duar urojnë: "Shëndet! - Për shumë vitra! - Mirë të viç njatër herë! "Kur ndahesh me ta, duke të përcjellë deri tek rruga jashtë, urojnë "Orë e mirë!"

Mbasi jep dorën, me gratë ofrohesh dhe përaqafohesh, rrallë mund të të puthin, ndërsa burrat vetëm të shtrëngojnë duart. Puthja mes burrave është e papranueshme...

1. Arthur Milchofer: *Atica und.... Faqe 264*

Kur shtëpia ka një plak apo plakë të moshuar, mbas trapezës ajo apo ai vihet në qendër të bisedës për të treguar sipas rastit se si ka qenë e kaluara e tyre, ç'zakone kanë pasur, si respektoheshin më parë këto rregulla, ç'njerëz me emër të mirë ka pasur fshati apo krahina e tyre. Shpesh në këto raste evidencohen njerëz te cilët janë dalluar për trimëri, njerëzit kurajozë dhe ata qe janë dalluar si njerëz të drejtë. Çështja dhe tema e "besës" është ndër më të preferuarat në këto biseda nga episodet dhe ndodhitë që tregohen. Eshtë tepër dinjitoze për ta të tregojnë raste kur vetëm për shkak se arvaniti ka dhënë besën dikujt, ai ka pranuar edhe ndëshkimet e rënda apo humbjet me pasoja jo të vogla. Kështu, e tregojnë shpesh dhe në shumë krhainë se "megjihtëse atij (arvanitit) i ishin ofruar shumë mundësi fitimi për mallin që ofronte, ai nuk pranonte ta jepte tek blerësi nga i cili dot e nxirrte fitime të mira, vetëm e vetëm se ai i kishte dhënë fjalën dikujt tjetër më parë". Në bisedat familjare kur qëllon të ketë arvanitë nga vendbanime të ndryshme dhe jo nga i njëjtë fshat, fillojnë të tregojnë vyrtytet e veçanta të moralit, besës, mikpritjes, edukatës, etj. të cilat i kishte më të avancuara njëri fshat në raport me tjetrin, apo shtojnë elementë të cilat nuk i gjen në zonat përreth, por vetëm në këtë apo atë fshat.

Për të treguar obligimin e madh të amvisës së shtëpisë që ta presin sa më mirë mikun, shpesh në tryezën e tyre vënë kulaç që ato e kanë përgatitur vetë. Ky eshtë një zakon që e gjen pothuaj në çdo shtëpi arvanite. Sipas zakonit një pjesë të këtij kulaçi, apo gjysmën e tij nuk e shtrojnë në tavolinë, por e mbështjellin për të ta dhëna me vehte së bashku me verën.

Për botën e arvanitit miku ka një vend të veçantë, *ndoshta* të rrallë. Ai nderohet dhe vlerësohet mbi çmimin e *shumë gjërave* të domosdoshme që kajeta. Arvaniti do të *pranonte* të përbollonte shqetësimet dhe vështirësitë që bijen mungesat e ndryshme, varfëria ekonomike, etj, por ai *do të ndjehej* tepër i qetë në se nuk do të ishte i varfër në miq.

Aq shumë i shtrin dhe rrit përmasat e vlerës se mikut ai sa
është gati të braktisë dhe sfidojë deri nevojën e perëndisë...

Më mirë miqësinë

Se sa perëndinë

dhe mikun ai don ta presë me tërë të mira por mbi të gjitha
ajo çka e bën mikun e vërtetë, sipas tij është fjala...

Vetëm me një fjalë të mirë

Bën një mik

Vetëm dhe pa miq asgjë nuk mund të bësh, me miq dhe
me shokë levizin dhe marrin rrugë shumë dëshira dhe
ëndrra, plotësohen dhe kryhen edhe ato që për një njeri të
vetëm mbeten të vdekura...

Një urë z'digjet vetëm

Do të tjera

....
Një dorë lan njérën

Dhe të dija fitirën

Me fjalët e tij tipike por edhe në biseda të zakonshme,
arvaniti e shpreh konceptin e gjërë dhe human, të çveshur
nga shpirtvogëlsia dhe tiparet e cingunit, kur thotë:

Më mirë të kesh një mik

Se sa shumë para

Përt'i dhënë përmasat reale, vlerat që ka miku për këdo,
proverbi çmon deri gjëra fare pa rëndësi për të kuptuar
nevojën e vërtetë të njeriut:

Njeriu ka anangj edhe për

milingonën çë del nga vëra

Veshja - kostumi i arvanitit

Veshja apo kostumi tradicional i arvanitit me gjithë
kohën e gjatë të shkëputjes së tij nga trojet amëtare, të
paktën deri në fundin e shekullit të XIX apo fillimin e shekullit
të XX-të, kur ende ruheshin veshjet tradicionale të popujve

të Ballkanit dhe më gjërë, kishte me ndryshime të pandjeshme atë formë dhe strukturë që kish marrë prej Arbërisë dikur. Informacionet për të veçantën në veshjen e arvanitëve janë të shumta dhe vijnë nga periudha kohore të hershme. Duke u vlerësuar si një fenomen i rrallë, kostumi popullor i arvanitit ka tërhequr mjart vëmendjen e studjuesve, udhëtarëve, artistëve dhe piktorëve të shumtë. Aq efekte të mëdha krijoj ai me bukurinë, shijen e hollë të derdhur në të, ornamentet, ngjyrat dhe punimet në ar dhe argjend, sa që në territoret ku u venods ky emigracion, veshja e tyre dhe veçmas fustanella shtangu shijet dhe syrin e popullsisë vendase. Magjia e saj mori ato përmasa sa imponoi ata të ndryshojnë traditën dhe imitojnë arvanitët në modën e tyre. Dhe kur ajo mori shtrirje dhe përmasa, në mënyrë të natyrshme u kthye në një veshje pothuaj kombëtare për Greqinë.

Ndër studjuesit e parë që na bien informacione për etnografinë e kësaj popullsie, janë udhëtarët anglezë, franceze e italiane të shekujve të 18-të.

"Veshja e arvanitëve të Atikës ndryshoi në rrjedhën e viteve, këmisha filloj të bëhet në ngjyrë blu të errët, brenda saj kishte një jelek leshi të veçantë, të mbyllur që ishte thjeshtëzuar tek fermelia suliose. Veç te tjeravë "ndrili" të cilin e prodhonte industria, filloj të zëvendesojë këmishën e ngushtë në gjoks dhe me shumë ornamente të qepurash e cila ishte e gjatë dhe varej e lirë nga mesi deri tek gjunjët. Zhvillimi i industrisë solli edhe copën e punuar trashë dhe të rrahur që quhej kuko, që kish ngjyrë të errët blu, e zbukuruar me shirita të zij dhe tirqe të gjata të pambukta"¹⁾

Bashkëudhëtarë dhe miku i Bajronit, Hobhauz i cili ka lënë një koleksion të pasur dhe me shumë vlera pikturash me skena nga jeta e arvanitëve, kostumet e tyre, peisazhe të ndryshme, etj në kujtimet e tij shënon: "I tërë kostumi shqiptar, i ri dhe i pastër, është më elegant i ngon se ndonjë tjetër që vishet në perandorinë osmane dhe ndoshta ai që duhet

1. K.Biris: "Arvanitet që i katagogj ton elinon", Faqe 319

të kushtojë më shumë. Veshja e grave është e mrekullueshme dhe ka ndryshim nga një fshat tek tjetri".¹⁾

Një tjetër studjues pasionant dhe i talentuar, konsulli i njojur anglez i fillimit të shekullit të kaluar në Gregi, William Martik Lik, rreth vitit 1809 shënon: "Shqiptarët e Greqisë (arvanitët) e ruajnë veshjen e tyre kombëtare. Fshatarët shqiptarë që banojnë Atikën (tërë krahina rreth Athinës) kanë një kostum ndryshe nga greku. Kjo gjë konstatohet qartas dhe në krahinën e Beotisë dhe krahina të tjera ku shqiptarët kanë vendbanimet e tyre... "²⁾

Qëndresa e tipareve të veçanta kombëtare në veshjet e arvanitëve nuk lidhet me ndonjë lloj konsrvatorizmi pa kulturë, apo për shkak të orjentimeve dhe instikteve ksenofobe, përkundrazi kjo veshje mbijetonte në mënyrë të natyrshme dhe me dinjitet duke rivalizuar dhe dominuar mbi bukurinë e veshjeve të vendasve. "Krahas saj (bukurisë së veshjes), ishte edhe fama e shqiptarëve e cila nxiti grekët e tanishëm të përshtasin fustanellën shqiptare si kostumin e tyre kombëtar - shkruan Finlay.

Po ky autor na bën të njojur se fustanellën deri aty rreth vitit 1810 e vishnin vetëm vajzat e vogla të fmailjeve të arhondeve arvanite në More. Në vitet e revolucionit të 1821, me të zbritën në territoret greke shqiptarët nga krahina të ndryshme dhe nga Suli. Kapodistria në qeverinë e tij të pasrevolucionit e vlerësoi atë veshje kombëtare, ndërsa vetë mbreti Otto e miratoi më pas atë zyrtarisht si të tillë.

Poeti i madh anglez i shekullit të kaluar, Lord Bajroni i befasuar nga bukuria e këtij kostumi shkruan në shënimet e tij; "ai është më i madhërishmi në botë". Kaq u mahnit nga ky kostum Bajroni, shkruan studjuesi grek A.Kolias, sa aj e vishte shpesh atë dhe ne njohim portretin e tij që thirret; "Bajroni me veshje greke", por që në fakt është "veshje shqiptare". Dhe e emërtuar pikërisht kështu njihet nëpër

1. Hobhouse: "A journey through Albania nad... Faqe 132.

2. W.M.Leak: "Researce in Greece" Faqe 411

botë tabloja e Bajronit".¹⁾

Duke u futur në pëershkrimin deri të detajeve të këtij kostumi, Bajroni i shkruan se jëmës: "Veshja shqiptare përbëhet nga një fustanellë e bardhë, kapotë e qëndisur në ar, jelek veludhi boje kërmëz të mbuluar plot me gjatane të artë dhe vendosur në mënyrë shumë harmonike. Janë të qëndisur me njëmijë e një ornamepte dhe dizenjo të bukur. Në brez mbajnë pisqolla argjendi dhe jataganë".

Ndërsa arkeologu anglez Dodwell duke qëmtuar imtësisht këtë veshje shkruan: "Arvanitët kanë shumë debolesë për abukurimet në argjend dhe për gunat. Të pasurit vishen me tre lloj kostumesh, në analogji me sezoni. Në dimët një gunë të shkurtër prej leshi të dhirtë, pa mëngë, me qime nga ana e jashtme... Në gjoks mbanin dy deri në katër kopsa të mëdha prej argjendi ose ari sa një kokërr vezë të punuar me një mjeshtri të çuditshme. Duke genë ashtu të qepura afër njëra-tjetrës ato duke u përplasur me njëra tjetrën gjatë lëvizjes së arvanitit lëshonin tinguj gjë që atyre u pëlqen shumë.

Në verë vishnin syrtykun pa mëngë, por duart mbuloheshin nga mëngët e këmishave. Kjo këmishë eshtë e gjatë dhe zurret deri tek gjunjët... Tëmbathuratë brendshme ishin të bardha dhe lidheshin poshtë gjunjëve me lidhëse me ngjyrë. Ndërsa çobenët dhe marinaret arvanitë vishnin bruce që mbrinte deri tek thëmbrat e këmbëve".

Ndërsa duke na pëershkuar veshjen e gruas arvanite po ky autor thotë; "Shqiptarkat (arvanitët) vishen me të njëjtën uniformë të gjitha, në gjithë Greqinë; Fustane të gjatë bojë të çelur, me gjatani të zi të gjerë anëve dhe pas. Fustanët e tyre festive ishin të kuq dhe shumë herë ngjyrë jeshilë të errët. Veshja e jashtme ishte më e lehtë, kurse nga sipër shtrëngonte mesin një brez i gjerë me stoli prej bronxi apo argjendi me dy tokëza të mëdha në formë gjysëm rrathi

1. 1. A.Kolias: "Arvanitës i doris tu neoteru elinismu",
Fq 238

përpara. Në kokë mbajnë një shami të bardhë që mbështillet tek gryka përpara ndërsa nga pas bie mbi supe. Flokët e tyre binin mbi kurriz të ndara në tre bishta të gjatë dhe që arrin në gati deri në tokë. Kyçet e duarve ishin të zbukuruara me gjerdanë me pjastra turke, talira spanjolle dhe me monedha të lashta greke. Kur ato kërcenin, tingujt metalikë të këtyre zburikimeve përziheshin me tingujt e daullës ose të pipzës. Kishin edhe byrzyllykë prej korali apo vathë të tillë, prej qelqi të ngjyrosur apo të paisur me monedha antike greke, turke dhe venecjane..."

"Kalcat që zakonisht arvanitët i veshin në luftë apo në udhëtime mbulojnë rreth e rrotull këmbën nga pas dhe anash... të tilla por të vogla metalike ata përdorin për të mbrojtur gjunjët. në gjuhën e tyre arvanitët kalcave u thërrasin çorape... Armët që mban arvaniti janë dyfekë, një palë pisqolla të lara në argjend, jatagani dhe shpata".¹⁾

Duke e krahasuar këtë veshje të arvanitëve, me veshjen e shqiptarëve në te njëjtën periudhë kohe, çdokush e ka të lehtë të dallojë identitetin e tyre, ngjashmérinë e plotë me njëra tjetër.

Në vitin 1824 Milingeni na e jep më konkretisht ngjashmérinë e plotë duke i parë nga afër të dy palët përmes një episodi i cili ka vlerë edhe në një kuptim tjetër... "Pak ditë mbas mbriggjes tonë në Hrisavica, u paraqiten tek Mavrokordhatua... 200 himarjotë të cilët kishin një paraqitje tepër luftarake nga tërë radhët e ushtrisë. Himarjotët nuk dallohen fare nga arvanitë sepse veshja e tyre dhe gjuha e tyre është komplet e njëjtë, plus faktin që edhe fenë e kanë të njëjtë, me të vetmin ndryshim që ata himarjotët nuk dinë asnjë fjalë greqisht".

Edhe në dokumente të tjera siç gjejmë në ketë shkrim të Milingenit në një tjetër te konsullit francez Pukevil, që pohon të njëtin fakt; himarjotët të paktën deri në dekadat e para të shekullit të kaluar nuk dinin asnjë fjalë greqisht, gjë që rrëzon

1. Dodwell: "Jaurmey in levant", faqe 159

pretendimin bajat, antihistorik dhe antishkencor të qarqeve shovene greke të cilat përpiken ta vlerësojnë dhe konsiderojnë këtë zonë si territor dhe pjesë te minoritetit grek.

Pothuaj të gjithë studjuesit dhe autorë të shkrimeve të ndryshme për shqiptarët dhe jetën e tyre, përherë kanë përshkruar pranë kostumit dhe në tërësi kudo ku ata janë gjendur, armët. Mjeku dhe akademiku anglez Henri Holland gjatë udhëtimit të tij nëpër Greqi e Shqipëri përshkruan një skenë të heshtur dhe tepër itneresante të një shqiptari në kohën e tij të çlodhjes, në gjumë... "Vëmendjen time e tërroqi një dritë e zbehtë nga një ndarje e vogël e një dhome përbri dhomës time. Hyra me kujdes në të dhe papritur pashë të shtrirë një Ifutëtar shqiptar të gjatë e të fuqishem pranë shkarpave të nje zjarri në vatrën që pothuaj ishte fikur. Ai flinte në një gjumë të rëndë. Fare pranë trupit të tij ai kishte armët, një pushkë e gjatë, dy pisqolla dhe pallia, të cilat dukeshin sikur ruanin vetë atë. Në tehun e pallës kishte diçka të mistershme që të shkaktonte një ndjenjë frike... Mos vallë çohej ky skifter papritmas dhe gjente përballë një të huaj që e vështronë në atë mënyrë...! U largova..."¹⁾

Po ky autor evidenton të njëjtat tradita në veshjen e shqiptarëve edhe tek banorët e krhainave të veriut të Shqipërisë, duke shtuar për ta; "...më tërroqën vëmendjen disa ushtarë shqiptarë të cilët mbanin të mbështjellë rreth kokës shami të kuqe me një pamje të çuditshme. Po kjo shami zbriste mandej dhe mbështillej rreth qafës së tyre. Këta burra ishin nga zonat e Shqipërisë veriore, ... janë përgjithësisht të gjatë, me fytyrë muskuloze, të ashpër në instiktet e tyre dhe të famshëm si ushtarakë..."²⁾

Një tipar interesant dhe tepër i veçantë i cili nuk gjendet në asnjë nga popujt e ballkanit apo edhe më gjërë, ka qenë tek arvanitët dhe jo pak tek shqiptarët, moda e flokëve dhe

1. *Henry Holland: A journey in...*" Faqe 72
2. Po aty Faqe 106

mënyra se si i mbanin ata ato dhe si qetheshin. Ata ruanin flokët në pjesën e përparme dhe anësore të tyre (mbi veshë) duke i lënë ato të gjata vetëm në pjesën e prapme të tyre. Autori grek Kolia thotë: "Arvanitët ishin te tualetit nga prapa, domethënë ruanin kokën nga përpara dhe nga anët duke lënë vetëm prapa baluket e flokëve... Kjo gjë nuk ishte një modë e thjeshtë, por një mbeturinë shumë e lashtë e trashëguar nga konservatorizmi i shoqërisë së lashtë shqiptare.

... Plutarku këtë zakon u a atribon Avanteve të lashtë të Eubesë. Ai thotë se zakoni u adoptua për arsyen e thjesht ushtarake, domethënë që të mos i kapnin armiqjtë nga mjekra dhe flokët, në betejat trup me trup. Këtë gjë e bëri edhe Aleksandri i Madh, ai urdhëroi ushtarët e tij që te ruheshin si edhe ai vetë... Edhe spartanët që ngjanin shumë me arvanitët, pikërisht në të njëjtën mënyrë ruanin kokën përpara dhe anash, duke lënë vetëm flokë nga pas si krifkën e kalit"

Këtë modë të mbajtjes të flokëve në këtë mënyrë e gjejmë të pasqyruar te shumë studjues që panë e ndoqën nga afër jetën dhe në tërësi botën e arvanitit. Kështu i gjejmë të pasqyruar ata në tablot apo gravura të tjera të kësaj kohe, si ato të Eduard Liri, Doduelli, Hjuzit, Karrajt, etj. Edhe shqiptarët të cilët zgresin të shumtë në territorët e greqisë në periudhën e revolucionit, dhe që kanë pozuar para piktorëve perëndimorë për tablot e tyre, mbanin njëlloj të qethura flokët. Në se do të binin ndërmend tërë portretet e kapedanëve dhe heroje arvanitë të revolucionit grek, do të konstatonim menjëherë këtë fakt. (Shih fig. 4)

* * *

Arvanitët në përgjithësi në jetën e tyre vlerësohen si njerëz bujarë, krenarë dhe që në këto çështje nuk duhen cënuar. Ata e duan dhe e kërkojnë miqësinë dhe e respektojnë atë, por ndërkohë ata vlerësohen si konservatorë në çeshtjet

e moralit. Në se studjohet nga afër ky fenomen, tek ata do të gjenin norma të cilat mbartin një ndjeshmëri të thellë sa për jetën bashkëshortore aq edhe atë të rive. Dekada të kaluara në ketë çështje, do të gjeje tek ata pothuaj të njëjtat norma që vijnë shumë pranë dispozitave morale dhe vlerësimëve që përcaktoheshin dikur në jetën e popullit tonë, apo më larg akoma në kohë, tek kanuni i Lek Dukagjinit. Ai që do të tentonte të ngacmonte një femër do të merre ndëshkim tepër të ashpër apo më e pakta do të shëmtohej përfjetë. Edhe sot gjentë përmenden si rudiment shprehja kërcënuese "Do të pres vesh e hundë".

Një tjetër fenomen i përhapur tek arvanitët, të paktën deri në fillimet e shekullit të XIX-të ishte hakmarrja. Rastet e fundit të hakmarrjes, studjues të kësaj çështjeje, i kanë gjetur tek arvanitët e Peloponezit dhe kryesisht në krahinën e Manit.

"Arvanitët e duan paranë,... por paraja nuk ka qenë përtakët në asnjë rast qëllim në vetvehte, por mjet dhe element që kontribon në forcën e tij, që konsolidon dinjitetin, lirinë dhe pavarësinë e tij... Ai do të hidhte në erë gjithë pasurinë e tij, të gjitha lodhjet dhe mundin e një jete të tërë përtëruajtur të pacënuar një nga idealet. Kur sakrifikon vetë jetën përdiealet e tua, ç'rëndësi mund të ketë paraja? - shkruan studjuesi arvanit A.Kolia.

Në përgjithësi arvanitët janë njerëz fjalëpak dhe që nuk parapëlqejnë shumë bisedat e stërgjatura apo njerëzit me fjalë shumë. Nuk do të pranonin që gruaja të fliste po aq sa burri, apo të zinte shumë vend në bisedat e tavolinës. Në kuvend në shoqëri apo nëpër dhoma të ftuarisht, të dëgjojnë me vëmendje dhe nuk ndërpresin atë që ka fjalën, por kur flet edhe vetë arvaniti nuk është e këshillueshme që dikush tjetër të flasë apo ndërpresë. Në se dikush do ta bezdiste në këtë mënyrë, ai nuk do të nguronte të përdorte më nervozizëm frazën: "Mos më q.... kuvendin!"

Morali i tyre në këtë çështje që përmendem koncetrohet në koncepte të cilat ata i kanë të ngizuara në fjalë të urta, që

i kanë përcjellë nga të parët e tyre si ligjësi morale të jetës.
Ndër to mund të përmendim:

Mos ha sa ke, mos thua sa di!
Të matesth pér të blesh!
Fol pak dhe gjej shumë
Të thëna, të bëra!
Ama peshtite përdhe, nuk e merr prap ta vesh në
golë!

Në marrëdhënie me mikun dhe përgjithësisht në jetë, arvaniti është njeri korrekt dhe ai do të ndjehej shumë i fyer në se do të konstatonte që edhe miku nga ana e tij nk do t'i përgjigjej me të njëjtën "monedhë". Ndoshta nuk do të preferonte të ta shprehte me fjalë pakënaqësinë, por atë do ta konstatojë dukshëm në fytyrën e tij.

Epilog

Arvanitët, siç kemi përmendur edhe më parë, janë futur gradualisht, dhe në mënyrë të natyrshme nëpër shekuj në jetën greke duke u bërë pjesë e saj, bile një pjesë vitale e këtij vendi. Shifra zyrtare të sakta për numrin e tyre asnjëherë nuk janë dhënë apo publikuar. Nuk e kemi fjalën për atë pjesë që është ndërfutur përmes lidhjeve martesore të hershme, të asimiluar dhe vendosur në qendra urbane dhe që paraqet vështirësi në identifik. Këto fenomene janë të natyrshme dhe të pranushme, tek e fundit shumë rrënje të vitalitetit të popujve lidhen pikërisht me këto fenomene. Por, në se flasim për shifra, në këtë çështje mungojnë edhe ato që do të evidenconin atë masë e cila është vendosur në njësi administrative unike, nëpër fshatra, krahina apo zona të tëra bashkë dhe pranë njëra-tjetrës, vetëm nga arvanitë.

Shpesh, konsiderohet dhe vlerësohet si numur i përafërt i saj shifra prej rreth tre milion e më tepër. Të vetmet shifra të grumbulluara nga periudha e emigrimeve të mëdha në shek e XIV Ilogariten në rreth 150.000 vetë. Por, kjo është vetëm mbledhja e thjeshtë e atyre që zbritën dhe gjejnë të evidencuara në dokumentet historike. Po sa dokumente të tjera ende nuk njohim? Më tej akoma, sa emigrantë të tjerë kanë mbetur pa u evidencuar në letrat e kohës dhe kancelarive? Në shumë raste dhe në mjaft vende të Greqisë mesjetare gjenden vendbanime shqiptare dhe popullsi shqiptare që nuk gjendet kur dhe në ç'numur pat zbritur ajo

- jashtë vendbanimeve që dokumentet historike zbërthejnë çështjen.

Por duhet marrë në konsideratë dhe logjika që ky numur nuk është i vogël, vetëm për shek. XIV, kur principatat (shtetet) nuk kishin popullsi asnjëherë më te madhe sa dhjetra mijshe, dhe kur vetë Greqia mesjetare nuk kish ato kufij të zgjeruar që ka sot. Atëherë kish pak principata ku futej ajo e Morasë, Atike - Beotisë, Thesolia dhe Eusoja. Në këtë zonë të kufizuar numri minimum prej 150.000 ishte tepër i rëndësishëm. E shtrirë dhe e shumfishuar në shekuj deri sot demografit e vlerësojnë atë "mjaft të madhe". Një pjesë e kësaj popullsie me kalimin e shekujve dhe kryesisht dy shekujt e fundit, mbas konsolidimit të strukturave shtetërore është shpërndarë e asimiluar, një pjesë tjetër e saj është në këtë proces dhe në vorbullat e asimilimit, ndërsa masa më e madhe e vendosur në krahina e zona larg qendrave urbane vazhdon të ruajë gjuhën e të parëve të saj.

Studjues grekë të kësaj çështjeje thonë "Aq të shumtë Jane arvanitët në Greqi sa çdo gur që do të lëvizje që poshtë tij do të flitej shqip".

Ata janë shtrirë, punojnë, krijojnë dhe jetojnë në tërë qelizat e organizmit të këtij vendi. E megjithatë të veçnatën e tyre e dallon edhe sot në botën greke. Si në të kaluarën edhe tani arvanitet nuk i shikon të ushtrojnë apo të merren shumë me tregëti. Kryesisht ajo pjesë që banon në fshat apo qyteza të vogla merret me punë bujqësie apo blektori. Ndër profesionet, më të preferuarat përtë janë ato ku lipsen tiparet e qëndrueshmërisë, forcës së karakterit etj. Të shumtë ata janë e shërbejnë në aviacion, në ushtri dhe një numur jo i vogël në drejtësi. Në mentalitet e arvanitit por edhe të të tjera ështëpërpunuar me kohë koncepti se "Arvaniti ja i drejtë" (arvaniti është njeri i drejtë).

Në kohët moderne nga gjiri i kësaj popullsie kanë dalë personalitetet me emër në jetën dhe fushat e artit, kulturës, politikës, etj. Ndër ta renditen një numur i madh poetësh, aktorë, këngëtarë, piktorë, etj.

"Nga njerëzit më të njohur të letrave greke (arvanite), janë Aleksandër Pali - pseudonimi i tij ishte Lekë Arvaniti, - Sotir Skipi, Vasil Rota, Kakërdhiu, Vretakua, Bogri, Cifori, Mateshi, Thisbi, etj. Me orijinë arvanite është edhe gjizi i madh dhe shqipimi i vërtetë i mbiemrit të tij është Gjiza... (Gjiza është ndoshta piktori më i madh i rilindjes greke të shekullit të kaluar - shën.ynë.) Arvanit është edhe piktori tjetër i madh Dhoksaraj." Kontributi i tyre veç në këto fushave shtrihet edhe në ndërtimtari, një aspekt ky tepër interesant dhe fare i pastudjuar deri më sot. Më shumë interes do të ishte vëzhgimi i kësaj fushe veçanërisht në vendbanimet e hershme arvanite ku strukturat dhe arkitektura e mjeshtërve shqiptare na bie fakte interesante të asaj tradite ndërtimesh që tek ne e gjejmë edhe sot në Shqipërinë e Jugut dhe të Veriut. Për mjaft objekte të tjera që ruhen si monumente apo objekte me vlera arkitektonike, si kulla, objekte kulti, ura të harkuara, etj edhe sot thuhet apo ekzistojnë dokumente që janë ndërtuar nga mjeshtër shqiptarë apo arvanitë. Eshtë e pamundur të renditen këtu arvanitet e tjerë, personalitete të vërtetë të fushave të shkencës, politikës moderne, etj. Kjo do të ishte vërtet një ndërmarrje e madhe dhe tepër e vështirë.

Duke e parë me realizëm dhge me objektivitet historinë e mesjetës dhe atë moderne të Greqisë, çdokush do gjente dhe konkludonte natyrshëm se ajo eshtë pazgjidhshmërisht e pleksur në çdo ind të saj e qelizë me elementin vital-arvanitet. Kjo nuk i mohon aspak vlerat dhe pasurinë e madhe popullit dhe botës greke. Përkundrazi, ajo shpalos e rrit dhe më tej vlerat e këtij populli bujar, mikpritës dhe me kulturë. Krah për krah njëri tjetrit, elementi vendas dhe ai i ardhur bënë historinë e së kaluarës, bëjnë të sotmen dhe do të bëjnë të ardhmen.



Fig. 1





Fig. 2

Fig. 3



STEMA E FAMILJES SE MERKUR BUAS

Në flamurin e këtij princi janë renditur disa stema dhe simbole nga të cilat një pjesë i takojnë vetë derës së Buajve- që ata pretendonin se kish trashëgimi mbretërore-ndërsa të tjerat janë simbolet e flamujve mbretërorë që Merkur Bua i pat fituar me shërbimet e tij në fushat e betejave. Sipas renditjes ata janë:

1. Flamuri me sfondin e kuq dhe dy yje anash e një kryq në mes: Eshtë flamuri që u a kishte dhënë Buajve Mbreti Kostandin kur ata ishin nisur nga Roma për të pushtuar Kostandinopojën.

2. Flamuri që mban simbolin e një iriqi me kurorë mbretërore në kokë: Eshtë që Buas ja kishte dhuruar Mbreti i Francës Ludoviku i XII kur përfitoret e tij, mbreti i dha titullin Kont dhe e veshi ceremonialisht.

3. Flamuri që mban simbolin e dallgëve të detit: Eshtë simbol që fisi i Buajve e kish të tijën mbasi ai trashëgonte feudin bregdetar të quajtur Buena.

4. Flamuri me stemën e dorës qe mban katër gjarpërij: Eshtë flamuri dhe simbol që Buajt e trashëgonin si pasardhës së derës Mbretërore të Pirros së Epirit.

5. Flamuri që ka për stemë një dragua me kthetra (ne qendër) me sfond blu. Eshtë flamur që ja dhuroi Mbreti Maksimilian i Gjermanisë kur e veshi Kont të Lazit dhe Suaveve mbas fitoreve të tij të bujshme.

6. Flamuri me simbolin e shqiponjës nën një sfond të kaltër: Eshtë flamuri dhe stema që ai mbante si Princ trashëgimtar i principatës së Angjelokastrës e cila ka qënë përherë qëndër dhe trashëgimi e përhershme e Buajve.



Fig. 4

BIBLIOGRAFI LITERATURE E SHFRYTEZUAR

1. Jona Paidhusi: "Ta vilia tu qitherona qe ta arvanitika tragudhiatis". Athina 1980
2. Jorgjiu P. Kolia: "Arvanites paromies", Athina 1984
3. Apostolos E. Vacalopoulos: "History of Macedonia" (1354 - 1833) Institute for Balkan studies Thesaloniki 1973
4. Aristidhi Kolia: "Arvanites qe i ketagogji ton elinon", Athina 1985
5. Antonio Belusci: "Dizionario frazeologico degli Albanesi D'Italia e di Grecia." Cozenca 1989
6. L. Conti - O. Marquet: "Spirito regale nei custumi della donna 6. arbèreshe", 1988
7. Tasos Vurnas: "Ali Pasas Tepelenlis" Athina 1978
8. Edward Lear: "Journals of a landscape painter in Grece and Albania", London 1987 (First edd 1851)
9. Vivien Noakes: "Selected Letters", London 1990
10. Henry Holland: "Travels in the Jonian isles, Albania, Thesaly, Macedonia 1812 - 1813", London 1815
11. Akademia e shkencave - Instituti i Historise Republika e Shqiperise: "Dokumente te periudhes bizantine për Historinë e Shqipërisë" Tiranë 1978
12. Instituti i Folklorit: "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar" Vëllimi I-III, Tiranë 1961
13. Marin Barleti: "Rrethimi i Shkodrës", Tiranë 1982
14. Marin Barleti: "Historia e Skëndërbeut" - botimi i Instituti i Historisë, Tiranë 1967
15. Kostas I. Biri: "Arvanites - i dori tu neoteru elenizmu" Athina 1967

16. Kostandinos Satha: "Elines Stratioti en ti dhisi", Athina 1886
 "*Mnimia Eliniqis Istorias*", vëllimi 1-8
 "*Turkokratumeni ellas*"
 "*Elenika anekdhota*", Athina 1867
17. Konstandin Paparigopoulos: "Istoria tu eleniku ethnos", Enciklopedi, vëllimi 1-8, Athina 1925
18. Arthur Milchhofer: "Attica und seine heutigen bevochner", Edd. 1891
19. George Finlay: "A history of Greece from its conquest by the romans", London 1847
20. W Millingen: "Memories of the affairs of Greece", London 1831
21. Pierre Bellon: "Los observations de plusieurs... trouvec... en Grece . . .", Paris 1553
22. N. Ballas: "Istoria tu Krusovo", Thesalonika 1962.
23. Mihail Lambrnidhi: "I allvani kata tin qirios Elladha qe tin peloponision" en Athinai - 1907
24. William Miller: "Istoria tis Frangokratias en elladha" vëllimi 1, 2 . . . - 1897
25. Kersopoulos. I: "Chronologie Albanaise", Athina 1937
26. Xane Koroneos: "Bua Andhrahatimata", Athina 1868.
27. Amantou K.: "I vori gjitones tis Elladhas", Athina 1923
28. M. Camille Paganell: "Historie de Scandërbeg", edd. 1855
29. Pouqueville P.C.H.L.: "Voyage de la Grece", 2 -nd Edd, Vols 1-6, Paris 1826
30. Stepan Gerlach: "Tagebuch", Frankfurth am mayn, 1674
31. I. H. Pullu: "I epiqissis ton allvanon en korinthia" Athina 1922
- 32 Fazlli Syla: Seminar ndërkombe tar mbi gjuhën, Letërsinë dhe kulturën Shqipe. "Gjuha Shqipe", Nr. 7, 1982
33. Revista "Mpesa": Organ i shoqatës "Marko Bocari" të Arvanitëve të Greqisë; Nr. 1-27 Athina; 1994
34. Akademie shkencore - Instituti i Historisë: "Burime

tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë", Tiranë
1975

35. Golfredo Rugiero: "Saggi di canti Albanesi", Cozenca 1876
36. Alfio Moccia: "Zëri i Arbëreshëve", 1973
37. Cyprien Robert: "Les Slaves de Turquie", 1852
38. Jeronim De Rada: "Kënga e Sprasme e Balës", 1964
39. Akademia e shkencave, Instituti i Historisë: Përkthime të "Acta Albana-Veneta", Radoniq:
40. Vasilis Rafaïlidhis: "Zbritjet e shqiptarëve dhe roli i tyre në krijimin e shtetit Grek.", Gazeta "Ethnos" 17. 5. 1987
41. Stepan Antoljak: "Sultan Jahja u Makedonija", Libri 13, Nr. 5, Skopje 1962
42. Aleksandrë Matkovski: "The Haidutks", Skopje 1961
43. Vasdrevallis I. K.: "Arqeia Verjas - Nausis", Thesaloniki 1955
"Historia Arqeas Makedonias", Thesaloniki - 1960
"Armatoli qe kleftes", Thesaloniki 1952
44. Inglizis N. : "Ta armatolika qe o iros Nikocaras filladhion" Athena 1884
45. Christos Jovanis : "Enciklopedhia - Grecia History Folklore" Athens 1985, vëllimi 1-7
46. Sakellariu M.B. : "Greek land in history - Macedonia" Athenon S.A. 1983
47. Coriolano P. Cippico: "Della guerre de venezjani nell'asia dal 1470 - 1473", Venezia 1796
48. Leake, William Martin: "Travells In northern Greece", vollum 1-4, London 1835
"Researches in Greece", London 1814
49. Zihni Reso: "Anastas Kulurjoti dhe gazeta Zëri i Shqiptarëve" Tiranë 1981
50. George Finlay: "A history of Greece", vol 1-6, Oxford 1877
51. Marjane Guerzeli: "Collection of Greek costumes of the 19-th century", Athens 1989
52. Ludovigo da Porta: "Lettere storiche", Selec 1873